

STUDIME ORIENTALE

REVISTË SHKENCORE



2



Prishtinë
2002

2

STUDIME ORIENTALE

REVISTË SHKENCORE

*Chazmploz v Shokk
Fth*



2

Prishtinë
2002

**ASSOCIATION OF ORIENTALISTS OF KOSOVA
PRISHTINA**



ORIENTAL STUDY
Scientific magazine

Editorial board

Dr. Muhammed al-Arnauti, Amman

Dr. Gazmend Shpuza, Tirana

Dr. Irfan Morina, Prishtina

Dr. Bahtije Gërbeshi, Prishtina

Chief editor: Dr. Feti Mehdiu

Editorial secretary: Mr. Isa Memishi

SO	Vol. 2	1-286	Prishtina	2002
----	--------	-------	-----------	------

SC

**SHOQATA E ORIENTALISTËVE TË KOSOVËS
PRISHTINË**

**STUDIME ORIENTALE
Revistë shkencore**

Redaksia:

Dr. Muhammed al-Arnauti, Amman

Dr. Gazmend Shpuza, Tiranë

Dr. Irfan Morina, Prishtinë

Dr. Bahtije Gërbeshi, Prishtinë

Kryeredaktor: Dr. Feti Mehdiu

Sekretar i redaksisë: Mr. Isa Memishi

2002

SO	Vol. 2	1-286	Prishtinë	2002
----	--------	-------	-----------	------

Fjala jonë

STUDIMI

Nehat Kra
VASIJETN
of Mulla L

Dr. Abdull
TEMATIK
- The them

Dr. Shefik
NJË HAP

Dr. Feti M
PËRKTHL
Arabian pe

Nexhat Ibr
ISLAMI D
in Mediaev

Bashkim A
ARABËT F

Fabrizio P
JEMENI M
turismus in

Dr. Ismail
HUMANIZ
foundation

Dr. Gazme
PËRFYTY
- Geograph

Dr. Salih T
BETEJA E
The battle

Përmbajtja – Table of contents

<i>Fjala jonë</i>	9
STUDIME	13
<i>Nehat Krasniqi, Prishtinë</i>	
VASIJETNAMEJA E MULLA DERVISH PEJËS - "Vasijetnameja" <i>of Mulla Dervish Peja</i>	13
<i>Dr. Abdullah Hamiti, Prishtinë</i>	
TEMATIKA E MISTICIZMIT ISLAM NË POEZINË E BEJTEXHINJËVE <i>- The themes of Islam mysticism in the poetry of folk poets</i>	53
<i>Dr. Shefik Osmani, Tiranë</i>	
NJË HAP I RI DREJT ARTIT – MUHAMET ÇAMI - Muhamet Çami	65
<i>Dr. Feti Mehdii, Prishtinë</i>	
PËRKTHIME TË POEZISË ARABE NGA SIRIA DHE SUDANI - Translations of the Arabian poetry into Albanian language – Arabic poetry from Syria and Sudan	73
<i>Nexhat Ibrahimii, Prizren</i>	
ISLAMI DHE MUSLIMANËT NË BULLGARIN MESJETARE - Islam and Muslims in Mediaeval Bulgaria (IX-XI century)	89
<i>Bashkim Avdiu, Prishtinë</i>	
ARABËT PAS MUHAMMEDIT A.S. - Arabs in the period of Muhammed	107
<i>Fabrizio Poretti, Bern</i>	
JEMENI MUZE I GJALLË - Jemen an lebendes eine ethnologische analyse des turismus im Jemen	117
<i>Dr. Ismail Bardhi, Shkup</i>	
HUMANIZMI ISLAM – THEMEL PËR DIALOG NDËRFETAR - Islam Humanism – foundation for inter religious dialogue	135
<i>Dr. Gazmend Shpuza, Tiranë</i>	
PËRFYTYRIMI GJEOGRAFIK I SAMI FRASHËRIT PËR IRANIN E KOHËS SË TIJ <i>- Geographical imagination of Sami Frasheri of Iraq of his time</i>	143
<i>Dr. Salih Trako, Sarajevë</i>	
BETEJA E KOSOVËS E VITIT 1389 NË HISTORINË E IDRIS BITLISIT <i>The battle of Kosova in the history of Idris Bitlisi</i>	153

Dr. Divna Gjuriq-Zamoio, Beograd
 KONTRIBUT PËR NJOHJEN E XHAMIAVE TË BEOGRADIT - Beilage Zur
 Kenntnis von Belgrader Moscheen 177

Olsi Jazexhi, Tiranë
 ROLI I ALEANCËS PANORTODOKSE BALLKANIKE NË DIVORCIN E
 SHQIPTRËVE NGA PERANDORIA OSMANE - The role of the Pan orthodox
 Balkan Alliance in the divorce of Albanians by the Osman state 191

MATERIALE..... 203

Dr. Feti Mehdiu, Prishtinë
 HAFIZËT TANË GJATË HISTORISË 203

NË TRIDHJETËVJETORIN E ORIENTALISTIKËS SHQIPTARE
 (Bibliografia kronologjike e arsimitarëve të Degës Orientalistikës në Prishtinë:
 F. Mehdiu, I. Rexha, A. Hamiti, I. Memishi) 213

PORTRET 239

JOHN A. ARBERY, 1905-1969 (F. Mehdiu) 239

KRIKKA DHE RECENSIONE 245

Përzgjedhje në komentimin e Kur'anit Kerimit, 1-10, Tiranë, 1996-1998 përktheu
 H. Selim Stafa. Botoi Komiteti Musliman i Shqipërisë – Komiteti i Botës Islame
 (F. Mehdiu) 245

Hafiz Ismet Dibra, A ka dyshim në qenjen e Zotit? Albanian Islamic
 Centre, Harper Woods, Mich. 1993 (1413 h.) (F. Mehdiu) 247

Katalogu i dorëshkrimeve Osmane në arkivat e Shqipërisë...Ankara, 2001, (Dr. Sh.
 Osmani) 249

Muhamed Mufaku, Ath-thekafetu-l-albanijjetu fi-l-ebxhedijjeti-l-arabijjeti,
 Al-Kuvajt, 1983, pp.212. (I. Memishi) 251

Muhamed Mufaku, Shqiptarët në botën arabe, Prishtinë, 1990, fq. 180,
 (B. Gërbeshi) 255

Darko Tanasković, Islam i mi, Beograd, 2000, pp.194, Partenon,
 (E. Duraković) 262

Jashar Rexhepagiq, Dervishët, rendet dhe teqet në Kosovë, në Sanxhak e
 në rajonet tjera, Pejë, 1999, fq. 282, (Gj. Shehu) 261

Dr. S e l
 (A. Ham

E-L-D i j

Kronikë

- Profes

- Zyra A

- U mba,

- Ndërro

Dr. Selçuk Eraydin, <i>Tesavvufi dhe tarikati</i> , Tetovë, 2001 fq. 428, (A. Hamiti)	257
<i>E l-D i j a</i> , nr. 57, 1999, Dubaj (F. Mehdiu)	265
Kronikë	267
- Profesorë të Universitetit të Prishtinës anëtarë të Akademisë Arabe të Shkencave.	
- Zyra Amerikane ndihmon hulumtimet e dorëshkrimeve orientale.	
- U mbajt Kongresi i Orientalistëve në Aman.	
- Ndërroi jetë prof.dr. Muhammed Hamidullahu.	
..... 177	
..... 191	
..... 203	
..... 203	
inë:	
..... 213	
..... 239	
..... 239	
..... 245	
ërktheu Islame	
..... 245	
mic	
..... 247	
(Dr. Sh.	
..... 249	
arabijjete,	
..... 251	
q. 180,	
..... 255	
..... 262	
rixhak e	
..... 261	

Lex

Ker
min e ri u
parë në vi
lexues e b
dytë. Stud
Ballkanin
mi, arkiteh
misht do t
rimit të po

Kjo
për një per
risht shqip
me popujt
që kuadrat
për të kont
burimore e
periudha e

Revi
katëse, të c
lin e kanë
me numrin
core të bëh

Të v
ardhmëria
shoqërore,
profesional
kemi suks

Do t
hapim një c
më fuqishë
rit ng doku

Nga
orientalisti

FJALA JONË

Lexues të nderuar,

Keni në duar numrin e dytë të revistës Studime Orientale. Në mileniu-min e ri u plotësuan kushtet për një revistë sikur kjo, dhe kjo e bëri hapin e parë në vitin e parë të shekullit të ri dhe të mileniumit të ri. Me ndihmën tuaj, lexues e bashkëpunorë të çmuar, opinionit më të gjerë po i afrojmë numrin e dytë. Studimet Orientale do të vazhdojë të pasqyrojë lidhjet e orientit me Ballkanin nga të gjitha fushat e dijes: art, histori, fe, gjuhësi, letërsi, ekonomi, arkitekturë, etnologji, etnografi, urbanizëm etj. Me një fjalë, këtu vazhdimisht do të gjejnë vend studime nga të gjitha aspektet e kulturës dhe qytetërimin të popujve që kanë qenë në kontakt në këto hapësira.

Kjo revistë vazhdimisht do të hedhë dritë sa më shumë dhe burimisht për një periudhë gjashtë shekullore gjatë së cilës popujt e Ballkanit, veçanërisht shqiptarët dhe Boshnjakët, kanë këmbyer vlerat kulturore – qytetëruese me popujt e orientit. Në radhë të parë me arabët, turqit dhe persianët. Pritet që kuadrat e specializuara në fushat e caktuara të shfrytëzojnë këtë shansë për të kontribuar që kjo periudhë e historisë tonë të pasurohet me argumente burimore e me trajtesa të thelluara e origjinale për çeshtje konkrete, si nga periudha e kaluar ashtu edhe nga koha jonë.

Revista Studime Orientale, do t'i bashkojë tëra kuadrat e fushave përkatëse, të cilat kanë potencial dhe vullnet, gjithashtu kanë edhe kapital, të cilin e kanë vjelur gjatë punës së tyre, për të kontribuar, siç po dëshmohet edhe me numrin e dytë, pa asnjëfar dallimi. Vetëm me një qëllim: e vërteta shkencore të bëhet pronë e të gjithë studjuesve dhe dashamirëve të dijes.

Të vetëdijshëm se pa e njohur mirë të kaluarën nuk mund të ndërtohet ardhmëria stabile, shpresojmë dhe presim përkrahje nga të gjitha strukturat shoqërore, të organizuara në institucione hulumtuese shkencore, kulturore, profesionale, edukative, ekonomike, etj., pa të cilën përkrahje nuk mund të kemi suksesin e dëshiruar.

Do të jemi të lumtur nëse, me këtë përpjekje tonën modeste, arrijmë të hapim një dritare të re në historinë tonë prej nga drita e dijes do të shndërris më fuqishëm në faqet e historisë dhe do të kontribuojë në shkundjen e pluhurit ng dokumente të shumta që i referohen kësaj fushe.

Nga ky numër fillojmë shenimin e tridhjetvjetorit të punës së Degës së orientalistikës në Prishtinë, të cilin përvjetor shpresojmë ta shenojmë në

mënyrë të denjë në vitin 2004 me ndonjë tryezë a sesion shkencorë për zhvillimin dhe perspektivën e studimeve orientale në trojet tona.

Jemi të bindur thellësisht, dhe këtë bindje na e forcon përkrahja Juaj, se me ndihmë të Zotit do t'ia dalim të kryejmë obligimin tonë.
Me Zotin përpara drejt ardhmërisë!

Shtator 2002

ncorë për

rahja Juaj,

tator 2002

Studime

M
krijuar s
vjetrën p
harresës
mirënjoh
dhe publ
opinionit
për këtë
shkruar n
nga gurra
ka ruajtu
të mirë të
një atdhe
Efendi G
konsideru
me ca ga
Gjakovës
Deri tani
Mulla De
ruhet në F

¹ Perfaqësu
Dervish Pej
(rreth 1685-
letërsie, bas
Begiri, Muç
Haxhi Ed'he

² M u h a m
Në: Dituria

³ Këngë të dh
dhe Mulla
melodinë që
1988, e kemi

STUDIME

Nehat Krasniqi, Prishtinë

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

VASIJETNAMEJA E MULLA DERVISH PEJËS

Mulla Dervish Peja është poeti më i vjetër¹ shqiptarë nga Peja që ka krijuar shqip me alfabetin arabo-osman dhe autori nga i cili kemi më të vjetrën përmbledhje të plotë poezish që është ruajtur deri sot. Velin e harrësës nga figura Mulla Dervishit e hoqi gjurmuesi dhe studiuesi i mirënjohur i letërsisë shqipe me alfabet arab Muhamet Pirraku duke zbuluar dhe publikuar një poezi, respektivisht një ilahi, të tij dhe duke sjellë para opinionit shkencor informacionet e para për atë.² Të dhënat jetëshkrimore për këtë autor, sikundër dhe për shumicën e autorëve tanë të vjetër, që kanë shkruar me alfabetin arabo-osman, janë të mangëta. Ato kryesisht janë vjelë nga gurra e traditës gojore, traditë kjo që për figurën e Mulla Dervish Pejës ka ruajtur dhe ka përcjellë gjeneratë pas gjenerate kujtimet dhe imazhin më të mirë të një dijetari të urtë, të një udhëheqësi shpirtëror të përkryer dhe të një atdhetari të palëkundur. Mulla Dervish Peja dhe kolegu i tij më i ri Tahir Efendi Gjakova, sipas traditës sonë gojore, në qarqe të caktuara, janë konsideruar madje, të shenjtë. Ilahija e Mulla Dervish Pejës, që është botuar me ca gabime nga Pirraku, ishte aq në zë sa që në minaret e xhamive të Gjakovës ajo këndohej, si sall, për të kumtuar vdekjen e ndonjë personi.³ Deri tani nuk janë gjetur dëshmi për datëlindjen dhe as për datëvdekjen e Mulla Dervish Pejës. Por, një vepër në dorëshkrim, nga fusha e logjikës, që ruhet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ofron të dhëna

¹ Përfaqësuesit më kryesorë të letërsisë shqipe me alfabet arab, që kanë jetuar para Mulla Dervish Pejës, janë: Mulla Hysejn Shkodra (rreth 1660 - 1737), Ibrahim "Nezim" Frakulla (rreth 1685-1760) dhe Sylejman Naibi (vd. 1772). Ndërkaq, autorët më të shquar të kësaj letërsie, bashkëkohës të Mulla Dervishit, janë: Mulla Salih Pata, Mulla Hysejn Dobraqi, Mulla Beqiri, Muçë Libohova, Elmaz Boriçi, Hasan Zyko Kamberi, Muhamet Kyçyku (1784-1844), Haxhi Ed'hem bej Tirana (1783-1848), Zenel Bastari, Tahir efendi Gjakova e tjerë.

² M u h a m e t P i r r a k u, Gjurmë të vepërimit të letërsisë shqipe me alfabet arab në Kosovë, Në: Dituria 1-2, Prishtinë, 1978, f. 98-99.

³ Këtë të dhënë gojore e kemi nga dy hoxhallarë të nderuar të Pejës, Mulla Muhamed Gashi dhe Mulla Muhamed Islami të cilët patën mirësinë ta këndonin përmang këtë ilahi me melodinë që e kishin dëgjuar si nxënës në Gjakovë. Këtë ilahi të kënduar prej tyre, në vitin 1988, e kemi të ruajtur në një shirit kasetofoni.

me interes lidhur me përkufizimin dhe përcaktimin e kohës, kur ka jetuar, respektivisht, kur ka vepruar autori ynë.⁴ Këtë vepër në dorëshkrim e ka kopjuar vetë Mulla Dervish Peja në vitin 1220 hixhrij (1805) Kështu që viti 1805 është vit i veprimtarisë intelektuale të Mulla Dervish Pejës dhe mund të shërbejë si dëshmi, sot për sot, e vetme pikëmbështetëse, për ta përkufizuar kohën kur ka jetuar ai. Në këtë dorëshkrim Dervish Peja para emrit të vet ka vënë titullin "Mulla" gjë që është një tregues i moshës dhe i karrierës së tij të konsiderueshme. Nisur nga parametra realë, siç janë: kohëzgjatja e studimeve, moshë mesatare e të diplomuarve, përvoja e nevojshme për të fituar këtë titull atë kohë, si dhe kopjimi i kësaj vepre në Pejë, pas mbarimit të studimeve, arrijmë në përfundim se, në vitin 1805 Mulla Dervish Peja ka qenë në moshën 35 - 40 vjeçare. Rrjedhimisht, ai është lindur brënda viteve 1765 - 1770. I ati i Mulla Dervishit quhej Mustafa, gjyshi Hysejn ndërsa stërgjyshi Muhamed.⁵ Dëshmi tjera të shkruara për jetën e Mulla Dervishit nuk janë gjetur. Nuk është ruajtur poashtu as nishani (mbishkrimi) mbi varrin e këtij shkrimtari, nga do të mësonim, të paktën, vitin e vdekjes së tij. Ndërkaq, nga tradita gojore merret vesh se Mulla Dervishi ka përjetuar pleqëri të thellë duke arritur rreth të njëqintës.

Mulla Dervish Peja krijimtarinë e letrare e nisi në kohën e lëvizjeve dhe përpjekjeve të fuqishme të popullit shqiptar nën udhëheqjen e pinjollëve feudalë vendës, për pavarësim nga Porta e Lartë, duke filluar nga Pashallëku i Shkodrës dhe duke përfshirë pothuaj tërë Shqipërinë etnike. Ajo ishte kohë e intensifikimit të marrëdhënieve ekonomike tregtare me Evropën që rezultoi, jo vetëm me paraqitjen e një cilësie të re në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit, por edhe me përhapjen e ideve të reja evropiane, jehona e të cilave trazoi ndërgjegjen shqiptare.

⁴ Dorëshkrimi ruhet në Sektorin e Koleksioneve Speciale, koleksioni Hasan Efendi Nahi, nr.3. Dorëshkrimi është në gjuhën arabe, mban titullin: "Sejjid Sherif alâ Tasavvurât" dhe është koment i Sejjid Sherif Ali b. Muhammed b. Ali el-Xhurxhâni (740 H./ 1340 - 816 H./ 1413) mbi veprën me titull: Tasavvurât ("Perfytirime") të autorit Kudb'ud-dîn Muhammed b. Muhammed er-Râzi el-Tahtâni (vd. 766 H./ 1364). Dorëshkrimi numron 74 fl. Me dimensionet 15.5 x 21.5 cm.

⁵ Nga kollofoni i veprës së larzëpërmendur në dorëshkrim, kopjuar nga Mulla Dervish Peja, fl. 74 b.

V
gjuhën s
quhet "I
dhe hiq
parë. M
është m
Kosovë.
Është një
gjërë në)
Gj
Por, asnj
fshati Kr
Bajram J
personale
Doli. Ko
Gjakovë.
Pejës nëp
veprën "M
Maliqit n
Mulla De
Për
ndonse i k
të kopjeve
tretën me
Kop
cm. Kjo p
ilahi të ci
veprës, be

⁶ Fjala Vasi
ndërsa emri

⁷ Shih shenit

⁸ Na ka sjell

⁹ Bajram Jus
me alfabet a
mësimdhënë
është ruajtur
ajo e Mulla I
dorëshkrimet
gjindet ndon
koleksione të
fjalës së shk

VEPRA

Vepra e **Mulla Dervish Pejës** mban emrin **Vasijetname**⁶ që në gjuhën shqipe do të thotë porosi, testament i shkruar, kushtimisht mund të quhet "**Libër testament**". Kjo vepër ka qenë e panjohur për letërsinë tonë dhe hiq poezinë e fundit të sajë që mban titullin **Ilahi**⁷, po botohet për herë të parë. Mbështetur në rezultatet e publikuara kërkimore shkencore, kjo vepër është më e moçmja përmbledhje poezish shqipe me shkrim arab e krijuar në Kosovë. Si e tillë, kjo vepër paraqet interes historiko – letrar e gjuhësor. Është një dëshmi me vlerë të veçantë dialektore për të folmen e Pejës dhe më gjërë në fillimshkullin XIX.

Gjer më tani kemi gjetur katër kopje të ndryshme të **Vasijetnames**. Por, asnjëra prej tyre nuk është autograf. Kopja e parë na ka ardhur nga fshati Krilevë⁸. Kopjen e dytë e kemi gjetur në Gjakovë, e ka kopjuar Bajram Jusuf Doli⁹. Kopja e tretë është gjetur në Shtimje në Bibliotekën personale të Mulla Hamdi Dautit, të cilën poashtu e ka kopjuar Bajram Doli. Kopjen e katërt e kemi gjetur në Teqen e Sheh Reshatit (Saadi) në Gjakovë. Përveç këtyre kopjeve, kemi gjetur fragmente nga vepra e Dervish Pejës nëpër biblioteka speciale dhe personale, gjithandej nëpër Kosovë. Në veprën "**Mefhumi iz'harit i Imam Birgjevisë n'guh shqip**", të Sheh Hilmi Maliqit nga Rahoveci, shkruar në vitin 1909, fl. 11b, gjenden disa bejte të Mulla Dervishit.

Për transkriptimin e **Vasijetnames**, kopje bazë kemi marrë të parën, ndonse i kemi konsultuar që të katërtat. Për nevoja praktike dhe të krahasimit të kopjeve, ato i kemi shenjuar: Kopjen e parë me A, të dytën me B, të tretën me C dhe të katërtën me D.

Kopja A ka 8 fletë, respektivisht 14 faqe tekst të formatit 14,5 × 21 cm. Kjo përmbledhje ka pesë poezi të titulluara **Nasihahat** "këshillë" dhe një **ilahi** të cilat kanë 258 distike. Në këtë numër nuk janë përfshirë titulli i veprës, besmeleja, hamdeleja dhe salveleja respektivisht vargjet invokeuese.

⁶ Fjala Vasijetname është kompozitë. Emri i parë vasijja është arab dhe don të thotë testament, ndërsa emri i dytë nâme është persian dhe don të thotë libër.

⁷ Shih shënimin 24.

⁸ Na ka sjellur z. Hamdi ef. Morina, për çka i falenderohemi.

⁹ Bajram Jusuf Doli (1833-1917) është personi më meritorë për ruajtjen e shkrimeve shqipe me alfabet arab-osman. Ishte libërlidhës (muxhelit) kopjues i palodhshëm dorëshkrimesh dhe mësimdhënës. Pothuaj e tërë krijimtaria e autorëve kosovarë që kanë shkruar me alfabet arab është ruajtur falë kopjeve që janë shkruar nga dora e tij. Poezitë e botuara nga M. Piraku, si ajo e Mulla Beqirit, e Mulla Dervishit dhe të tjera, janë kopjuar nga Doli. Vëglat për lidhjen e dorëshkrimeve dhe të librave i ka ndërtuar nga druri. Nuk ka qytet në Kosovë që nuk mund të gjindet ndonjë dorëshkrimi tij. Mund të themi se mbi njëqind dorëshkrime që ruhen nëpër koleksione të ndryshme në Kosovë janë kopjuar dhe janë lidhur nga ky dashamir i madh i fjalës së shkruar.

Kjo kopje është shkruar me shkrimin e quajtur Nes'h. Titulli i dorëshkrimit, titujt e poezive dhe cezurat janë shkruar me ngjyrë të kuqe, për t'u dalluar nga poezitë të cilat janë shkruar me ngjyrë të zezë. Letra është prodhuar në Toscolano të Lombardisë, në Vitin 1805-1806¹⁰, gjë që vërteton filigrani respektivisht shenja e prodhimit e cila është e shtypur në fl. 3 dhe fl. 5 të këtij dorëshkrimi. Meqë dorëshkrimi A nuk është datuar dhe deri sot nuk është gjetur autografi i **Vasijetnames**, vjetërsia e letres mbetet si dëshmi e qëndrueshme orientuese për përcaktimin e vjetërsisë së kësaj vepre. Mbështetur në këtë, mund të themi se **Vasijetnameja** e Mulla Dervish Pejës është shkruar brenda viteve 1805 – 1810.

Rreth përmbajtjes së **Vasijetnames**, gjuhës dhe vjershërimit të saj, nuk po ndalemi këtë herë, meqë qëllimi ynë është që kjo vepër të botohet e plotë, e riprodhuar me transkriptim dhe me skanim, duke ofruar jo vetëm mundësi verifikimi empirik të punës së kryer, por edhe mundësi reale për vazhdimin e punës së mëtejshme nga kushdo që dëshiron.

Në transkriptim kemi përdorur edhe shenja të zgjatimit të disa zanoreve. Nuk jemi të sigurt se këtë e kemi bërë në mënyrën më të mirë. Zanoret e gjata i kemi shenjuar jo vetëm të rastet kur ato shprehin gjatësinë kompenzatore, por edhe atëherë kur zgjatimi i gabuar dhe i pa vend i ndonjë rrokjeje do të ndërronte kuptimin e fjalës gjatë leximit.

Në fund kemi dhënë një tabelë në të cilën pasqyrohen ndryshimet në mes kopjeve gjë që, besojmë, është me interes për studiuesit e ardhshëm të kësaj vepre.

¹⁰ Sipas: Georg Eineder, *Monumenta chartae papyraceae historiam illustrantia*, Holland, MCMLX, si njësia nr 1037, 1038.

shkrimit,
u dalluar
odhuar në
filigrani
fl. 5 të
i sot nuk
dëshmi e
aj veprë.
vish Pejës

nit të saj,
botohet e
jo vetëm
reale për

t të disa
të mirë.
gjatësinë
d i ndonjë

shimet në
hshëm të

هَذَا كِتَابٌ مِنْ صِفَاتِهِ
 مَلَاوَرُوشِ بِدِيهِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ وَصَلَّى اللَّهُ عَلَى سَيِّدِنَا
 وَنَبِيِّنَا مُحَمَّدٍ وَآلِهِ وَصَحْبِهِ أَجْمَعِينَ
 مَنْ دَبَّيْهِمْ تَبَاؤُنْدِيسٍ قِتْ نَصِيحَتِ أَهْمُ نَيْسِ
 كِتْ سَا تَوْرَقِ أَهْمُ قَيْسِ رَحْمَتِ إِهْوَفَتِ بِرْ كَمُونِ
 لَو مَتْنَا بِرْ بِرْ نَدِيَتِ نَا فَا إِلَى مَا تَمِيرُكَ دِيَتِ
 أَيْ رَوْبِ بِرْ حَقِّكَ تَارِيَنِ دِي يَكْ نَجَّتِ بِرْ كَمُونِ
 إِمَارِي كِتْ بِرْ مَبْرُوتِ مُحَمَّدِ وَتِ رَحْمَتِ
 وَهَوْتِ نَابُوتِ أُمَّتِ حَمْدِ هَوْتِ بِرْ شِ كَمُونِ
 دِي يَا شُكْرُكَ نَهْتِ يَا مَبْرُوتِ رَوْلَتِ
 مَا يَمِيَا نِ تَمْحَمْدِ نَجَّتِ هِي بِرْ كَمُونِ

بِرْ دِي يَا

1b/HAD

4

8

12

16

¹¹ "Ky është L

¹² a Falënderis
pejgamberin t

¹³ nasihat (ar.)

¹⁴ Gjysëmvarg

¹⁵ rahmet (ar.)

¹⁶ din (ar.) fe.

¹⁷ hak (ar.) i.e.

¹⁸ xhen-net (ar.)

¹⁹ Pejgamber (r

²⁰ Um-met (ar.)

²¹ Hamd (ar.) p

²² Shyqër (ar.)

²³ Ni'met (ar.)

²⁴ Devlet (ar.)

TRANSKRIPTIMI I VASIJETNAMES

1b/HADHA KITABI VASIJ-JETNAME-I MULLA DERVISH PEJA ¹¹

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM
EL-HAMDU LIL-LAHI RAB-BIL'ÁLEMÎN
VE SAL-L-ALL-LLAHU 'ALÁ SEJ-JIDINÁ
VE NEBIJ-JINÁ MUHAM-MEDIN VE ÁLIHI
VE SAHBIHI EXHME'ÍN ^{11a}

- 4 Me ndihëm t'Perendís // Kët nasihat ¹² e kom nís
Gjith së turki e turkís ¹³ // Rahmet ¹⁴ i kôft përgjithmôn.
- 8 Lúmt na për Perendín // Na fali má t' mírin dín ¹⁵
Aj rob për hak ¹⁶ qi ta dín // Dije n'xhennet ¹⁷ përgjithmôn.
- 12 I madhi gjíth peygambervet ¹⁸ // Muhamedi vet rahmet
Zoti na boni ymmet ¹⁹ // Hamd ²⁰ i kôft prej nesh gjithmôn.
- 16 Dija shyqrin ²¹ ni'metit ²² // Ja mbrine devletit ²³
Me imán t'Muhamedit // N'xhennet hi përgjithmôn.

¹¹ "Ky është Libër i testamentit të Mulla Dervish Pejës."

^{11a} Falënderimi është për Allahun, zot i gjithë botrave. Allahu e bekoftë zotriun dhe peygamberin tonë Muhammed, familjen e tij dhe të gjithë shokët e tij."

¹² nasihat (ar.) këshillë.

¹³ Gjysëmvargun: Gjith sa turki e turkísë, kupto: Gjithë sa muslimani e muslimaneje.

¹⁴ rahmet (ar.) mëshirë.

¹⁵ dín (ar.) fe..

¹⁶ hak (ar.) i.e vërtetë.

¹⁷ xhen-net (ar.) parajsë; kopsht.

¹⁸ Peygamber (pers.) lajmëtar, i dërguar i Zotit.

¹⁹ Uj-met (ar.) komunitet.

²⁰ Hamd (ar.) përnderim.

²¹ Shyqër (ar.) falenderim.

²² Ni'met (ar.) begati.

²³ Devlet (ar.) fat, mirëqenie; shtet. (Ketu: mirëqenie).

پرندييا اور زندهي آيکه يان منداندي قوي
 پرفيهه کتابت شقوي وند اي حجت کتون
 ميا اوداک پيغمبرت فرض او اجب سنت
 مستحب همداي بيت موسيوي استياش کتون
 مکتمو کو نشفاعتک قوشيا بون طاعتک
 افتموي سلامتک اکت جنتک پر کتون
 موسي پنه کناهن ابيا مفضب اللهک
 ايذنون رسول اللهک قهر ايزهت اوشت کتون
 نکند بسن ذبيت هدر تنبيه قايون قرانت
 فرجه پرندي بنا بهتر اور داي مومبا کتون
 ملا درو نيش قيه مند موسي استياش کتون
 قيود نيا مين اشقون زند آخرت اوشت کتون

- ²⁴ kitab (ar)
- ²⁵ farz (ar)
- ²⁶ vaxhib (ar)
- ²⁷ sun-net
- ²⁸ mustehe
- ²⁹ edeb (ar)
- ³⁰ shkronja
- ³¹ shefa-cat
- ³² ta-cat (ar)
- ³³ selamet
- ³⁴ gjynah (ar)
- ³⁵ gadab (ar)
- ³⁶ Resulull
- ³⁷ kahr (ar)
- ³⁸ tenbih (o)
- ³⁹ Kjo fjale
- ⁴⁰ uzdaj (sl)
- ⁴¹ dunja (ar)
- ⁴² ahiret (ar)

2a/

- 4 Perendija urdhnoj // Aj qi pat mend e ndigoj
Për fije Qitapit ²⁴ shkoj //Vendi i tij xhennet gjithmôn.
- 8 Mba udhën Pejgamberit // Farze ²⁵ e vaxhib ²⁶ synnetit ²⁷
Mystehab ²⁸ hem edebit ²⁹ // Mos ju dáj se t'jesh gjithmôn.
- 12 Me qektō gjō(n) ³⁰ shefáatin ³¹ // Kush ja boni táatin ³²
E fitoj selametin ³³ // Gjet xhennetin përgjithmôn.
- 16 Mos e puno gjynahin ³⁴ // E bje m'gazap ³⁵ Allahin
Idhnon Resulullahin ³⁶ // Kahri ³⁷ i Zotit ôsht gjithmôn.
- 20 Niqind e pesdhijet hér // Tenbih ³⁸ ka bō n'Kur'an
Frigu Perendís ³⁹ përhér // Uzdáj ⁴⁰ m'to mba gjithmôn.
- 24 **Mulla Dervish** kije mend // Mos tet'mashtron kurni send
Kjo dynjá ⁴¹ vjen e shkon rend // Āhireti ⁴² ôsht gjithmôn.

²⁴ kitab (ar.) libër

²⁵ farz (ar.) urdhër i Zotit që përmes Kur'anit i obligon besimtarët ta zbatojnë,

²⁶ vaxhib (ar.) detyrë, obligim

²⁷ sun-net (ar.) traditë.(Gjithë ç'ka thënë, punuar dhe pëlqyar pejgamberi Muhamed).

²⁸ mustehab (ar.) vepër e dëshiruar (sipas të Drejtës Islame).

²⁹ edeb (ar.) edukatë.

³⁰ shkronja n është shkruar nga një dorë tjetër.

³¹ shefa<at (ar.) ndërmjetësim; angazhim.

³² ta<at (ar.) adhurim. Në fillim të kësaj fjale një dorë tjetër ka shtuar shkronjën l.

³³ selamet (ar.) shpëtim .

³⁴ gjynah (pers.) mëkat.

³⁵ gadab (ar.) hidhërim .

³⁶ Resulull-llah (ar.) I dërguari i Zotit.

³⁷ kahr (ar.)mërzi, vuajtje.

³⁸ tenbih (ar.) vërejtje.

³⁹ Kjo fjalë gabimisht është shkruar; Perendin.

⁴⁰ uzdaj (slav.) mbështetje, shpresë.

⁴¹ dunja (ar.) bota , kjo botë.

⁴² ahiret (ar.) bota tjetër.

26

نیکبختی

چیله سونک ای دلی مجته ن توت
 مؤس قلمور قوندک مپا مانلیغ سوت
 خلقت ایشته بیقصور و ای تی نعب
 پوز روست سچ و ای تی مقکور نوقیانی
 اینکه مریش و هتتا انی زوتک ای
 نات ادت جالشیت مؤسرت انک نفای
 با خصوص نفاقیت ایقادا زوتون
 صونیا امر قوی صونتا امر قوش مؤمبوتون
 بیون نوکل لوطیور زوتت بتدیمن
 صونتا بیون خصمی ندیره پوز کون

دیه

43 "Këshilla

44 deli (turq

45 mexhuar

46 halk (ar.

47 kusur (ar.

48 çallshit (t

49 ba- husus

50 nafaka (ar

51 tevek-kul

52 hasini (ar

53 dher-re (t

2b/

Nasîhati uhrá⁴³

3 Çile synin, ej deli⁴⁴ mexhnûn,⁴⁵ ti vet,
Mos kqyr kôndin me pa ma t'lig se vet!

Halkit⁴⁶ i sheh ni kusûr,⁴⁷ vëti nimi,
Porosit te çvëti me kqyr nuk jemi.

6 Aj qi mer vesh vehten, e di Zotin aj,
Nat e dit çallshit⁴⁸ me mos ranën n'faj.

9 Bá-hustis⁴⁹ nafakët⁵⁰ i ka dá Zotyn,
S'un ja mer kúj , s'un ta mer kush, me u mbýton

Bon tevekkyl,⁵¹ lutju Zotit, të ndimon,
S'un ta bon hasmi⁵² ni zerre⁵³ por gjimon.

⁴³ "Këshilla tjetër".

⁴⁴ deli (turq.) çapkën, kapadai.

⁴⁵ mexhnun (ar.) i marrë.

⁴⁶ halk (ar.) popull; krijesë. Këtu: tjetërkuj.

⁴⁷ kusur (ar.) e metë , lëshim.

⁴⁸ çallshit (turq.) puno.

⁴⁹ ba- husus (pers.) posaçërisht.

⁵⁰ nafaka (ar.) fat; të mira të jetës që i përkasin njeriut

⁵¹ tevek-kul (ar.) mbështetje në Zotin.

⁵² hasmi (ar.) armiku.

⁵³ dher-re (ar.) grimcë,atom.

دِيَّيْهِ وَنِيَانِ اَوْشْتِ زِ وَاللَّهِ شَهْ مَسُوهُ
 كَثِ شَفَا هُوَيْتِ بُوَزْ عَمَلِي وَرَيْنِ مَسُوهُ
 دِيَّيْهِ اَلِيْفَا تَلِيْقِكْ اَقَا جَزْءَا
 مَبُوْتَا نَفْسِيْكَ سَا سْتَقَا مَبُوْتَا بُوْنِ غَزِي
 نَقُو سِنْدِ نَفْسِيْكَ كِه بُوْنِ صُلْحِ اسْتِنْفَاكْ
 يَا قَدْ وَهْ تَابَتْ اَسِيْشْ اَنْوَا يَا تَبِيْرَتْ
 اِنْ هُوَ لَوْ فِتْكَ مَوْسِدَايْ بِرِ هَرِ مَدْرِيْكَ
 شَرِيْكَ اَقَا دِيْكَ مَا تَمَا دِ نِيَا رِيْ اِيْقَاكْ
 بِرِ سَكُوْفِيْ تَا هِنْدِيْ وَوَتِ سَبِيْرَتْ
 بِرِ بِيَا رِيْ مَسُوْ اَنْيْ شَهْ سَكُوْشِ تَبِيْرَتْ
 اِيْمِيْ شُوْكَتِ قَلْكَ اَوْ كَرِيْكَ سَمْعَا اِلَاخْ
 دَا شْتَهْ دُنْيَا اَوْ بُوْنِ بِرِيْ كُنْ اِحْتِيَاخْ

54 zevale (ar.) fu

55 amel (ar.) pun

56 xheza (ar.) shp

57 nefis (ar.) epsi

58 gaza (ar.) lufta

59 sulh (ar.) pajti

60 sherr (ar.) e (i)

61 ilaxh (ar.) bar

62 ihtijaxh (ar.) i

3a/

Dije dynjān, ôsht zevale,⁵⁴ shih me sý,
Gjithshka hupet por ameli⁵⁵ vjen me tý.

3 Dije e liga të ligën e ka xhezá⁵⁶
Mbyte nefsin⁵⁷ sa s'të ka mbyt bon gazá⁵⁸

6 Nuk ô send nefsi qi bon sulh⁵⁹ e s'të nget,
Ja ti do ta presish ato ja të pret.

Edhe luftën mos e dāj përher me dreq,
Sherrin⁶⁰ e ka, dije, ma t'madh njeri i keq.

9 Për s'gjóni tehin limo vet, s'të pret,
Po bjeri m'sý, ani shih se qysh të pret.

12 Iki shoqit keq, ô gjerpën s'ka iláç⁶¹,
Dashte dynjā, u bone por qen ihtijáç⁶².

⁵⁴ zevale (ar.) fund, shkatërrim; mundim.

⁵⁵ amel (ar.) punë, këtu: vepër e mirë.

⁵⁶ xheza (ar.) shpëgim.

⁵⁷ nefis (ar.) epsh; shpirt.

⁵⁸ gaza (ar.) luftë.

⁵⁹ sulh (ar.) pajtim, qetësim.

⁶⁰ sherr (ar.) e (i) keqe.

⁶¹ ilaxh (ar.) bar sheruex.

⁶² ihtijaxh (ar.) i nevojshëm për diç.

يَا لَئِذَا كُنَّا تُرَابًا فَيُعْثَبُونَ
 نَشْرِي كَقَمُونَةٍ جُلِي سَوْتٌ سَسْتَوْتٌ
 زُوتٌ مِمَّا زُنْتَوْتٌ نَأْسٌ لَوْ جَسْنَا
 يَا لَئِذَا مَدَدْنَا رَأْسَنَا كَمَا
 مَبَسْنَا فِدْنِيَا سَعُونَ مَمْنٌ مَوْسِرٌ
 كَأَشْوَقِيَّةٍ بِرَأْسِنَا زُوتٌ بِرَأْسِنَا
 دِي زَبَانِيَّتِ أَنْوَاحِ صِرْمَرِيْنِ دِي
 بِيَا سَقِيَّةٍ نِيَا سِي بِيْنِي بِلَهْ
 امْرِيْنِ أَنْوَاحِ رُوْمِ اِبْرِيْتِ
 شَتَانْدِيْمِي مِيْطِيْمِي نَجْمِيْمِي
 يَا لَئِذَا كُنَّا تُرَابًا فَيُعْثَبُونَ
 دِي بِيْنِي اِيْمَانِي رُوْمِي دِي رَمَانِي اِيْمَانِي

نتیجہ

3.b/

3

6

9

12

⁶³ Në dorësh.⁶⁴ hisab (ar.)⁶⁵ xhevab (ar.)⁶⁶ memqyn (t)⁶⁷ zebani (ar.)⁶⁸ hazur (ar.)⁶⁹ divan (pers.)⁷⁰ jyn (turq.)⁷¹ eme (ar.) u⁷² topuz (turq.)

me dorzë dru

⁷³ xhehen-ner⁷⁴ çare (pers.)⁷⁵ derman (pe

3.b/

Djali e gjôja ô dynjë qi t'huton,
Sherri qektyne çili sýt se t'shiron⁶³.

3 Zoti me Madhni t'vet nés lyp hesáp⁶⁴,
Bâje menden para Tij qysh ep xheváp⁶⁵.

6 Mbasi m'dynjë s'u kôn memqyn⁶⁶ mos árdh,
Qashtu kije para Zotit për me árdh.

Djÿ zebānit⁶⁷ atō hazēr⁶⁸ rrin divōn⁶⁹,
Bjeshkët e dynjās jyni - pluhën⁷⁰ i bōn .

9 Emrin⁷¹ e Zotit aty ruve e pret,
Shtatdhejmi mej'tapuz⁷² n'xhehnem⁷³ i qet.

12 Djali e gjôja u djÿt çare⁷⁴ s'i bōn,
Dini imāni robit derman⁷⁵ i bōn.

⁶³ Në dorëshkrim është: t'siton

⁶⁴ hesab (ar.) llogari.

⁶⁵ xhevab (ar.) përgjigje.

⁶⁶ memqyn (turq. nga: mumkin ar.) mundësi.

⁶⁷ zebani (ar.) gjarpër; engjëll që ka për detyrë t'i hudh në ferr të denuarit; grua shpirtligë.

⁶⁸ hazur (ar.) i gatshëm.

⁶⁹ divan (pers.) përmbledhje; tubim, kuvend.

⁷⁰ jyn (turq.) lesh (jyni-pluhën = pluhur leshi)

⁷¹ emr (ar.) urdhër.

⁷² topuz (turq.) topuz (mjet lufte, fillimisht shkop me xhungë në njërin anë, pastaj top hekuri me dorzë druri dhe hekuri).

⁷³ xhehen-nem (ar.) ferr.

⁷⁴ çare (pers.) zgjidhje problemi.

⁷⁵ derman (pers.) shërim, shpëtim.

زَرَعٌ أَمِيرًا لِيَفَانَهُ قَفْرًا شَيْتٌ ۝
 زُرِّيُوجِنَّتِكَ مَدْنِيَا مَوْسَرِ شَيْتٌ ۝
 بِرِيحِي كُنَاهِتِ فَوْزِ قَلَايِ مَبُونِ زُرِّيِمِ ۝
 قَوْنَدِرَةٌ جَهَنَّمِ زُرِّيُوجِنَّتِ اسْرُفَرِيِمِ ۝
 مَا يَلْتَمِسُ مَوْنَدِيِمِ جَهَنَّمِ وَلَهُنَّ تَرُوشٌ ۝
 يَهُزُّ سَوْنَشِي شَيْبَهَهُ سَكُهُشُ وَلَهُنَّ نَبُوشٌ ۝
 فَهَرِكُ اَزْرُوتِ اَبَانِ قَدَلٍ وَجُودِ ۝
 اَمْرِيِنَهْ قِي جَالِشِي اَبِيَا رَهْ مَوْجُودِ ۝
 اَيْلَهْ لَهْ رِضَانَهْ تَنْزُوتِ نَبِيَهْ فَيُوقِ ۝
 زُرِّيُوجِنَّتِ تَوْفِيْقِكَ نَوْعِ نَابُوقِ رِغِيوقِ ۝
 هَكَتْ هَرَهْ جَالِشِي مَسَارِدِ يُونَايِ مَرِيَتِ ۝
 اِنْدِيِمَكُونِ زُرِّيُوجِنَّتِ كَرِيِمِي مَسْدَرِيَتِ ۝

3

6

9

12

76 greshit (s)

77 vuxhud (ar)

78 mevaxhud (ar)

79 riza (ar.) ko

80 tevlik (ar.)

81 refik (ar.)

82 kerim (ar.)

4a/

- Zerre e mîr a e liga nuk greshit ⁷⁶,
 Ruju xhenetin me dynjë mos e shit!
- 3 Prej gjynahit for kallaj me bô durim,
 Kundra xhehnemit z' durohet as ni grîm.
- 6 Ma'j'leti mundim n' xhehnem vlon trûsh,
 Porsi vegshi shihe se qysh vlon n' prush .
- Kahrin e Zotit e bā(n) nuk del vuxhûd ⁷⁷,
 Emrin e Tij çallshit e bjere mevxhûd ⁷⁸.
- 9 Aj qi le rizân ⁷⁹ e Tënzot dije fîk,
 Zoti tevîkin ⁸⁰ néve na bôft refîk ⁸¹
- 12 Gjithhere çallshit me t'ârdh puna dréjt,
 I ndimôn robit Kerimi ⁸² me t' dréjt.

⁷⁶ greshit (sllav.) gabon.

⁷⁷ vuxhûd (ar.) trup, organizëm , qenje, ekzistencë.

⁷⁸ mevxhûd (ar.) prezent.

⁷⁹ riza (ar.) kënaqësi.

⁸⁰ tevîk (ar.) ndihmë, përkrahje.

⁸¹ refîk (ar.) shok.

⁸² kerim (ar.) fisnik. (Mendohet në Zotin.)

٤٤

رُوبِ اَوْشْتِ مَأْمُورِ مَبْرُجِ قَانِ تَوْتِ زُونِ
 اَيِ اَدْنِيَسَهْ قُوْنِ كَالِكِ يَأَقُوْ مَبُوْتُوْنِ
 مُلُوْنِ رُوْبِيْشِيْ بِاِجَارَهْ غَرِيْبِ
 رَحْمَتِكْ تُوْنْدُ زُونِ مَانِ بُوْنِيَا غَرِيْبِ

مَنْصُومَهْ دَرِ نَصِيْحَتِ اٰخِرَتِ
 خَبَرِ دَارِ بُوْنِ اَيِ غَافِلِهْ قِيَامَتِ قَامَقُوْبِ بِيْسِكْ
 مَكْتِ عَمْبَرِ اَيُوْنِ حَاصِلَهْ مِيَا مَبْرِيْ جَنَّتِ لُكَا وَاَسْ
 اِنُوْنِ رُوْبِيَا يَهْ مَتَا جَمْعَا هْ بِهْ جَفْتِ وَنْدِ سَبُوْهَتِ لِيَا
 صُوْرِ اَقَامْدُوْرَهْ مَنْدُوْ شَقَا هْ مِيَا مَبْرِيْ جَنَّتِ لُكَا وَاَسْ
 سَدَا يَتِ سِرْمُوْرِ مَرَزِيْ اَرِيْ هْ شَرُوْفَهْ اَطْلَاسْ اَزْدِيَا
 كَقُوْ اَوْشْتِ پَرِ مَنْدِ كَا وِيْ هْ مِيَا مَبْرِيْ جَنَّتِ لُكَا وَاَسْ
 اَتُوْ اَوْشْتِ بِيْسِ نَبُوْتِمَانْتِ هْ مَجْتِ نَدِرِ هِيَهْ قَالُوْرِيْ

مستور

4b/

3

5

9

13

17

⁸³ me'mur (ar.)⁸⁴ garib (ar.) i l⁸⁵ karib (ar.) sh⁸⁶ "Këshilla tje⁸⁷ haberdar (pe⁸⁸ gafil (ar.) i sh⁸⁹ kijamet (ar.)⁹⁰ kopmak (tur⁹¹ umr (ar.) jetë⁹² hasil (ar.) fitr⁹³ xhen-net' ul-t⁹⁴ saraj (turq.) i⁹⁵ sërri (turq.) t⁹⁶ diba (pers.) a⁹⁷ kalure (pers.)

4b/

- Robi ôsht me'múr⁸³ me bô çkaf thôt Zotÿn,
Aj e di se kô ngjallën ja kô mbÿton.
- 3 **Mulla Dervishi** pa çäre garîb⁸⁴,
Rahmetin Tônd Zoti Mâdh bônja karîb⁸⁵.
- 5 **MANZÛME – DER NÂSIHAT-I UHRÂ**⁸⁶
Haberdâr⁸⁷ bonu ej gâfil⁸⁸ // Kijamet⁸⁹ kâ me koptisën⁹⁰
- 9 Me qet ymbër⁹¹ e bon hâsil⁹² // Me ja mbrî xhennet'ul- me'vâs.⁹³
E tôn dÿnjâja me ta ç'kâ // Po çëkti vend s'i bôhet päg
- 13 Sot e kâ m'dôre mend kush kâ // Me ja mbrî xhennet'ul-me'vâs.
- Sarajet⁹⁴ sërm⁹⁵ dÿrÿzit âri // Shtrÿe atlas edhe dibâ⁹⁶
- 17 Qe ku ôsht përmënd qârî // Me ja mbrî xhennet'ul-me'vâs.
- Atÿ ôsht lisi ni motmât // Me gjeth ndër hije kallurij⁹⁷

⁸³ me'mur (ar.) i urdhëruar.

⁸⁴ garîb (ar.) i huaj, pa të afërm.

⁸⁵ karîb (ar.) shumë i afërm.

⁸⁶ "Këshilla (tjetër në vjershë".

⁸⁷ haberdar (pers.) dijetar; i interesuar, i zgjuar.

⁸⁸ gâfil (ar.) i shkujdesur, indolent.

⁸⁹ kijamet (ar.) shkatërrimi i gjithësisë, apokalipsi.

⁹⁰ kopmak (turq.) pëlçitje.

⁹¹ umr (ar.) jetë.

⁹² hasil (ar.) fitim, arritje.

⁹³ xhen-net'ul-me'va (ar.) Është emri i një shkalle të xhenetit.

⁹⁴ saraj (turq.) pallat.

⁹⁵ sërm (turq.) argjend.

⁹⁶ dibâ (pers.) armaç (cohë mëndafshi e qëndisur me ar e me argjend).

⁹⁷ kalure (pers.) mbathje dhe mobilie të veshura me lëkurë të përpunuar.

50

مَتَوَرَّبِي بِأَمْسِئَا وَمَبِئَشْ بِلَوْتِ نَبَاهِي جَنَّتِ الْمَأْوَأَسِ
 مَبِي حَمِي اَنَّهُ عِلْمَانَتِ تَكْتِ تَقِيْتِ اَرِيْنِ دِيُونِ
 اَوْ فَا تَبَارِي اَمِي كَقَا اِيْمَانِ اَمَامْبِرِي جَنَّتِ الْمَأْوَأَسِ
 تَمَلِكِ اَمَسْتِ دِيْبِيَهْ يَكْتَمُونِ اَنَّهُ اَمَسْتِ كِتْ جَقَافِ كُنْتِ
 اَصْلَاعَتِ بِيُونِ رِيْتِ قَاتِنِ مِيَا مَبِي جَنَّتِ الْمَأْوَأَسِ
 نِيَا رِي اِسْتِيْتِ اِحَارَتِ كَيْفِ رِكُوَهْ سَبِيْمِ نِمَا زِيْفِ قَالِ
 اَوْ نَسْ تَنْزَوْتِ رِيَهْ قَا رَا لَ مِيَا مَبِي جَنَّتِ الْمَأْوَأَسِ
 هَمُوشِ بِيُونِ دِرْ تَحِيَانِ اَسِيْنِ كِنَاهِتِ نَوْ قَانِيُو بَرْدِيْنِ
 يُو جَاهِلِي سَقَا سَا يَفِيْنِ مِيَا مَبِي جَنَّتِ الْمَأْوَأَسِ
 نَوْبَهْ جَقَافِ بَهْرَهْ بِيُونِ تَهْ بَهْ دَرَا كِتِ رُوِيُو مَاسِيَهْ اَمِيْدِيْنِ
 يُو جَاهِلِيْتِ سَوْدِ مَكْتِ نَوْبَهْ مِيَا مَبِي جَنَّتِ الْمَأْوَأَسِ
 نَفِيْتِ عَمْبِرِ بِيُونِ سَوْمِ فَا يِ حِجَهْ اَللَهِيْتِ نَوْ قَا اُو زِي

5a/

4

8

12

16

20

24

⁹⁸ turli (turq.) l⁹⁹ bahçe (pers.)¹⁰⁰ huri (ar.) bu¹⁰¹ gilman (ar.)¹⁰² mulk (ar.) st¹⁰³ ita'at (ar.) c¹⁰⁴ zeqat (ar.) de¹⁰⁵ namaz (pers.)¹⁰⁶ derd (pers.)¹⁰⁷ xahil (ar.) s¹⁰⁸ saji (turq.)¹⁰⁹ tevbe (ar.) p

5a/

- Me tyrlí⁹⁸ pemësh ô mbùsh plôt // Ni bahçe⁹⁹ e xhenet'ul-me'väs.
- 4 Me mij hyrî¹⁰⁰ edhe gilmän¹⁰¹ // T' gjith turkit i rrîn divän
Ô fatbârdh aj qi ka imän // E ja mbrî xhenet'ul-me'väs.
- 8 Ni mylk¹⁰² ôsht dije përgjithmön // Aty ôsht gjithçkaf qi t'dön
Itâat¹⁰³ bôn Zotÿn ka thôn // Me ja mbrî xhenet'ul-me'väs.
- 12 Njeri i shtrëjt e çartaqejf // Zeqât¹⁰⁴ s' ep hem namáz¹⁰⁵ nuk fäl
Udhës Tënzot dije ka däl // Me ja mbrî xhenet'ul-me'väs.
- 16 Kush e bon dert¹⁰⁶ të hân e t'pfn // Gjynâhit nuk i ik për dfn
Po xhahili¹⁰⁷ s'e ka sajgn¹⁰⁸ // Me ja mbrî xhenet'ul-me'väs.
- 20 Bône çkaf bône bôn tevbe¹⁰⁹ // Drëqit rÿju más ju ujdís
Po çallshit sot me qet tevbe // Me ja mbrî xhenet'ul-me'väs.
- 24 Në kët ymbor bône shúm fäj //Veç Allahit nuk kâ uzdäj

⁹⁸ turli (turq.) lloj-lloj.

⁹⁹ bahçe (pers.) kopsht.

¹⁰⁰ huri (ar.) bukuroshe e parajsës.

¹⁰¹ gilman (ar.) djaloah që shërben në parajsë.

¹⁰² mulk (ar.) sundim

¹⁰³ ita<at (ar.) dëgjueshmëri, bindje.

¹⁰⁴ zeqat (ar) detyrim material i të pasurve ndaj të varfërve.

¹⁰⁵ namaz (pers.) adhurim të cilin muslimani është i obliguar ta bëj.

¹⁰⁶ dert (pers.) kokëqarje.

¹⁰⁷ xhahil (ar.) injorant.

¹⁰⁸ sajgi (turq.) nderim, respekt.

¹⁰⁹ tevbe (ar.) pendim.

56

مَنَّا سَأَلَتْ مَرْحَمَتَ بِهِ قَوْلَ آيَةٍ مِيَا مَبْرِي جَنَّةِ الْمَأْوَأَسِ
 مَرْعَبْرَتِ شَهْرِكَ دِيكَ يَارِ دِيَتِ نَصِيحَتِ دَقَّة مِيَا قَت مَانِ دِيَتِ
 جَلِي سَوْتِ نَقْوُونِ دِيَتِ مِيَا مَبْرِي جَنَّةِ الْمَأْوَأَسِ
 تَمَانِ بِنِ زَمُونِ اِنْ يَمِ حَقِيْقِي كِه زُو بِيكِ اِي اَبُونِ نَوْ فِيْلِي
 كِنَاهِتِ فَوْرَتِ دُو هَتِ مِي اِيْتِي مِيَا مَبْرِي جَنَّةِ الْمَأْوَأَسِ
 مَلَانِ مَرْوِي شَرِيَتِ يَارِي نَهِي كِر مَرِ اَوْتِ يَارِي كَشْفُوغِي
 مَخْدَمَتِ نَمِ اَنْ يِ نَوْ فَمُوغِي مِيَا مَبْرِي جَنَّةِ الْمَأْوَأَسِ

نصیحتی آخری

مَدَدِ قَا كِه تَبُو شَتِ وُو بِيْتِمِ حَلَالِ قَا سَقَانَا يَزُو وُو بِيْتِمِ
 سِيَا قَطِيَا سَبُوْمِ قُو بِيْتِمِ اِنْ مَوْ سَمَانِيْتِي وَ يَارِ
 حَلَالِ مَا قُوْنِ نِقَا شُوْرُو سُوْا لِ بُوْ هَشِ قُوْا مَوْ رُو
 بِتِ عَالَمِ بِيُوْنِ قَسُوْنِ وُوْرُو بُوْ جَاهِلِي قُوْ كُوْ اَرْ شَانِ

قون

4
8
12
15
19
23

110 merhamet
 111 ibret (ar.) m
 112 tahkik (ar.)
 113 ja rah (ar.)
 114 kerem (ar.)
 115 jar (pers.)
 116 hidmet (ar.)
 117 "Keshilla t
 118 halal (ar.) v
 119 ferjad (pers
 120 sual (ar.) py
 121 calim (ar.) c
 122 irshad (ar.)

5b/

- M'né sällt merhamet¹¹⁰ bôft Aj // Me ja mbrf xhennet'ul-me'väs.
- 4 Merr ibret¹¹¹ shoqi diq pã dît // Nasihat dëka mjaft me dît
Çili sýt në kto dy dît // Me ja mbrf xhennet'ul-me'väs.
- 8 T'Madhin Zot e dím tahkik¹¹² // Qi robin Aj e bon tevfik
Gjynahit fort duhet me j'ik // Me ja mbrf xhennet'ul-me'väs.
- 12 **Mulla Dervish** ti jã rab¹¹³ thúj // Qeremi¹¹⁴ Yt jãr¹¹⁵ i gjithkôj
Me hizmet¹¹⁶ tem e dí nuk muj // Me ja mbrf xhennet'ul-me'väs.

15 NASÍHATI UHRĀ¹¹⁷

- 19 Medet kãqe tepôsht vôjtëm // Hallall¹¹⁸ ke s'ke na porvôjtëm
Si baktija s'e bôm kujtim // Edhe mos me na thír ferjad?¹¹⁹
- 23 Hallall me kôn ni kafshore // Sual¹²⁰ bohesh ku e more
Ti alim¹²¹ bonu ksodore // Po xhahili ku gjô irshad?¹²²

¹¹⁰ merhamet (ar.) përdëllim.

¹¹¹ ibret (ar.) mësim (nga shembulli i keq).

¹¹² tahkik (ar.) verifikim.

¹¹³ ja rab (ar.) o Zot!

¹¹⁴ kerem (ar.) fisnikëri.

¹¹⁵ jar (pers.) i, e dashur.

¹¹⁶ hidmet (ar.) shërbim, përkujdesje.

¹¹⁷ "Këshilla tjetër"

¹¹⁸ halal (ar.) vepër a gjësend i lejuar sipas të Drejtës Islame.

¹¹⁹ ferjad (pers.) britmë, bërtitje.

¹²⁰ sual (ar.) pyetje.

¹²¹ alim (ar.) dijetar.

¹²² irshad (ar.) udhërrëfim.

قَوْمَهُ هَوَّبَ اَوْزَانِ اَي كَيْرِي ۝ اَهْوَبَ مَبَاسِيْنَه قَوْمِ كَثْرِي
 مَجْلِسِ نَالَتْ قَلْوَزُ قَوْمِي ۝ اَلْوَبُ سَايْفِيْنَ سِيَهْ اَسْتَادِ
 نَهْرَهْ يَبْقِي هِي اَشْقَرْت ۝ سَنْدُ سَبُونِ قَوْشِ قِيَاثِ
 كَهْمِشْ اَبُونِ كَا سَتَهْ اَهْيَقُوْت ۝ دُرُيْ سَبُونِ بَرِنْدَهْ اَسْلَ اَوْلَى
 كِتَابِ قَوْمِ سَبْرِي نَبْرُ ۝ نَهْ قَائِدَهْ اَنْ مَتْرَانِ مَرُ
 زَبُونِ قَوْمِ زُوْمَنْدِ مَبْرَهْ ۝ قَوْشِ اَمُو يَنْفُوتِ تَبْوِي اَز اَنْ
 يَاحُجَجِ قَا يَا دِ بَاغِ تَرِي ۝ نَهْرِ عَرُضِ لَوِي نَهْمَنْ نَيْرِي
 مَسُو مَاشْتَرُو مَنَهْنِ فَا طَرِي ۝ سَاوَسْتِ زَوْتِي اَقَا اِيْرَادِ
 كِنَاهِي نَفَارِ قَوْمِ مَشِيْبِيْنَ مَدُو قَا قِيَا بِيْنَ صِرَاطِ كَبْرِيْنَ
 مِيْاَرِي اَي يَنْفَلِشْتِ كِه اِيْرِي جَزَانِ اَهْيَا قِي مَكْتِ اَرْغَادِ
 دِيَهْ اَي ظَالِمِي مَ اَنْتِ ۝ كِنَاهِي نَهْ قَوْمَهْ نَكَا قِي
 قَبِي بِيْقِي تَبُو دَا قَبِ ۝ بِيْرَ اَسْتِغْفَارِ بِنَهْ اِرَاقِ

6a/

4	K
	N
	I
8	C
	C
12	Z
	J
15	M
	C
19	M
	I
23	I

123	mexhlis
124	ustad (pe
125	ne faide
126	azad (pe
127	tabak (t
128	erz (turq
129	irad (ar.
130	kypry (t
131	jangllësh
132	irgat (gr
133	zalim (a
134	istigfar (

6a/

- 4 Kur e hup údhën aj qi prf // E hup mbas tîna ky qetri
Në mexhlis ¹²³ nalt kqyr ku t' rri // E lyp sajgîn se je ustâd? ¹²⁴
- 8 Niher kujtoju hej i shkret // Send s' e boni kush kët jêt
Qysh e bon qashtu e hjek vet // Dobt s' bon prind e as evlâd.
- 12 Qitapi kur s' t' hi n' trû // Ne fajde ¹²⁵ edhe me t' rã drû
Zotÿn kur z' do n' mend me t' prû // Kush a muj thõt t' bôj âzâd? ¹²⁶
- 15 Ja hõxh kê ja tabak terzî ¹²⁷ // Niher êrz ¹²⁸ lyp t' vÿn njerzî
Mos u mashtro me thôn fatzî // Se ôsht zotnî e ka irâd. ¹²⁹
- 19 Gjynâhi ngarkohet m' shpîn // Do ta keejni Sirât qyprîn ¹³⁰
Mjeri aj jangllëshit ¹³¹ qi i prfn // Xhezân e hjek me gjith argâd. ¹³²
- 23 Dije ej zâlim ¹³³ i véti // Gjynâhi n' ktõ e n' gjëti
Ka ni pik-pik t' u bõ dëti // Bjer istigfâr ¹³⁴ bõnu âzâd!

¹²³ mexhlis (ar.) kuvend, tubim.

¹²⁴ ustad (pers.) profesor

¹²⁵ ne faide (turq.; ar.) ç'fitim?

¹²⁶ azad (pers.) i çliruar, i lirë.

¹²⁷ tabak (turq.) lëkurpunues, terzi (turq.) rrobaqepës.

¹²⁸ êrz (turq.) nderë, sedër.

¹²⁹ irad (ar.) të ardhura nga pasuria e patundur.

¹³⁰ kypri (turq.) urë.

¹³¹ jangllësh (turq.) gabim.

¹³² irgat (greq.) punëtor me mëditje; ndihmës

¹³³ zalim (ar.) tiran.

¹³⁴ istigfar (ar.) pendim.

رَجُوعُ مَوْتٍ بَعْدَ نَيْمَانٍ بِشِمَانٍ مُحَمَّدٌ أَمَّتْ أَوْشَتْ زُفُونُ
 كِهْ بَرْدِي نَفُوقُ أَبُونِكَ قَالَتْ أَرَهُ مَقُونُ جَلَدُ
 زَهْتِ دَهْتِ مِيدَرِ شَتِكِ اِرْحَمِكَ صِيَادِ شَتِكِ
 حَقِي هَوِي مَقُونُ قَاشَتِكِ رُوِي سَهْوِيَّتِ اَبْدِ اَبَاكَ
 مَلَانِ مَرِيشِ جَمَالُوبِ اِنْكَازِ قَلُونِ اَوْدِيسِ بِيَهْ اَبِي
 دِيَهْ كِتْ هَمِشِ بُونِ وَايِي بِرِ نَدِيَا تَبُوقِ اِمْدَانِ

4
 8
 12
 17
 21

نصیحتِ آخری

اَوَّلُ تَرَابِ اِخْرِ تَرَابِ هِنْدِ مَرِيَّتِ كِنَاهِتِ بِاِحْسَابِ
 مَا نَيْتِ قُوهِ كُوَسْرِ اَبْجَوَابِ قَايِنَا نَمَهْ دِيَتِ شَرِ يَا غَفُورُ
 هِيچِ مَسْدِ اَقَارُوبِ كِهْ نَفُوقِ بُونَا اِيْرَانِ سَرْمَايِهْ پَلُوقِ
 وَاللّٰهِ اَوْ مَسْدِ دَرُوهِ قُوَتِ نَمِيْرِ اَمْرِ شَايِ قِيْبِهْ دُوْغُورُ
 دَرُوْشَتِكِ بِهْ قَايِنَا اَرِشْتِ مِيْبُوْ نَفُوعِطِ بُوْرِ اَمِيْرِ نَيْتِ

پر آخرت

135 ruxhu< (a
 136 pishman (a
 137) dahi (tur
 138) xhel-lac
 139 ebed-abad
 140 imdad (ar.
 141 "Keshilla
 142 "Dhe në fi
 143 ja Gafur (a
 144 sermaje (p
 145 va<z (ar.)

6b/

- Ruxhû¹³⁵ kur bôn nimend pishmân¹³⁶ // Muhamed ymmetit ôsht
dhôn
4 Qi për dâhî¹³⁷ nuk e punon // Falet edhe me kôn xhelât.¹³⁸
- Zotit duhet me j(u) drashtën // E rahmetin me ja dashtën
8 Haki hûj me kôn kashtën // Rúju se hupet ebed-âbâd.¹³⁹
- Mulla Dervish** çka lyp n'gjéti? // Kqyr ujdísu për véti
12 Dije gjithkush i bôn véti // Perendija të bôft imdâd.¹⁴⁰

NASÍHATI UHRÂ¹⁴¹

- Ev-vel turâb âhir turâb¹⁴² // Ndërmjet gjynáhet pa hesâp
17 M'at jét ku e qýsh ep xhevâp // Kâj nât e dít thirr já Gafûrr.¹⁴³
- Hiç mend a ka rôbi qi thôt; // Bona irât sermâje¹⁴⁴ plôt,
21 Vallâhi u mundove kot // N'é mbrâm shêj kije dy gúr.
- Drýshkin po kâ zembra rôbit // Me'j bô ni va'z¹⁴⁵ por e mbërzit

¹³⁵ ruxhû< (ar.) këthim

¹³⁶ pishman (ar.) pendim.

¹³⁷) dahi (turq.) gjithashtu; përsëri.

¹³⁸) xhel-lad (ar.) vrasës, xhelat.

¹³⁹ ebed-abad (ar.) përgjithmonë.

¹⁴⁰ imdad (ar.) ndihmë.

¹⁴¹ "Këshilla tjetër".

¹⁴² "Dhe në fillim, dhe në përfundim".

¹⁴³ ja Gafur (ar.) o Mëshirues, (o Zot).

¹⁴⁴ sermaje (pers.) kapital.

¹⁴⁵ va<z (ar.) predikim, këshillim.

١٥
 بِرْ اَحْرَبْت سِي مَوْعَبِتْ ۞ كَوْشْدُو نَلُوچ مِيكْتِ رُوغُوْر
 دُنْيَانِ الْوَبْ قَوْتِيْنِ مَسْمِ ۞ كَوْمِي سَمُو كَوْش بُوِي فِتْمِ
 نَاسْ غَرُو يَهْ هِي دِيَالِي سِيْمِهْ نُوْقَدَلْ عِلَاجِ الْاَقْبُوْر
 شَدُوْش نِيَانِ بَا قِيْنِهْ اَنْفِيْتْ شَاهِلُوْ كَتُوْر هَتْ مَدِيْتْ
 شَكْرِيْ بِيُوْنِيَانَا نَهْ اَنْفِيْتْ ۞ عَمْرِيْ سَهِيْبِهْ بِيُوْنِ مَرُوْر
 عَمْرِيْتْ رُوِيْ كِيْمِيَا اَقَا ۞ مَا خَرَجْتِيْنِ سُوْنِ بَرِيْقَا
 حَافِي اَزِي سِتِهْ بِيُوْر سِقَا ۞ نَمْبِرْ اَمْرُوْصَايْتِ مَشْ لِقُوْر
 جَهَنْمِكْ اِنْكَازِ سَبُوْنِ ۞ خَيْرِ عَمَلِكْ پَرِيْ سِيَابُوْنِ
 نَفْسِيْ چِقَاقِيْ لُوِيْ كِتْ يَانُوْنِ ۞ كَتُوْر بْ شَهْهْ اَمْرِيْ غُوْر
 الْقَارِعَهْ قَانُوْنِ ۞ زَنْتُوْنِ مِيَاْفْتِ اَوْ مَقُوْنِ پَرِيْمُوْتِكْ
 نَكَاْلَمْ اَشُوْهْمِيْهْ زَبْتُوْنِ ۞ لُوْتْتْ مَكَاْفَا نَرِيْنِ سِنُوْر
 اَهْدُرْدِ اِيْمَانِ مَنْدِيْ مَقُوِيْ ۞ نَفْسِيْ مَشِيْرْ كَوْشْدُوْر تَمُوْر

146 jetim (ar.)

147 il-la kubur

148 shahilék (g)

149 murur (ar.)

150 kimja (ar.)

151 beka (ar.)

152 kasab (ar.)

153 inkar (ar.)

154 hajr amel (

155 perde (per)

156 el-kari-ah

157 byz-bytyn

158 nefsi (ar.)

7a/

- 4 Për ahiret si m'ù gobit // Qýsh do n'illoç mej'qit dð gúr?
Dyñjån e lyp ku t'jen me tim // Gjumi s'e mer qysh bðj fitim
- Nés grúja véj djali jetim¹⁴⁶ // Nuk del ilaç il-lå kubúr.¹⁴⁷
- 8 Shëndosh t'jén barkin e ngít // Shahllék¹⁴⁸ qetð duhet me dít
Shyqrin ti bønja nát'e dít // Ymri si hije bøn murúr.¹⁴⁹
- 12 Ymrin røbi kimjá¹⁵⁰ e kå // Me e harxhitën sot për beka¹⁵¹
- Ha flü e rri shih porsî kå // N'ë mbråm kasapit¹⁵² mish likúr.*
- 16 Xhehenemin inqår¹⁵³ s'e bøn // Hajr amelin¹⁵⁴ pérde¹⁵⁵ s'ja bøn
Nefsi çkaf lyp gjith ja bøn // Qet rob shihe zembra tij gúr.
- 20 El-kåri'ah¹⁵⁶ ka thøn Zotýn // Mjåft ð me køn për me t'mbytn
Ngjållem e shohim byz-bytýn¹⁵⁷ // Løtet me gjak derdhen si gúr.
- 24 Ah derd i madh me ndej m'gúj // Nefsi¹⁵⁸ me thír qysh do t'múj

¹⁴⁶ jetim (ar.) bonjak.¹⁴⁷ il-la kubur (ar.) veçse vorri.¹⁴⁸ shahllék (pers. & turq.) gjendje mbretrore, mirëqenie e lartë.¹⁴⁹ murur (ar.) kalim.¹⁵⁰ kimja (ar.) gjë shumë e çmuar, gjë me shumë vlerë.¹⁵¹ beka (ar.) amshim.¹⁵² kasab (ar.) mishshitës, kasap.¹⁵³ inkar (ar.) mohim.¹⁵⁴ hajr amel (ar.) vepër e mirë.¹⁵⁵ perde (pers.) streh, perde¹⁵⁶ el-kari-ah (ar.) katastrofa, kijameti.¹⁵⁷ byz-bytýn (turq.) të gjithë.¹⁵⁸ nefsi (ar.) shpirti im.

٢٦
 بِرِنَانِ ابَابِ هِنْدُ سَبِيهِ قَوِي تَارِي رَسُولِ بُونَ ظَلُوز
 رَنَرْتِ اَمْتِي بِهَرِ اَمْتِي يَا رَتِ لَوِي اَمْتِي
 جَهَمْتِكِ مَوْسَمِ الشُّوَرِ هَمِي نَاغِيكَ بِسَابُونَ مَصُورِ
 قِتِ مَلَا دُرُ عَرِيشِ مَوْسَمِ اَمْتِي يَا رَتِ سَانِ وَاوَسْتِ نَفَايِ
 بِرِي كَاتِنَه حَوَرِيَتِ اَلَايِ قَرِيشِي اَوِي نِ اَغْرَمُونِ مَنُورِ
 اللهُ
 كَتُرُ سَقَامِي تَتَوَرْتِ يَا مِي كُنَاهَا زَرْوَبِ اَدِي مِي يَا مِي
 مُحَمَّدِ اَمْتِي يَا مِي هُنَا رَحْمَتِ تَبُونَ اَللهِ
 جَوَاهِرِ عَرِي بُوَشِ نَا شَقُوْرَه نَوَه دُنْيَا يَه نَامَشْتِ قَوِي
 عَمَلِ سَقُوْمِ نَا سَرْدَاغِي قَرِيشِي مَنَا رَحْمَتِ تَبُونَ اَللهِ
 اِهْتَلِ شَشِ اَنُوقِدِي تَا مَمُوِي نَقَسِ سَاوَرِي تَا
 نِقَه نِيْتِمِ بِلَا مِي بِرِي تَا اَبِي تَبُونَ مَرَحْمَتِ اَللهِ
 البغ

Pe
 4 T
 X
 8 K
 Pr
 13 Qe
 M
 17 Xh
 An
 21 I v
 Ne

159 zuhur (ar.) pu
 160 um-meti (ar.)
 161 allaj (greq.) g
 162 nur (ar.) drite
 163 xhevahir (per)
 164 bosh (turq.) z

7b/

- Për nân e bāb n'mend s'i bje kûj // Téri Resuli bôn zuhûr.¹⁵⁹
- 4 Thrret ym-meti¹⁶⁰ por ym-metf // Jā rab-bi lypi ym-metf
Xhehenemin mos ma lsho Ti // Me mi djegën pse bôn kusûr.
- 8 Kët **Mulla Dervish** mos e dāj // Jā rab-bi sado ôsht n'faj
Prej qátyne hyrít allaj¹⁶¹ // Karshi u vîn i gzôjn me nûr.¹⁶²

ILAHÍ

- 13 Qetor s'këmi të tût jémi // Gjynâhqâr rob e dím jémi
Muhamed ymmetit jémi // M'né rahmet Ti bon Allah.
- 17 Xhevahir¹⁶³ ymri bosh¹⁶⁴ na shkoj // Neve dynjāja na mashtroj
Amel s'kôm nés me dek ku shkoj // M'né rahmet Ti bon Allah.
- 21 I vogël kesh e nuk dfta // M'mujti nefsi si u rrita
Në kujtim plakemi prita // Apet bon merhamet Allah.

¹⁵⁹ zuhur (ar.) paraqitje

¹⁶⁰ um-meti (ar.) komuniteti im

¹⁶¹ allaj (greq.) grumbull.

¹⁶² nur (ar.) dritë

¹⁶³ xhevahir (pers) gur i çmuar, diamant

¹⁶⁴ bosh (turq.) zbrazët

4

8

12

16

الغزوب يوم اذنا جاز انوت سيومو سوبه كان
 حق امنن اقية عقاز مفا لفايت تيا الله
 تياروت قالته ايمانك بمكت ساد ربي ذم مالك
 حوال شر شيطانك نال ان غووتت يا الله
 مدد امنن ناخر ووتت اذنه ووردي نار افشوتت
 يا باهجه يا بونار بووتت تحت بونه يا الله
 مارون رويش لطفك توند افق اوزدي كنه فير توند
 كناهت ييا شق اذنه ماروند تفالحي يا كريم الله
 تمت
 ...
 ...
 ...
 ...

165 naçar (p
 166 gaf-far (C
 167 havale s
 168 lutf (ar.

8a/

- 4 I lig rob jôm edhe nâçâr¹⁶⁵ // I zoti s'jôm me bô ni qâr
 Hak emnin e kije Gafâr¹⁶⁶ // Mi fal fajet Ti jā Allah.
- 8 Ti jā Rab-bi falna imānin // Me gjith sa derdi dermānin
 Havāle sherri shejtānin¹⁶⁷ // Na largo vet Ti jā Allah.
- 12 Medet emni na harrohet // Edhe vorri na rrafshohet
 Ja bahçe ja bunār bohet // Ti xhennet bone jā Allah.
- 16 **Mulla Dervishi** lutfin¹⁶⁸ tond // E kā uzdāj qeter korkond
 Gjynahet bjeshk edhe ma rond // Ti falmi jā kerfīm Allah.

T e m - m e t

¹⁶⁵ naçar (pers.) i pamundësishëm, i pafuqishëm.

¹⁶⁶ gaf-far (ar.) falës i madh i gabimeve.

¹⁶⁷ havale sherri shejtānin (ar.) "largona t'keqen e djallit".

¹⁶⁸ lutf (ar.) butësi.

بلا طائل عن الكتاب بعون الله
الملائكة الوهاب

الحمد لله رب العالمين والصلوة على خير خلقه محمد وآله الطيبين
قد وضع المصنف من تحرير هذا الكتاب في وقت الفجر في يوم السبت
الحفنة من شهر رمضان في تاريخ الثامن عشر من سنة ثمانمائة واليه في مدينة
تريكي عن يد عبد الضعيف المتدب الحاج في ركنه الله تعالى مظلوم ورجس
بن مصطفى بن حسين بن محمد بن علي بن محمد بن عبد الله بن عبد الله بن عبد الله
و جميع اساده و جميع المؤمنين والمؤمنات والمسلمين والمسلمات
به حشدة يا رحيم الرحمن

محمد

هذا الكتاب هو من تصانيف
مولا دervish Pejës

Faksimili i kollofonit të autografit të Mulla Dervish Pejës.

No
1b /
2a /
2b /
3a /
e dorëshk
tivisht, vs
3b 4
5

Ndryshimet në krahasim me kopjet tjera të Vasijetnames*

- 1b / 1-2 Hadha kitabi vasij-jetname-i Mulla Dervish Peja A :
Arnavutça
nasihatname-i Mulla Dervish B
- 3-7 Bismil-lahir-rahmanir-rahim. El-hamdu lil-lahi rab-bil
alemin,
ve sal-lallahu ala sej-jidina ve nebij-jina Muham-medin ve
alihi ve sahibi exhmein A : --- B
- 15 përgjithmon A : gjithmon B
- 16 gjith A : --- B ; peygambervet A : peygamervet B
- 22 t' Muhamedit A : Muhamedit B
- 2a / 4 i tij A : tij B
- 5 udhon Pejgamberit A : udhën Pejgamerit B
- 6 e vaxhib A : vaxhib B
- 9 gjo A : --- B
- 11 e fitoj A : e fiton B
- 12 gjet A : gjo B
- 16 osht A : o B
- 20 uzdaj m'to mba A : uzda mba m'to B
- 21 kije A : kiej B
- 24 osht A : o B
- 2b / 1 Nasihati uhra A : Arnautçe B
- 5 porosit A : parasit B
- 7 me mos A : mos me B
- 9 me u A : m'u B
- 10 lutju A : lutu B
- 3a / 2 gjithshka hupet A : gjith kho jet B
- 3 e ka A : ka B
- 4 mbyte A : myte B
- 5 s'të ngjet A : s'të get B
- 8 njeri i keq A : njeri keq B
- 9 tehin limo vet A : tehi limohet B
- 11 gjerpën A : gjarpën B
- *) Numrat që i kemi shënuar para ndryshimeve, i pari tregon fletën e dorëshkrimit A, respektivisht faqen, ndërsa dyti tregon rreshtin, respektivisht, vargun.
- 3b 4 baje A : baja B
- 5 mbasi A : masi B ; memqyn A : mymqyn B ; mos ardh A :
mos

- me ardh B
 6 para A : porpara B ; për A : --- B
 7 divon A : divan B
 11 u dijt A : at dit B
- 4a 3 kallaj A : kollaj B
- 4b 2 mbyton A : myton B
 3 pa çare A : e pa çare B
 4 bonja A : bonna B
 5 Manzume der nasihati uhra A : Arnautçe ilahi B, C : Ilahi shqip D
 7 koptisën A, BII ** : koptisun BI, C : kojdisun D. Në kopjen D vargu i dytë i kësaj poezie është vendosur në vendin e vargut të tretë dhe anasjelltazi.
- 8 e bon A, BII,C,D : bohet BI
 9 mbri A, BI, D : mri BII, C
- Në kopjet BI dhe D pas rreshtit të nëntë të kopjes A janë shkruar edhe këto vargje:
- Mos e dbir ti ymrin ton
Fjalën mos me mesdisun
Për at Zot mir ne m'digosh
Me ja mbri xhenet'ul-me'vas. BI :
Mos e tbir ti amelin bosh
Fjalën mos me marsdisun
Për at Zot mir bon ne m'digofsh
Me ja mbri xhenet'ul-me'vas. D . Në kopjen D mungojnë
 vargjet vijuese deri në rreshtin 19 të fl. 5a.
- 13 mbri A : mri BI, BII, C
 14 sërm A : syrm BI, BII, C ; dyrzit A : dyrot BI, BII, C
 16 përmend A : përnimend BI, BII, C
 18 motmat A : motmot BI, BII, C
 19 me xheth A, BI : me çu BII : me hec C
- 5a / 1 mbush A : mushun BI, BII, C
 6 mbri A : mri BI, BII, C
 8 gjithçkaf A, BI : gjithshkaf BII, C
 9 Zotynë ka thonë
 10 mbri A : mri BI, BII, C

***) Poezia *Haberdar bonu ej gafil*, në kopjen B është kopjuar dy herë: në fl. 12b-13a dhe në fl. 56a-56b prandaj, në tabelën e ndryshimeve e kemi shenjuar me BI dhe BII.

- C : Ilahi
- Në kopjen
ë tretë dhe
- mbri A : mri BII, C. Në kopjen BI mungojnë rreshtat 13- 18.
- 16 për din A : por din BII, C
- 18 mbri A : mri BII, C
- 19 çkaf A : çka BI, D : shkaf BII : shka C
- 20 ruju mas ju ujdin A : ru mos i ujdin BI, D : ru mas ju ujdin BII, C
- 21 po çallshit sod A, BII, C : lutju Zotit BI, D
- 22 mbri A, BI, D : mri BII, C
- 23 ymbor A : ymor BI, BII, C, D
- 24 veç Allahit nuk ka uzday A : m'qeter kond nuk o uzday BI :
veç Allahit nuk o uzday BII : veç Allahit nuk osht uzday C :
m'qeter kond nuk ka uzday D
- 5b / 1 sallet A : sallt BII : sall C : por BI, D
- 2 mbri A, BI, D : mri BII, C
- Në kopjet D dhe BI pasojnë vargje të cilat nuk i gjejmë në kopjet A,
BII dhe C. Ato janë:
Temeli punës o tuta
Sevapin e bon (i) urti
Kto s'e mer vesh i piti
Me ja mbri xhenet'ul-me'vas.
Në kopjen BI në vend: *e bon, është: u boj.*
- 5 çili syt në kto A : pa çallshit në kto BI, D : çili syt ti kto BII, C
- 6 mbri A, BI, D : mri BII, C
- Vargjet vijuese 7,8,9,10 në kopjet BI dhe D mungojnë.
- 10 mbri A : mri BII, C
- 11 Mulla Dervish ti ja rab thuj A, BI, BII, C : Mulla Dervish
ja rab D
- 15 Nasihati uhra A : Arnautçe ilahi B, C
- 16 hallall ke e s'ke na porvojtëm A : hallall ke ho haram vojtëm
B, C
- 18 si baktija A, C : si bagdija B
- 6a / 2 e hup mbas tina ky qetri A : e hup qetri qi osht mas ti B
- 4 se je ustad A : se jom ustad B, C
- 12 a muj A : a mun B, C
- 13 ja hoxh ke ja dibag terzi A : po hoxh ke ja tabak terzi B : ja
hoxh ke ja tabak terzi C
- 15 mos u A, B : mas u C
- 19 pri A : prin B, C
- 23 t'u bo A : bohet B, C
- herë:
yshimeve e

- 6b/ 1 nimend A, B
 5 me ju drashtën A : me i dreshtën B, C
 6 dash tën A : deshtën B, C
 10 çka A, B : shka C
 11 gjithkushi bon A, B : gjithkush i bon C
 13 Nasihati uhra A : Ilahi shqip B : Arnautçe ilahi C
 15 ndërmjet gjynahet A : ndërmjet gjynahe B : dërmjet
 gjynahet C
 19 sermaje A, B : sermoje C
 20 u mundove A, B : u mundue C
 23 e mbërzit A, B : e mërzit C
- 7a/ 1 m'u gobit A, C : me u gobit B
 3 me tim A, B : më tim C
 17 çkaf A, B : shka C
 18 zembra A : zemra B, C
 20 me t'bytn A : me t'mbytn B : me t'mytyn
 21 shohim A, C : shohum B
- 7b/ 1 nan A : non B, C
 6 mos ma A, B : mos e C
 22 mos daj A : mos e daj B, C
 23 I gzon A, B : e I gzojn C
 24 Ilahi A : Ilahi shqip B, D : Arnautçe ilahi C
 24 Në kopjet B, C, D vargu 18 vjen para vargut 17.
 25 më ne rahmet ti bon Allah A : më ne bon merhamet Allah B,
 25 C, D
 26 nefsi si u A, C, D : nefsi u B
- 8a/ 1 jom A, B, C : jam D
 6 me gjith A : e gjith B, C, D
 7 sherri shejtanin A : hiqna shejtanin B, C, D
 8 na largo vet ti ja Allah A : m'ne bon merhamet Allah B, C, D
 12 bone A : bonna B, C, D

M
 poetry usi
 partially b
 Vasijetnar
 author wro
 historical
 it presents
 precisely t

Nehat Krasniqi

“Vasijetnameja” of Mulla Dervish Peja

Summary

Mulla Dervish Peja is the first Albanian poet from Peja who wrote poetry using the Arabic and Osman alphabet. Up to date, his activities have partially been presented. Here, for the first time we are publishing his work *Vasijetnameja*, professionally transcribed with the Albanian alphabet. The author wrote this work between 1805 – 1810. The work “*Vasijetname*” has a historical and literary importance as well as a dialectological one, given that it presents the language of Dukagjin at the end of the 18th century, more precisely the outskirts of Peja from where Mulla Dervish came from.

Doc. Dr.
Fakulteti

Ko
turqëve n
edhe të s
paraqitja
së turqëve
pas konta
nën sundi
fillojnë të
Natyrisht
edhe në
shqiptarëv
ngjyrë dhe
tona"².

Pran
botimi i t
turqisht, e
arabe. Ker
një nga sh
popullit sh

Hull
trashëgimi
përbashkët
dhe me fry
mënyrë të
shqiptarëv
shqipe pa
konsiderue
edhe G. Sh

¹. Nexhat
periudhën p

². Metin J

TEMATIKA E MISTICIZMIT ISLAM NË POEZINË E BEJTEXHINJËVE

Kontaktet e para të shqiptarëve me Islamin datojnë para ardhjes së turqëve në trojet shqiptare. Ato ishin kontakte më të hershme të Evropës, pra edhe të shqiptarëve me arabët respektivisht me islamimin.¹ Por, sado që paraqitja e Islamit dhe e kulturës islame ndër shqiptarët ndodh para ardhjes së turqëve në Ballkan, njohja e drejtpërdrejtë e shqiptarëve me Islamin bëhet pas kontakteve të tyre me turqit osmanlinj, pra pasiqë trojet shqiptare futen nën sundimin osman. Pas rënies nën sundimin osman shqiptarët me të madhe fillojnë të islamizohen, dhe për këtë ndikonin rrethana e faktorë të ndryshëm. Natyrisht që dërvishët endacak dhe tarikatat kanë luajtur rol të rëndësishëm edhe në islamizimin dhe ngritjen kulturore, shkencore e artistike të shqiptarëve, pra në zhvillimin e jetës kulturore islame. "Ato i kanë dhënë ngjyrë dhe ton të posaçëm atmosferës shoqëro-politike dhe fetare në viset tona"².

Prandaj detyrë parësore e jona është edhe grumbullimi, studimi dhe botimi i trashëgimisë së shkruar në gjuhët orientale arabisht, persisht e turqisht, e të mos flasim për krijimtarinë letrare të shkruar shqip me grafi arabe. Kemi parasysh trashëgiminë kulturore shqiptare islame, e cila është një nga shtyllat themelore të karakteristikave kulturore dhe kombëtare të popullit shqiptar.

Hulumtimi dhe studimi i kulturës shpirtërore e materiale dhe të trashëgimisë kulturore të popullit tonë, e cila ka lindur si rezultat i jetës së përbashkët shumëshekullore me popujt musliman nën Perandorinë osmane si dhe me frytet e saj kulturore me kulturën tonë autoktone duhet të bëhet në mënyrë të institucionalizuar. Dhe kjo trashëgimi shpirtërore e materiale e shqiptarëve e lënë në vepra të ndryshme në gjuhët orientale e në gjuhën shqipe padyshim që ishte një kontribut i çmuar dhe me vlerë të konsiderueshme për kohën e vet në kulturën orientale. Por siç konstaton edhe G. Shpuza: "Kjo pasuri me vlera të shumanshme deri vonë nuk u muar

¹ . Nexhat Ibrahim, *Kontaktet e para të islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane*, Shkup, 1997, fq. 102.

² . Metin Izeti, *Tarikati Bektashian*, Tetovë, 2001, fq. 68.

parasysh, sepse ajo nuk konsiderohej pjesë e kulturës shqiptare për rjedhojë as pjesë e historisë së saj³.

Megjithatë tash viteve të fundit ka filluar të mendohet ndryshe për këtë trashëgimi të begatshme kulturore, dhe kjo po bëhet preokupim më i shpeshtë i studiuesve⁴ të cilët e çmojnë dhe e vlerësojnë nivelin intelektual të atyre shqiptarëve që krijuanë në gjuhët orientale dhe kontribuan në zhvillimin e kulturës, dijes dhe në veçanti, letërsisë në gjuhët orientale dhe i vejnë në pah lidhjet me karakter të ndërsjellë të kulturës shqiptare me kulturën orientale-islame.

Kështu, mbi bazë të kësaj trashëgimie të shumtë kulturore, shkencore, fetare-islame, letrare e filozofike, të shkruar në gjuhët orientale, fillon të shkruhet edhe poezia shqipe me grafi arabe. Dhe kjo poezi shqipe e shkruar me grafi arabe, ose poezia e bejtexhinjëve siç njihet në letërsinë tonë, ishte poezi e qarqeve të caktuara intelektuale, por që përhapej shpejt, në një anë për shkak se tashmë nëpër të gjitha qendrat e mëdha kishte numër të konsideruar intelektualësh, të formuar në medresetë e shumta që funksiononin nëpër ato qendra dhe të cilët pëlqenin artin poetik dhe merreshin me përkthimin e veprave të njohura poetike sidomos persiane, por edhe të atyre arabe e turke, dhe në anën tjetër edhe për shkak se kultura islame ishte përhapur në popull dhe se ajo më nuk ishte e huaja për ta, sepse tashmë shqiptarët me shumicë i përkisnin fesë islame dhe rrjedhimisht edhe kësaj kulture.

Letërsia shqipe e shkruar me grafi arabe nuk lind rastësisht. Ajo lind në mjediset urbane ku kishte intelektual dhe një masë që dinin shkrim leximin arab, në mjediset ku ishin formuar qarqet kulturore ku vepronin medrese të shumta. Ajo lindi si nevojë e kohës pasi që ata krijues që deri dje krijonin në gjuhët orientale e panë se për të komunikuar me masat duhej krijuar në gjuhën amtare. Dhe kështu fillon të krijohet një poezi shqipe e ndikuar nga poezia orientale-islame si për nga forma e motivet edhe për nga teknika poetike, por që për lexuesit kjo teknikë poetike dhe këto forma e motive poetike nuk ishin të panjohura ngase ata poezi të këtillë kishin lexuar e dëgjuar në gjuhët orientale dhe nuk do mend se në atë kohë alfabeti arab ishte më i përhapuri ndër shqiptarët. Kjo poezi shqipe e shkruar me grafi arabe do të krijohet plot dy shekuj nga e cila do të trashëgojmë vepra të

³ Gazmend Shpuza, "Jeta letrare në gjuhët orientale në Shqipëri", Perla, 2001, nr. 1-4, Tiranë, fq. 3.

⁴ Gazmend Shpuza, *Jeta letrare në gjuhët orientale në Shqipëri*, në: Perla, 2001, nr. 1-4, fq. 3-13; Shaban Sinani, *Dorëshkrime orientale dhe tradita kulturore e Shqipërisë*, Perla, 2001, nr. 1-4, fq. 24-38; shih edhe: Hasan Kaleshi, *Roli i shqiptarëve në letërsinë orientale*, në: *Seminari i kulturës shqiptare për të huaj*, 2/1967, Prishtinë, fq. 151-217. (Fakulteti Filozofik). Shih edhe në: Hasan Kaleshi, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame*, Prizren, 1991, fq.112. etj..

bukura p
pjesë të l
Muhame
shqipe e
panagjiri
kasida (v

Në
misticizm
atë të be
ndriçuar,
mënyrë
shoqëror

Rr
ndryshme
islame në
Në qend
kulturës
krijuesit
të cilëve
njohja e
(arabe, p
poetë të

Be
me invol
Nezimi
Tij, si dh

L
L
L
Z

dhe pasta
pason be
jap munc

Ne
Je
As
ndoqën r
ata vetë
emri i vë

Be

⁵ Vargjet
Arkivin e

bukura poetike me vlera të çmueshme artistike me autorët e njohur të kësaj pjese të letërsisë së vjetër shqipe si: Ibrahim Nezimi, Hasan Zyko Kamberi, Muhamed Çami, Zenel Bastari, Dalip Frashëri e të tjerë dhe të cilët letërsinë shqipe e pasuruan si me tema të reja që trajtuan si përshkrimi, satira, panagjirika, ashtu edhe me forma të reja poetike, si mesnevia (poema), kasida (vjershë e gjatë-oda), ilahia (vjershë fetare), gazeli (lirika) e të tjera.

Në këtë shkrim dëshirojmë të vëmë në dukje tematikën e misticizmit islam dhe disa tipare të ndikimit të letërsisë orientale-islame në atë të bejtexhinjëve shqiptarë. Poezia e bejtexhinjëve ka qenë më pak e ndriçuar, e trajtuar në mënyrë të sipërfaqshme dhe disa herë e interpretuar në mënyrë të gabuar. Studiuesit tanë më tepër janë marrë me aktivitetin shoqëror e politik të shkrimtarit sesa me krijimtarinë letrare e artistike të tij.

Rruga e formimit të poetëve bejtexhinj ishte medreseja në vise të ndryshme të Shqipërisë, dhe një numër sosh edhe kishin vazhduar studimet islame në Stamboll, e në ndonjë qendër tjetër, ku qëndronin me vite të tëra. Në qendrat e tilla ata paiseshin me njohuri të shkëlqyeshme Islame, kulturës dhe rrymave të mendimit islam, sidomos mësonin shumë për krijuesit letrar e filozofët arabë, persianë e turqë, mendimet dhe pikëpamjet e të cilëve do të na reflektohen edhe në krijimtarinë e tyre letrare. Pikërisht njohja e tyre e mrekullueshme e thesarit të pasur të letërsisë orientale-islame (arabe, perse e turke) bënë që ata të formoheshin e të komplettoheshin si poetë të mirë të kohës që njihnin shumë mirë artin poetik.

Bejtexhinjtë, si në mbarë poezinë islame, zakonisht poezitë i fillojnë me invokacion, falënderim Zotit dhe lavdrim profetit Muhammed, p. sh. Nezimi shkruan se Divanin e ka nisur në emër të Zotit dhe dashurisë ndaj Tij, si dhe që zemra i rrah për profetin Muhammed:

*Bismil-lahi nisa divanë
Për sevda tënde ja Mevla,
Për Muhammed Mustafanë
Zemra rrate ja Mevla⁵.*

dhe pastaj në frymë të misticizmit islam, për të shprehur nënshtrimin e tij, pason bejti ku thotë se Nezimi nuk e do kënaqësinë dhe kërkon nga Zoti t'i jap mundim:

*Nezimi s'e do sefanë
Jepi xhefanë, ja Mevla.*

Ashtu sikur vepronin poetët e Orientit edhe bejtexhinjtë shqiptarë e ndoqën rrugën e tyre për të përdorur emra poetik (mahlas) dhe si zakonisht ata vetë e shpjegojnë në poezitë e tyre se cili është emri poetik i tyre e cili emri i vërtetë. Kështu vepron edhe më i madh i tyre Nezimi:

*Benim mahlasëm Nezimdir**

⁵ Vargjet e Nezimit i citojmë nga Divani i Nezimit që në dorëshkrim ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë me signaturë F. 43, D. 2 dhe F. 43, D. 3.

Emrin e kam Ibrahim.

e kështu kishte vepruar edhe Muçi Zade autori i vjershës më të vjetër shqiptare me grafi arabe *Imzot, mos më lerë pa kave*, një lutjeje humoristike të përbërë nga shtatëmbëdhjetë strofa katërshe e cila daton nga viti 1725 e që përfundon me këto vargje:

*Lut-iu Zotit Muçi Zade,
se heq bari shumë derde,
se s'ke as pilaf as zerde!
Imzot, mos më lerë pa kave!*⁶

Kështu, duke lexuar poezitë e poetëve më të hershëm I. Nezimit, S. Naibit, H. Z. Kamberit, M. Çamit, Z. Bastarit, D. Frashërit, por edhe të atyre të mëvonshëm Tahir Boshnjakut, Dervish Salihut, Sheh Malës e të tjerëve mund të hetojmë se ata nga çdo aspekt janë nën ndikim të poezisë orientale-islame. Tek e fundit edhe te popujt e tjerë të islamizuar ishte vështirë të gjeje ndonjë poet krejt origjinal. Si shumë poetë turqë, edhe bejtexhinjtë shqiptarë ishin të ndikuar shumë nga poetët klasik të famshëm persian duke u përpjekur që mangësinë e ideve ta kompenzojnë me virtuozytete gjuhësore e poetike.

Natyrisht me qëllim që lexuesi ynë të kuptoj më mirë poezinë mistike islame, duhet të paiset me njohuri më të gjera rreth misticizmit islam-tesavufit, zhvillimit të tarikateve/rendeve dervishe në botën islame e në Shqipëri për çka edhe kohëve të fundit kemi disa botime⁷.

Nuk ka dyshim që numri më i madh i poezive të bejtexhinjëve, duke filluar nga Nezimi janë të karakterit fetar, janë poezi mistike islame dhe del se misticizmi islam ishte karakteristikë dalluese për shumë shkrimtarë shqiptarë që shkruan me grafi arabe. Tek e fundit ata ishin formuar në këtë frymë, andaj edhe morali i tyre dhe përgjithësisht, mendimi që kanë për jetën dhe botën është i karakterit fetar-mistik islam. Kjo ndodh për shkak se të

¹ Emri im poetik është Nezim.

⁶ Cituar sipas: Osman Myderrizi, *Letërsia shqipe me alfabetin arab*, Buletini i shkencave shoqërore, 2 / 1955, (fq. 148-154). E kështu vepronë gati të gjithë në gazelet e tyre ku në bejtin e fundit (makta) përmendin emrin e tyre ose edhe të dilberit - murshidit të tyre.

⁷ Dr. Selçuk ERAYDIN, *Tesavufi dhe tarikatat*, Tetovë, 2001, f. 428; Jashar Rexhepagiqi, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, Dukagjini - Pejë 1999, f. 282; Hans Joachim Kissling, *Derviški redovi i pučki islam*, SUFIZAM, Izdanje "Vuk Karadžić", Beograd, 1981, s. 118-126; Nedim Filipović, *Tasavvuf - islamski misticizam*, Prilozi za orijentalnu filologiju, XXIV / 1974, Sarajevo 1976; Metin Izeti, *Tarikati bektashian*, Tetovë, 2001, f. 184; Baba Rexhepi, *Misticizma islame dhe Bektashizma*, Nju-Jork, 1970 dhe në Tiranë, 1995; Robert Elsie, *Islam and the dervish sects of Albania*, *The Islamic Quarterly A Review of Islamic Culture*, Volume XLII, Number 4, 1998, London, England, (fq. 266-289), etj.

gjithë ata marrë me ata edhe ja merreshin vetëdijen k ai iluminia

Kjo fundit, refl nëpërmjet pakënaqësi dedikohej, shoqëroro-kjo ishte p masës.

Pikë më së pak komplekse e veçantë s quhet islam

Kësh interpretuar kuptimet e tekstuale, e Tema që m njohja e Z gjëje dhe i gjallesa e k

Dy ja ekzoterik d e parë e zh pretendojnë Muhammed dijetarët të plotësojë n -sheriatis. H merret krye

⁸ Me sa dijme bërë Mr. Hajd

⁹ Nedim Fi 1976, s. 13.

¹⁰ Më gjerës Metin Izeti, T

gjithë ata dijetarë islam të paisur me moral e dituri islame gjatë jetës janë marrë me përhapjen e këtij morali dhe këtyre diturive islame, dhe nga masa ata edhe janë konsideruar si persona të shquar në jetën fetare, sidomos ata që merreshin me doktrinën e misticizmit islam. Natyrisht që kjo nuk përjashton vetëdijën kombëtare, mbase edhe angazhimin e tyre jashtë vetëdijes fetare, si ai iluminist, patriotik e shoqëror.

Kjo poezi, e cila flet për moralin islam, për përsosjen shpirtërore, tek e fundit, reflekton edhe rrjedhat shoqërore që në atë kohë zhvilloheshin edhe nëpërmjet vetëdijes fetare. Dhe duke pasqyruar kështu edhe preokupimet e pakënaqësitë shpirtërore e fizike të masave fetare islame të cilave u dedikoheshin, ka shprehur në këtë mënyrë edhe nivelin e përgjithshëm shoqëroro-kulturor të kohës kur ka jetuar e vepruar poeti. Në fund të fundit, kjo ishte poezia e cila i përshtatej nivelit të vetëdijes fetare e kulturore të masës.

Pikërisht poezia mistike islame e bejtexhinjëve shqiptarë kujtojmë që më së paku është studiuar⁸. Ndërsa siç dihet si temë shumë e gjerë dhe komplekse "Misticizmi islam nuk mund të vështrohet i izoluar, si veprimtari e veçantë spirituale, por duhet të merret në kompleks të asaj çështje e cila quhet islam dhe civilizimi i tij"⁹.

Kështu, misticizmi islam është zhvilluar duke medituuar dhe interpretuar temat e ndryshme Kur'anore, sidomos duke u thelluar në kuptimet e fshehta spirituale, që ndryshojnë nga kuptimet e dukshme e tekstuale, e nga kjo dalin edhe kuptimet themelore të misticizmit islam. Tema që më së shumti meditohej në misticizëm, padyshim ishte përsiatja e njohja e Zotit të gjithëfuqishëm, i cili bën çka don, i cili është krijues i çdo gjëje dhe i cili është i përhershëm e i pambarim, përderisa të gjitha ato gjallesa e krijesa të Tij do të mbarojnë e shkatërrohen.

Dy janë aspektet në bazë të të cilëve mund t'i qasemi islamit: aspekti ekzoterik dhe aspekti ezoterik. Këto dy aspekte vijnë në shprehje që nga faza e parë e zhvillimit të islamit. Që të dy këta aspekte të qasjes ndaj islamit pretendojnë të kenë mbështetjen e vet në Kur'an dhe në traditën e profetit Muhammed (synnet)¹⁰. Kështu, si bartës të islamit egzoterik paraqiten dijetarët të cilët konsiderojnë që detyra themelore e çdo muslimani është t'i plotësojë normat religjioze dhe morale të përcaktuara në bazë të ligjit hyjnor -*shariatit*. Pra kjo anë e mendimit të të kuptuarit dhe të zbatuarit të fesë merret kryesisht me rregullat e jashtme të saj. Ndërsa dijetarët e islamit

⁸ Më sa dijmë analizën më të mirë rreth karakterit mistik të poezive të bejtexhinjëve e ka bërë Mr. Hajdar Salihu, shih: *Poezia e bejtexhinjëve*, "Rilindja", Prishtinë, 1987.

⁹ Nedim Filipoviç, *Tasavvuf - islamski misticizam*, POF, XXIV / 1974, Sarajevo, 1976, s. 13.

¹⁰ Më gjerësisht shih: Dr. Selçuk Eraydin, *Tesavvufi dhe tarikatat*, përktheu Metin Izeti, Tetovë, 2001.

ezoterik synojnë njohjen e Zotit. Dhe sipas tyre me respektimin e udhëzimeve praktike të shariatit mund të jesh në harmoni me hakikatin, por nuk mund të vish deri te njohja e Tij -*ma'rifa* e cila është njohje e të vërtetës absolute (hakikat). Të njohësh të vërtetën, sipas tyre, domethënë të njësosh me të, të jesh një me Allahun.

Gjithë kjo që u tha, na shërben të shpjegojmë kompleksin e realitetit historik e fetar nga të cilat do të dalë tesavufi, pra misticizmi islam i cili ekzistimin e vet e ka mbështetur në interpretimin ezoterik të islamit. Misticizmi islam orientohet kah mendimi i thellë, e i lirë, që nënkupton mësimin e brendshëm të fesë. Dhe tesavufi tash, pos anës formale të fesë, merret me esencën e saj, me hulumtimin e të padukshmes, të fshehtës, pretendon njohjen e së vërtetës, Zotit. Pikënisje e misticizmit islam është Tevhidi, mësimi për njëshmërinë e Zotit. Dhe, sipas misticizmit Zoti njihet me zemër e jo me mendje dhe mund të njihet vetëm atëhere kur uni njerëzor shlyhet pranë pambarueshmërisë së Zotit. Sipas përfaqësuesve të misticizmit, të njohësh të vërtetën domethënë të njësosh me të, të jesh një me Allahun. Dhe kështu fillon përhapja e rrymës së tesavufit që si fazë të hershme ka atë të shekullit VIII e pastaj fazë të zhvillimit të vet të theksuar atë të shekullit X -XII kur tashmë fillojnë të lindin rendet (tariketet) islame¹¹ dhe tashmë pos Sirisë, e Bagdadit, kjo frymë e të menduarit mistik islam kalon në Iran, Turqi e Indi dhe pastaj edhe në vise të tjera. Dhe në këtë mënyrë do të zhvillohet letërsia shumë e pasur sufiste e josufiste në të cilën ideologjia e tesavufit edhe tematikisht edhe artistikisht do të ndikoj thellë.

Po ashtu, shumë bejtexhinj shqiptarë kanë qenë ihtarë të ndonjë tarikati, jo vetëm për faktin se në shekujt XVIII e XIX shumë dijetar të dalluar kanë qenë pjesëtar të ndonjë tarikati mistik, por për faktin se një numër i madh i poezive të shumë bejtexhinjëve, jo vetëm që janë me karakter fetar, por thjesht kanë të gjitha karakteristikat e poezisë së misticizmit islam të shkruara sipas modelit të poezive mistike të kohës në të cilën krijohej. Në mesin e atyre poezive mistike, ka asosh me të cilat synohet të formësohet e të mbjelllet te masat mendimi fetar dhe të njihen ata me rregullat fetare, mbi të gjitha me ato të tarikateve që mëtojnë që njeriun ta shpënë sa më afër pranisë së Perëndisë duke u përshkruar dervishëve mënyrën e rrugën të cilën duhet ta ndjekin, ku duhet të kalojnë nëpër shkallë

¹¹ Tarikat është shumësi i fjalës Tarik që do të thotë: rrugë për të njohur Zotin, respektivisht zhvillimi praktik i jetës i plotësuar sipas rregullave dhe principeve të përcaktuara të asaj rruge. Çdo tarikat ka themeluesin e vet sipas të cilit edhe është emërtuar. Për tarikatat shih: Dr. Selçuk ERAYDIN, *Tesavufi dhe tarikatat*, Tetovë, 2001, f. 428; Jashar Rexhepagiq, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, Dukagjini - Pejë, 1999, f. 282; Hans Joachim Kissling, *Derviški redovi i pučki islam*, në: *Sufizana*, Izdanje "Vuk Karadžić", Beograd, 1981, s. 118-126; Metin Izeti, *Tarikati Bektashian*, Tetovë, 2001, fq. 184 etj.

të caktua
veçantë e
duhet t'i
"Ah un i i

A
e
M
ç

A
n
C
d

E
l

Ker
kalojnë n
shkallën e
arrihet te
përshkruh

Tes
arrihet afë
n njihet vet

sufist, org
është zem

(mahabba
njeriut nd

e tyre shp
vëmendje

gjithpërfsh
Zotin nuk

krejt deri

kur mistik

kulmore e

Po

në veçant

mënyra e

pastaj të p
arsye Nez

¹² Cituar s
alfabet ara

të caktuara. Prandaj të gjitha këto shkallë e faza kalojnë me kujdes të veçantë dhe me mbikqyrje të udhërrëfyesit (murshidit) shpirtëror të cilit duhet t'i nënshtrohen bindshëm. Këto shkallë përshkruhen mirë në poezinë "Ah un i mjeri kesh tu fjet" të Dervish Hasanit:

*Ah, un i mjeri kesh tu fjet
e m'dul gjumi per ahiret,
Me ni myrshid jam perpjek,
çka m'kallzojti ah medet.*

*Ai mi çeli kater dyer,
njonda osht ah sheriat
Osht e dyta tarikat
dera tret hakikat;*

*Edhe njonda osht marifet
lumi ai qi e ka gjet.¹²*

Këto shkallë (sheriat, tarikat, hakikat, marifet), që dervishët duhet t'i kalojnë me devotshmërinë dhe adhurimin e tyre ndaj Zotit për të arritur shkallën e njeriut të përsosur, të pastër e të patëmeta dhe kështu të mund të arrihet te njohja e Zotit dhe te shijimi i bekimit dhe kënaqësisë së Tij, përshkruhen në poezi të shumë bejtexhinjëve.

Tesavufi përqëndrohet në mendimin për Zotin, në dëshirën që të arrihet afria e Zotit dhe mëshira e Zotit, të njihet Ai. Ndërkaq, Zoti mund të njihet vetëm në përputhje me fjalët "Nuk ka hyjni pos Zotit". Sipas mësimi sufist, organi me të cilin njeriu e njeh praninë e Zotit nuk është mendja, por është zemra. Tash si mjet për t'iu afuar Zotit është dashuria ndaj Zotit (mahabba/ashk). Në këtë dashuri kemi procesin metafizik të dashurisë së njeriut ndaj Zotit. Dhe dashuria e zjarrtë e mistikëve ndaj Zotit dhe avanturat e tyre shpirtërore të vuajtjes si metoda të të afuarit ndaj Zotit kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve. Dashuria e mistiku është si një medium jomaterial gjithpërfshirës dhe energji e takimit të njeriut dhe Zotit. Ndërsa mistiku me Zotin nuk njehet (nuk bashkohet) substancialisht, por me anë të dashurisë, krejt deri të më e larta "Unë" nëpërmjet të dialogut të zemrës dhe Zotit. Pra kur mistiku e thekson varshmërinë absolute ndaj Krijuesit, lind kënaqësia kulmore e llojit të vet e vetëmohimit dhe të dëshmimit të Zotit me plot zell.

Po ashtu nga poezitë mistike të bejtexhinjëve tanë ka asosh në të cilat në veçanti trajtohet dashuria ndaj Zotit, dashuri e cila për mistikun është mënyra e drejtpërdrejtë për të arritur te njohja dhe përfytyrimi i Zotit e që pastaj të pasoj shlyerja e individualitetit të tij dhe njësimi me Zotin. Për këtë arsye Nezimi betohet se "Sirrë (fshehtësinë) e ashkut kush nuk e di / bil-lahi

¹² Cituar sipas: Muhamet Pirraku, *Gjurmë të veprimtarisë letrare shqipe me alfabet arab në Kosovë*, në: DITURIA, nr. 1-2, 1978, Prishtinë, fq. 91.

që s'është njeri", dhe sipas tij "ai që e mohon ashkun / nuk është insan, është gomar" dhe shkon deri atje sa që të tillin ta konsideroj pa iman:

*Një që shanë ashikërinë
Ka bërë inqar Perëndinë,
A s'e vritni faqezinë,
A s'e vritni!*

ose në të cilat përshkruhet mënyra e kryerjes së ritualeve mistike-dhikri (ziqri), të përmendurit e emrit të Zotit zëshëm duke u përcjellë edhe me muzikë e vallëzim që simbolizon aktin spiritual në rrugë të privimit të vetes, ku krijohet atmosfera e ekstazës mistike e cila sufijtë i shpie në rrugën e vetëshkatërrimit, në ndarjen e shpirtit nga trupi dhe kështu të arrijnë gjendjen e njësimt me Zotin, përkatësisht njohjen e Zotit. Kështu Sheh Jonuzi shkruan:

*Me e dit nehsin, ziqer Zotin
Me e bo sabri osh ilaq,
Me nur të ziqrit shëndoshe zemrën
Ziqri daim është ilaq.¹³*

Dhikrin si ceremoni e ushtrojnë të gjitha tarikatet. Udhëtimi shpirtëror i sufiut sendërtohet vetëm nëpërmjet dhikrit. Dhe siç shkruan S. Eraydin, qëllimi i jetës së njeriut është arritja e përsosshmërisë dhe vështrimi i bukurisë hyjnore. Kjo përsosshmëri arrihet vetëm me ndihmën e dhikrit. Njerëzit që bëjnë dhikër dalëngadalë i braktisin kënaqësitë e kësaj bote dhe në zemër vendosin dashurinë ndaj Allahut xh. sh. Njeriu i cili e përkupton Allahun xh. sh. me qetësi shpirtërore në fund arrin gradën e ihsanit (bërja e ibadetit sikur e sheh Allahun) dhe afërsinë me Krijuesin.¹⁴

Cak i rrugës mistike, respektivisht i udhëtimit shpirtëror është tejkalimi i egos dhe kjo rrugë nuk mund të kalohet pa murshid/rehber (udhëheqës shpirtëror). Mistiku në këtë udhëtim shpirtëror futet pasi të jetë përgatitur mirë, pasi të jetë pastruar mirë zemra e tij. Ai duhet të jetë i vendosur, i durueshëm për t'i përballuar vështirësitë e ndryshme me të cilat ballafaqohet dhe t'i nënshtrohet udhëzimeve të murshidit të tij i cili në mënyrë graduale e shpie në shkallë të ndryshme shpirtërore. Dhe natyrisht se në këtë rrugë peripecitë janë të shumta sepse siç shprehet edhe Nezimi:

*Pa mos hequrë një mushkil
Kush u bë naili meram!*

që domethënë se askush nuk e arrin qëllimin pa vuajtur e hjekur mundime në rrugën për njohjen e Zotit.

¹³ Mr. Hajdar Salihu, *Poezia e bejtexhinjëve*, "Rilindja", Prishtinë, 1987, fq.299.

¹⁴ Dr. Selçuk ERAYDIN, *Tesavvufi dhe tarikatet*, Tetovë, 2001, fq. 117.

Ndër
tij shpirtëro
Babai thotë

Fsh

Dh

Sh

Q

dhe mistik
sepse poqë
iniciativën
synimin që
një strofë e
i tarikatit e
rrugën dhe
vështirë ve

So

Pe

Ri

M

Po

përdorur e
kuptuar e
sidomos r
edhe në t
termat e
me tarika
terme e n
edhe vet
filozofinë
shpirtëro
luan rol
doktrina

Ar

përgatitje
poezitë e
tyre, po

¹⁵ Mr. h

* Salik - p

* Rahi - u

* Rehber

* Mushk

Ndërsa gjetja e murshidit për mistikun që do ta përcjell në udhëtimin e tij shpirtëror është e domosdoshme, kështu bejtexhiu Muharrem Mahzuni Babai thotë:

Fshi lotët nga sytë

Dhe kërko mejdan,

Shiko gjej myrshidin

Që të bën derman.¹⁵

dhe mistiku duhet t'i nënshtrohet bindshëm udhërrëfyesit, apo mësuesit, sepse poqëse nuk e dëgjon dhe futet në udhëtim shpirtëror i mbështetur në iniciativën e vet, ai nuk do të arrij sukses kurrë dhe nuk mund të arrij synimin që të përjetoj dritën e njohjes së Krijuesit. Këtë e kuptojmë edhe nga një strofë e një poezie të Nezimit ku shohim se një salik që është bërë anëtar i tarikatis dhe ka marrë rrugën e udhëtimit shpirtëror pa udhëzues ai nuk e di rrugën dhe mundohet ta gjej sipas mendjes së vet prandaj edhe e ka shumë të vështirë vendqëndrimin të cilin duhet kaluar gjatë udhëtimit shpirtëror:

Sot një salik u bë rahi**

Pa rehber udhënë s'e di*

Rreh ta gjenj me mend të ti

Mushkil menzili ti gajet.*

Po ashtu te bejtexhinjtë tanë terminologjia e misticizmit është përdorur dendur që dëshmon për karakterin mistik të poezive. Prandaj për t'i kuptuar e interpretuar këto poezi duhet paisje e gjerë intelektuale islame, dhe sidomos njohje e zhvillimit të tesavufit dhe të tarikateve në botën islame, po edhe në trojet shqiptare, e në veçanti të njihen e të kuptohen nocionet e termat e shumtë, të cilët janë të lidhur ngushtë me misticizmin, respektivisht me tarikatatet. Ato nuk duhet marrë thjesht si fjalë leksikore, por më tepër si terme e nocione me kuptim të caktuar teorik e filozofik. Sepse këto terme, si edhe vetë praktika e ritualeve kanë të bëjnë me psikologjinë, etikën, filozofinë e religjionit, kulturologjinë, letërsinë dhe jetën e situatat shpirtërore, se ato janë simbole poetike. Dhe në doktrinën mistike simboli luan rol shumë të rëndësishëm për arsye se sipas mendimit të mistikëve, doktrina ezoterike mund të transmetohet vetëm me ndihmë të simbolit.

Arsyeja pse bejtexhinjtë shqiptarë shkruajnë poezi fetare, do parë në përgatitjen e tyre fetare si dhe te masa me të cilën komunikonin ata me poezitë e tyre nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, edhe në faktin se në kohën e tyre, poezia më e realizuar dhe më e kërkuar për masat e gjera popullore në

¹⁵ Mr. hajdar Salihu, *Poezia e bejtexhinjëve*, Prishtinë, 1987, f.237.

* Salik - pasues (anëtar) i një tarikati, udhëtar shpirtëror.

* Rahi - udhëtar.

* Rehber- udhërrëfyes.

* Mushkil menzili ti gajet - është i vështirë shumë vendqëndrimi i tij.

botën islame ishte poezia mistike me poetët e njohur të misticizmit, që ishin inspirim për poetët e ardhshëm të të gjithë popujt islam. Dhe, siç thamë, mëtim kryesor i poezisë së tesavufit ishte njohja e Krijuesit dhe e Islamit. Natyrisht, në rrugën e tyre të njohjes së Krijuesit të gjithësisë dhe Islamit poetët shqiptar janë nën ndikim të mistikëve të njohur të botës islame dhe të mësimëve të tyre, e kjo edhe do të ndikojë shumë në strukturën e poezisë së tyre. Këta poetë në poezitë e tyre moto kishin krijimin e njeriut të përsosur - *insani kamil*, njeriut me shpirt të pastër, me vrytje të larta morale, me kulturë e vetëdije të theksuar fetare islame duke besur se në këtë mënyrë do të mënjanoreshin veçoritë e këqija të njerëzimit. Ata pra synojnë një shoqëri ideale, një shoqëri të devotshme fetarisht e të pastër moralisht sipas rregullave që përcakton Islami. Ndërsa këto edhe ishin koncepte të përgjithshme në poezinë orientale islame. Këto ishin tema që dominonin në poezinë orientale islame, me forma vjershash e mjete të njohura stilistike të poetikës orientale.

Nga poezitë e disa bejtexhinjëve që mund t'i lexojmë nëpër veprat e studiuesve tanë, mund të shihet se ata i njihnin thellë disiplinën e dijes islame, problematikën e mendimit islam, sidomos thellimin e tyre në çështjen e transcencës së Zotit, përfytyrimin e njohjen e Zotit që ishte bërë bosht i poezisë së misticizmit islam, ngase islami burimor ndalonte të menduarit e thellë rreth kësaj çështjeje duke u njafuar me ato që thotë Allahu për vetë. Sidomos, vërehet ndikimi i klasikëve të njohur mistik si Xhami, Attari, Gazaliu, Hal-laxhi, Rumi, Emre, Fuzuli etj., si edhe i teknikës letrare të kohës, respektivisht i letërsisë orientale islame. Madje, jo që lehtë vërehen reflektimet dhe ndikimet e poezisë orientale, porse ato janë të shkruara si poezi shqipe e asaj shkolle, sepse lidhjet poetike të tyre me poezinë orientale-islame janë të natyrshme, madje edhe të pashmangshme, pasi që ata u shkolluan e u formuan në ato shkolla dhe në atë frymë. Kështu, jo vetëm që kompozicioni dhe forma në shumë poezi të tyre plotësisht u përgjigjen atyre të natyrës së këtyllë të poetëve të tjerë mistik - oriental, por edhe pjesë të caktuara të poezive të tyre mistike, na dalin shumë të ngjashme me pjesë të poezive mistike turke, persiane e arabe. Prandaj integrimi i gjithanshëm i ndikimeve të përmendur, që mund të argumentohen qysh të krijimtaria e Nezimit, krijuesit më të hershëm të bejtexhinjëve që njohim sot, do të vërehen në tërë krijimtarinë e bejtexhinjëve që është pjesë përbërëse e letërsisë shqipe, dhe gjithësi këto ndikime duhet të merren edhe si tregues të nivelit të depërtimit të kulturës islame të intelektualët dhe të shtresat e gjera popullore shqiptare.

Dhe për fund, të themi se këto vepra, (veprat shqipe me grafi arabe) të cilat ende kanë mbetur të pabotuara, pos fragmentarisht, nga disa poezi të autorëve të caktuar, pa marrë parasysh kohën kur janë shkruar, kanë rëndësi në dhe peshën e vet, sepse tek e fundit i kanë kontribuar zhvillimit të mendimit shoqërorë, kulturës, e mbi të gjitha zhvillimit të letërsisë shqipe. Fundja, shumëllojshmëria e mendimit fetar e kulturor për çdo popull duhet të jetë begati, sepse ato shprehin aktivitetin e shpirtit njerëzor të popullit tonë dhe du-

het të ku
gjithnjë k
përbërëse
suar në v
pjesë të l
nat kanë
pjesë e l
që e meri

Dr. Abdu

where in
themes o
literature
consider
social ar
artistic c

schools o
of the cl
reflected

Albanian
the case
general
motto of
virtues,
spiritual

Th
poetry.
intellect
the poet
the deve
Albanian

het të kuptojmë se edhe këto vepra ishin veprimtari e shoqërisë sonë dhe gjithnjë kanë mëtur që të mos jenë një tërësi e ndarë, por të jenë si një pjesë përbërëse e një tërësie kulturore, letrare shqiptare. Këtë jo rrallë e kanë theksuar në vargjet e tyre krijuesit e tillë. Qëndrimi i shoqërisë sonë ndaj kësaj pjese të letërsisë shqipe ka qenë inferior e mospërfillës. Ndërsa tashti rrethana kanë ndryshuar, është krijuar realitet i ri në të menduarit dhe edhe kjo pjesë e letërsisë sonë ka filluar të trajtohet drejt e mbarë, dhe t'i jepet vendi që e meriton e që duhet ta ketë në tërësinë tonë letrare-kulturore.

Dr. Abdullah Hamiti

The themes of Islam mysticism in the poetry of folk poets summary

The Albanian poetry written in Arabic alphabet arose in urban areas where intellectuals and literate people lived. Here we are considering the themes of Islam mysticism and some features of the impact of oriental Islam literature on the part of Albanian folk poets. This aspect has not been considered sufficiently given that our scholars have mostly dealt with the social and political activities of a writer rather than with his literary and artistic creativity.

The Albanian folk poets were excellent experts of Islam, culture and schools of the Islam opinion. They were well acquainted with the creativity of the classic Islam poets, the opinions and viewpoints of them are also reflected in literary creativity.

There is no doubt that the largest number of poems written by Albanian folk poets, starting from Nezimi, have a religious character. This is the case knowing that they were educated in this spirit and their moral or in general their opinion for life and the world is of an Islam character. The motto of this Islam mystic poetry was to create a perfect man, with a spirit, virtues, culture, and a high Islam religious conscience. This being the spiritual path to learn about God.

The poetry of the folk poets was impacted by the Islam oriental poetry. Therefore, they are indicators of the Islam cultural level of intellectuals and overall levels of the then society. It is worth mentioning that the poetry of the folk poets is important for us given that it has contributed to the development of the social opinion, culture and development of the Albanian literature.-kulturore.

Prof. She

Shp
private më
Tematikë
bukur shq
sociale, p
poligonale
M. Kyçyk
një studiu
të skulptur
kulturës sh

Var
në rrezën
të tij ku k
shqiptarë
ku ai bëri
Bir i një
vazhdoi e
dhe përve
turqishten
dhe i ditur
ta çuar për
tij besimta

Në
lidhej me
autorë gaz
madhësht
nxënësit q
arab. Edhe
përballont

M.
përkthime
problemin
atdhetari i

HAP I RI DREJT ARTIT TË MUHAMED ÇAMI-KYÇYKU (1782-1844)

Shpupurishja nëpër skedare të disa bibliotekave dhe të disa arkivave private më çuan te veprat e Muhamet Çamit, të shkruara dy shekuj më parë. Tematikë e kohës së shkuar, pasqyrë e shekujve XVIII-XIX. Çamërishte e bukur shqipe, e pasur, që me veshjen e saj artistike paraqet problematikë sociale, psikologjike, urbane, që ngrit autorin në rangun e një figure poligonale në qendër të shoqërisë çame, që e njeh edhe me një emër tjetër: M. Kyçyku. I denjë për t'u rimarrë i ridimensionuar nga pena mjeshtërore e një studiuesi të traditës dhe për t'u gdhendur në përjetësi nga dalta e një ustai të skulpturës, ky përfaqësues duhet të zërë vendin që i përket në historinë e kulturës shqiptare.

Vargjet e veprave të tij më sollën përpara, si në ekran, malin e Milesë, në rrëzën e të cilit shtrihet Konispoli, vendlindja e Çamit, shkollën e mesme të tij ku këndohej mevludi shqip, varganet e gjatë të mërgimtarëve të varfër shqiptarë që tjetërsoheshin në dhe të huaj, ateneun e famshëm të Al-Az'harit, ku ai bëri studimet e larta.

Bir i një familjeje të pasur, Muhameti, pasi mbaroi studimet brenda vendit, vazhdoi edhe dhjetë vjetë të tjerë jashtë, ku u formua nga ana intelektuale dhe përvetësoi tri gjuhët klasike të Lindjes islame: arabishten, persishten, turqishten e periudhës osmane. U kthye në vendlindje në moshë të pjekur dhe i ditur, plot ëndrra për ta bërë shkollën e Konispolit qendër kulture, për ta çuar përpara veprimtarinë artistike në vendlindje, për t'i bërë pasardhësit e tij besimtarë të denjë dhe qytetarë të përkorë.

Në vendlindje ai gjeti zanafillën e një tradite artistike në formim, që lidhej me dy emra vjershëtorësh: Nezim Beratin dhe Hasan Zyko Kamberin, autorë gazelesh, kasidesh dhe divanit shqip. Gjete gjithashtu një medrese madhështore, ku mësimet zhvilloheshin në gjuhë të huaj, por të paktë ishin nxënësit që i zotëronin ato. Nxënësit flisnin shqip, por shkruanin me alfabet arab. Edhe ai vetë nuk pati dijeni për ndonjë alfabet tjetër që mund të përballonte tërë tingujt e gjuhës shqipe.

M. Çami-Kyçyku iu kushtua krijimtarisë artistike, përshtatjeve, përkthimeve në gjuhën amtare, pa ndonjë përpjekje për të zgjidhur problemin e alfabetit, nga e majta në të djathtë, që e mbrojti më vonë atdhetari i tij Hasan Tahsini.

Duke mos pasur angazhime ekonomike, u mor me njohjen e folklorit nga i cili huazoi vargun e tij 8-rrokësh, shprehjet e tij karakteristike dhe në bazë të tërë krijimtarisë së tij letrare vuri dialektin çam. Krijoi bibliotekë personale, ku shquanin veprat e teologjisë islame, ato artistike si të Firdusit (Firdavsi), Xhamiut, Al-Busirit etj. Bëri për vete një varg studentësh që u përpoqën ta shëmbëllojnë ustain e tyre dhe shkroi, sipas të dhënave të besueshme, 17 vepra që e përfaqësojnë opusin e tij. Ky opus ngërthen novelën artistike, poemën e gjatë, pamfletin, panegjrikën, veprën agjeografike, temën fetare etj.

Vokacioni i mësuesit u përpunua tek ai gjatë studimeve 21-vjeçare që bëri për teologji e filozofi. Ai iu përkushtua profesionit të mësuesit për 34 vjet dhe arriti piketa të larta: letërsisë shqipe i dha të parën novelë artistike, gjuhësisë shqipe të folmen e punuar çame, si gjuhë mësimi në shkollën shqipe, aljamiadës opusin e tij të madh, traditës një përfaqësues të shquar, Konispolit emrin dhe veprën e tij.

Vepra e tij i ngjet një poliedri ku shquan sidomos poeti, gjuhëtari, pedagogu, tekstologu dhe sociologu. Le ta analizojmë në këtë fokus këtë poliedër të shoqërisë shqiptare të shekullit XVIII-XIX.

Muhamet Çami - Poet

Vendlindja e poetit që vendi i ekstremeve, por njëkohësisht edhe gurrë e pasur e krijimtarisë popullore. Folklorin e saj e frymëzonin nga njëra anë blegtorët e shumtë që endeshin bjeshkëve nëpër pllaja e bashтина dhe çukave e gërxheve, të shoqëruar nga kopetë e tyre, duke kërkuar kullota, kurse nga ana tjetër muhaxhirët që ndërmerinin rrugët e gjata të mërgimit plot vuajtje të papritura të përtej detit, duke kërkuar një jetë më të mirë. M. Çami që i ndjeshëm, natyrë kureshtare, i bindur ndaj principeve të shoqërisë që përfaqësonte, edukator në misionin e tij. Ai u mbërthye pas problemeve që tronditnin shoqërinë e tij, mjediset me të cilët përballëj çdo ditë.

"Erveheja" është një pjellë e këtij preokupimi. Është modeli i gruas që ëndërronte të edukonte M. Çami, ashtu siç është "Jusufi" te poema "Jusufi dhe Zelihaja", modeli i mashkullit.

Në rreth 900 vargje novela "Erveheja" bën hapin e parë në këtë gjini të letërsisë sonë. Me botimin e saj më 1888 nga Jani Vretoja në Bukuresht, ajo u bë libri më i lexuar gjatë periudhës së Rilindjes sonë. Më vonë ajo tërhoqi edhe skenën e teatrit. Më 1967 u shfaq në skenën e teatrit të Prishtinës, kurse pesë vjet më vonë edhe në atë të Tiranës. Vepra e M. Çamit i kishte rezistuar kohës. Nga shkrimtarët e vjetër shqiptarë M. Çami (pas dramës "Besa" të S. Frashërit) është nga të rrallët që u duartrokoi nga publiku artdashës.

Subjekti i novelës "Erveheja" nuk është origjinal, por i përpunuar. Për burimin e huazimit të këtij subjekti janë bërë disa hamendësime. Të gjitha këto të çojnë në thesarin letrar të Lindjes. Autori shqiptar e përpunoi fabulën

e saj. I dh
Ervehesë p
këtë novel

Në i
paraqitet c
është e
psikologji
ndonëse p.

Jani
përpunuar
botoi më
ishin botu
min e tij
qëroi nga
lexuar, se
kopje edhe

Një
"Jusufi d
Jusuf" e l
rolin eduk
letrare, fe
Një galeri

Kët
me gënjes
luftë të v
protagoni
kurthet. S
drejtësinë
personalit
afërmëve
me stoicia

Vle
studiuës s

Ke
Arkivin e
vargje dh
Jusufit (a
daton 10
më se dy
problem;
i autorit I
përgatitun
përdorej.

e saj. I dha jetë asaj, duke e paraqitur atë në mjedisin tonë, duke i veshur Ervehesë petkun moral që aspirojnë të gjitha vendet e globit dhe duke e bërë këtë novelë një vepër letrare me përmasa të gjera.

Në rreth 900 vargje tetërrokëshe, Erveheja, protagonistja e novelës, na paraqitet e hijshme, e mençur, besnike, me karakter të fortë, stoike. Vepra është e pasur me figura letrare, me personazhe që përfaqësojnë botë psikologjike të tyre, që kanë bindje vetiake, që gjenerojnë qëndrime heroike, ndonëse paraqesin kontraste në karaktere.

Jani Vretoja, pasi u bind për vlerat e saj artistike në variantin e përpunuar të Hajdar Argjirokastritit, e çliroi edhe më nga fjalët e huaja dhe e botoi më 1888 në Bukuresht, në Shypshkronjën e Shoqërisë "*Dituria*", ku ishin botuar edhe një varg veprash të tjera në gjuhën shqipe. Në letërkëmbimin e tij me Sotir Kolenë, ai shprehet se i pëlqeu shumë kjo vepër, se "e qëroi nga fjalët e huaja", se kjo vepër ka emocionuar të gjithë ata që e kanë lexuar, se e ka botuar me tirazh të lartë dhe se interesohet për të dërguar disa kopje edhe në Elbasan e Pogradec.

Një vepër tjetër me rëndësi e M. Çamit është edhe poema e gjatë "*Jusufi dhe Zelihaja*". Subjekti i kësaj poeme është huazuar nga "*Suretu Jusuf*" e Kur'anit. Natyrisht në poemë merr ngjyra letrare, por pa devijuar rolin edukativ islam. Konstruktiv artistik i shërbejnë: gjuha, epitetet, figurat letrare, fenomenet psikologjike të shumëllojshme dhe ato etiko-edukative. Një galeri e tërë personazhesh paraqitet në këtë poemë.

Këtu ndeshet e mira me të keqen, e drejta me padrejtësinë, e vërteta me gënjeshtëri. Poema e ushqen vazhdimisht lexuesin me bindjen se në këtë luftë të vazhdueshme, fitimtare do të dalë e vërteta, e drejta, e mira. Jusufi, protagonist i poemës, është shembëlltyrë e stoikut që sfidon krimin, vuajtjet, kurthet. Stoicizmi i tij është proverbial. Vullneti i tij i hekurt. Besimi në drejtësinë, që vonon por nuk harron, është i patundur. Madhështia e personalitetit të tij shkon në rritje kur paraqit kapërcimin e tradhëtisë të të afërmëve të vet, kur përballon tundimin seksual që i shkakton Zelihaja, kur me stoicizëm të pashembulltë i tejkalon vuajtjet e burgut të pamerituar.

Vlerat e saj artistike dhe etike janë bërë objekt interesi për shumë studiues shqiptarë dhe të huaj.

Kemi dijeni se kjo temë është trajtuar edhe shumë kohë më parë. Në Arkivin e Shtetit (Tiranë) ekzistojnë disa dorëshkrime të shkruara shqip, në vargje dhe në prozë, me shkronja arabe, që kanë për subjekt "*Historinë e Jusufit (a. s.)*", duke iu referuar Kur'anit Kerimit. Një nga këto dorëshkrime daton 1035/1625, d.m.th. një shekull e gjysmë para lindjes së M. Çamit ose më se dy shekuj para vdekjes së tij. Pikërisht me këtë dorëshkrim lind një problem: rishikimi i datëfillimit të aljamiadës shqiptare. Nëse ky dorëshkrim i autorit Rustem Efendi, nga Gorica (Korça) jep të dhëna për kohën kur është përgatitur, për vendin ku do të shfrytëzohej, për destinacionin ku do të përdorej, për dialektin në të cilin është shkruar, atëherë do të mund të

zberthehen një varg pikëpyetjesh me rëndësi për këtë problem.

Me problemin e aljamiadës tonë janë marrë: Osman Myderrizi, Hasan Kalessi, Dhimitër Shuteriqi, Mahmud Hysa, Muhamet Pirraku, Rexhep Ismaili, Shaban Çollaku, Robert Elsie etj.

Një variant të "*Jusufi e Zelihaja*" e botoi më 1992 në Tiranë, Ibrahim D. Hoxha, i cili ruan edhe veprat e tjera të M. Çamit.

Muhameti Çami - Gjuhëtar dhe pedagog

M. Çami-Kyçyku filloi punën si mësimdhënës në shkollën e mesme të Konispolit rreth vitit 1809-1810. Aty vazhdoi si mësues për më se tridhjetë vjet, duke lënë gjurmë dhe duke krijuar traditë kryesisht si pedagog dhe si gjuhëtar. Kontributet e tij duhen vlerësuar në optikën kontekstuale lidhur me kohën, rrethanat dhe nivelet.

E rëndësisë së dorës së parë është nisma e tij për të përdorur tekstet në gjuhën e folur shqipe si teskte mësimi. P.sh. "*Mevlud*", i përpunuar nga ai në gjuhën shqipe, zhvillohej si lëndë mësimi në shkollën ku jepte mësim (medrese). Në të njëjtin plan duhet vlerësuar edhe poema "*Jusufi dhe Zelihaja*", e cila shfrytëzohej nga studentët e tij për të kuptuar më lehtë tekstin e sures së XII të Kura'nit. Ai shkroi me alfabet arab dhe bëri disa përpjekje për të plotësuar kërkesat që ka shqipja ndaj zanoreve. Ai zotëronte greqishten, por nuk dimë a ka ndikuar kjo në këtë drejtim. Nuk kemi ndonjë të dhënë se a ka njohur M. Çami-Kyçyku gjuhë të tjera europiane.

Duke iu referuar përsëri fondeve që disponon Arkivi i Shtetit - Tiranë¹, njoftohemi se ekziston një numër i konsiderueshëm tekstesh mësimore të gramatikës së gjuhës arabe, që përdorehin në shkollat e asaj kohe.

Disa të dhëna dëshmojnë për vokacionin e tij si pedagog dhe gjuhëtar. Si pedagog, në krahasim me të tjerët, ai bëri një hap përpara duke komunikuar shqip, duke shkruar shqip, duke u shprehur me një gjuhë artistike dhe me një fjalor të pasur të të folmes çame. Si pedagog ai zgjeroi horizontin intelektual të nxënësve, si gjuhëtar zgjeroi gamën e njohurive, duke i shtuar gjini të reja divanit të Nezimit dhe vjershave të Hasan Zyko Kamberit.

M. Çami-Kyçyku megjithë përgatitjen e tij të gjerë linguistike, nuk kapi dy fusha kryesore as si pedagog e as si gjuhëtar: njëra i përket përdorimit të fjalëve të huaja, në mjaft raste të panevojshme, të cilat vazhdonin ta molepsnin gjuhën amtare, kurse tjetra e mospërpunimit të një alfabeti, që t'i përgjigjej plotësisht të 36 tingujve të gjuhës shqipe, siç u përpoqën më vonë Hasan Tahsini me të tjerë.

Muhamet Çami - tekstolog

¹ "Katalogu i dorëshkrimeve osmane në arkivat e Shqipërisë". Ankara, 2001.

Në
trevat shq
medrese,
famullitar
shkolla, k
radhë, në
shqipe jo.

Tek
këto kush
nxënësit q

M. Ç
ose niveli
pasojat që
e përdorim
Kështu ai j
i asaj kohe
përmendsh
mësimor q

Ky
ndërgjegjs
kuptonin s
kuptohet n

Ai l
përdor si
krijimtaria
mësimor.

tekstin e
studim më
edhe në at
të rëndësis

Në
probleme
gurbetit,
botëkuptir
konispolas
medreseja

Si
preokupon
gëzonte er
e diagnost
pamfletist

Në periudhën e sundimit osman shumëllojshmëria e shkollave në trevat shqiptare që një dukuri e rëndomtë. Kishte shkolla si: mejtepe, medrese, ruzhdiye, idadiye, darulmuallimin, etj. (për muslimanët), shkolla famullitare, pravosllave, episkopale, metropolitane etj. (për ortodoksët), shkolla, kolegje, gjimnaziume (për katolikët). Në përgjithësi, shekuj me radhë, në të tëra këto shkolla mbizotëronin gjuhët e huaja, vetëm gjuha shqipe jo.

Tekstet mësimore që përdornin këto shkolla ishin në gjuhë të huaj. Në këto kushte rendimentet qenë të pakta e të vonuara. Të paktë ishin edhe nxënësit që arrinin të vazhdonin më lart.

M. Çami, me formimin intelektual që kishte, nuk u pajtua me gjendjen ose nivelin dhe administrimin e medresesë ku filloi të punonte. Ai i pa pasojat që sillte në formimin e botëkuptimit islam mungesa në kohën e duhur e përdorimit të gjuhës së folur shqipe, mungesa e teksteve në gjuhën amtare. Kështu ai hartoi "*Mevludin*" shqip, që ndofta është i pari tekst shkollor shqip i asaj kohe. Nëpërmjet këtij libri shqip, që kuptohej, mësohej, përvetësohej përmendsh dhe këndohej në kor nga nxënësit, filloi "modernizimi i procesit mësimor që kërkonte shkolla".

Ky proces shënoi një hap të madh përpara, sepse i bëri nxënësit të ndërgjegjshëm për atë që lexonin, sepse duke lexuar në gjuhën amtare kuptonin shumë më përpara kush ishte profeti, çfarë përfaqësonte Ai, çfarë kuptohet me "Vit i pikëllimit" e kështu me radhë.

Ai hartoi tekstin "*Jusufi e Zeliha*", për të cilin ka të dhëna se u përdor si tekst mësimor. Në kushtet e shoqërisë së asaj kohe, e gjithë krijimtaria letrare e tij, që u rishikua, u kopjua, u lexua, shërbeu si tekst mësimor. Siç e thamë më sipër, nuk kemi të dhëna tashmë për tashmë për tekstin e gramatikës nëse është vepër e tij apo jo. Jemi të bindur se një studim më i thelluar rreth kontributit të tij, jo vetëm në fushën e letërsisë, por edhe në atë të pedagogjisë, ku ai ka shërbyer kryesisht, do të jepte të dhëna të rëndësishme për vendin që zë M. Çami në atë zonë.

Muhamet Çami - sociolog

Në shoqërinë shqiptare konispolase të shek. XVIII-XIX gëlonin probleme të shumta sociale: varfëria ekonomike, plaga e rëndë e e pandarë e gurbetit, përhapja e veseve negative si ajo e alkoolizmit, prapambetja, botëkuptimi i prapambetur etj. Përballë kësaj maxhorance, shoqëria konispolase kishte një pakicë intelektuale, burim i së cilës ishte shkolla ose medreseja ku jepte mësim edhe Muhamet Kyçyku.

Si pjesëtar i kësaj shoqërie, ku ai bënte pjesë si teolog që e preokuponte formimi botëkuptimor i besimtarëve; si pedagog i shkollës që gëzonte emër të mirë në tërë zonën, ishte i preokupuar për gjendjen, prandaj e diagnostifoi atë, përcaktoi qëndrimin e tij dhe veprimet si vais, si mësues, si pamfletist. Shkroi dy pamflete: "*Alkooli*" dhe "*Gurbetllinjë*", që janë dy

sinjale të fuqishme të alarmit shoqëror të kohës. Të dyja këto plagë ai i përshkroi lidhur me shoqërinë në tërë gamën e tyre: nga ana ekonomike, nga ana morale, nga ana e marrëdhënieve shoqërore. Tregoi pasojat e alkoolizimit, rrjedhimet e emigrimit. Duke lexuar këto pamflete të del përpara një botë e varfër, njerëz të hidhëruar, familje që vuajnë, individë të pezmatuar që i ndjek nga pas dhimbja, konispolas të brengosur që plandosen nëpër mejhane duke u dehur me verë e raki, duke u shamatuar, duke u grindur, duke u vrrarë. Dhe pas këtyre moralizimit.

xxx

Gjatë shekujve XVIII-XIX në disa qendra shqiptare si në Shkodër, Berat, Prizren, Elbasan, Shkup, Prishtinë etj. mori zhvillim tregtia, zanatet dhe punishtet e metaleve, drurit, leshit etj. të cilat u bënë faktorë pozitivë për shtytjen e lëvizjes kulturore në mjediset e tyre. Në këto qendra ku funksiononin shkollat në rangun e medreseve, u aktivizuan në lëvizjet kulturore edhe studentët që kishin bërë studimet në Stamboll, Kajro etj.

Intelektualë të formuar në drejtime teologjike, kulturore, letrare, artistike etj. si Muhamet Çami-Kyçyku, i dhanë një impuls të ri shoqërisë së përgjumur mesjetare, sidomos duke shkruar gjuhën shqipe, në atë gjuhë që komunikonin tërë shtresat e shoqërisë shqipfolëse. Novela, poema e gjatë, pamfletet etj. e pasuruan fondin e librit shqip. Në mungesën e shtypshkronjave ata i shumëfishonin me anë të qatipëve (shkrues profesionistë) veprat e tyre duke i bërë të njohur plagët, kontradiktat, adhurimet etj. që përshkonin shoqërinë shqiptare.

Në shekullin XIX numri i atyre që shkruanin në gjuhën amtare me alfabet arab ishte shtuar ndjeshëm. Në këtë dukuri duhen parë dhe disa rrjedhime. Shtimi i lexuesve, tematika gjithnjë e më shumë shoqërore, e mbi të gjitha, formimi i një koncepti bashkëkohor, një koncepti të ri botëkuptimor për rolin e shkrimit në gjuhën amtare, që lidhej me një sërë pikëpamjesh, parimesh dhe interesash.

Shkrimtarë si Nezim Frakulla, që krenoheshin se po e bënin shqipen "bejan" (stil artistik), si Muhamet Çami që theksonte se bejtet po i bëjmë shqip etj., provonte se shqipja është një gjuhë e pasur me shprehje dhe fjalor për të transmetuar mesazhe artistike dhe filozofike, se ajo afirmonte rrugën drejt identitetit si komb.

- Akade...
- drejtim...
- Azem...
- Çami,
- Hajdar...
- shtypës...
- Çami, I...
- Çollak...
- Elsie, E...
- Hoxha,
- Tiranë,
- Hysa, M...
- Hysa, F...
- Inalçik,
- Ismaili,
- Kalesh...
- Katalo...
- Mufake...
- Myderr...
- shoqëro...
- Naska,
- Osmani...
- Osmani...
- Pirraku...
- Prishtin...
- Saliku,
- Shuteri...
- Instituti...
- Letërsis

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë (Grup autorësh nën drejtimin e Prof. Dh. Shuteriqit), *Historia e Letërsisë Shqiptare*. Tiranë, 1993.
- Azemi, Emin – Halimi, Shkëlzen. *Shqiptarët e Egjiptit*. Shkup, 1993.
- Çami, Muhamet. Erveheja-vjershuarë prej Muhamet Çamit. Mbaruarë prej Hajdar Argjirokastritit edhe qëruarë fjalët' e huaja prej J. Vretosë. Shtypurë ndë shtypëshkronjëtoret të Shoqërisë "Dituri" ndë Bukuresht, 1888.
- Çami, Muhamet. Jusufi dhe Zelihaja. Tiranë, 1992.
- Çollaku, Shaban. *Historia e letërsisë shqipe nga fillimet deri në vitin 1939*.
- Elsie, Robert. *Historia e letërsisë shqiptare*. Pejë, 1997.
- Hoxha, Ibrahim. Medreseja e Konispolit. Në buletin "Qytetërimi Islam". Tiranë, 1999, Nr. 14.
- Hysa, Mahmud. *Alhamiada shqiptare*. Studime letrare. Shkup, 1997.
- Hysa, Prof. Dr. Mahmud. Hyrje në letërsinë shqiptare. Prishtinë, 2000.
- Inalçik, Halil. *Perandoria osmane*. Shkup, 1995.
- Ismaili, Rexhep. *Tekste të vjetra*. Botues "Dukagjini". Pejë, 2000.
- Kaleshi, Hasan. *Kontributi i shqiptarëve në diturinë islame*. Riad, 1992.
- *Katalogu i dorëshkrimeve osmane në arkivat e Shqipërisë*. Ankara, 2001
- Mufaku, Dr. Muhamed. *Shqiptarët në botën arabe*. Prishtinë, 1990.
- Myderrizi, Osman. *Letërsia shqipe me alfabet arab*. Në "Buletinin për shkencat shoqërore". Viti 1951, Nr. 1, 1955, Nr.2.
- Naska, Kaliopi. *Çamëria*. Tiranë, 1999.
- Osmani, Shefik. *Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë*. Tiranë, 1998.
- Osmani, Tomor. *Udha e shkronjave shqipe*. Shkodër, 1999.
- Pirraku, Dr. Muhamet. *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*. Prishtinë, 1989.
- Saliku, Mr. Hajdar. *Poezia e bejtexhinjëve*. Prishtinë, 1987.
- Shuteriqi, Dhimitër. *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*. Tiranë, 1976.
- Instituti Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. *Historia e Letërsisë Shqipe*. Tiranë, 1959.

Prof. Shefki Osmani

Muhamet Çami Summary

During the 18th and 19th century there was a development of trade and craftsmanship in many Albanian centers such as: Shkoder, Berat, Prizren, Shkup, Elbasan etc. Many cultural movements were born in these centers and staff who had completed their studies in the most prominent cultural and educational world centers such as Istanbul, Kajro and others were involved in them.

These intellectuals, amongst who is Muhamet Cami (1778-1884) gave a new boost to society in the cultural and literary aspect. ...

This contribution talks about some aspects not well known so far of the poet M. Cami, who said that "bejtet are being made in Albanina". This proves that the Albanian language is a rich language with expressions to convey artistic and philosophical messages from the world literature. By doing so, he affirmed the path towards the Albanian national identity.

Dr. Feti Me
Fakulteti i

POEZI A

8.1.1

Poet,

profesor i
përmbledh
gjithë vepr
librin me tr

A.S.

poezitë: Da
Rilindje, në
kemi konst
shenimet q
vepra në p
punime dhe
në librin e l
nuk i hasim

• Pjesë nga
shqipe 192
1990. Edhe
poezisë së re
e shkencave
Kuvajti, Fil
gjuhën shqipe

¹ Në vitin
Fakultetin F

² A'da itih
Amur, bot. i

³ Rilindja, d

⁴ Krahaso m

Dr. Feti Mehdiu- Prishtinë
Fakulteti i Filologjisë

POEZI ARABE NGA SIRIA DHE SUDANI TË PËRKTHYERA NË GJUHËN SHQIPE

8.0 Poezi arabe nga Siria *

8.1. Dr. Ahmed Sulejman Al-Ahmed (1926)

Poet, kritik letrarë, doktor shkencash në filozofi dhe sociologji, profesor i letërsisë arabe në Universitetin e Damaskut¹, është autor i disa përmbledhjeve me poezi dhe autor i disa veprave me kritikë letrare. Me gjithë veprat e përkthyer ai ka 27 vepra të botuara.² Në vitin 1976 botoi librin me tregime për fëmijë nga letërsia bullgare.

A.S. al-Ahmed në gjuhën shqipe, për herë të parë, është prezentuar me poezitë: *Dashuria dhe Marramenti (fragment)*. Ky përkthim është botuar në Rilindje, në vitin 1979, por nuk jepet shenimi se kush i përktheu.³ Megjithatë kemi konstatuar se këto poezi i përktheu nga gjuha arabe M. Mufaku. Në shenimet që jepen, me këtë rast, për autorin thuhet se ka botuar "mëse 200 vepra në poezi, dramë, kritikë e studime". Me siguri këtu fjala është për punime dhe artikuj të ndryshëm, sepse në shenimet bibliografike që i gjejmë në librin e botuar në Damask në vitin 1984 nga Lidhja e Shkrimtarëve arabë, nuk i hasim këto shënime.⁴

* Pjesë nga disertacioni i doktoratës: *Përkthimet e letërsisë arabe në gjuhën shqipe 1922-1982*, të mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, në vitin 1990. Edhe më parë janë botuar pjesë nga kapitulli për poezinë. Shih: *Përkthimet e poezisë së re arabe në gjuhën shqipe - Algjeria, Gj. Albanologjike, nr.27,1997 (seria e shkencave filologjike) Prishtinë; ... Iraku, Filologji, nr.4,1997, Prishtinë; ... Kuvajti, Filologji, nr.5,1998; Prishtinë; Poetët palestinezë më të përkthyer në gjuhën shqipe, Filologji, nr.6,1998, Prishtinë.*

¹ Në vitin 1980, me rastin e vizitës së tij në Kosovë, mbajti një ligjëratë në Fakultetin Filozofik për studentët dhe studjuesit e letërsisë arabe.

² *A'da ittihad al-kuttab al-arab*, Dimishk, 1984. Përpiloi Edib Izzet dhe Ismail Amur, bot. i dytë, f.238.

³ *Rilindja*, dt.21.6.1979, Prishtinë.

⁴ Krahaso me shenimin nr. 2, fq.51

Në vitin 1980 poezia e tij *Alivanosja*, të cilën e përktheu nga gjuha frenge Nexhmedin Saliu, me një shenim të shkurtër për autorin, u botua në *Zëri i Rinisë* nr.17-18/1980. Të njëjtin vit, gjithashtu në *Zëri i Rinisë*,⁵ N.Saliu përktheu nga frengjishtja dhe botoi poezinë *Ikja*. Të gjitha këto poezi të përkthyer, sikurse tërë krijmtarinë poetike të Ahmed S. Ahmedit, i përshkon një frymë lirike e dashurisë e shprehur në frymën moderne

8.2. Makhbula Al-Shalak (1921)

Më tepër është e njohur si shkrimtare për fëmijë. Është autore e tre librave me tregime, prej të cilëve dy janë për fëmijë,⁶ dhe autore e një përmbledhje poezishë që doli nga shtypi në vitin 1982, (*Ugnijjatu kalb – kënga e zemrës*), lexuesit tonë i është prezentuar me poezinë *Nëna e therur*. Ky përkthim është botuar në *Rilindje* dt.13.VII.1978.

Poezia e M. Shalakut, *Nëna e therur* të cilën e ka përkthyer në gjuhën shqipe M. Mufaku, është më tepër se një kushtim për t'u mobilizuar në mbrojtjen e çështjes palestineze. Përveç kësaj, ajo me një simbolizëm të cekët thumbon edhe një smundje akute të botës arabe. Poeteshja Shalak e ndien thellë klithmën e nënës therur e cila kërkon ndihmë, por kjo nuk mund t'i përgjigjet pikërisht nga përçarjet ndërarabe, se

*"isha i zënë në ciklonin tim
në grindje me vëllëzërit
ne s'jemi vllëzër
se jetojmë përherë në grindje
dhe nuk bashkohemi fare."*

M. Shalak në gjuhën shqipe më tepër është prezentuar si prozatore.

8.3. Nihad Rida (1927)

Është autor i njëmbëdhjetë përmbledhjeve me poezi dhe i një romani. Ka përkthyer shumë vepra letrare nga gjuha frenge në gjuhën arabe.⁷ Ka marrë pjesë në Seminarin Ndërkombëtarë për gjuhën dhe letërsinë shqiptare.⁸ Nga krijmtaria e tij poetike, në gjuhën shqipe janë përkthyer poezitë: *Mendime të revoltuara dhe Takimi ynë që te hëna*.

Poezitë e N. Ridës, në përkthim të M. Mufakut, për herë të parë u botuan në *Zëri i Rinisë*⁹ me një shenim rasti, por pa të dhëna biografike për

⁵ *Zëri i Rinisë*, nr.32, dt.26.7.1980, fq.15, Prishtinë.

⁶ Shih shenimin nr. 2.

⁷ Po aty.

⁸ *Seminari i kulturës shqiptare për të huaj*, X,1985, Prishtinë.

⁹ *Zëri i Rinisë*, dt 12. 7.1978, fq.13, Prishtinë.

poetin. Të
Takimi ynë
përkthyer
dhe është
popullore

"th
seps
shpe
gjuh

8.4.

Poe

në botën i
urrejtje, m
lirikës ero
titullohet
dashuri n
dashurisë
përcjellura

Min

– ai shpall
papranses

Kab

këndoi po
i prezentoh
krijmtaris
Kabbani f
popullit të
dashurisë.
cilën ai de

Ai s

"Të

për

¹⁰ *Rilindja*,

¹¹ Shih shen

¹² Darko

ljubavi, "Z

¹³ Nizar K

poetin. Të njëjtin vit, poezia e dytë u botua edhe në *Rilindje*¹⁰ me titullin *Takimi ynë në hënë*. Ky titull, vështruar në krahasim me origjinalin është përkthyer më drejt se në rastin e parë. Poezia e Nihad Ridës është simbolike dhe është një poezi në të cilën poeti me mjeshtri të rrallë din të shkri urtinë popullore në mënyrë që në poezi ta shpreh shkaku e humbjes së luftës:

*"thonë se e kemi humbur luftë,
sepse kemi gjuhë të gjatë si gratë:
shpatat tona janë më të gjata se trupat tonë
gjuhët tona janë më të gjata se shpatat tona!"*

8.4. Nizar Kabbani (1923)

Poet i njohur sirian, i cili ka botuar 16 vepra me poezi.¹¹ N. Kabbani, në botën arabe, ka përjetuar edhe famë e respekt por edhe mospërfillje e urrejtje, mu për shkak të shprehjes së tij shumë të lirë në vargjet e tij të lirikës erotike.¹² Përmbledhjen e parë me poezi e botoi në vitin 1944 e cila titullohet *Zeshkania më tha*, dhe më këtë, u bë poeti më i lexuar dhe më i dashuri ndër masat e rinisë arabe. Rininë arabe e përvehtësoi me lirikën e dashurisë ashtu që poezitë e tij shpesh komponoheshin dhe këndoheshin të përcjellura me muzikë.

Mirëpo, në anën tjetër, mu për këtë arsye – për shkak të lirikës erotike – ai shpallet joserioz nga një masë e opinionit arab. Poezia e tij trajtohet si e papranusehme për shkak të vlerave të ulëta morale etj.

Kabbani, diplomat, poet, jurist,¹³ bashkë me të cilin edhe rinia i këndoi poezitë e tij, por edhe i fishkëlloi, lexuesi ynë e nejt në vitin 1977. Ai i prezantohet lexuesit shqiptarë me një poezi që i takon periudhës së dytë të krijimtarisë së tij, periudhës pas vitit 1967, nga ajo periudhë kur edhe Kabbani fillon të shfrytëzojë si burim për poezinë e tij gjendjen reale të popullit të vet – arabëve. Këto tema zëvendësuan temat e mëparshme, ato të dashurisë. Ai i prezantohet lexuesit shqiptarë me poezinë *Një rrugë*, me të cilën ai del si një revolucionarë i denjë për lirinë e Palestinës.

Ai shet edhe unazën e nënës për armë,

*"Të tëra i lash peng
për një pushkë"*

¹⁰ *Rilindja*, dt. 28.9.1979, fq.11, Prishtinë.

¹¹ Shih shenimin nr. 2.

¹² Darko Tanasković, Nizar Kabbani – Neprolazno detinjstvo i sazrevanje ljubavi, "Zivot" nr.4, 1979, Sarajevo, pp.379-383.

¹³ Nizar Kabbani, Kissati ma'ash-shi'r, Bejrut, 1973.

duke u lutur që ta marrin në luftë

"në palestinë të më merrni me ju
o njerëz!
dua të jetoj ose të vdes si burrë".

Këto vargje të Nizar Kabbanit, në shiqim të parë tingëllojnë fortë, por megjithatë nuk e kanë forcën e vargjeve të poetëve palestinezë. Kabbani bie në provimin e revolucionit kur thotë se gjuha në të cilën mësoni nuk ka vlefte as një gram para një pushke...

Poezia *Një rrugë* u botua në *Rilindje*,¹⁴ përkthyer nga I. Ahmedî, në vitin 1977. Këtu është dhënë edhe shenimi se poezia është marrë nga përmbledhja e titulluar LA, e cila është botuar në Bejrut në vitin 1971.

Pas kësaj, Kabbani prezentohet me katër poezi: *Ditari i një kusari*, *Ditari i një gruaje indiferente*, *Bukë, hashash dhe hënë dhe Vrasja e imamit*. Këto poezi i ka përkthyer, nga arabishtja, M. Mufaku dhe u botuan në Fjala, në vitin 1978. Bashkë me këto poezi përkthyesi boton një artikull me titull *Një poet nga orienti dhe kundër orientit*,¹⁵ i cili i kushtohet krijmtarisë dhe qëndrimit kritik të Kabbanit ndaj qasjes së zgjidhjes së problemeve të grumbulluara me shekuj në shoqërinë arabe. Prandaj titulli i këtij artikulli, kështu si është, nuk përkon me përmbajtjen e artikullit.

Të katër poezitë e përmendura, ashtu siç ishin këtu, janë përfshirë edhe në librin *Antologji e poezisë së re arabe, Prishtinë, 1979*. Në vazhdim vetëm: *Antologjia... Me këto poezi poeti thumbon gjendjen ekzistuese në orient, angazhohet për ndryshimin e gjendjes në orient, dëshiron të ketë një orient si duhet të jetë, e jo të përsërisin*

"... si papagaj, predikimet fetare"
dhe të shkojnë
"... te hoxha i lagjës
që të na bëjë magji për fëmij".

Ai angazhohet gjithashtu që femra arabe të mos e shikojë bashkëshortin si xhelatin Masrur të "njëmij e një netëve" por të vendosen raporte normale në jetën bashkëshortore e ndërnjerzore. Kabbani i kritikon njerëzit e orientit, kritikon atë shtresë të arabëve të cilët:

¹⁴ *Rilindja*, dt.1.12.1977, f.12, Prishtinë.

¹⁵ *Fjala* nr. 13, dt.15.7.1978, f.11, Prishtinë. Autori i artikullit e quan kundra orientit vetëm për shkak se Kabbani thumbon vetet e këqia të orientit, prandaj, mendojmë se nuk mund të thuhet "kundra orientit" ashtu sikundër nuk mund të thuhet p.sh. për Migjenin kundra shqiptarëve, vetëm pse kritikon të metat e popullit a të rrethit të vet.

*"I lusin varret e evliave
për oriz...për fëmij"*

dhe më në fund me shembullin e tij konkret, i vetëdijshëm se "... për veprën time meritoj vrasje". Por që të mos sillet më :

*"si kokërr në tespihët e imanit
pa mend...pa krye...pa këmbë"*

ai merr guximin të pranojë:

*"E vrava imamin në emrin tim
dhe në emrin e miliona deleve,...
Me vrasjen e tij i vrava o zotërinj
Të gjithë ata që nga njëmij vjet
Bëjnë të zeza me fjalë..."¹⁶*

Poezia *Ditari i një kusari* është botuar edhe për së treti herë. Herën e tretë e gjejmë në revistën *Kosovarja*,¹⁷ nga i njëjti përkthyes.

Ismail Ahmedi përktheu poezinë e Nizar Kabbanit, *Ditari i Palestinës*, të cilën poeti ia ka kushtuar Palestinës, e cila u botua në *Zëri i Rinisë* (16.9.1978, f.13.) kurse, Feti Mehdiu përkthen poezinë *Guvernatori dhe zogu*, në të cilën poezi poeti shpreh revoltën kundër organeve të pushtetit sepse ata nuk e lejojnë të qarkullojë lirisht me libra "*nëpër atëdheun arab*", me qëllim që

"i'ua lexoj poezitë e mia masave"

por ata i kërkojnë

*"...pasaportë për zogun (librin)
fjala në atëdheun tim paska nevojë për pasaportë"*

Në këtë mënyrë poeti i zemëruar nga një sjellje e tillë, i hedh e i shkel të tëra poezitë e tij dhe kthet prap në vendin e vet

*"I hudhur
si gotë e coptuar".*

¹⁶ *Antologjia... fq.41.*

¹⁷ *Kosovarja*, nr.6, dt. 1.6.1982, Prishtinë.

Poezia *Guvernatori dhe zogu* është botuar tri herë. Herën e parë u botua në *Flaka e vëllazërimit*,¹⁸ e pastaj në *Bota e Re*¹⁹, brenda vitit 1980, kurse në vitin 1981 u botua edhe në revistën *Koha*, nr.6/1981.

8.5. Rijad Salih Al-Husejn (1954 -1982)

Megjithëse ky poet vdiq në moshë të re, jetoi vetëm 28 vjet – sa edhe Migjeni, ai ka lënë tri përmbledhje me poezi në gjuhën arabe.²⁰ M.Mufaku nga poezitë e tij ka përkthyer në gjuhën shqipe poezinë *Marsejeza e kohës neutronike*, e cila është botuar në *Fjala* nr. 7/1978.

8.6. Rexha Arnaut (1946)

Poetsha e re me prejardhje shqiptare është e njohur edhe si përkthyes nga gjuha frenge në gjuhën arabe. Ka botuar dy përmbledhje me poezi në gjuhën arabe si edhe një libër me poezi të përkthyer nga gjuha vietnameze.

Në gjuhën shqipe, M. Mufaku i ka përkthyer katër poezi të saj dhe i botoi, herën e parë, në *Zëri i Rinisë* nr.23, dt.3.6.1978. Të njëjtat poezi janë përfshirë edhe në librin *Prapa natës, Prishtinë*, me 1980. Në vazhdim vetëm *Prapa natës...* Poezitë e R. Arnautit që janë përkthyer shqip janë: *Një shenj, Lindje, Deti dhe Valët*, të cilat ishin botuar më parë në *Zëri i Rinisë*, si edhe ato : *Shpresë, Prekje, Stuhi dhe Lumi*, të cilat botohen në këtë libër për herë të parë.

Këto poezi japin një pasqyrë për preokupimet e poeteshës e cila simbolikisht shëron mijëra plagë:

"çdo valë
po thërret tjetrën valë
të pastrojë mijëra plagë
të mjekojë sytë
e mbyllur
me tampon harrese"

ose raporti i lumit të vogël me detin e madh, i cili e din se derdhet në det, por

"s'ka rëndësi!
Lumi i vogël po zbulon botën në udhëtimin e tij...
Pastaj le ta përbijë qetësia e detit.
S'ka rëndësi!"

¹⁸ *Flaka...* dt.9.3.1980, Shkup.

¹⁹ *Bota e Re*, nr.8, dt.15.4.1980, f.15, Prishtinë.

²⁰ Shih shënimin nr. 2.

8.7.
Në
prezentuar
optimist.

"G
sepse
"e
ash

Ket
Adem Ga
dt.192.196
janar, kurs
shqiptarë
poezinë ar

8.8.
Sha
shtatë janë
për fëmij.
në *Flaka*.
edhe një s
e ka përkth

8.9.
Abc
por edhe j
tij të pavar
barida. K
Kosovën s
Në

poezia e ti
Rinisë nr.
Mehdiut i
Rilindje,²²
në *Flaka*.
vonë, në
Fatimeje,

²¹ Shih shen

²² *Rilindja*.

8.7. Sulejman Al-Isa (1921)

Në gjuhën shqipe është përkthyer poezia e tij *Nesër* e cila është prezentuar qysh në vitin 1962. Nga kjo poezi e tij shihet se S. Isa është optimist. Ai ka besim të paluhateshëm për ardhmëri më të mirë, prandaj

"çdo nesër duhet me pru ngadhnjim"

sepse

*"e nesërmja jonë në shkëlqimin e vet
është ma e fortë se vdekja"*.

Këtë poezi të Sulejman al-Isës e ka përkthyer nga serbokroatishtja Adem Gajtani, nga *Knjizevne Novine*, dhe e botoi në *Flaka e Vëllazërimit* dt.192.1962,f.7. Fakti se kjo poezi është botuar në gjuhën serbokroate me 26 janar, kurse në gjuhën shqipe me 19 shkurt të njëjtit vit flet se në opinionin shqiptarë mbretëronte një etje dhe interesim i madh për t'u njohur me poezinë arabe.

8.8. Shavki Bagdadi (1928)

Shavki Bagdadi është autor i njëmbëdhjetë veprave, prej të cilave shtatë janë përmbledhje poezishë kurse të tjerat janë tregime për të rritur dhe për fëmij.²¹ Tek ne është përkthyer poezia e tij *Të shkruajsh poezi* që u botua në *Flaka...* 3.4.1977, të cilën e ka përkthyer Neki Fejza. Përkthyesi afron edhe një shënim të shkurtër për autorin, por nuk ka shënuar se nga cila gjuhë e ka përkthyer. Sipas mendimit tonë ky është përkthim nga serbokroatishtja

8.9. Abdulkadr Arnaut (1936-1993)

Abdulkader Arnauti është i njohur më tepër si piktor, jo vetëm në Siri por edhe jashtë Sirisë, si në botën arabe ashtu edhe më gjërë me ekspozitat e tij të pavarura. Shkruan edhe poezi. Ka botuar përmbledhjen *Rimad ala erdin barida*. Ka prejardhje nga Dobërlluka e Vishtirrisë dhe këto lidhje të tij me Kosovën shprehen edhe në poezinë e tij, por në gjuhën arabe.

Në gjuhën shqipe janë përkthyer tetë poezi të tij. Për herë të parë poezia e tij *Gozhdë e ndryshkët* u botua, në përkthim të M.Mufakut, në *Zëri i Rinisë* nr.32 të vitit 1977. Në vitin vijues, me 1978, në përkthim të F. Mehdiut janë botuar poezitë *Vარი im*, e cila herën e parë u botua në *Rilindje*,²² dhe *Shpërngulja*, e cila bashkë me poezinë *Vარი im* janë botuar në *Flaka...* dt.16.2.1978, me një shënim të shkurtër për jetën e autorit. Më vonë, në përkthim të M. Mufakut u botuan poezitë *Zoti dhe Ademi*, *Fat Fatimeje*, *Dashuri sot dhe Vinjetë*, në *Rilindje* të datës 4.1.1979.

²¹ Shih shënimin nr. 2.

²² *Rilindja*, dt. 16.2.1978, f.11, Prishtinë.

Ndërkaq në librin *Prapa natës*,²³ Andulkadr Arnauti është përfaqësuar me gjashtë poezi prej të cilave vetëm poezia *Arkivoli* botohet për herë të parë, sepse pesë të tjerat lexuesi ynë i ka lexuar edhe në faqet e shtypit të përditshëm.

Në poezinë e këtij poeti idhtësia e së kaluarës që kanë përjetuar parardhësi e tij, do të gjejë shprehje dhe do të shpërthejë sidomos në poezinë *Shpërngulja*, ku thotë:

"Në arkën e parë...
pata lënë, në te...para se të shpërngulem
një grusht mburrje... një pjesë të vehtes
E mbylla arkën.. dhe shkova"

Arnautin e preokupojnë edhe probleme të jetës e cila është tepër dinamike kur njeriu nuk ka kohë të shohë as edhe ku shkel dhe kënd po e shtyp. Sëkëndejmi edhe dashuria është shndërruar në numra:

"sot vetëm digitroni
mund ta masë dashurinë"

8.10. Ajshe Arnaut (1946)

Është shkrimtare e talentuar nga Siria. Në vitin 1960 fitoi shpërblimin e parë në një konkurs letrar për tregim në Liban. Pasi që nuk kishte më shumë se katërmëdhjet vjet kritika letrare e quajti Sagan e Sirisë. Ajshe Arnauti është prezentuar në Antologjinë e poeteshave arabe që u botua në Nju Jork, kurse lexuesi ynë, me poezinë e saj, njihet në vitin 1977. Atë vit, M. Mufaku përktheu poezitë e saj: *Do të pres dhe Dyndja*, dhe i botoi në *Zëri i rinisë*²⁴. Në librin *Prapa natës*, Ajsheja prezentohet me gjashtë poezi të cilat botohen për herë të parë, në këtë libër, si edhe me poezinë *Dyndja* që ishte botuar edhe më parë në *Zëri*... nr.32/1977.

Poezitë e përkthyer që janë botuar në këtë vëllim janë : *Agimi i fëmijërisë, Pa titull, çdo gjë është e rreme, I ndëshkuar, e i dhunuar, Pjellë e ndryshkut dhe Ngaher* kur... Këto gjashtë poezi, të njëjtin vit u botuan edhe në revistën *Fjala* nr.7/1980. Poezitë janë nxjerr nga libri *Prapa natës* dhe janë përcjellë me një shenim për autoren.

Poetësia i ka lënë hapësirë të mjaftueshme edhe çështjes së shpërnguljes së familjes së vet, si rrjedhojë e një lufte, kur

²³ Muhamed Mufaku, *Prapa Natës*, poezi e shqiptarëve të Sirisë, Prishtinë, 1980. Botoi Rilindja, fq.76. Mëtej vetëm *Prapa Natës*.

²⁴ *Zëri i Rinisë*, nr. 32, dt. 8.9.1977, Prishtinë.

²⁵ Këta dy
të cilëve K

²⁶ Baraka
Vizaretu-th

²⁷ Bota e P

"shpërtheu një luftë në qiell
midis pëllumbave të zezë të huaj
dhe pëllumbave tonë të bardhë...

dhe me atë rast i vdiq gjyshja dhe e lanë në rrugë. Prandaj ajo që atëherë bartë në shpirtë një përmallim të zjarrt,

*Në gjakun tim
Kaherë ka ngelur si zjarr
Zjarri i dashurisë
Zjarri i mallit
Për vendin tim".*

Në poezitë e saj shfaq edhe preokupimin e saj me problemin e krimeve gjithënjëzore në tërë botën, të cilat si një lojë shahu kanë filluar kaherë – qysh me fillimin e gjinisë njerëzore në tokë. Për ta shprehur këtë ajo motivin historik që e ka burimin tek bijt e Ademit, e shkrinë në talentin poetik dhe me imagjinatë të vrullshme do të përfundojë:

*"Dhe deri më tani
o miq të mi të vdekur e të gjallë
që nga koha e Kabilit dhe Habilit²⁵
nuk u krye loja as tani".*

8.11. Barakat Latif Arnaut (1935)

Barakat Latif Arnauti është poeti shqiptarë arabofon, i cili është përkthyer më së shumti në gjuhën shqipe. Ai është një puntorë hekurudhe, prandaj edhe përmbledhjen e vet me poezi e ka titulluar *Këngët e llokomotivistit*²⁶. Kjo përmbledhje doli nga shtypi në vitin 1979 në Damask, dhe, të njëjtin vit u përkthye dhe u botua në gjuhën shqipe poezia *Këngët e llokomotivistit* dhe u botua në *Rilindje* dt.3.8.1979. Këtë poezi e përktheu nga gjuha arabe Abdulatif Arnauti, gjithashtu një shqiptarë nga Siria, i cili edhe vetë shkruan poezi në të dyja gjuhët: arabisht dhe shqip.

Nga i njëjti përkthyes kemi edhe dy poezi tjera të Barakatit : *Poema e mërgimtarëve dhe Vargje pa titull*. E para u botua në *Bota e Re*²⁷ kurse e

²⁵ Këta dy janë simbol i krimit dhe i së keqes në botë. Janë dy bijt e Ademit a.s. prej të cilëve Kabili bëri krimin e parë në botë, vrau vëllaun e vet Habilin.

²⁶ Barakat Latif Arnaut, Anashid saiku-l-kitar, Dimishk, 1979, f.90. Botoi Vizaretu-th-thekafeti va-l-irshadu-l-kavmijj.

²⁷ *Bota e Re*, nr. 3-4, dt.15.2.1980, f. 20, Prishtinë.

dyta në Rilindje.²⁸ Këto dy poezi nuk janë në përmbledhjen e përmendur të Barakatit.

Në vitin 1980 Muhamed Mufaku përktheu dhe përgatiti për shtyp librin **Prapa natës**, në të cilin libër B. Arnauti përfaqësohet me nëntë poezi: *S'ka frikë, Gjethet e limonit, Tymi dëshmon njerinë, Makinat, Një paraqs prapa natës, Shpresë, Gjykimet, Shokut udhëtarë, I, II, III dhe Ah, tash e pranaj varfërinë tënde*. Të përmendim se pesë nga këto poezi, një vit më vonë, me 1981, u botuan edhe në *Flaka e Vëllazërimit*.²⁹

Poezinë e brakat Latif Arnautit e përshkon fryma e patriotizmit të dyfishtë: malli ndaj atëdheut prej nga u shpërngulën të parët e tij, dhe, dashuria ndaj vendit dhe njeriut të rrethit ku jeton. Ky këndon drejtpërdrejt për njeriun punëtorë, për gjendjen e tij, i këndon, njeriut i cili është:

"duke jetuar prej thonjëve"

dhe pret

"gjykimin si lule në shkretëtirë" (PN, f.42)³⁰

Poeti e don njëlloj vendlindjen e të parëve dhe i vjen shumë keq që:

*"Kur na konfiskuan atëdheun
pse s'e përdora grushtin tim
që e kisha përherë letërnjoftim"?* (P.N. f.41)

Gjatë përkthimit, sidomos të poezisë *Shokut udhëtar*, e cila ka dalë me 26 vargje më pak, është bërë, sipas mendimit tim, një shkurtim i panevojshëm. Megjithatë porosia të cilën poeti ua drejton lexuesve mund të nxirret edhe nga këto vargje, e ajo është, vetëdija e lartë për durim dhe qëndruesë, madje edhe te fëmijët, kur ata

*"I luajnë dhëmbët me buk thatë
kaloj një vit pa bukë
te fqiu ynë..."*

i cili lutet

*"baba,
shkruaje një poezi të gjatë"*

²⁸ Rilindja, dt.31.1.1980, f.11, Prishtinë.

²⁹ Flaka... dt.15.2.1981, Shkup.

³⁰ shkurtica për librin Prapa Natës.

³¹ Shih shë

³² Bota e F

³³ Fjala, d

të gjatë
 sa varfëria jonë
 aq sa të mund të blejmë
 rrobat e rinisë për shkollë"

dhe kjo shpresë po rritet

"në grushtin e fëmijëve të mi".

8.12. Bandar Abdu-I-hamid (1947)

Ka botuar gjashtë përmbledhje me poezi në gjuhën arabe,³¹ kurse në gjuhën shqipe është prezentuar me poezinë *Dashnori*. Këtë poezi e ka përkthyer nga origjinali, Muhamed Mufaku të cilën e ka marrë nga përmbledhja e B. Abdu-I-hamidit *I'lanat al-mayt va-l-hur-rija* (Shpalljet e vdekjes dhe të lirisë) dhe e botoi në *Bota e Re*,³² Më këtë rast, përkthyesi, ka dhënë edhe një shenim të shkurtër për autorin, që gjithsesi e ndihmon lexuesin shqiptarë sepse i afron edhe disa tituj të veprave të tij.

8.13. Halil Merdun Beg (1898-1959)

Lexuesi ynë, këtë poet, e njeh përmes poezisë *Melodia e kumrisë*, të cilën e përktheu nga arabishtja Hamdi Thaçi dhe është botuar në *Rilindja* dt.6.9.1973, fq.10. H. Merdun Beg është me origjinë shqiptare, por nuk është përfshirë në librin Prapa natës.

8.14. Hatixhe Arnaut (1934)

Është autore e dy përmbledhjeve me poezi. Shkruan edhe prozë – tregime, por vetëm në gjuhën arabe. Para lexuesit shqiptarë është prezentuar, për herë të parë, me poezinë *Lotët*, e cila u botua në *Zëri i rinisë* nr.32/1977. Në vitin 1979 janë botuar edhe dy poezi të sajë në *Fjala*.³³ *Jam vajzë pa atë dhe Flamuri*. Këto poezi i përshkon një mallë i thellë dhe i pashuar për atëdheun – vendlindjen e të parëve, ku poetesha dëshiron, të paktën afër atdheut, të ketë një fole

"që të qetësohem nga dhembjet e mia" (P.N. f.34.)

atje ku flamuri

"... valon mbi dheun e të parëve...
 dhe sado që vargjet:

³¹ Shih shënimin nr. 2.

³² *Bota e Re*, dt.15.1.1981, Prishtinë.

³³ *Fjala*, dt.1.9.1970, Prishtinë.

"Të erdhi koha e krenarisë
valo në qetësi
ngritu sa më lart mbi dhe
mburru me krenari
se shpata do të shpëtojë!"

tingëllojnë si një shprehje declarative, ata prapëseprapë përmbajnë në vehte diçka që vlon në ndjenjat e poeteshës për të shfaqur respektin dhe kujdersin ndaj flamurit komëtarë të saj.

Të dyja këto poezi i ka përkthyer nga origjinali Muhamed Mufaku dhe janë përfshirë në librin Prapa Natës të botuar në prishinë, në vitin 1980.

8.15. Mustafa Huluki (1850 – 1915)

Huluki është një figurë ushtarake, përkthyes dhe poet, veprimtaria e të cilit ka ngel në faqet e shtypit të Sirisë dhe Libanit. Rrjedh nga shqiptarët e Kavallës,³⁴ të cilët janë shpërngulur dhe janë vendosur në Siri. Në poezinë e tij vërehet përvoja jetësore e shprehur në poezi me theks refleksiv dhe romantik,

"nëse s'ka kurrfar të mirë në vetmi
njafton të jeshë larg njerëzve të ligj" (PN, f.17)

ose

"Në mes meje e teje
ka një ngjashmëri:
një trup shkrihet
dhe një zemër digjet"

Në gjuhën shqipe është prezentuar në librin Prapa natës, me 1980, me dy poezi: Qiriut dhe vetmi., të cilat i ka përkthyer nga origjinali Muhamed Mufaku.

9.0. Poezi arabe nga Sudani

9.1. A. Halavani

Poeti sudanez Halavani, në gjuhën shqipe, është prezentuar me poezinë *Odë miqësisë dhe unitetit*, në të cilën ven në spikamë rëndësinë që ka bashkëpunimi ndërmjet popujve të botës. Poeti angazhohet që në botë të mbretërojë miqësia midis popujve ngase kjo është arma më e fortë kundër armikut:

³⁴ Shih shënimin nr. 2.

Poe
popujve të

"Gj
u pë
pop
për
Që

Hal
poezi e ka

9.2.

Fit

botoi për
njëmbëdh
shqiptarë
të cilën
Nëntori.³⁶

Pa

...³⁷ Me
kthyer, n
bjeve. Ai
ajo të ket
Ai është
Poezia e

"n

po

dh

si

³⁵ Rade
pp 392-3

³⁶ Nëntor

³⁷ Shih: A

*"Miqësia në mes të popujve të botës
është si një zjarr skëterre për armikun
Miqësia në mes të popujve
Është një çels i vërtetë për fitoren."*

Poeti thekson se armiku nga asgjë nuk frikësohet sa nga bashkimi i popujve të ndërgjegjeshëm, prandaj ai përfundon:

*"Gjith bota
u përket popujve,
popujve që luftojnë,
për lirinë, drejtësinë:
Që luftojnë për çlirimin e tyre".*

Halavani është i bindur thellësisht se vetëm drejtësia ngadhjën. Këtë poezi e ka përkthyer I. Çaçi dhe është botuar në Mësuesi nr.43/1973.

9.2. Muhammed Al-Fituri (1930)

Fituri është poet dhe dramaturg, i cili duke filluar nga viti 1955, kur e botoi përmbledhjen e parë *Agani Afrika* (Këngët e Afrikës), ka botuar njëmbëdhjetë vepra letrare. Nga këto dy janë drama në poezi.³⁵ Lexuesi shqiptarë M. Fiturin e njeh prej vitit 1957 përmes poezisë së tij *Unë jam i zi*, të cilën e ka përkthyer Mark Gurakuqi dhe u botua në revistën letrare *Nëntori*.³⁶

Pas kësaj periudhe, në vitin 1979, prezentohet edhe në Antologjia e ...³⁷ Me dy poezi: *Vdiq nesër dhe Hidhërimet e qytetit të zi*, të cilat i ka përkthyer, nga origjinali Muhammed Mufaku. Fituri e quan vehten poet i dhembjeve. Ai shpreh dhembjen e tërë Afrikës së zezë, për të cilën angazhohet që ajo të ketë tretman si tërë vendet tjera, pavarësisht çfarë ngjyre kanë afrikanët. Ai është luftëtarë i denjë për të drejtat e liritë njerëzore të zezakut të Afrikës. Poezia e tij është shpresëdhënëse dhe plot besim e kurajo, se:

*"një ditë do të piqet për mua fryti i korrjes
po edhe qielli, toka dhe rrjedha e lumit
dhe do të marrë fund uria e dheut
si dhe e njerëzve!" (Antologjia... f.89)*

³⁵ Rade Božović, Čovek procenjuje čoveka a ne bog. *Život*, nr. 4, 1979, Sarajevo, pp 392-395. Shih edhe shënimin nr.2, f. 566.

³⁶ *Nëntori*, nr.5, 1957, Tiranë.

³⁷ Shih: Antologjia e poezisë re arabe e M. Mufakut...

Në vitin 1965, nga një përkthyes i panjohur e këmi të përkthyer poezinë e Futurit Vërshimi i zi, e cila është botuar në gazetën Flaka...³⁸ Kjo është një poezi ku shprehet mllefi dhe revolta e poetit kundër dallimeve racore dhe kundër robërimit të zezakëve nga njerëzit e racës së bardhë.

Fituri është bashkë me masat popullore të Afrikës dh e ai

"skalit në murin e kohës
këngët e Afrikës të mbytura në gjak".

9.3. Taxh As-sirr Al-Hasan (1930)

Poet modern i cili në Sudan radhitet në avangardën e poezisë së re. Lexuesi ynë e njih prej vitit 1961, me poezinë Lulja në shtegun e kujtimeve. Poezia është përkthyer nga dy përkthyes të ndryshëm. Sëpari e përktheu Din Mehmeti, sipas të gjitha gjasave nga serbokroatishtja, dhe e botoi në Rilindja dt.3.9.1961. Po këtë vit, e njehta poezi botohet edhe në revistën Jeta e Re nr.5/1961, në përkthim të Enver Gjerçeku.³⁹

Kur i krahasojmë këto dy përkthime e shohim se përkthimi i Din Mehmetit është më i plotë, gjë që shprehet edhe në vargjet e kësaj poezie. Të dy përkthyesit e kanë për bazë botimin në serbokroatisht nga Književne Novine të datës 25.8.1961.

T.al-Hasan është prezentuar, në gjuhën shqipe, edhe në vitin 1966 me poezinë *Atbara* e cila botohet në gazetën Drita⁴⁰. Bashkë me këtë poezi të Hasanit, botohet edhe një poezi nga një poet sudanez Hair, A.M. *Një bij, një mij ngrihen*, por për këto nuk ka shenime më të hollësishme.

³⁸ Flaka... dt.9.5.1965, f.6, Shkup.

³⁹ Poezitë e botuara në *Jeta e Re*, nr. 5, 1961, i përgatiti për shtyp Enver Gjerçeku, mirëpo, me që E. Gjerçeku nuk shenon se kush është përkthyes, në Bibliografinë e orientalistikës Jugosllave nga Bisera Nurudinoviç trajtohet si përkthyes i këtyre poezive. Pasi që këto poezi janë botuar më parë në gazetën Flaka... Rilindja, dhe atje është dhënë emri i përkthyesit, mendojmë se këtu E.Gjerçeku ka bërë përgatitjen për botim në këtë revistë. Shih: *Letërsia arabe në Jeta e Re, 1949-1989*, Studime Orientale, nr.1, 2001, Prishtinë.

⁴⁰ *Drita*, dt.24.4.1966, Tiranë.

The
"Translatio
defended i
been publi
the Arabic
In
their poetr
paper is i
enabling s
reasons the

⁴¹ See in:
Prishtinë: F
nr. 6/1998,

Dr. Feti Mehdiu

Translations of the Arabian poetry into Albanian language – Arabic poetry from Syria and Sudan

Summary

This is a chapter from the dissertation of the Ph.D. entitled "Translations of Arabic literature into Albanian language"- 1922-1982, defended in 1990 at the University of Prishtina. Some parts have already been published in the past⁴¹ and here we will present the chapter containing the Arabic poetry from Syria and Sudan which are translated into Albanian.

In this study we see that the Syrian and Sudan poets have presented their poetry to the Albanian readers in the 60's of the 20th century. This paper is illustrated with some translated lines into Albanian language, enabling scholars to come up with their own judgement with regard to the reasons that lead the Albanian translator to translate these poems.

⁴¹ See in: *Gjurmime albanologjike*, nr. 27/1997, seria e shkencave filologjike, Prishtinë; *Filologji*, nr. 4/1997, Prishtinë; *Filologji*, nr. 5/1998, Prishtinë; *Filologji*, nr. 6/1998, Prishtinë.

ISLAM

Në
evrocentr
XV, atëhe
qytetërimi
periudhën
sllav, kur
rurale dhe
në pjesët
çështje p
madhe e t

Në
popujt m
trojeve il
me çonin
ke, ekono

Në
musliman

¹ Periodizi
është i gat
botimi I, 1
islamske h

² Shih: M
Hercegovin
Islamske c
nr.2/1982,
botimi II,
III, Prishtin

³ Marija
Prishtinë,

*Nexhat Ibrahim, Prizren
Këshilli i Bashkësisë Islame*

ISLAMI DHE MUSLIMANËT NË BULLGARINË MESJETARE (shekujt IX - XI)

Hyrje

Nëse e pranojmë si të saktë periodizimin e historisë që e ofron evropocentrizmi¹, se Mesjeta kryesisht fillon e mbaron ndërmjet shekujve V e XV, atëherë shenjat dhe gjurmët e para historike e arkeologjike të kulturës e qytetërimit islam në Ballkan, sidomos në trojet iliro-shqiptare, shpiejnë në periudhën kur popujt e sllavëve të jugut ende i përkisnin religjionit të tyre sllav, kurse ilirët gjendeshin ndërmjet rezistencës së fuqishme në pjesët rurale dhe përqaqimit të ngadalshëm të kristianizmit greko-bizantino-romak në pjesët urbane. Shkencëtari boshnjak M. Haxhijahiq, kur e trajton këtë çështje pohon se "shfaqja e Kristianizmit të sllavët e jugut, ose të pjesa më e madhe e tyre, nuk është më e vjetër nga shfaqja e Islamit."²

Në kontaktet dhe koekzistencën e hershme të popujve ballkanikë me popujt muslimanë determinuan kushtet natyrore-gjeografike të Ballkanit dhe trojeve iliro-shqiptare. Rrugët tokësore e detare transballkanike me mileniu-me çonin për Azi e Afrikë, dhe mundësonin fërkime dhe koekzistencë politike, ekonomike, tregtare, ushtarake, por edhe kulturore - filozofike.³

Në këtë pikëpamje duhet kuptuar edhe praninë e Islamit dhe të muslimanëve në Ballkan dhe në veçanti në trojet iliro-shqiptare.

¹ Periodizimi i këtillë i përgjigjet traditës pagano-kristiane evropiane dhe pa dyshim është i gabueshëm. Shih: Muhammed Umhazun, *Dirasa et-tarhi-l-islamijj*, Rijad, botimi I, 1416 apo përkthimi boshnjak: Muhammed Umhazun, *Koncept izucavanja islamske historije*, botimi I, Sarajevo, 2000, fq. 5 - 88.

² Shih: Muhammed Hadzijahic dhe të tjerë, *Islam i Muslimani u Bosni i Hercegovini*, Sarajevo, 1977, fq. 20; Muhammed Hadzijahic, *Neki pojavni oblici Islamske civilizacije u nas*, Argumenti - Časopis za društvenu teoriju i praksu, nr.2/1982, Rijekë, fq. 212; dhe shkrimet tona: *Islami në Ballkan para shekullit XV*, botimi II, Prizren, 2000, dhe *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, botimi III, Prishtinë, 2000.

³ Marija Gjukanović, në: Grup autorësh, *Historia e letërsisë botërore*, vëll. I, Prishtinë, 1989, fq. 190 - 191

Kjo temë deri tash vetëm fragmentarisht është trajtuar në literaturën e huaj, kurse në atë shqiptare është injoruar tërësisht, është e paprekur.⁴ Është detyrë e institucioneve shkencore dhe e individëve që në të ardhmen Mesjetës t'i përkushtohen të liruar nga prangat dhe shabllonet judeo-kristiane dhe greko-romake, paliane dhe svetosaviane, kryqtare dhe inkuizicionale, karagjorgjiane dhe shënstevaniane. Mos të frikësohemi se hulumtimi i historisë islame ndër ne do të thotë edhe islamizimi ynë.

I. Prejardhja dhe vendlindja e bullgarëve, vendosja e tyre në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare

Deri sot shkenca e historisë nuk posedon të dhëna të sakta mbi prejardhjen e bullgarëve. Hipotezat dhe tezat e ndryshme që qarkullojnë në literaturë duhet pranuar me rezervë, sepse historitë nacionale për arsyeza tendencioze të dhënat historike i interpretojnë konform politikës aktuale nacionale. Megjithatë, historianët neutral kontribuan që të krijohet një pasqyrë më reale.

Bizantologu botëror G. Ostrogorski bullgarët i quan "popull turk",⁵ kurse historiani anglo-amerikan, N. Malcolm, bullgarët i quan si fis turk,⁶ të cilët deri në shekullin VIII - IX ishin turqishtfolës, kur filluan të asimilohen.⁷ *Enciklopedia Britanike* bullgarët i quan "racë turaniane me prejardhje hune - avare"⁸ Edhe shkencëtari boshnjak A. Hukiq Bullgarët i quan fis turko-tatar, për të shtuar se janë "pasardhës direkt të Hunëve, të cilët pas migrimeve të mëdha pas shekullit të V-të u ndanë në dy grupe: njëri grup u vendos në Evropën qendrore dhe të mesme, kurse tjetri grup u vendos rreth lumit Vollga dhe degës së saj Karnu. Aty formuan Bullgarinë Pavolliane. Ky grup më vonë, gjatë viteve 921 - 922 e pranoi Islamin.⁹

⁴ Viteve të fundit nga ne dhe nga disa të tjerë kjo temë është prekur me nga disa rreshta, që nuk ka përmbushur as nevojat më elementare shkencore.

⁵ Georges Ostrogorski, *Historia e Perandorisë Bizantine*, Tiranë, 1997, fq. 83.

⁶ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, botimi II, Prishtinë - Tiranë, 2001, fq. 23.

⁷ Runciman, *Bulgarian Empire*, fq.93, sipas: N. Malcolm, op.cit., fq.377, fusnota 3. Kurse A. K. Bogdan bullgarët i quan përzierje të fiseve "Bullgare-Turke-Ugrike" të sllavizuara që në trojet thrako-ilire u vendosën në fund të shekullit VI. A. K. Bogdan, *Historia e shqiptarëve nga Ilirët e lashtë në erën e Islamit*, në: *Univers - revistë shkencore kulturore*, Nr. 1/2001, Tiranë, fq. 54.

⁸ *Encyclopaedia Britannica*, LTD, vol. IV, fq. 359.

⁹ Abdurrahman Hukić, *Arapi i Islam u Evropi*, Glasnik VIS-a, Sarajevë, nr. 4-6, 1961, fq. 152.

Në
Vollgës, e
Kutriguri.
të Detit të
Utiguri fo
Nul
këtë duhet
Sipa
Ahmed Ibr
me po këtë
herë i mbu
musliman,
përreth De
Rret
shqiptare l
fis turk kis
lënë gjurm
përjetoi p
ndarjes së
Sipa
filluan ver
interesante
ishin tejet
përdornin r
djegur dis
furishme të
dhe Epirin
200.000 nj
sllavëve dh
kishtare ba
që shkeli ke
zhytë në gj

¹⁰ Sipas: H. I
1999, fq. 10
1907, sipas:
vitit 1943, fo
¹¹ N. Malco
¹² Robert d
¹³ Blerim Q
¹⁴ Sipas: B. C
¹⁵ B. Çela, o

Në shekullin IV konsiderohet se bullgarët jetonin ndërmjet Uralit dhe Vollgës, që në vitin 433 ndahen në dy grupe: 1) Grupi i Utigurit dhe 2) Kutriguri. Grupi i Utigurit pas njëqind vitesh formoi një shtet të fortë në veri të Detit të Zi, të cilin në vitin 560 e shkatërruan Avarët. Por në vitin 582 Utiguri formoi shtetin e tij në Vollga.

Nuk kemi të dhëna të sakta mbi vendlindjen e tyre, por supozojmë se këtë duhet kërkuar në vendlindjen edhe të vetë turqve.

Sipas veprës "*Risaletu Ibn Fadlan*" të udhëpërshkruesit musliman Ahmed Ibn Fadlanit, në veri të lumit Vollga (ai e quan Itl) gjendej një qytet me po këtë emër me banorë, sipas tij, sllavenë, që quhej Bullgar, thajse çdo herë i mbuluar me borë, me shtëpi prej druri. Mes'udi, udhëpërshkrues tjetër musliman, pohon se Bullgarinë e banonin bullgarët dhe se ky vend gjendet përreth Detit të Zi.¹⁰

Rreth kohës së vendosjes së bullgarëve në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare ka mendime të ndryshme. Mirëpo, konsiderojmë se "*bullgarët si fis turk kishin filluar të plaçkisin në Ballkan në fund të shekullit V, duke mos lënë gjurmë më të thella.*"¹¹ Sipas D'Angely, prej vitit 534 deri 562 "*Iliria përjetoi pushtimet e sllavëve, bullgarëve dhe hunëve*"¹², që atëherë, pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë më 395, i takonte ritit bizantin.¹³

Sipas shkencëtarit çek, F. Dvornik, "*sllavët, avarët dhe bullgarët e filluan vendosjen e tyre në Ballkan nga fundi i shekullit VI.*"¹⁴ Është interesante të thuhet, se sllavët nuk kishin ushtri të veten, por numerikisht ishin tejet shumë. Ushtrinë e posedonin avarët, të cilët popullin sllavë e përdornin për ushtri. Pas vitit 580, avarët dhe sllavët, duke vrarë, plaçkitur e djegur disa vite rresht, filluan sllavizimin e Ballkanit. Sidomos, sulmet e furishme të hordhive avarë, sllavë e bullgarë, pas vitit 617, Ilirinë, Thrakinë dhe Epirin e zhytën në gjak ... Mendohet se si viktima e skllëvër ranë mbi 200.000 njerëz.¹⁵ Natyrën e pushtimeve të Ballkanit nga ana e avarëve, sllavëve dhe bullgarëve e përshkruan F. Dvornik: "*E gjithë kjo organizatë kishtare bashkë me shumë monumente të kulturës kristjane, u çdukën kudo që shkeli kamba sllavë. Për gati një shekull i gjithë gadishulli i Ballkanit, u zhytë në gjak dhe në zjarr dhe shumë qytete të lashta dhe të lulëzime u bënë*

¹⁰ Sipas: H. Mehmed Handzić, *Teme iz opce i kulturne historije*, vëllimi II, Sarajevo, 1999, fq. 100. Shih; Jakut, *Mu'xhem'ul-buldan*, I, fq. 379 dhe II, fq. 379, Kairo, 1907, sipas: Mustafa Busuladžić, *Muslimani u Rusiji*, Sarajevë, 1996, botim reprint i vitit 1943, fq. 11.

¹¹ N. Malcolm, op. cit., fq. 23.

¹² Robert d'Angely, *Enigma nga Pellazgët te shqiptarët*, Tiranë, 1988, fq. 237.

¹³ Blerim Çela, *Shqiptarët ndër shekuj*, Tiranë, 2001, fq. 115.

¹⁴ Sipas: B. Çela, op. cit., fq. 115.

¹⁵ B. Çela, op. cit., fq. 116.

hi e pluhur."¹⁶ Pas vendosjes së sllavëve, avarëve dhe bullgarëve në Ballkan, popullsia në Iliri e përreth "për një kohë të gjatë ishte larguar nga krishterimi (bizantin, N. Ibrahim). Dhuna e ushtruar nga pushtuesit, djegia dhe rrënim i çdo gjëje mbi tokë, bëri që "ndërtesa kishitare të asaj kohe (shekullit VII, N. Ibrahim) më nuk ka."¹⁷

Kah fundi i shekullit VII, përkatësisht në vitin 679 e pas, bullgarët nën udhëheqjen e kanit Asparuh, u shkëputën nga supremacia e avarëve (dhe sllavëve, N. Ibrahim), por edhe nën presionin e Kazarëve, dhe duke e kaluar Danubin, u vendosën në mes Danubit dhe Selanikut, përkatësisht në tokat e Bullgarisë së sotme, duke u pavarësuar nga Bizanti.¹⁸ Mirëpo, pasi bullgarët ishin numerikisht më të vegjël se sllavët, gjuha bullgare filloi të zëvendësohet me atë sllave. Këtë fakt e pohon edhe N. Malcolm, për të theksuar se gjuha bullgare është zhdukur kah gjysma e shekullit IX.¹⁹ Edhe G. Ostrogorski ishte i mendimit se "vërshimi i popullit turk të Bullgarëve në Ballkan është nga mesi i shekullit VII e pas".²⁰

Në fillim të shekullit VIII, dyndjet sllave morën fund në Ballkan, duke rezultuar me ndryshime të mëdha të strukturës etnike të vendeve të Ballkanit. Thrakët, banorët e parë të Ballkanit bashkë me Ilirët,²¹ u zhdukën krejtësisht duke e formuar Bullgarinë e sotme.²² Kurse vendbanimet ilire u ngushtuan dhe më tepër dhe popullsia që banonte në vendet që sot quhen Slloveni, Kroaci, Dalmaci, Bosnje, Serbi, Maqedoni, Mal i Zi u asimiluan krejtësisht duke u sllavizuar ose duke u shfarosur.²³

Pjesërisht këtij asimilimi apo kësaj shfarosjeje i shpëtuan trojet iliro-shqiptare, dëshmi të së cilës janë shqiptarët e sotëm.²⁴

¹⁶ F. D v o r n i k, Les Slaves, Byzance et Rome au IX-e siècle, 1926, sipas: Tajar Zavallani, *Histori e Shqipërisë*, botimi II, Tiranë, 1998, fq. 80. Shih gjerësisht: Neritan Ceka, *Ilirët*, Tiranë, 2001, fq. 277 (275-278).

¹⁷ Hansjurg Frommer, *Die Illyrer*, Karlsruhe, 1988, në: *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, Prishtinë, 1990, fq. 173.

¹⁸ *Encyclopaedia Britannica*, vol. IV, fq. 359. B. Çela, op. cit., fq. 126. G. Castellan pavarësimin bullgar e përshkruan si vijon: "Gjatë gjysmës së dytë të shekullit VII një popull turanian, i afërt me turqit, protobullgarët e detyruan Bizantin ta njetë shtetin e tyre qysh më 681". Georges Catellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë, (-), fq. 23.

¹⁹ N. Malcolm, op. cit., fq. 377; Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit*, vëllimi I, Tiranë, 1999, fq. 28.

²⁰ G. Ostrogorski, op. cit., fq. 83.

²¹ Për këta dy popuj ka të dhëna të mjaftueshme se janë ndër banorët e parë të gadishullit ballkanik. Shih: B. Jelavich, op. cit., fq. 17.

²² B. Çela, op. cit., fq. 117.

²³ B. Çela, op. cit., fq. 117; Krhs.: T. Zavallani, op. cit., fq. 75.

²⁴ Shih: Neritan Ceka, *Ilirët*, Tiranë, 2001, fq. 275 tj.

Ve

kryesisht

sllavëve,

fundi i

shekujve

bullgarët

dallonin

vonë për

konsideru

harruan g

Qo

mbrojtje

Bizantit,

popullatë

Kë

arabe.²⁸

Në

zgjerimin

agresiv, e

perandori

në Shqipë

De

sundimit

zgjeruan e

kundër ar

kusarët ar

Maqedoni

²⁵ Ibid., fq.²⁶ G. Ostr²⁷ Për luftë

Britannica,

²⁸ Rade H

području, l

²⁹ Shih: H

130; Shan

³⁰ N. Malc³¹ Grup aut

150 - 151.

³² Dragan T

Aktiviteti ushtarak bullgar në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare

Vendosja e bullgarëve në Ballkan e sidomos në trojet iliro-shqiptare, kryesisht është kryer nëpërmjet avarëve, si elitë sunduese ushtarake, sllavëve, si masë në ushtrinë avarë dhe atë bullgare. Këto sulme filluan kah fundi i shekullit V, në mënyrë josistematike, për t'u intensifikuar gjatë shekujve VI e VII.²⁵ Kah fundi i shekullit VII (679) kani Asparuh, i shkëputi bullgarët nga dominimi avaro-sllav. Ndonëse në fillim sllavët dhe bullgarët dallonin mjaft²⁶ në gjuhë, në besim dhe në traditat tjera, këto dallime më vonë për shkak të aleancave dhe bashkëpunimeve të tjera, u zvogëluan konsiderueshëm. Kjo para së gjithash manifestohet në faktin se, bullgarët e harruan gjuhën e tyre me prejardhje turke dhe pranuan sllavishten.

Qoftë në ofanzivë me synim zgjerimi, qoftë në defanzivë me synim mbrojtjeje, gjatë disa shekujve bullgarët bënë luftëra të përgjakshme kundër Bizantit, Hungarisë, Ruisisë, popullit peçeneg, fiseve të ndryshme dhe popullatës vendëse thrakase dhe iliro-shqiptare.²⁷

Kështu, më 821 deri 823 bullgarët i gjejmë aktiv në luftërat bizantino-arabe.²⁸

Në kufijt lindor të Ilirisë patën arritur bullgarët, të cilët synonin zgjerimin e shtetit të tyre. Kështu, gjatë viteve 830 – 880 bullgarët janë tejet agresiv, duke mbjell tmerr në viset e pushtuara, që deri atëherë i mbante perandoria bizantine. Në vitin 851 ata u shtrinë në Maqedoninë qendrore dhe në Shqipërinë e jugut, duke pushtuar Ohrin dhe Devollin.²⁹

Deri në vitin 850 bullgarët e pushtuan edhe Kosovën.³⁰ Kurse gjatë sundimit të Simeonit (sundoi prej 893 – 927) kufijt e shtetit bullgar u zgjeruan edhe në të gjitha tokat shqiptare.³¹ Simeoni duke përfutur nga lufta kundër arabëve në Selanik, ku shkoi si ndihmë për Bizantin që t'i dëbojnë kusarët arabë, fitoi nga Bizanti dhuratë përveç Selanikut edhe pjesën tjetër të Maqedonisë,³² që pastaj ta pushtojë më 904 Vlorën dhe Himarën, më vonë

²⁵ Ibid., fq. 300 – 301.

²⁶ G. Ostrogorski, op. cit., fq. 83.

²⁷ Për luftërat bullgare hungareze, ruse, peçenega, kumane etj. shih: Encyclopaedia Britannica, vol. V, fq. 359.

²⁸ Rade Bozović, *Arapi u usmenoju narodnoj pesmi u srpsko-hrvatskom jeziku području*, Beograd, 1977, fq. 176.

²⁹ Shih: Hansjorg Frommer, *Die Illyrer*, op. cit., fq. 173; B. Çela, op. cit., fq. 130; Shan Zefi, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren, 2000, fq. 47.

³⁰ N. Malcolm, op. cit., fq. 27.

³¹ Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, vëll. I, botimi III, Prishtinë, 1979, fq. 150 – 151.

³² Dragan Tashkovski, *Mbi kombin maqedonas*, Shkup, 1975, fq. 36 dhe 96.

Butrintin dhe Nikopojën (Prevezën), pastaj qytetin ilir Antiparea (Berati) e prej këtej pushtuan luginën e Vjosës³³ etj. Këtë sukses të bullgarëve e ndihmoi konsiderueshëm grupi turano-bullgar i Asparuhut, që deri atëherë ishte i stacionuar në Detin e Zi në Lindje.³⁴

Në dekadat vijuese ra edhe Durrësi (1005), Manastiri (1014), Shkodra³⁵ etj. Ky ishte, pak a shumë, edhe zeniti i bullgarëve në trojet iliro-shqiptare.

Lëvizjet etnike, misionariste dhe heretike

Bullgaria mesjetare, por edhe trojet iliro-shqiptare, ishin udhëkryq i lëvizjeve të ndryshme të popujve, të grupeve misionariste dhe sekteve heretike. Janë të shumta këto lëvizje³⁶, por ne do të përmendim vetëm disa shembuj.

Bogumilizmi. - Pas Simeonit, e në periudhën e sundimit të Car Pjetrit në Bullgari, shfaqet sekta bogumil, që ngjashëm me mesailianët dhe paulicianët, u shpërngulën masovikisht në Bullgari e Maqedoni.³⁷ Konsiderohet se fillimi i tyre në Ballkan zë fill në shekullin e VIII, kur paulicianët e Armenisë nga Bizanti qenë transferuar në Thraki që t'i mbrojnë kufijtë kundër Bullgarisë.³⁸ Nismëtar i bogumilizmit ishte popi Eremi i quajtur Bogumil, që jetoi në shekullin X. Ky proklamoi idetë maniheiste dualiste, duke e quajtur veten kristian të mirë.³⁹

Bogumilizmi me doktrinën e tij, kundërshtoi katolicizmin dhe ortodoksizmin dhe ishte shumë më afër Islamit dhe monoteizmit të tij. Për

³³ Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar (395 – 1875)*, Tiranë, 1999, fq. 78; B. Çela, op. cit., fq. 130.

³⁴ Shih: D. Tashkovski, op. cit., fq.22.

³⁵ B. Çela, op. cit., fq.130; Hansjorg Frommen, op. cit., fq. 173.

Kleriku katolik Atë Lech Rynkieciéz S. J. konsideron se gjatë viteve 917 – 1019 nën sundimin bullgar ra Shqipëria qendrore – jugore, me përjashtim të bregdetit që mbeti në duart e Bizantit. Shih: Disa data të rëndësishme historike, në: David Xhuxho, *Papa në Shqipëri më 25 prill 1993*, Radio Vatikani – Drita, 1995, fq. 128.

³⁶ Në Bullgarinë mesjetare, pos kristianëve kishte edhe hebraikë dhe muslimanë. Po ashtu, ekzistojnë edhe sektet e bogumilëve, babunëve, patarinëve, katarëve, albigjezëve e të tjetër, që shtriheshin prej Armenisë deri në Francën Jugore. (Shih: G. Ostrogorski, op. cit., fq. 182; Vjekoslav Klaić, *Poviest Bosne do propasti kraljevstva*, Zagreb, 1882, fq. 347.

³⁷ G. Ostrogorski, op. cit., fq. 182

³⁸ Shan Zefi, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren, 2000, fq. 93.

³⁹ V. Klaić, op. cit., fq. 347; Sh. Zefi, Op. cit., fq. 92.

këtë arsyë,
Serbia etj.
trojet iliro-
në shekull
Kulin ban
ortodoksi
kurse me a
me vetëdës

Kon
në Serbi e
pos asaj që
ndikuan d
Bullgari, r
turqit vard
eksteriorë,

Peçe
shekullin I
njihen me
periudha e
pranoi kri
Peçeneget
por edhe n
tyre të shl
iliro-shqip

Sari
lëvizjet e t
ndër bizan

⁴⁰ V. Klaić
ni u krilu ju
Dh. Shuteric

⁴¹ V. Klaić

⁴² Grup auto

⁴³ Th. W Ar
në dorëshkr
III, Prishtinë

⁴⁴ Gjerësisht
trojet iliro-s
Edukata isla

⁴⁵ Rade Bo
op. cit., fq 2

këtë arsye, bogumilizmi u ndoq rigorozisht nga Bizanti, Bullgaria, pastaj nga Serbia etj. Në pamundësi veprimi, bogumilët filluan lëvizjet e tyre nëpër trojet iliro-shqiptare për t'u vendosur në shekullin XII në Bosne.⁴⁰ Më vonë, në shekullin XIII bogumilizmi u bë fe zyrtare e shtetit në Bosne, kur mbreti Kulin bani me dekret të vetin, lëkundjet ndërmjet katolicizmit romak, ortodoksizmit greko-bizantin i stabilizoi në Kishën boshnjake bogumile,⁴¹ kurse me ardhjen e osmanlinjve në Bosne, populli boshnjak e pranoi Islamit me vetëdëshirë, pa rezistencë, sikur edhe shqiptarët.⁴²

Konsiderojmë se kalimi i bogumilëve nga Lindja në Bullgari, e pastaj në Serbi e trojet iliro-shqiptare, nuk ishte pa ndikim të shqiptarët. Gjithashtu, pos asaj që doktrina bogumiliste ishte më afër Islamit se kristianizmit, ata u ndikuan drejtpërdrejt nga mësimet islame edhe gjatë qëndrimit të tyre në Bullgari, në trojet iliro-shqiptare e të tjera, nga Sari Salltuku, peçenegët, turqit vardariot, muslimanët e Panonisë etj. Këta edhe ishin disa nga faktorët eksteriorë, që nga shqiptarët feja Islame u përqaftua pa përplasje të mëdha.⁴³

Peçenegët. - Fërkimet e para të peçenegëve⁴⁴ me bullgarët i hasim në shekullin IX e pas. Këto fërkime disa shekulle ndikuan te bullgarët që të njihen me mësimet islame, krahas njoftimeve që kishin për Islamit, nga periudha e parakristianizmit më 856, kur kani bullgar Borisi, personalisht e pranoi kristianizmin ortodoks dhe filloi kryqimin e popullësisë vendëse. Peçenegët herë-herë në aleancë me bullgarët, e herë-herë në armiqësi me ta, por edhe në Perandorinë Bullgare për disa shekuj ndikuan që "arsimimin e tyre të shkëlqyeshëm" arabo-islam, ta bartin në tërë Ballkanin dhe trojet iliro-shqiptare.⁴⁵

Sari Salltuku. - Paraqitja e Sari Salltukut në skenën historike dhe lëvizjet e tij misionariste, paraqesin faktin me rëndësi në përhapjen e Islamit ndër bizantinët, bullgarët, hungarezët dhe trojet iliro-shqiptare në shekullin

⁴⁰ V. Klaić, op. cit., fq. 347; Suljaga Saliagić, *Mi bosansko-hercegovački muslimani u krilu jugoslovenske zajednice*, Banja Luka, 1940, fq. 9; Sh. Zefi, op. cit., fq. 93; Dh. Shuteriqi, *Gjurmime letrare*, Tiranë, 1974, fq. 24...

⁴¹ V. Klaić, op. cit., fq. 347; Sh. Zefi, op. cit., fq. 93.

⁴² Grup autorësh, *Rreth përhapjes së islamit te shqiptarët*, botimi II, Prizren, 2001.

⁴³ Th. W Arnold, *Povijest islama*, Sarajevo, 1990. (është e përkthyer edhe në shqip, në dorëshkrim); N. Ibrahim, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, botimi III, Prishtinë, 2000.

⁴⁴ Gjerësisht për peçenegët: N. Ibrahim, *Prejardhja dhe vendosja e peçenegëve në trojet iliro-shqiptare e në Ballkan dhe roli i tyre në përhapjen e islamit në këto troje*, *Edukata islame*, nr. 65/2001, Prishtinë, fq. 57 - 76.

⁴⁵ Rade Bozović, op. cit., fq. 183 etj.; Muhammed Hadzijahić, *Islam i muslimani*, op. cit., fq. 26 etj.

XIII e XIV, në kohën kur shtetet e atëhershme evro-balkanike ndërmerrnin të gjitha masat për çrrënjosjen e pikëpamjeve heretike.⁴⁶

Nga Buhara nëpër Anadoll, qysh prij vitit 1241 Sari Salltuku dhe ithtarët e tij të shumtë, u vendosen në Dobrukhë të Bullgarisë, atëbotë territor bizantinas.⁴⁷ Prej Dobrukhës, Sari Salltuku dhe ithtarët e tij lëvizën në drejtime të ndryshme. Gjurmët materiale, toponimia dhe legjendat e shumta dëftojnë se ai ishte në misione fetare e ushtarake në Panoni, Hungari, Çeki, Sllovakia, Shkup, Srem, Maçvë, Bosnje, Krujë, Durrës, Opojë, Pejë, Gjalllicë të Gjakovës, Prilep të Deçanit, Shën Naum të Ohrit, etj.⁴⁸

Këta tre shembuj (bogumilët, peçenegët, Sari Salltuku) nuk janë të vetmit, por janë shembuj shumë të qartë për ta pasqyruar pak më realisht gjendjen politike, fetare, sociale e kulturore në Bullgari dhe në trojet iliro-shqiptare, para kristianizimit të Bullgarisë, gjatë kristianizimit dhe pas përfundimit të procesit të kristianizimit.

Bullgarët para kristianizimit të tyre

1.-Gjendja shpirtërore në Bullgari dhe në trojet iliro-shqiptare në periudhën historike të problematizuar ishte e determinuar nga faktori ushtarak, politik e ekonomik. Romakët, gotët, anzhujt, sllavët, avarët, peçenegët, bullgarët dhe popullësia vendëse e Evropës ishin në konflikte reciproke të vazhdueshme, madje deri në shfarosje. Thrakët, peçenegët dhe pjesërisht iliro-shqiptarët janë shembuj tipik të mbijetimit të më të fortit.

Kristianizimi i tipit katolik e ortodoks gjatë shekujve gjithnjë e më shumë institucionalizohej. Rezistenca e besimeve të lashta gjithnjë e më tepër dobësohej nga ofanziva shfarosëse e romakëve, bizantinëve, pastaj e sllavëve etj.⁴⁹

⁴⁶ Kemal H. Karpat, Gradjanska prava muslimana Balkana, në: *Muslimani Balkana – Istočno pitanje u XX veku*, Tuzla, 2001, fq.96; Skender Rizaj, *Shqiptarët dhe Serbët në Kosovë*, Prishtinë, 1991, fq. 49.

⁴⁷ Halil Inalxhik, Perandoria osmane –1300 – 1600, Shkup, 1995, fq. 269 – 270; Dzemail Cehajić, *Derviški redovi u jugoslovenskim zemljama*, Sarajevo, 1986, fq. 101. Shënimet historike tregojnë se me Sari Salltukun janë shpërngulur disa dhjetëra mija njerëz të vendosur në 12.000 tenda. Sipas: Grup autorësh, *Muslimani Balkana*, op. cit., fq. 96.

⁴⁸ Shih gjerësisht: N. Ibrahimi, *Sari Salltuku dhe roli i tij në përhapjen e islamit në trojet ilir-shqiptare e ballkanike para shekullit XIV*, dorëshkrim, fq. 21.

⁴⁹ Naser Ferri, *Latronët – lëvizje e rezistencës kundër romanizimit*, Bajku – e përditshme e dt. 23. 11. 1996, Prishtinë, fq. 13. N. Ibrahimi, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, op., cit., fq. 179 – 216.

Eks
shqiptarët
drejtpërdre
janë të pa
Kri
e ilegalisht
shekullin
se "Kristian
proces i h
dyfishohes
ktheheshin
zor."⁵¹

Në l
e popujve
fillimisht
muslimanë
të kristian
shpirtërore

2.- N
Islami dhe
shtrihej në
se prania
dekada par
luajtur treg
Këtë temë
Islamo-mus
nëpërmjet
nëpërmjet F

Disa
Bullgare dh
kulturë të la
i vjetër kro

⁵⁰ N. Ibrahimi, është edhe kë
të përfunduar
Pejë, 2000, fq.
ndër shekuj, l

⁵¹ J. Le Goff

⁵² N. Ibrahimi
17 – 37 dhe 4

⁵³ R. B o z o

Ekzistojnë supozime, asnjëherë të argumentuara historikisht, se shqiptarët u kristianizuan menjëherë pas vdekjes (sic!) të Jezusit, drejtpërdrejt nga Pali. Përpjekjet që kjo "e vërtetë" të plasohet si e vërtetë janë të paqëndrueshme.⁵⁰

Kristianizimi i Evropës dhe Ballkanit vërtetë filloi herët individualisht e ilegalisht, që të intensifikohet në shekullin IV, kurse për të marrë hovë në shekullin IX e për të përfunduar në fund të shekullit XIII. J. Le Goff pohon se "*Kristianizimi në Rusi, Ukrainë dhe Ballkan në shekullin X, XI e XII është proces i hapur*", për të vazhduar se në këto troje "*shpesh revoltat pagane dyfishoheshin, shndërroheshin në kryengritje shoqërore, kurse masat ktheheshin në paganizëm, sepse kristianizimi mesjetar është nga lart dhe me zor.*"⁵¹

Në këtë gjendje politike, ushtarake dhe ekonomike gjendja shpirtërore e popujve ishte e ndrydhur nga pushtuesit dhe sunduesit e ndryshëm fillimisht paganë e më vonë kristianë. Shembulli i fesë islame dhe i muslimanëve në Perandorinë Bullgare ende të pakristianizuar dhe më pastaj të kristianizuar, është shembull shumë i qartë si një pasqyrë e gjendjes shpirtërore në këto troje në këtë periudhë historike.

2.- Nuk disponojmë me të dhëna ekzakte se prej kur janë vendosur Islami dhe muslimanët në trojet e perandorisë mesjetare bullgare që atëherë shtrihet në pjesën më të madhe të trojeve iliro-shqiptare, por ishte e sigurtë se prania Islamo-muslimane është e evidente qysh në shekullin IX, disa dekada para kristianizimit të bullgarëve. Sigurisht se rol me rëndësi kanë luajtur tregtarët, misionarët, migrimet e dhunshme dhe ato ekonomike etj.⁵² Këtë temë orientalisti jugosllav R. Bozhoviq e përkufizon ashtu që praninë Islamo-muslimane në këto troje e sheh kryesisht "*nëpërmjet Bizantit, nëpërmjet basenit të Mesdheut: Spanjës, Egjiptit fatimit dhe Sicilisë, nëpërmjet Hungarisë, apo veriut dhe luftëtarëve nomadë të peçenegëve*".⁵³

Disa burime qartazi flasin se në fillim të shekullit IX, në Perandorinë Bullgare dhe në vendet fqinje muslimanët ekzistonin masovikisht, me një kulturë të lartë fetare, kulturore, por edhe të banimit, ushqimit etj. Historiani i vjetër kroat V. Klaiç pohon se, në Bullgari dhe në vendet fqinje ka pasur

⁵⁰ N. Ibrahim, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, op. cit. I këtillë është edhe konstatimi se "në trevën e Kosovës kemi vetëm procesin e krishterizimit të përfunduar në antikën e vonshme..." Muhamet Tërnav, *Studime për Mesjetën*, Pejë, 2000, fq. 265. Shih edhe: Shyqri Nimani, *Trojet shqiptare në harta dhe stema ndër shekuj*, Prishtinë, 1996, fq. 18 etj.

⁵¹ J. Le Goff, *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, Tiranë, 1997, fq. 182 - 183.

⁵² N. Ibrahim, *Islami në Ballkan para shekullit XV*, botimi II, Prizren, 2000, fq. 17 - 37 dhe 43 - 77.

⁵³ R. B o z o v i c, op. cit., fq. 176.

muslimanë.⁵⁴ F. Raçki pohon se "tregohet se arabët, duke shpërndarë libra, kanë përhapur islamin...".⁵⁵ Edhe Llujo Taller në librin e tij "Nga fallxhorët e magjistarët deri të mjeku modern" thekson se në këtë kohë Bullgaria ishte përplotë muslimanë dhe se njëherë bullgarët madje i kanë djegur librat muslimane në Bullgari.⁵⁶

Tashmë pamë, se bullgarët dhe Bullgaria, që atëherë në shekullin IX kapte pos Bullgarisë së sotme edhe trojet iliro-shqiptare,⁵⁷ ishin përplotë libra muslimane (saracene), mirëpo ndonëse Franjo Raçki thekson, se Arabët janë ata që i sollën dhe i distribuuan librat, nuk kemi hasur në të dhëna se në cilat gjuhë ishin librat saracene (muslimane) në Bullgari, sepse po të ishin në arabishte nuk shohim ndonjë rrezik për bullgarët dhe kristianizmin e tyre të ri dhe për vetë Borisin. Ka gjasë, që këto libra të kenë qenë në gjuhën e popullit, e mbase me shkronja arabe⁵⁸, që për bullgarët do të ishte rrezik më i madh⁵⁹ se sa librat islame në gjuhën arabe, që pakush i kuptonte nga populli.

Për muslimanët në Bullgari në pjesën e parë të shekullit IX, është ruajtur dëshmi e dorës së parë në Arkivin e Vatikanit, në kreun CIII të letres së njohur të papës së 113 Shën Nikolla I i Madh (që sundoi gjatë viteve 858 – 867)⁶⁰ me titullin "*Response Nicolai I Papae ad consulata Bulgarorum*", ku thotë:

"De Iberis profanis, quos a Saaracenis vos abstalisse ac apud vos habere perhibetis, quind facienden sit, in quiritis. Qui nimirund non sunt reservandi: 'Carrumpunt' enim, sicut scriptum est 'mores bonos colloquia male', sed utpate noxiū et blas phemi ignitradendi".

"Ju pyetni ç' duhet bërë me librat heretikë, të cilët pohoni, gjenden te ju, kurse i keni marrë nga saracenët. Ato, natyrisht, nuk duhet ruajtur, sepse sikur që është e shkruar (në Enciklikën mbi Korinasit), kuvendimet e këqija

⁵⁴ V. Klaić, op. cit., fq. 347.

⁵⁵ Franjo Raçki, *Bogumili i patarenit*, fq. 350, sipas: Mehmed Handžić, *Islamizacija Bosne i Hercegovine i poreklo bosansko-hercegovačkih muslimana*, Sarajevo, 1940, fq. 13.

⁵⁶ Franjo Raçki, op. cit., fq. 350. Shih: Mustafa Spahić, *Povijest islama*, 4, Sarajevo, 2000, fq. 136.

⁵⁷ Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, fq. 194; Muhamet Tërnavë, *Popullësia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, 1995, fq. 20.

⁵⁸ Kjo nuk është e pamundur kur dimë se edhe Polakët që pranuan Islamin në mesjetë në shekullin XIII përdornin shkronjat arabe edhe për gjuhën amtare polake, sikur që boshnjakët mo vonë përdornin bosançiçen apo shqiptarët alfabetin e adaptuar arab. Shih: A. Hukić, *Arapi i islam u Evropi*, Glasnik VIS-a, Sarajevë, nr. 7-9, 1961, fq.280.

⁵⁹ Muhamet Hadžijahić, *Islam i Muslimani*, op. cit., fq. 22.

⁶⁰ Zef Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Prizren – Zagreb, 1998, fq. 438.

prishin moralin e shëndoshë, e për këtë si të dëmshme dhe heretike dorëzoni zjarrit." ⁶¹

Nga përgjigjja e papës drejtuar Borisit, qartë duket se bullgarët, përkatësisht kani Borisi, në hamendjet e tij më tepër politike ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, në këtë periudhë, iu drejtua papës së Vatikanit për këshillë, se si të veprojë me librat saracene (d.m.th. muslimane) pas kristianizimit të muslimanëve dhe të tjerëve në Bullgari. Këtë ndodhi e regjistrojnë si burimet muslimane, ashtu edhe ato jomuslimane. ⁶²

Përkundër kristianizimit të muslimanëve me dhunë në Bullgari, një pjesë e muslimanëve vazhduan të jetojnë në këto dhe trojet përreth. ⁶³ Prania e peçenegëve, e ithtarëve të Sari Salltukut dhe muslimanët vendas janë argumenti më i fuqishëm për pohimin tonë se Islami vazhdoi të jetojë.

Historiani e udhëpërshkruesi musliman Jakut el-Hamevi shënon se, në vitin 922 / 309 hixhrij, i dërguari i mbretit bullgar e njoftoi halifin abasit në Bagdad, El-Muktedir Bil-lah, për pranimin e Islamit nga ana e mbretit dhe e familjes së tij. ⁶⁴

Ndonëse me ndryshime tejet të vogla, po këtë ndodhi e hasim edhe te udhëpërshkruesi i njohur musliman Ibn Fadlani, i cili njofton se gjatë kohës së sundimit të halifit El-Muktedir Bil-lah (295-320 hixhrij / 907-932) arriti një i deleguar nga qyteti i Bullgarëve dhe njoftoi se sunduesi i sllavenëve ⁶⁵ me emrin Bulutvar ka përqaftuar Islamit dhe se kërkon dikë që do t'ia mësojë atij dhe të tjerëve këtë fe. Halifi El-Muktedir e përgatiti dhe e dërgoi një delegacion me dhurata, kurse shkresën ia dorëzoi Ibn Fadlanit. Ibn Fadlani e përshkroi udhëtimin e tij, por ky udhëpërshkrim humbi, pos disa fragmenteve. Këto fragmente Rusët në Petrograd më 1823 i botuan në

⁶¹ Citati në origjinal dhe përkthimi i tij janë sipas: Muhamed Hadzijahić, *Islam i Muslimani*, op. cit., fq. 22.

⁶² Shih: *Enciklopedija živih religija*, Beograd, 1990, fq. 132; Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë, (-), fq. 39-40; Miroslav Brandt, *Srednjovjekovno doba povijesnog razvitka*, vëllimi I, Zagreb, 1980, fq. 345; Dhori Qiriazi, *Krishterimi i Shqipërisë*, Tiranë, 2000, fq. 55; Rade Bozović, op. cit., fq. 178; Hansjorg Frommer, *Die Illyrer*, Karlsruhe, 1988, në: *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, Prishtinë, 1990, fq. 178; G. Ostrogorski, op. cit., fq. 162 etj.

⁶³ Ka mendime se një pjesë e Bullgarëve Povollian mbetën në Bullgari, por një pjesë migroi këtë kohë por sidomos rreth vitit 1238, duke ikur para sulmeve të furishme të ushtrisë së Xhingiz-hanit. Një pjesë e tyre u vendosë në Hungari, një pjesë në Finlandë dhe në pjesët tjera më të qota. Shih: A. Hukić, nr. 4-6/1961, op. cit., 152 dhe 281.

⁶⁴ Jakut el-Hamevi, *Mu'xhem'ul-Buldan*, Kairo, 1323 /1906, fq. 486 - 487, sipas: F. Rexhepi, *Kultura arabo-islame në Ballkan para ardhjes së turqve*, Dituria islame, nr. 76/1996, Prishtinë, fq. 36.

⁶⁵ Ibn Fadlani nuk e bën dallimin ndërmjet sllavëve dhe bullgarëve.

original e përkthim.⁶⁶ Ibn Fadlani përshekruan sunduesin bullgar Bulutvarin se si e priti dhe gostiti, se si e mori emrin Xhafer, ai përshekruan ushqimet dhe pijet, traditat e tyre etj.⁶⁷

Një burim tjetër sunduesin bullgar Bulutvarin dhe popullin e tij e vendos përbri Vollgës. Rreth qytetit bullgar jetonin fise që merreshin me gjueti, kurse banorët e tyre, bullgarët povollian, duke iu falënderuar sunduesit të tyre Allmasit (në burimet tjera Bulutvari) e pranuan fenë Islame. Me kërkesë të Allmasit, halifi abasit El-Muktedir Bil-lah i dërgoi dijetarët e tij në Bullgarinë Povolliane me qëllim që të përhapet Islami. Më vonë shtatë dijetarë nga këta do të shkojnë në Hungari dhe në Evropën e mesme për ta përhapur Islamit.⁶⁸

Praninë e Islamit në Bullgari e vërejmë edhe në burimet tjera pravosllave. Në vitin 896 / 376 hixhrij në Kiev të Ukrainës, shkoi një i deleguar musliman ta përvetësojë Shën Vlladimirin, mbretin e Ukrainës, që ta përqafojë Islamit. Pasi që ai ishte ende në religjionin e tij të vjetër sllav, i ftoi teologët muslimanë bullgarë të Vollgës që t'ia ekspozojë themelet e besimit të tyre. Vlladimiri edhe vetë morri pjesë në diskutime shkencore.⁶⁹

Vetë Vlladimiri këtë ndodhi e përshekruan në mënyrën vijuese: "Ja erdhën Bullgarët duke më thënë: prano ligjin tonë (Islamit, N. Ibrahim). Pastaj erdhën gjermanët duke e lavdëruar ligjin e vet. Pas tyre erdhën hebraikët. Më në fund erdhën grekët të cilët i kritikuan të gjitha fetë pos të tyre ... Këshilltarët më thanë: "Ti e di, o sundues se askush nuk e qorton atë, që është e tij, por përkundrazi, vetëm e lavdërojnë. Nëse dëshiron me kujdes të njoftohesh, dërgoi disa njerëz tu, që t'i studiojnë traditat e ndryshme fetare dhe të shohin se si disa popuj e lavdërojnë Zotin."⁷⁰

Nga burimi tjetër, nga kronika mesjetare ruse 'Povest vremenih leta' e shekullit XI, lexojmë, se Vlladimiri pas takimit me shumë delegacione të

⁶⁶ Sipas: H. Mehmed Handžić, *Teme iz opce i kulturne historije*, op. cit., fq. 101.

⁶⁷ Ibid., fq. 101 – 102.

⁶⁸ Sipas: T. O. Tarhani, *Neki spomenici islamske kulture u Madzarskoj, Islamska misao*, nr. 43/1982, Sarajevë, fq. 43.A. Hukić pohon se "sunduesi i Bullgarëve Povollian Almasi i dërgoi dhuratat të çmueshme halifit El-Muktedir Bil-lahit, pasi e pranoi Islamit dhe një shkresë në të cilën kërkoi t'i dërgohen njerëz të ditur. El-Muktediri e dërgoi një delegacion në krye me Ahmed ibn Fadlanin. Ibn Fadlani pos tjerash shkroi udhëpërshkrimin e tij, ku përshekroi Bullgarinë, Bashkirinë, vise të detit Kaspik etj. A. Hukić, op. cit., fq. 152.

⁶⁹ M. Hadžijahić, *Islam i Muslimani*, op. cit., fq. 21 – 22. Për bullgarët povollian apo vollgian, të grupit të Utigurit mendohet se fillimisht ishin politeistë, por shumë herët, në vitin 900, e pranuan islamit, që sigurisht ka të bëjë me Allmasin apo Bulutvarin. Shih: *Encyclopaedia Britannica*, vol. IV, fq. 359.

⁷⁰ Chronique dite de Nestor, ann. 987, XLI, Paris, 1884, sipas: Marko Sustjić, *Hrestomatija izvora za opstu istoriju srednjeg vijeka*, Sarajevë, 1980, fq. 355.

feve të ne
verifikua
në Bullg
Këto dek
në vitin 9

N
masive n
fuqishëm
madhe të

3.-

(679 e pa
ardhje tu
më i mad
faktor në
ria filloi
Papatit d
(serbët, n

Atë

të kontes
ta pranoi
interveno
kristianiz
kristianiz
vet nën

⁷¹ Shih: P
Shkëlzen
31, fusnot

⁷² Sipas A
sllavjen t
Biblija i e
Evropë të
shekullit

zgjerim e
Edhe M

kishte fil
Mesjetën,

⁷³ M. Bra

⁷⁴ Georg
shkencore
kristianiz
saktë të v
Jellavič
ndodhi në

feve të ndryshme, e dërgoi një delegacion për t'i vizituar disa qendra, për ta verifikuar besimin e tyre. Pas kthimit të delegacionit, ata pohuan: "Erdhëm në Bullgari dhe pamë se si luten ata në tempull, përkatësisht në xhami...". Këto deklarata ata i dhanë në vitin 6495 sipas kalendarit të tyre, përkatësisht në vitin 987 sipas kalendarit gregorian.⁷¹

Nga e tërë kjo që u cek rezultoi, se në këto vise ka pasur vendbanime masive muslimane, pos tjerash edhe xhami të shumta, që janë argument i fuqishëm, se Islami ishte fe më e hershme te banorët vendorë të pjesës më të madhe të Evropës Juglindore.

3.- Pavarësimi politik i bullgarëve nga Bizanti në fund të shekullit VII (679 e pas), asimilimi gjuhësor i tyre duke e harruar gjuhën e tyre me prejardhje turke, por duke e pranuar sllavishten nga populli sllav, numerikisht më i madh, dhe zgjerimi i shtetit bullgar në të gjitha anët, Bullgarinë e bëri faktor në regjion. Njëkohësisht, krahas fërkimeve politiko-ushtarake, Bullgaria filloi fërkimet intenzive edhe në rrafshin shpirtëror, kryesisht ndërmjet Papatit dhe Bizantit, që ishte karakteristik edhe për popujt tjerë përreth (serbët, maqedonët, rumunët e rusët) në shekujt IX - X.⁷²

Atë kohë me Bullgarinë sundonte kani Borisi (852 - 889). Për shkak të kontesteve me Bizantin, kani bullgar Borisi u përcaktua që kristianizmin ta pranojë nga Frankët, d.m.th. nga Roma. Mirëpo, me të kuptuar për këtë, intervenoi Bizanti si në tokë ashtu edhe në det, duke e detyruar Borisin që kristianizmin ta pranojë nga Bizanti.⁷³ Sipas G. Castellan, Borisi e pranoi kristianizmin më 864 nga duart e priftrinjeve bizantinë, duke e vënë shtetin e vet nën jurisdiksionin e patrikut bizantin Fotit.⁷⁴ Me këtë rast Borisi u

⁷¹ Shih: Pamjatniki literatury drevnei Rusi: XI - naceo XII v. fq. 123 - 125, sipas: Shkëlzen Maliqi, *Vizantijski kulturni areal*, Thema, 4(3), 1985, Prishtinë, fq. 20 - 31, fusnota 3.

⁷² Sipas A. Gams, serbët, maqedonët, bullgarët, rumunët dhe rusët pranuan pravosllavjen bizantine prej shekullit VIII deri në shekullin X. Shih: Andrija Gams, *Biblija i drustvo*, Novi Sad, 1979, fq. 269. J. Le Goff procesin e kristianizmit në Evropë të filluar më herët e sheh si proces të hapur që mori fund vetëm në fund të shekullit XIII, të imponuar me dhunë nga perandoritë apo shtetet në formim e zgjerim e sipër. J. Le Goff, op. cit., fq. 182 - 183.

Edhe M. Tërnavë është i pajtimt se fillimi i procesit të kristianizimit të sllavëve kishte filluar nga fundi i shekullit IX e tutje. Muhamet Tërnavë, *Studime për Mesjetën*, op. cit., fq. 10.

⁷³ M. Brandt, op. cit., fq. 348.

⁷⁴ Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë, (-), fq. 39. Në literaturën shkencore historike qarkullojnë disa data të kalimit të kanit bullgar Borisit në kristianizëm. Mendojmë se dallimet e vogla më tepër janë çështje të llogaritjes jo të saktë të viteve se sa diç tjetër dhe nuk paraqet problem për historinë. P. sh. B. Jellaviç në veprën *Historia e Ballkanit*, I, Tiranë, 1999, faqe 28 pohon se kryqimi ndodhi në vitin 865, kurse në *Enciklopedija zivih religija*, Beograd, 1990, faqe 132

pagëzua me emrin Mihajli III. Kurse Mihajli III, si shpërblim për veprimin e Borisit, e barti mbi Borisin sundimin suprem mbi pjesët veriperëndimore të Maqedonisë dhe mbi pjesët jugore të Shqipërisë dhe njëherit, gjatë kungimit të Borisit, Mihajli III – perandori bizantin, u bë kumbar i Borisit.⁷⁵

B. Jelavich luhatjet e Borisit ndërmjet Romës dhe Bizantit, përkatësisht njohjen e jurisdiksionit të Romës fillimisht dhe braktisjen e saj e sheh si veprim politik.⁷⁶

Me gjithë ndikimin që kishte Bizanti mbi Borisin bullgar dhe mbështetjen politike dhe ushtarako-ekonomik që e zhvillonte mbi bullgarët, Borisit, gjatë viteve 866 – 869 ishte në bisedime me papën Nikolla I, që Bullgaria të vihet nën ndikimin papnor. Njëherit, Boris i pengoi klerikët grek në kristianizimin e bullgarëve, duke marrë premtime nga papa Nikolla I, se Bullgaria do ta formojë ipeshkvinë e pavarur dhe klerikët romakë do t'i kryqojnë sipas ritit romak. Mirëpo, në Sinodin e vitit 870 u vendos që dioqeza bullgare të varej e të administrohej nga Konstantinopoli.⁷⁷ Përkundër bashkëpunimit të sërishëm të Kishës bullgare me Bizantin për arsye të ndryshme, Kisha bullgare e ruajti organizimin e vet ekleziastik.⁷⁸ Mendojmë se, edhe princat lokalë bullgarë ndikuan, që Borisit të afrohet kah Bizanti,

pohon se kryqimi ndodhi ndërmjet vitit 864/865. G. Ostrogorski, op. cit., fq. 162 mendon se kryqimi ndodhi saktë në vitin 866. Edhe vepra e grupit të autorëve, *Historia e popullit shqiptar*, vëllimi I, botimi III, Prishtinë, 1979, faqe 150, e sigurisht në mbështetje të tij edhe Blerim Çela, op. cit., fq. 130, cekin se kryqimi i kanit bullgar Borisit dhe popullit të tij ndodhi në vitin 866. Shih: Neritan Ceka, op. cit., fq. 162.

Për vendin e pagëzimit të kanit Borisit burimet historike janë diç më të varfëra, por në mbështetje të disa veprave dhe gjurmëve arkeologjike vërejmë se ky ishte Ballshi në vitin 866. Ballshi sipas arkeologëve dhe historianëve është qyteti Bylisi, në Antikitetin e Vonshëm, apo në fqinjësi të afërt me të, më vonë të quajtur nën ndikimet sllave Gllavinicë, që gjendet në Shqipëri. (Neritan Ceka, op. cit., fq. 247 – 249, 286; 288.). Kjo argumentohet edhe nga një pllakë, rrasë guri me një mbishkrim, i cili u zbulua para Luftës së II Botërore në gjuhën greqishte në rrënojat e bazilikës së Ballshit ku lexojmë: "U pagëzua prijësi i Bullgarisë, Borisit i quajtur Mihal, me popullin e tij të dhënë nga perëndia në vitin 6374 (ky vit sipas kalendarit bizantin tregon krijimin e botës sipas Biblës, e që korrespondon me vitin 866, që normalisht është paradoks, N. Ibrahim)." Sipas: Praschniker C., *Muzakia und Malakastra*, fq. 23; dhe BZHSH, vëllimi II, fq. 29, sipas: Dhori Qiriazi, op. cit., fq. 55. Krhs.: Neritan Ceka, op. cit., fq. 304.

⁷⁵ Dragan Taškovski, op. cit., fq. 35 – 36.

⁷⁶ Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit*, I, Tiranë, 1999, fq. 28.

⁷⁷ *Enciklopedija žvih religija*, op. cit., fq. 132; M. Brandt, op. cit., fq. 348; Dh. Qiriazi, op. cit., fq. 44. *Encyclopedia Britannica*, vol. V, fq. 359.

⁷⁸ B. Jelavich, op. cit., fq. 28.

sepse ata i kërkesa e Bo zua nga papa vitin 925, ku ishte Ohri, i e fetare, kurs përfshinte p

Kristia nin, sepse B hësisht kristi rëve⁸⁴ për t'i tianizimi i Pe të njëjtën ko futjes së një kishtarë, kish

Më në rezultuar me shtetëror dhe zhdukur mu xhamitë etj. territorin që

Bullga vitin 1014 -

⁷⁹ Momir Jo

⁸⁰ Ibid.

⁸¹ G. Castell

⁸² N. Malco

⁸³ M. Jović.

⁸⁴ T. Zavalu

⁸⁵ Hansjorg

⁸⁶ Shih: N. M op. cit., fq. 45

⁸⁷ Mustafa numrit aq të r

⁸⁸ N. Malco cit., fq. 49.

sepse ata i frikësoheshin afrimit bullgaro-frank.⁷⁹ Për më tepër kjo, kur kërkesa e Borisit për autoqefalitet të kishës bullgare drejtuar Romës u refuzua nga papa Nikolla I.⁸⁰ Kjo do të arrihet vetëm në kohën e Simeonit, në vitin 925, kur ky e formoi patrikanën bullgare.⁸¹ Qendër e patrikanës së re ishte Ohri, i cili në shekullin IX – X, paraqiste qendër të fuqishme kulturore e fetare, kurse në fund të mbretërimit të car Samuilit, kryepeshkopata e Ohrit përfshinte peshkopatën e Shkupit, të Lypjanit dhe atë të Prizrenit.⁸²

Kristianizimi i bullgarëve ndikoi në shumë pikëpamje në tërë regjionin, sepse Bizanti u forcua edhe më shumë në Ballkanin qendror,⁸³ e njëkohësisht kristianizimi shërbeu si faktor integrues ndërmjet sllavëve dhe bullgarëve⁸⁴ për t'i përballuar rreziqet nga Perëndimi katolik. Në anën tjetër, kristianizimi i Perandorisë Bullgare pati një rëndësi të madhe kulturore, sepse në të njëjtën kohë ai ishte një konsolidim vendimtar i kulturës sllave ndërmjet futjes së një gjuhe të shkruar të tyre; gjithashtu, me sllavizimin e përfaqësisë kishtarë, kisha bullgare i shpëtoi edhe varësisë së fortë nga Bizanti.⁸⁵

Më në fund, kristianizimi i solli Bullgarisë fundin e sllavizimit, që pati rezultuar me ndërrimin e gjuhës amtare me atë sllave, i solli bashkimin shtetëror dhe etnik të perandorisë së re,⁸⁶ duke i asimiluar apo persekutuar e zhdukur muslimanët dhe kulturën shpirtërore e materiale të tyre (librat, xhamitë etj.), të krijuar për një kohë të gjatë, por edhe popujt tjerë në territorin që ata e sundonin.⁸⁷

Rënia e bullgarisë mesjetare

Bullgaria e pushtoi Kosovën qysh në vitin 850 dhe atje mbeti deri në vitin 1014 – 1018, kur vdiq perandori Samuil,⁸⁸ kur definitivisht dorëzoi

⁷⁹ Momir Jović, *Istoriya Srba*, Prishtinë, 1997, fq. 49.

⁸⁰ Ibid.

⁸¹ G. Castellan, op. cit., fq. 40.

⁸² N. Malcolm, op. cit., fq. 42.

⁸³ M. Jović, op. cit., fq. 55.

⁸⁴ T. Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, botimi II, Tiranë, 1998, fq. 75.

⁸⁵ Hansjorg Froemer, op. cit., fq. 177. Krhs.: B. Jellaviç, op. cit., fq. 28.

⁸⁶ Shih: N. Malcolm, op. cit., fq. 28. Krhs.: B. Çela, op. cit., fq. 130; Dh. Qiriazi, op. cit., fq. 45.

⁸⁷ Mustafa Spahiç, *Povijest islama*, 4, op. cit., fq. 136. Ky pohon se "përkundër numrit aq të madh, muslimanët qenë asimiluar, kryquar, devastuar dhe shfarosur."

⁸⁸ N. Malcolm, op. cit., fq. 28. Krhs.: B. Çela, op. cit., fq. 130; Dh. Qiriazi, op. cit., fq. 49.

edhe garnizonet e fundit në Berat dhe kalanë e Tomorrit.⁸⁹ Sipas të njëjtit burim, Bullgaria u largua nga të gjitha vendet e pushtuara në Shqipëri tek në vitin 1041.⁹⁰ Gjatë kësaj periudhe Bullgaria u përpoq ta forcojë sundimin e vet me të gjitha mjetet që kishte, duke luftuar kundër muslimanëve, por edhe grupeve më të vogla etnike, të a. q. grupeve heretike. Mirëpo, perandoria rivale, Bizanti, në fillim të shekullit XI, në vitin 1014 në Betejën e Kleidonit, në krye të së cilës ishte Basili II, e shkatërroi perandorinë bullgare dhe e ktheu në gjirin e perandorisë bizantine⁹¹. Me këtë rast, ai urdhëroi "masakrimin e 10.000 bullgarëve të zënë robër në këtë luftë duke ua verbuar sytë."⁹² Kështu u mbyll edhe një faqe e historisë, ndonëse bullgarët kanë vazhduar të jetojnë edhe më tej.

Perandoria mesjetare bullgare, mund të thuhet me plot gojës se, është ngushtë e lidhur me fenë islame dhe muslimanët. Prania e muslimanëve në perandorinë bullgare, e kjo nënkupton edhe trojet iliro-shqiptare të cilat ishin nën okupimin e tyre, është e argumentuar si nga burimet vatikane, ashtu edhe nga ato bizantine, islame etj. Këshilla e papës Nikolla I drejtuar kanit bullgar Borisit për masat që duhej ndërmarre kundër muslimanëve dhe krijimit shpirtëror e kulturor të tyre – librit, është dëshmia më e fuqishme se kryqëzatat e inkuizicioni dhe luftërat e mëpastajme kundër muslimanëve deri në ditët e sotme, janë pasojë e jotolerancës dhe të mosnjohjes judeo-kristiane e greko-romake ndaj vlerave jashta tyre.

Është obligim shkencor por edhe moral që studiuesit e ndryshëm (historianët, arkeologët etj.) të na ta studiojnë historinë jo duke i seleksionuar temat varësisht rrethanave politike e ideologjike, por ajo, historia duhet të studiohet në tërësinë e vet. Islami dhe muslimanët janë realitet për disa shekuj gjatë mesjetës në Ballkanin Juglindor, pra edhe në trojet tona duke e përballuar dhunën e ushtrive dhe besimeve pagane e kristiane.

⁸⁹ Neritan Ceka, op. cit., fq. 306.

⁹⁰ Ibid., fq. 307.

⁹¹ *Encyclopaedia Britannica*, LTD, vol. I, fq. 511.

⁹² The Barnes Review, New York, Mars – Prill, 2000, vëllimi VI, nr. 2, sipas: A. K. Bogdan, *Historia e shqiptarëve nga lirinë e lashtë në erën e Islamit*, në: Univers, nr. 1, 2001, Tiranë, fq.54. Sipas Enciklopedisë Britanike Basili II vrau e masakroi 15000 bullgarë. Shih: *Encyclopedia Britannica*, vol. V, fq. 360.

Nexhat Ibrahim

Islam and Muslims in Mediaeval Bulgaria (IX-XI century)

Summary

Even before the formation of the state and before the people became Christians, the mediaeval Bulgarian Empire, which also included the Illyrian-Albanian territories occupied by them at that time, was closely associated with Islam and Moslems. The point of this scientific theory is proved by manuscripts from the Vatican and also from Byzantine and subsequently Islamic sources, etc. The advice of Pope Nicholas I to the Bulgarian Khan Boris, about steps which should be taken against Moslems and the spiritual creativity of their culture – books and mosques, is strong evidence that the Crusades and Inquisitions and the wars which followed against Moslems up till the present day are the result of Jewish – Christian and Greek-Roman ignorance and rejection of values other than their own, but also continuous intolerance throughout history...

Me v
shtetit të tyre
vendosën dh
ruajtur shteti

Udhën

Siç ndodh sh
nda në mend
t'u prijë diku
e disa thon
përkrahën M
Ebu Bekri, sh

Gjatë k

ishte i preok
grupe. Njëri
bashkua dis
shpallën pejs

Ebu B

renegatëve, p
shkatërrohej

muaj arriti që

Është r

ushtri dhe bën

Pas stë

luftën për në
Bizantin.⁶

¹ Halid Bulji

² Filip Hiti

³ Bajrush Ah

⁴ F. Hiti, vep.

⁵ Po aty.

⁶ Muhammed

ARABËT PAS MUHAMEDIT A.S

Koha e hulefa-i Rashidinëve

Me vdekjen e Muhammedit a.s., muslimanët mbetën pa themeluesin e shtetit të tyre i cili bashkonte pushtetin politik dhe fetar. Për këtë muslimanët vendosën dhe zgjodhën për prijës të tyre Ebu Bekrin r.a. (632 –634) për të ruajtur shtetin islam të posaçmërisht formuar.

Udhëheqësi që do të zgjidhej, duhej të udhëhiqte në të dy aspektet¹. Siç ndodh shpesh në histori, edhe pas vdekjes së Muhammedit a.s., populli u nda në mendime se kush duhet t'u prijë. Disa përkrahnin mendimin se duhet t'u prijë dikush nga muhaxhirët (për arsye se Muhammedi a.s. ishte nga ata) e disa thonin se duhet të jetë nga ensarët (sepse ata e ndihmuan dhe e përkrahën Muhammedin a.s.)². Në fund ata u pajtuan që prijës i tyre të jetë Ebu Bekri, shoku më i afërt i Muhammedit a.s.

Gjatë kohës së shkurtër të sundimit të tij (dy vjet), Ebu Bekri kryesisht ishte i preokupuar me renegatët (e islamit). Renegatët ndaheshin në dy grupe. Njëri grup nuk pranonte të jepte zekatin, ndërsa grupi tjetër iu bashkua disa avanturierëve që vetit ia përshkruan vetitë e të dërguarit (u shpallën pejgamber)³.

Ebu Bekri ishte i paluhatur në vendimin e tij për dorëzimin e renegatëve, pa kushte, në të kundërtën lufta nuk do të ndalej derisa të shkatërrohej njëra palë⁴. Ushtria e Ebu Bekrit në një afat përafërsisht gjashtë muaj arriti që t'i nënshtrojë të gjithë renegatët⁵.

Është me rëndësi të cekim se Ebu Bekri është i pari i cili përgatiti ushtri dhe bëri lufta për të drejtat e të varfërve, atyre që u takonte zekati.

Pas stabilizimit në Siujdhesën Arabe, Ebu Bekri vendosi të filloj luftën për nënshttrimin e dy shteteve më të forta të asaj kohe, Persinë dhe Bizantin.⁶

¹ Halid Buljina "Postanak države", në "Takvimi"-1998, Novi Pazar, fq. 180.

² Filip Hiti "Istoria Arapa", botimi i dytë, Sarajevo, 1988, fq. 139-140.

³ Bajrush Ahmeti "Historia islame - 2", Prishtinë 1997, fq. 31.

⁴ F. Hiti, vep. cit., fq. 141.

⁵ Po aty.

⁶ Muhammed Hamidullah "Hyrje në Islam", Shkup 1985, fq. 214.

Fatkeqësisht, sundimi i tij i shkurtë, nuk ia mundësoi arritjen e qëllimeve. Synimet e tij do t'i realizojë halifi pas tij. Ebu Bekri ndërroi jetë në moshën 61 vjeçare, pas një sëmurje jo aq të gjatë.

Omer Ibnu-l-Hattab r.a. 634-644

Ky ishte halifi i dytë musliman.⁷ Edhe ky sikurse halifi i parë u zgjodh në mënyrë demokratike.

Gjatë kohës së halifatit dhjetëvjeçar të Omerit, muslimanët realizuan luftërat më të rëndësishme. Pasi e mori pushtetin në dorë, ushtarët muslimanë hynë në Siri dhe në Palestinë. Në vitin 638 bjen definitivisht Damasku⁸. Në vitin 641 muslimanët kishin në sundim Egjiptin, Palestinën, Irakun, Sirinë dhe përparonin nga Turqia e sotme⁹. Megjithatë kjo nuk është e tëra. Muslimanët hynë edhe në Persi dhe në betejën për Nehavendin (642) ngadhjnjen ndaj perandorit të fundit Sasanid. Me 3-nëntor-644 një rob krishter nga Persia e therri atë pas shpine me një thikë të helmuar¹⁰.

Othman Ibn Affan r.a. 644-656

Pas vdekjes së Omerit, tri ditë vazhduan konsultimet për zgjedhjen e halifit të ri. Ditën e katërt të konsultimit për halif u zgjodh Othmani.

Kur erdhi në krye të shtetit Islam, Othmani ishte në moshën 70 vjeçare. Ai ishte i butë nga natyra dhe nuk ishte i rreptë si Ebu Bekri dhe Omeri.

Në kohën e sundimit të tij kërkohesh që halifi të jetë më i ashpër sepse kufijt e shtetit ishin zgjeruar, kurse standardi jetësor i njerëzve ishte më i lartë se në të kaluarën.

Edhe në kohën e tij vazhduan luftërat me Persinë dhe Bizantin. Gjatë kohës së tij u nënshtrua Azerbejxhani dhe disa pjesë të Ermenisë. Po ashtu në kohën e tij u vra (651) edhe perandori i fundit persian Jezdexhirdi.

Në kohën e tij u themelua edhe marina e parë muslimane me të cilën muslimanët arritën ta nënshtronjë Qipron, Rodosin, Kretën, kurse Konstantinopoja përjetoi rrethimin e parë nga ana e muslimanëve¹¹. Në Afrikë muslimanët morën nga bizantinët të gjitha qytetet që i mbanin ata, nga Tripolitania e deri në Tanger. Kurse në lindje e kaluan Oksusin që të marrin edhe ca pjesë në Kinë¹². Sjelljet e halifit të urtë i keqpërdorën disa

⁷ Majkëll Harti "100 Personalitete më me ndikim në histori", Tetovë 1997, fq. 216.

⁸ Tomas Arnold "Povijest araba", Sarajevë fq. 80

⁹ Gjërësisht për pushtimet në kohën e Omerit, shih: B. Ahmeti "Historia islame-2", vep. cit., fq. 50-66.

¹⁰ F. Hiti, vep. cit., fq. 171.

¹¹ M. Hamidullah "Hyrje në islam", vep. cit., fq. 215.

¹² Po aty.

mendjele
cilët halif
tij dhe m
tij, derisa

Pas
Zgjedhja
mëparshë
gjithë sho
detyrë. P
dërgoi del
urdhëri i
Muaviut¹⁴

Kol
sidomos a

Pas
harixhi et
munduan
akterët kry
Egjiptit).
ramazan të

Pas
muajsh, p
Muaviu e
Medina në
e trashëgu

Baz
Rre

ndryshme,
kur'anor,
Sunnive k
udhëheqës
institucion
kurse har
lirë të po

¹³ Bajrush

¹⁴ Po aty, fq

¹⁵ Po aty, fq

¹⁶ H. Bulj

¹⁷ H. Bulj

mendjelehtë (që ishin nën ndikimin e hipokritit hebre Abdullah ibni Sebe) të cilët halifin e akuzonin pa kurrfar baze. Akuzuesit përgatitën komplot kundër tij dhe me 17-18 Dhul Hixhe të vitit 35 Hixhri (656), e vranë në shtëpinë e tij, derisa ai ishte duke lexuar Kur'an¹³.

Ali Ibn Ebi Talib r.a. 656-661

Pas vrasjes së Othmanit, për muslimanët erdhën ditë të vështira. Zgjedhja e Aliut nuk u bë sikurse bëheshin zgjedhjet e halifëve të mëparshëm. Aliu në fillim nuk dëshoi të pranojë zgjedhjen pa prezencën e të gjithë shokëve të Muhamedit a.s.. Pas 8 ditë diskutimesh Aliu e pranoi këtë detyrë. Pasi që e muarr timonin e shtetit në duar, të gjithë mëkëmbësve u dërgoi dekrete me të cilat shkarkoheshin nga detyra e deriatëherëshme. Këtëj urdhëri iu nënshtruan të gjithë me përjashtim të mëkëmbësit të Sirisë, Muaviut¹⁴.

Kohën e Aliut e karakterizojnë luftërat e brendëshme për pushtet, e sidomos ato me mëkëmbësin e Sirisë.

Pas shkaktimit të trazirave, muslimanët ndahen në grupe (suni, shii, harixhi etj.). Të gjitha trazirave që u bënë, tre pjesëtarë të grupit Harixhi u munduan t'u japin fund (së paku kështu mendonin) dhe këtë duke mbytur akterët kryesor (sipas tyre), Aliun, Muaviun dhe Amr ibn Asin (mëkëmbës i Egjiptit). Por kjo nuk u shkoi për dorë. Ata vetëm Aliun e vranë me 14 ramazan të vitit 40 hixhri (661)¹⁵.

Pas vdekjes së Aliut halifatin ia besojnë djalit të tij, Hasanit i cili pas 6 muajsh, për t'i dhënë fund trazirave, jep dorëheqje në favor të Muaviut. Tani Muaviu e shpallë veten për Halif dhe qendrën e hilafetit e transferon nga Medina në Damask. Kështu fillon një periudhë e re e shtetit islam, monarkia e trashëguar e zëvendëson zgjedhjen demokratike¹⁶.

Bazat burimore dhe natyra e hilafetit

Rreth burimit natyror të hilafetit grupet muslimane kanë mendime të ndryshme. Një pjesë e Sunnive konsiderojnë se hilafeti është institucion kur'anor, ngase bazohet në ajet kur'anor (*en-Nisa: 59*). Kurse pjesa tjetër e Sunnive konsiderojnë se hilafeti mbështetet në sunet, sepse Muhammedi si udhëheqës shtetëror e fetar i bashkësisë islame, e ka themeluar këtë institucion. Shiitë janë të mendimit se hilafeti është institucion kur'anor, kurse harixhitë e mbajnë mendimin se hilafeti është çështje e vendosjes së lirë të popullit, ai mund të jetë apo të mos jetë, varësisht nga nevoja¹⁷.

¹³ Bajrush Ahmeti "Historia islame-2", vep. cit., fq. 87.

¹⁴ Po aty, fq. 90.

¹⁵ Po aty, fq. 97.

¹⁶ H. Buljina, vep. cit., fq. 182.

¹⁷ H. Buljina, vep. cit., fq. 182.

Sunnitë dhe Shiitë, edhe pse kanë mendime të ndryshme rreth disa pikave, këtu pajtohen në atë se hilafeti është institucion obligativ, jo vetëm fetarë por edhe si element shtetëror i Islamit.

Është me rëndësi të cekim se hilafeti nuk është i njëjtë me qeverinë e Muhammedit a.s. (të Dërguarit). Për dallim nga Muhammedi, halifi nuk kishte autoritet të lartë, por ishte një mandator i thjeshtë i popullit, i cili e zgjedh, e nëse është nevoja edhe e shkarkon. Halifi ishte një prijës që i bashkonte dy funksione-prijës shtetëror dhe prijës shpirtëror. Ai ishte udhëheqës politik me plot kuptimin e fjalës, por njëkohësisht ishte edhe mbikqyrës dhe mbrojtës i fesë. Mirëpo halifi nuk ishte i autorizuar në interpretimin e pavarur të teksteve të fesë. Kjo e drejtë, si edhe e drejta për aprovimin e vendimeve të rëndësishme për organizimin shtetëror i takonte bashkësisë islame si tërësi (ixhmau-l-umeti), përkatësisht atyre të cilët kishin kualifikimet e nevojshme fetare, morale e intelektuale. Do të thotë se plotësimi i normave ligjore dhe fetare pas vdekjes së Muhammedit a.s. i takon vetëm bashkësisë islame si tërësi e jo individëve, pra as halifëve.

Mënyra e zgjedhjes e hilafetit

Të drejtën aktive të votimit, në shtetin Islam, e kishin të gjithë muslimanët dhe muslimanet e moshës madhore (e që ishin mentalisht të shëndoshë). Këtë e theksojnë qartë juristët islam: "Për atë që pajtohen muslimanët të jetë kryetarë i tyre, duke iu betuar për besnikëri, verifikohet zgjedhja e tij dhe atë duhet përkrahur¹⁸.

Pasi që populli e kishte të drejtën e zgjedhjes së kryetarit të shtetit, atëhere ai këtë mund ta realizonte në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë indirekte. Zgjedhja e halifëve ishte bërë në mënyrë indirekte, nga ana e një grupi të popullit, që quheshin "ehlul-hali-vel-akdi"-ata që janë kompetent për të gjykuar¹⁹.

Për të hyrë në këtë grup duhej patur cilësitë vijuese:

1. Drejtësia me të gjitha kushtet e saj.
2. Dituria me të cilën arrihet deri te njohuria se kush e meriton udhëheqjen, me kushtet e konsiderueshme në të, dhe
3. Arsyeja dhe urtësia për të ardhur deri te zgjedhja e më të përshtatshmit dhe më të arsyeshmit për postin e kryetarit (prijësit)²⁰.

Raporti i këtyre me popullin ishte raport ndërmjet zëvendësit dhe të autorizuarit. Ata bënin zgjedhjen e drejtpërdrejtë të halifit në vend të

¹⁸ D r. Abdu-l-kerim Zejdani "Individi dhe shteti në sheriatin islam", Shkup 1994, fq. 22.

¹⁹ Ata të cilët janë kompetent për të shkarkuar dhe obliguar, nga Nerkez Smailagić "Leksikon Islama", Sarajevë 1990, fq. 173.

²⁰ H. Buljina, vep. cit., fq. 186.

popullit. A
zgjedhje.
konsidero

Të d
e lartpërme

1. Q
jetë i aftë
diturinë e t
islame për

2. K

(nga gjener
Kundër kët
sia e Muha
thatë, pa n
parë, por ec

Halif
nuk ishte ar
si në zbatim

Pasi

përfaqësues
burim i pu
Muhammed
kishte push

ishte i kuff
konsensusi
karakterit d
njëkohësisht

ixhmain e k
shikimi poli
Ky p
ndërroj këtë
kundërshtim

Njëri

konsultimi e

²¹ Po aty, fq. 1

²² H. Buljina

²³ Po aty, fq. 1

²⁴ Shih: Kur'a

popullit. Ata janë të autorizuar të popullit në kryerjen e të drejtës për këtë zgjedhje. Së këndejmi zgjedhja e kryetarit të shtetit nga ana e tyre konsiderohet zgjedhje nga vet populli.

Të drejtën pasive të votimit e kishin të gjithë ata që plotësonin kushtet e lartpërmendura si dhe këto kushte:

1. Që kandidati për funksionin më të lartë fetarë dhe shtetëror duhet të jetë i aftë të komandoj dhe të gëzoj besimin e shumicës si respekt për diturinë e tij dhe besnikërinë ndaj frymës së Islamit; ai duhet ta ketë cilësinë islame për frikë ndaj Zotit dhe të jetë i pajisur me cilësi të burrështetit.

2. Kushti i dytë varet nga prejardhja e halifit. Shumica e muslimanëve (nga gjeneratat e para) konsiderojnë se halifi duhet t'i përkas fisit Kurejsh. Kundër këtij mendimi janë Harixhinjtë dhe Mu'tezilët të cilët thonë se porosia e Muhammedit a.s. për këtë, nuk është e transmetuar besnikërisht. Megjithatë, pa marrë parasysh qëndrimet e ndryshme, jo vetëm katër halifët e parë, por edhe dy dinastitë arabe (Emevitë dhe Abasitë) i takojnë këtij fisi²¹.

Kompetencat e halifatit

Halifi edhe përkundër pozitës së lartë të prijësit fetar dhe shtetëror, nuk ishte as i shenjtë, as mbinjerëzor. Nuk dallohej nga muslimanët e tjerë, si në zbatimin e dispozitave, ligjit ashtu edhe para gjykatës.

Pasi që populli e zgjidhte halifin, pozita juridike e tij ishte pozitive e përfaqësuesit dhe e të autorizuarit të popullit. Por edhe pse populli ishte burim i pushtetit, prapëseprapë pushteti i tij ishte i kufizuar-jo absolut. Muhammedi a.s. si i dërguar edhe pse ishte i dërguar me shpallje-vahj ai nuk kishte pushtet absolut. E kjo assesi nuk mund të ndodhte me halifin, i cili ishte i kufizuar jo vetëm me Kur'an dhe Sunet por edhe me ixhmain konsensusuesin të cilin e kontrollonte krejt bota islame²². Me këtë fakt shihet karakteri demokratik i ixhmainit, i cili si institucion demokratik shpreh njëkohësisht vullnetin hyjnor dhe njerëzor. Për këtë, me të drejtë I. Goldzieri ixhmain e konsideron si "çelës i evolucionit historik të sistemit Islam, si nga shikimi politik, fetar dhe juridik"²³.

Ky pushtet i kësaj natyre nënkupton se halifi nuk ka mundësi ta ndërroj këtë sistem, e as që ka mundësi ta përdorë pushtetin e vet në kundërshtim me të.

Njëri prej kufizimeve të halifit është që ai ta konsultoj popullin, ngase konsultimi është i normuar me sheriat²⁴. Duke patur parasysh të drejtën e

²¹ Po aty, fq. 187-188; Mevdudi "Të drejtat e njeriut në Islam", Shkup 1992, fq. 15.

²² H. Buljina, vep. cit., fq. 185.

²³ Po aty, fq. 183-184; B. Ahmeti, "Historia islame 2", vep. cit., fq. 13.

²⁴ Shih: Kur'an, Ali Imran: 159.

popullit për konsultim dhe detyrimin e halifit për të, juristët islam theksojnë se mospërfillja e kësaj të drejte nga ana e halifit shkaktonte shkarkimin e tij²⁵.

Gjithashtu mbarë populli, por edhe individit, ka të drejtë ta kontrollojë halifin dhe të gjithë funksionarët e tyre në punë dhe në sjelljet e tyre që kanë të bëjnë me çështje të shtetit²⁶.

Atëherë kur halifi i tejkalon kompetencat e përfaqësuesit apo është i paafte për zbatimin e tyre, populli ashtu siç e ka emëruar në atë detyrë, ashtu e shkarkon.

Dinastia e Emevive 661-750

Me vrasjen e halifit të tretë (Othmanit) bota islame hyri në periudhën e luftave të brendshme për pushtet, të cilat përafërsisht vazhduan 20 vjet. Me ardhjen e Abdul Melikut (685-505) në krye të shtetit, pushteti forcohet dhe fillon vala e re e pushtimeve. Maroku dhe Spanja në njërin anë dhe India veriore dhe Transoksania në anën tjetër iu bashkangjiten teritoreve islame²⁷. Derisa ushtria tokësore islame korri këto suksese edhe marina luftoi me sukses kundër marinës më të mirë bizantine, dhe luajti një rol të rëndësishëm në pushtimin e Afrikës Veriore, Spanjës dhe ishujve të detit Mesdhe.

Në kohën e Abdul Melikut u shënuan shumë risi, prej tyre farkimi i monedhave arabe (arabët deri në këtë kohë nuk i kishin monedhat e tyre, ata shfrytëzonin monedhat bizantine) kështu që ekonomia në kohën e tij merr hov të madh. Medicina veçanërisht ishte objekt i kujdesit të pushtetit, i cili pat marrë përsipër të përkthejë në gjuhën arabe shumë vepra të huaja²⁸. Prej sunduesëve emevi dallohet edhe Omer ibn Abdu-l-Azizi (717-719) sundimi i të cilit që i shkurtër por brilant. Muslimanët e krahasojnë sundimin e tij me sundimin e gjyshit të tij Omer ibnu-l-Hatabit.

Omer ibn Abdu-l-Azizi me devotshmërinë e tij korri suksese të panumërta në çdo lëmi, si në përhapjen e Islamit ashtu edhe në shuarjen e kryengritjeve. Ai urdhëroi që të revidohen të gjitha regjistrimet e konfiskimeve të mëparshme, pastaj mjetet t'ua kthejë pronarëve të vërtetë apo trashëgimtarëve të ligjshëm. Ndërpreu tatimet e paarsyeshme, madje shkoi aq larg sa urdhëroi që të kthehen disa qytete të marra me dhunë nga ana e ushtrisë muslimane²⁹.

Me shpalljen Muaviut halif, monarkia e trashëguar e zëvendëson zgjedhjen demokratike. Kjo bën që në krye të shtetit islam të vinë edhe njerëzit e paafte për sundim, të cilët ishin të dhënë pas luksit, dëfrimit,

²⁵ Abdulkerim Zejdani, vep. cit., fq. 35.

²⁶ Po aty, fq. 42.

²⁷ Sami Frashëri "Përhapja e Islamit", Shkup, pa vit botimi, fq. 8.

²⁸ M. Hamidullahu "Hyrje në Islam", vep. cit., fq. 217.

²⁹ F. Hiti, vep. cit., fq. 212.

kështu që la
repression mb
arabe. Mirëp
sunduesi të t
këtij admini
Medinës si d
dha fund dina
Një an
admistruesve
(prijësve) të
Pasardhësi i
dinastie, shpe
Halifati i dytë
deri me 1492.

Admini
Regjistrat për
mbaheshin me
ushtrinë, "Div
e aftë për us
interesohej për
përsionale. Kët
punëve të bre
halifit, "Divan

Shteti is
me, të cilat i u
shumten e rast
Këto provinca

1. Hixha
 2. Iraku-i
 3. Xhezi
- ishite edhe Erme
4. Siria-
Humsin.
5. Egjipti
herë pas herë bë

³⁰ B. Ahmeti -2

³¹ H. Buljina, v

kështu që lanë pas dore përparimin dhe rregullimin shtetëror. Ata bënë represion mbi popullin dhe nënçmonin të gjithë ata që nuk ishin me origjinë arabe. Mirëpo muslimanët nuk mund të ishin lojal dhe t'i nënshtroheshin një sunduesi të tillë, kështu që u bënë disa kryengritje³⁰. Rezistenca më e madhe këtij administrimi i bëhej posaqërisht nga besimtarët e devotshëm të Medinës si dhe nga ana e disa provincave lindore. Një nga ato kryengritje i dha fund dinastisë emevite dhe hilafetit në Damask.

Një anëtarë i kësaj dinastie arrinë që të shpëtojë nga ndjekja e admistruesve të rinjë, dhe në Kordovë (në Spanjë) me ndihmën e emirëve (prijësve) të atjeshëm arrinë të themelojë shtet të ri të pamvarur (718). Pasardhësi i tij Abdurrahman III (912-961), prijësi më i famshëm i kësaj dinastie, shpallet Halif i Magribit (perëndimit) Islam. Kështu formohet Halifati i dytë me qendrat e tij në Kordovë dhe Grenadë. Ky hilafet vazhdon deri me 1492.³¹

Ndarja administrative e shtetit në kohën e Emevive

Administrata shtetërore në kohën e emevive mbahej shumë në rregull. Regjistrat për të ardhurat dhe të dalurat shtetërore "Divanul Haraxh" mbaheshin me saktësi dhe ruheshin në Ministrinë e financave. Regjistrat për ushtrinë, "Divanul Xhund" përmbanin shënime të sakta për të gjithë personat e aftë për ushtri, në të gjitha provincat, ndërsa administrata ushtarake interesohej për pajimet dhe ushqimin e ushtrisë si dhe për të ardhurat e tyre personale. Këto evidenca i mbante Ministria e Mbrojtjes, kurse ministria e punëve të brendëshme mbante shenimet mbi të gjitha dekretet dhe urdhërat e halifit, "Divanur-resail".

Shteti islam në kohën e emevive ndahej në gjashtë provinca autonome, të cilat i udhëhiqnin mëkëmbësit e emëruar nga halifi. Mëkëmbësit në të shumten e rasteve mbanin në duar të veta tërë pushtetin në provincat e tyre. Këto provinca ishin:

1. Hixhazi-me kryeqendër në Medine. Ky përfshinte edhe Jemenin i cili herë pas herë pavarësohej.
2. Iraku-me kryeqendër në Basër dhe në Kufe.
3. Xhezira-me kryeqendër në Mosull. Në kuadër të kësaj province ishte edhe Armenia dhe Azerbejxhani.
4. Siria-me katër qarqe: Palestinën, Jordanin Lindor, Damaskun dhe Humsin.
5. Egjipti nën administratën e të cilit ishte edhe Afrika Veriore, e cila herë pas herë bëhej e pavarur.

³⁰ B. Ahmeti -2, vep. cit., fq. 150-151.

³¹ H. Buljina, vep. cit., fq. 189.

6. Spanja e cila në fillim ishte nën administratën e mëkëmbësve të Afrikës Veriore dhe më vonë u bë provincë e pavarur me qendër në Kordovë³².

Me zgjerimin e kufijve të shtetit islam, u shtua shumë numri i banorëve, kështuqë nga fundi i sundimit të emevive, numri i banorëve musliman arriti në afro 50 milion..

Dinastia Abbasite 750-1258

Ardhja në pushtet e dinastisë Abasite përputhet me përçarjet e para politike brenda botës së vetme të vendeve Islame. Mbretëria më së pari u përgjysmua në principata të shumta e të pavarura. Andaluzia (Spanja) u bë halifat i veçant-rival, e që gjerë me shkatërrimin e saj në vitin 1492 mbeti e ndarë nga halifati lindor, kur Bagdadi e zëvendësoi Damaskun si kryeqytet i ri³³.

Shteti islam në kohën e abasitëve nuk karakterizohet me pushtimet e mëdha, mirëpo shteti jashtëzakonisht përparoi në çdo pikpamje. Provincat pjellore të Mesopotamisë, Sirisë dhe Egjiptit, muslimanët i shfrytëzuan dhe krijuan pasuri të mëdha. Nga të ardhurat që i tubonin halifët abasi, dashamirët e përparimit dhe të arsimit shpenzonin një shumë bukur të madhe për ngritjen e kulturës te populli në tërësi.

Dinastia abasite (halifati i Bagdadit), të cilën e themeluan Ebu Abas es-Sefahu dhe Ebu Xhafer el- Mensuri, arriti kulminacionin në periudhën mes sundimit të halifit të tretë (Muhamed el-Mehdiut 775-785) dhe të halifit të nëntë (Vathikut 842-847) e posaqërisht në ditët e Harunur-Rashidit dhe pasardhësit të tij Me'munit³⁴ Duke folur për këtë periudhë J. Risleri shkruan: "Autoriteti i Harunur-Rashidit ka tërënjë sikur magneti kah kryeqendra të gjithë talentët dhe njerëzit gjenial. Ai tuboi rreth vetës një parlament jo të rendomtë, të përbërë nga juristët, mjekët, poetët, gjuhtarët, muzicientët, artistët... Në histori nuk është regjistruar që një pallat mbretëror të ketë tubuar aq intelektual të shkëlqyer sikur pallati i Harunur-Rashidit ... Kjo ka qenë koha e kulturës dhe tolerancës së rafinuar! Gjatë kohës së sundimit të halifit Me'mun, në territorin e shtetit islam gjendeshin mbi 11 000 kisha disa qindra sinagoga dhe tempuj të zoroastrës... Në universitetin Nidhamije të Bagdadit është studiuar Kur'ani, hadithi, e drejta, filologjia, letërsia, gjeografia, historia, etnografia, arkeologjia, astronomia, matematika, kimia, muzika dhe gjeometria. Mësimi në shkollat fillore dhe ato të shkallës së dytë kanë qenë falas. Me një fjalë kjo është periudha më e rëndësishme intelektuale e historisë islame³⁵.

³² Bajrush Ahmeti, "Historia islame-2", vep. cit., fq. 152-153.

³³ M. Hamidullahu "Hyrje në islam", vep. cit., fq. 218.

³⁴ F. Hiti, vep. cit., fq. 276.

³⁵ Cituar sipas Alija Izetbegović "Pse muslimanët janë të prapambetur", fq. 11-13.

Përp
pushtetin
ushtarak n
provinca t
ashpëra.

Mo
autoritativ
universitete
muslimanë
Një
Fatimi ia p
turqit në E

Me e
nga lindja n

Edhe
lindje. Pozi
dhe koman
personi më
vinin sekre
Priovincat,
civil apo u
rregullit, p
të cilëve is
gjykatësi s
Kordovë, S
Nga denim
(prerja e du
Gjen

shkallë aq
Evropë, e s
Dijetari ho
islame pot
Evropën e
kufizuar të
fetarë dhe
Sevilje, që

³⁶ F. Hiti, v

³⁷ Po aty, fq.

³⁸ Po aty, fq.

Përparimi lulëzoi dhe më tepër në këtë shtet derisa halifët humbën pushtetin për shkak të politikës së gabuar. Në Bagdad disa komandant ushtarak morën guxim dhe grabitën pushtetin nga halifët. Gjithashtu disa provinca të largëta u shpallën të pavarura, gjë që shkaktuan luftime të ashpëra.

Mongolët në Bagdad në vitin 1258, mbysin halifin, njerëzit më autoritativ dhe dijetarët. Gjatë invazionit mongol u shkatërruan të gjitha universitetet. Biblioteka të tëra u dogjën. U shkatërrua e gjithë ajo që muslimanët me shekuj e kishin ndërtuar.

Një anëtar i dinastisë abasite shpëtoi dhe u strehua në Egjipt. Sulltani Fatimi ia pranoi pushtetin si halif dhe atje vazhdoi hilafeti deri kur erdhen turqit në Egjipt.

Halifati Andaluzian

Me ardhjen e dinastisë Abasite në pushtet, Spanja (Andaluzia) ndahet nga lindja muslimane.

Edhe në Andaluzi organizimi shtetëror ishte pothuajse i njëjtë si në lindje. Pozita e halifit ishte e trashëguar, edhe pse shpesh ndodhte që oficerët dhe komandantët të zgjedhin atë që më shumë u konvenonte. Pas halifit, personi më autoritativ ishte veziri (nëse nuk ekzistonte oborrtari). Pas vezirit vinin sekretarët, që së bashku me vezirin përbënin Divanin (Këshillin). Provinca, që gjithsejt ishin gjashtë (pa Kordovën), i udhëhiqnin prijësit civil apo ushtarak të quajtur Vali. Drejtësinë e ndante Halifi, i cili sipas rregullit, pushtetin gjyqësor ia dorëzonte kadinjëve (gjykatësve), në krye të të cilëve ishte Kadil-Kudati (gjykatësi suprem). Aktet penale i shqyrtonte gjykatësi special i quajtur Sahib esh-Shurtah. Gjykatësi tjetër special, në Kordovë, Sahib el-Muzalim, shqyrtonte akuzat ndaj funksionarëve shtetëror. Nga denimet e zakonshme në Andaluzi ishin: gjoba, burgimi, shëmtimi (prerja e duarve), mbytja, etj.³⁶

Gjendja e përgjithshme kulturore në Andaluzi në këtë kohë arriti shkallë aq të lartë sa që qendra e hilafetit ishte qendra më kulturore në Evropë, e së bashku me Stambollin (Carigrad) dhe Bagdadin, edhe në botë³⁷. Dijetari holandez Dozy, me entuziazëm thekson se në Andaluzinë e epokës islame pothuajse mbarë popullsia dinin shkrim-lexim, në kohën kur në Evropën e krishterë, shkrim-leximi ka qenë monopol vetëm i një numri të kufizuar të klerikëve. Të tërhequr nga kjo kulturë e shkëlqyeshme, personat fetarë dhe laik nga tërë Evropa e krishterë shkonin në Kordovë, Toledo dhe Sevilje, që të mësonin në universitetet Islame³⁸.

³⁶ F. Hiti, vep. cit., fq. 477.

³⁷ Po aty, fq. 476.

³⁸ Po aty, fq. 481; Alija Izetbegović "Pse muslimanët janë të prapambetur", fq. 14.

Prej vitit 775 e deri në vitin 1031 në hilafetin andaluzian ekzistonte vetëm një halif, kurse më vonë, emirët dhe udhëheqësit filluan të përçahen deri sa janë bërë 20 halif, 50 provinca dhe dhjetëra vilajete të pavarura, vetëm për shkak të zilisë dhe lakmisë ndaj pushtetit, dhe kështu fillon grindja dhe përçarja³⁹. Përçarjet dhe mosmarrëveshjet e emirëve ishin shkaktare të dobësimi, dekadencës dhe të shkatërrimit të halifatit andaluzian.

Pas 700 vjetëve, në vitin 1492, gjurmët e fundit të hilafetit musliman këtu do t'i shkatërrojnë të krishterët Kastilen.

Me përfundimin e këtij pushteti, humbi ai qytetërim i zhvilluar, i cili shtrihej në Evropë gjatë shekujve të mesjetës. Për një kohë të shkurtër krishterimi i respektonte kontratat për paqe me muslimanët, mirëpo pastaj filluan të zbatonin planin që kishin hartuar prej më parë për shkatërrimin dhe zhdukjen e muslimanëve, të qytetërimin dhe të kulturës së tyre.⁴⁰

Arabs in the period of Muhammed

Summary

In this short reflection, you have an opportunity to enter into a wide door of knowledge, where you may find a lot of accurate guideances that about the building of this "Historiccal Tower" since its beginning.

There is no other way of recontucting a new society endowed with a new mentality and universal concepts of the happienes of the life. Under the script of the state of Madina, was aplicated a tolernat and obligative poli, inspired from the Kur'an and Sunnah. Thouse two wings of balance in Islam build up:

Islamic Shari'ah – jurisdiction that shallenges even the modern constitutions.

Estabilishment of economic sistem.

Military and educational ilminisation.

A rapid development in the structure of this emblem of a society with Islamic reflections, till today was made the most sublime nature and the most peaceful in human soul.

³⁹ Taha Mudevver "Andaluzia dhe perandoria osmane", Shkup 1995, fq. 19.

⁴⁰ Xhelal e l-Alim "Qëndrimi i perëndimit ndaj islamit dhe muslimanëve", Prishtinë, 1997, fq. 11.

Mr. Fab
SGMOIK
Kulturen

Ky
Etnologji
turizmi n
Në një ka
vete, por
gjendet
konsidero
fundit tu
Megjitha
ndryshme
kuptuesh
udhëtarë
botërore.

Në
mi kryes
buohet p
mirëqenie
riut dhe
gjuhën os
Kë
mi në de
Ndonëse
deve të i
udhëtojm
dhe të A
gjithmon

Mr. Fabrizio Poretti - Bern

SGMOIK (Schweizer Gesellschaft für den Mittleren Osten und Islamische Kulturen)

JEMENI MUZE I GJALLË

Analizë etnologjike e turizmit në Jemen

Ky studim është pjesë nga punimi i licenciaturës në Institutin e Etnologjisë në Universitetin e Bernit. Është e rrallë qasja që të hulumtohet turizmi nga pikëpamja etnologjike dhe që një etnolog të merret me turizëm. Në një kohë ku nga njëra anë bota bëhet „më e vogël“ dhe më e lidhur mes vete, por nga ana tjetër rriten edhe urrejtjet, sidomos kur bota muslimane gjendet në shënjestër të paragjytimeve dhe përgjithësimeve, turizmi konsiderohet shpesh si mjet për pajtimin e popujve. Për fat të keq, kohët e fundit turistët janë bërë edhe caqe të sulmeve terroriste dhe rrëmbimeve. Megjithatë, nëpërmjet një kontakti të drejtpërdrejtë të njerëzve nga vende të ndryshme, pritet që të krijohen përciptime më realiste dhe të rritet shkalla kuptueshmërisë për tjetrin. Ky studim, duke marrë si shembull një grup udhëtarësh në Jemen, një vend që këtyre ditëve ka hyrë përsëri në lajmet botërore, hedh një dritë kritike mbi këtë tezë.

Turizmi në vendet në zhvillim

Në Kartën e „World Tourism Organization“ (WTO) shkruhet: „Qëllimi kryesor i Organizatës është të promovohet turizmi me qëllim që të kontribuohet për zhvillimin ekonomik, për pajtimin ndërkombëtar, për paqe, për mirëqenie, për respektin dhe mbrojtjen e përgjithshme të të drejtave të njeriut dhe të lirisë për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh racën, gjininë, gjuhën ose fenë“.

Këto janë dobitë e turizmit që synohen për vendet në zhvillim. Turizmi në destinacione të largëta u zhvillua prej gjysmës së dytë të viteve 60. Ndonëse sipas WTO-së dy të tretat e turizmit botëror zhvillohet brenda vendeve të industrializuara, turistët nga Evropa, Amerika Veriore dhe Japonia udhëtojnë gjithmonë e më shumë në vendet e Afrikës, të Amerikës Jugore dhe të Azisë, sipas parimit të rritjes së rrezes së udhëtimeve. Arsyet janë gjithmonë e më të volitshme për këmbimin, përmirësimin e infrastruktu-rës,

më shumë kohë të lirë, më shumë para dhe mobilitet.¹ Pra turizmi është një derdhje e të pasurve në vendet e të varfërve, të cilët vetë janë përjashtuar nga turizmi.

Me gjithë këtë varësi, qeveritë e shumë vendeve në zhvillim i japin rëndësi parimore ndërtimit të turizmit, që sipas tyre përmban parakushtet për ta kapërcyer moszhvillimin. Janë hartuar shumë masterplane nga firma dhe organizata të mëdha perëndimore. Megjithatë, euforia e viteve 60 për këtë formë të këndshme të ndihmës për zhvillim u ul në fillim të viteve 70, sepse ndikimet ekonomike (valutat, punësimi, të ardhurat, efekti shumëzues etj.) mbeteshin më të vogla nga ç'pritej. Sidomos popullata e varfër nuk përfitonte mjaft nga investimet e bëra. Njëkohësisht studime të ndryshme u përkushtuan vëmendje pasojave ekologjike dhe sociokulturore të turizmit. Në disa vende, si në Goa, ndodhën protesta kundër politikës së turizmit. U kërkuan forma alternative dhe të qëndrueshme të turizmit.

Sidoqoftë, tendencat shkojnë drejt shfrytëzimit të punëtorëve turistikë dhe zbritjes afatgjatë të çmimeve në favor të vendeve të industrializuara. „Veriu prodhon nevoja të konsumit turistik, dhe jugu i plotëson“.² Ndonëse numri i destinacioneve turistike dhe interesi për vende të largëta është në rritje, aftësia e turistëve për t'iu përshtatur rrethanave të reja nuk rritet përpjesëtimisht, por bëhet fjalë më shumë për një globalizim të tipit „commodification“. Meqë kulturat „primitive“ nuk përputhen me zakonet dhe nevojat evropiane, gjasa për të përjetuar kultura të tjera mbetet e vogël. Udhëtarët në vend të huaj gjejnë gjithmonë e më shpesh të njëjtat „civilizime teknike dhe riprodhime“.³

Në Lindjen e Mesme, turizmi po zhvillohet në mënyrë jo të vazhdueshme për shkak të problemeve politike dhe ushtarake në vende të ndryshme (sulme ekstremiste mbi turistë evropianë, tensionet mes Sadam Hysenit dhe SHBA-ve, konflikti izraelo-palestinez, gjendja e tensionuar në Algjeri, hijet e luftës në Afganistan etj.). Në Jemen, vetëm në vitet e fundit qeveria përpiket ta përmirësojë gjendjen katastrofale ekonomike me anë të turizmit.

Perceptimi i së huajes

Në komentimet e turistëve për vendet e vizituara shfaqen shpesh stereotipe dhe paragjykitime. Dallime kulturore dhe të botëkuptimit

¹ Shih Jost Krippendorf, *Die Ferienmenschen. Für ein neues Verständnis von Freizeit und Reisen*, München 1984, f. 49 ff.

² Gero Fischer, „Reisen arum, ^ohin und ^as man davon hat“, *Kultur des Reisens. Notizen, Berichte, Reflexionen*, ed. Andreas J. Obrecht, Mario Prinz dhe Angelika Svoboda, Wien 1992, f. 23.

³ Shih Hans Magnus Enzensberger, „Eine Theorie des Tourismus“, *Universitas* 42, 1987, f. 670.

shpjegohet
Kështu tje
mjedise të
të përgjith
Megjithatë
krijojnë
interpretot
paragjykit
stabilizuar

Në
bukur, ek
vendasit p
Kërkohet p
thjeshtë.⁴
XVIII. Nul

Ekzo
huaj dhe
sauvage“.
pengon nd
edhe ksen
konservati
huaj shërbo
dhe agresiv
Dualizmi i
me vendas

Turiz
turistëve d
parakushtet

⁴ Shih Jost
Ferntourism
Hamburg 1
und Urlaubs

⁵ Melber, i

⁶ Shih Mar
Aufsätze 198

⁷ R o l a n
Reisens“,
Tourismusfo

shpjegohen me anë të mendimeve që janë specifike për kulturën e vetë. Kështu tjetri nuk është subjekti, por objekti i interaksionit. Sidomos në mjedise të reja lind nevoja për interpretime skematike të realitetit. Koncepte të përgjithshme janë thjeshtësimet që ndihmojnë për ta mbajtur orientimin. Megjithatë, këto përgjithësime janë një filtër i perceptimit dhe kështu krijojnë probleme komunikimi mes grupeve që e perceptojnë dhe interpretojnë realitetin sipas skemave të ndryshme. Në një mjedis të ri, paragjykimet shërbejnë për t'u mbrojtur nga pasiguria dhe frika dhe për ta stabilizuar vetëkuptimin individual dhe social.

Në kontekstin turistik, vendi i huaj u duket udhëtarëve si diçka e bukur, ekzotike. Në turizëm në vende të largëta dhe në kontaktin me vendasit projektohet çiltërsia e jetesës arkaike dhe lumturia e varfërisë. Kërkohej para jua e humbur: ajo që është zanafillëse, e natyrshme, statike, e thjeshtë.⁴ Ky mekanizëm projekcioni nuk ka ndryshuar shumë prej shekullit XVIII. Nuk ka pasur „çkolonializim të vetëdijes“.⁵

Ekzotizmi është i lidhur me glorifikimin dhe romantizimin e botës së huaj dhe njerëzve të huaj, sidomos me motivin e Rousseaus „le bon sauvage“. Pikërisht për shkak të transferimit romantik të mallit, ekzotizmi pengon ndryshimin e rrethanave sociale. Në këtë kuptim, edhe ekzotizmi edhe ksenofobia janë strategji psikike shmangieje me qëndrim themelor konservativ.⁶ Të dyja kanë më pak të bëjnë me të huaj se me vetveten. Bota e huaj shërben si ekran për të projektuar mallt dhe dëshirat, por edhe frikat dhe agresionet e veta. Jashtë perceptohet ajo që ndodh brenda vetes. Dualizmi i projekteve pozitive dhe negative shihet mirë në interaksionin me vendasit.

Interaksionet turistike

Turizmi si „situatë interetnike“⁷ nënkupton një kontakt kulturor midis turistëve dhe nikoqirëve. Realizimi i suksesshëm i kontakteve është një nga parakushtet për t'i relativizuar paragjykimet. Mirëpo, ky kontakt, i veçantë

⁴ Shih Jutta Bertram, „Arm, aber glücklich ...“: *Ahnungsmuster im Ferntourismus und ihr Beitrag zum (Miss-)Verstehen der Fremde(n)*, Münster-Hamburg 1995, f.79 dhe Christoph Henning, *Reiselust. Touristen, Tourismus und Urlaubskultur*, Frankfurt 1997, f. 125.

⁵ Melber, in: Bertram, op.cit, f. 78.

⁶ Shih Mario Erdheim, *Die Psychoanalyse und das Unbewusste in der Kultur. Aufsätze 1980-1987*, Frankfurt 1988, f. 261.

⁷ Roland Lutz, „Der Subjektive Faktor. Ansätze einer Anthropologie des Reisens“, *Reisen und Alltag. Beiträge zur kulturwissenschaftlichen Tourismusforschung*, ed. Dieter Kramer dhe Roland Lutz, Frankfurt 1992, f. 249.

për turistët, i zakonshëm dhe i përsëritur për nikoqirët, mbetet i shkurtër dhe mjaft i përciptë.⁸

Gjatë këtij komunikimi ndërkulturor krijohet një marrëdhënie e cila është e përcaktuar nga dallimet kulturore. Mungon gjuha e përbashkët, ka mungesë informimi për rrethanat sociale, kulturore dhe të jetës së përditshme. Meqë kontaktet zakonisht përkufizohen mbi njerëz në lidhje me industrinë turistike, kjo është një marrëdhënie „psikoeconomike“, komerciale, funksionale – larg prej autenticitetit të kërkuar. Për turistët, të huajt në vendet e tyre bëhen sende qejfi për t'u konsumuar sikur pejsazhi, sidomos njerëzit që banojnë në rajonet ekzotike dhe mezi të civilizuar të planetit tonë.⁹

Autenticiteti kërkohet në çdo rajon që ende nuk e ka filluar ose realizuar procesin e modernizimit. Etja për t'u kuptuar i shtyn njerëzit në kërkim të zanafillave kulturore. Ky autenticitet është një element i jetës jo të përditshme.

Me gjithë kritikën negative, gjatë „situatave interetnike“ turistët duhet të konsiderohen gjithashtu si dukuri e re dhe e rëndësishme. Zhvillimi i këtyre „situatave interetnike“ varet nga rrethanat specifike me shumë variante të ndryshme.

Historia e Jemenit

Jemeni është vendi më jugor i Gadishullit Arabik, me 527.970 km² dhe 16 miliona banorë.¹⁰ Shtetet fqinje janë Arabia Saudite në veri dhe Omani në lindje. Në perëndim kufizohet nga Deti i Kuq, në jug nga Oqeani Indian. Pjesa veriore dhe juglindore e Jemenit janë shkretëturi, ndërsa në anën perëndimore të malësisë në qendër të vendit bien reshje monsunit dhe mundësojnë një agrikulturë intensive nëpër tarraca. Prandaj Jemeni është vendi më pjellor dhe rrjedhimisht me popullsi më të dendur në Gadishullin Arabik. Gjuha është arabishtja, dhe 99,9% të banorëve janë muslimanë.

Koha e lulëzimit të Jemenit ka qenë nga viti 500 para erës sonë deri në vitin 500 të erës sonë. Mbretëri të rëndësishme u formuan në këtë fazë (mbretëria sabeje dhe ajo minaje). Agrikultura dhe tregtia me Evropën dhe Indinë u siguronin jemenasve mirëqenie. Jemeni ishte vendi i origjinës së temjanit, i cili transportohej me anë të bregut jugor të Arabisë deri në

⁸ Shih John Lea, *Tourism and development in the third world*, London – New York 1991, f.62.

⁹ Shih Hermann Bausinger, „Grenzenlos ... Ein Blick auf den modernen Tourismus“, *Reisekultur. Von der Pilgerfahrt zum modernen Tourismus*, ed. Klaus Beyrer dhe Gottfried Korff, München 1991, f.346.

¹⁰ Shih Abdulaq Samir, Raporti për Unescon 1996, dhe informacionet në internet (www.odci.gov/cia/publications/95fact/ym.html).

Mesdhe.
pjesërisht

Jer

së muslim
mëtejshme
shumica
Zaid u bë
dinastinë
65 imamë

Osi

shkurtër:
dhe pjesë
sidomos j
më të gjat
rajon në fi

Më

rrugën det
si „protekt

Në j

vendin nga

1962 një g

rrëzuan me

„Republika

civile me

mbështetës

Më 1969 u

të Egjiptit

ekonomisë

fazë të një

Golfit dhe

riinvestohe

mëdha si në

Në j

Çlirimit Ko

pas tërheq

¹¹ Shih H u
Development

¹² Shih A l f r
Mittelalter b
Mitteilung de

¹³ Shih T a t r
North Yemen

Mesdhe. Nga kjo kohë kanë mbetur shumë gjurmë arkeologjike, që vetëm pjesërisht janë gërmuar.

Jemeni që njëri nga vendet e para që e pranoi fenë Islame. Pas ndarjes së muslimanëve në sunitë dhe shiitë më 661 ndodhën edhe ndarje të mëtejshme. Në çështjen e trashëgimisë së imamit të katërt të shiitëve, shumica e zgjodhi Muhammed Al-Bakirin, kurse për një pakicë vëllau i tij Zaid u bë imami i pestë legjitim. Në vitin 897, Yahya Al-Hadi themeloi dinastinë zaidite si traditë shtetërore në veri të Jemenit, duke qenë i pari nga 65 imamë zaiditë.

Osmanët e okupuan Jemenin dy herë për një kohë relativisht të shkurtër: 1538-1635 dhe 1871-1905.¹¹ Me gjithë ndërhyrjen në jetën politike dhe pjesërisht në atë ekonomike, ata nuk lënë gjurmë të qëndrueshme, sidomos jo në fushën sociale. Vetëm rajoni Tihama u pushtua për një kohë më të gjatë, edhe nga fuqitë koloniale, sepse trupat e huaja e pushtuan atë rajon në fillim si bazë për pushtimin e malësisë.¹²

Më 1839, britanikët e okupuan qytetin e Adenit si bazë strategjike në rrugën detare nga Evropa në Indi. Më 1937 e aneksuan gjithë Jemenin jugor si „protektorat i Adenit“.

Në pjesën veriore sunduan imamët deri në vitin 1962 duke e izoluar vendin nga ndikime perëndimore dhe modernizuese. Pas disa trazirave, më 1962 një grup oficerësh jemenas të ndikuar nga nacionalizmi arab i Naserit e rrëzuan me puç imamin Al-Badr, i cili shkoi në ekzil në Londër. U shpall „Republika Arabe e Jemenit“. Për shtatë vite u zhvillua një luftë e tërbuar civile mes republikanëve të mbështetur nga trupa egjiptase, dhe mbështetësve të imamit, në anën e të cilëve luftuan trupa të Arabisë Saudite. Më 1969 u mblodh në Sana'a parlamenti i parë i Republikës sipas shembullit të Egjiptit. Me ndihma të huaja masive kërkohej një modernizim i ekonomisë dhe i shoqërisë. Kështu në fund të viteve 70, vendi përjetoi një fazë të një mirëqenieje relative. Shumë punëtorë kishin emigruar në shtetet e Golfit dhe dërgonin një pjesë të të ardhurave të tyre në Jemen, ku riinvestoheshin. Pasojat e këtyre zhvillimeve shiheshin sidomos në qytetet e mëdha si në Taiz, Hudeida dhe Sana'a.¹³

Në jugun e Jemenit, NLF-ja (National Liberation Front - Fronti i Çlirimit Kombëtar) udhëhoqi një luftë të gjatë kundër britanikëve. Më 1967, pas tërheqjes së fuqisë koloniale, u shpall „Demokracia Popullore e

¹¹ Shih Hussain Mohammed Abdulla, *The Culture, Tourism, and Development. The case of Yemen*, Sana'a 1996, f. 2.

¹² Shih Alfred Schlicht, „Interkontinentale Beziehungen im Roten Meer vom Mittelalter bis zu den Anfängen der europäischen Expansion“, *Jemen-Report. Mitteilung der Deutsch-Jemenitischen Gesellschaft e. V.*, viti 21 (1990), nr. 2, f.24.

¹³ Shih Tatro Earleen Fisher, „Political and economic aspects of modern North Yemen“, *Newsletter*, vol. III (1), 1983, f.23.

Jemenit¹⁴. Në vazhdim, regjimi socialist në Jemenin jugor u radikalizua nën ndikimin e shteteve socialiste¹⁴, nga të cilat mori ndihma. Për dekada me radhë, Partia Socialiste e Jemenit përpigjej – pa sukses të vërtetë – ta shkatërronte strukturën tribale të shoqërisë.

Me luftën civile të vitit 1986 dhe me shembjen e Unionit Sovjetik, jugu socialist, duke humbur përkrahjen ideologjike dhe materiale, u destabilizua. Kjo e çoi vendin në një krizë ekonomike me kërcënimin e falimentimit të shtetit. Ky ka qenë një nga faktorët kryesorë për bashkimin e Veriut me Jugun në maj 1990. Shteti i ri, Republika e Jemenit, kishte një sistem pluralist. Kryeqyteti u bë Sana'a. Ish-presidenti i Jemenit verior, Ali Abdallah Salah, u bë president i ri, ndërsa ish-presidenti i Jugut, Ali Salim Al-Beid, kryetari i Parlamentit. Kushtetuta e Jemenit të bashkuar u miratua në një referendum më 1991. Në pranverë 1993 u bënë zgjedhjet e para të lira. Qeveria u formua prej një koalicioni nga Kongresi i Përgjithshëm Popullor i presidentit Ali Abdallah Salah dhe partia islamiste Islah e udhëheqësit të konfederatës më të fuqishme tribale, Abdallah ibn Hussein al-Ahmar. Partia Socialiste nën Ali Salim al-Beid ishte në opozitë.

Nga maji deri në qershor 1994 ndodhi një luftë mes ushtrive ende të pabashkuara veriore dhe jugore. Doli fitimtar Ali Abdallah Salah me aleatët e tij, kurse Partia Socialiste humbi gjithë rëndësinë politike sepse u fajësua për separatizëm.¹⁵ Në prill 1997 ndodhën zgjedhje të reja parlamentare. Fitoi Ali Abdallah Salah me shumicë dërrmuese, kështu që Kongresi i Përgjithshëm Popullor u bë e vetmja parti qeveritare.

Jemeni ndodhet në një krizë të vazhdueshme ekonomike, politike dhe tribale, gjë që përbën një rrezik për konflikte të mëvonshme.

Zhvillimi i turizmit në Jemen

Njëri nga evropianët e parë që udhëtuan nëpër Jemen në kohën osmane ishte italiani Ludovico de Varthema në fillim të shekullit XVI. I veshur si mameluk, udhëtoi nëpër Egjipt dhe Siri në Gadishullin Arabik dhe si i pari e përshkroi Jemenin në hollësi nga përjetimet e veta. Udhëtarë të tjerë të hershëm qenë Carsten Niebuhr (1763) dhe Renzo Manzoni (1877). Deri në shekullin XIX, udhëtarët interesoheshin kryesisht për çështje gjuhësore dhe historike të periudhës paraislame.

Vetëm në fund të viteve 60, pas luftës civile, Jemeni verior u hap gradualisht për udhëtarë të huaj. Atëherë nuk kishte asnjë rrugë të asfaltuar. Për shkak të topografisë si dhe të ndarjes së vendit në zona tribale,

¹⁴ Shih Galia Golan, *Soviet policies in the Middle East from World War Two to Gorbachev*, Cambridge etj. 1990, f. 228.

¹⁵ Shih Iris Glosemeyer, *Liberalisierung und Demokratisierung in der Republik Jemen, 1990-1994. Einführung und Dokumente*, Hamburg 1995, f.14.

komunike
strehime

Rr

Në fillim

cili, sipas

Krahas k

jemenitë

banke në

Sana'a „C

pjesëmarr

të huaj, s

promovua

Meq

të vështir

turizmit n

iniciativev

lejoheshin

marrë një

në çdo ko

dhe keqpë

dhe paraqet

Nën

mirëfilltë,

socialiste

kontrolluar

Popullorë.

Adenit kish

Në f

të dy qever

kjo organiz

¹⁶ Shih T a t

¹⁷ Shih M o

Alsiyaha, vo

¹⁸ Shih M o

Alsiyaha, vo

¹⁹ Shih A l a

l'Association

Orientales, 1

²⁰ Shih A b d

the Yemen, 1

komunikacioni ishte i vështirë. Nuk kishte asnjë hotel modern, por vetëm strehime shumë të thjeshta kolektive.

Rrugët e para të asfaltuara u shtruan nga kinezët dhe nga gjermanët.¹⁶ Në fillim të viteve 70, qeveria e krijoi „Tourism Department“ në Sana'a, i cili, sipas një ligji të ri, duhet të merrej me zhvillimin e turizmit në Jemen. Krahas kësaj, kishte edhe shumë iniciativa private. Kështu, më 1977, dy jemenitë e themeluan agjencinë më të madhe turistike me ndihmë të një banke në Sana'a.¹⁷ Si nëndegë të Departamentit të Turizmit u themelua në Sana'a „General Tourism Corporation“ për t'u marrë me reklamë, broshura, pjesëmarrjen në panaire dhe promovimin e zanatit vendas. U thirrën ekspertë të huaj, sidomos nga Tunizia. Patë shumë projekte për të mbrojtur dhe promovuar zona të përcaktuara si bregdetin.¹⁸

Megjithatë shumë prej këtyre planeve nuk u realizuan kurrë për shkak të vështirësive të shumta. Nga njëra anë, përgjegjësit për zhvillimin e turizmit nuk kishin përvojë. Nga ana tjetër, përballë numrit të madh të iniciativeve private synonin të ushtronin sa më shumë kontroll, kështu që lejoheshin vetëm udhëtime në grup. Nëpër një procedurë burokratike duhej marrë një autorizim i rrugës së udhëtimit, një kopje e të cilit duhej dorëzuar në çdo kontroll ushtarak ose policor. Një problem tjetër ishte korrupcioni dhe keqpërdorimi i fondeve. Sidoqoftë, Jemeni verior është zhvilluar shumë dhe paraqet tani një bazë infrastrukturore për turizëm modern.

Nën sistemin socialist në Jemenin jugor nuk kishte turizëm të mirëfilltë, përveç disa qendrave, pushimoresh për punëtorë nga vende socialiste si Kina. Në mes të viteve 70, vendi u hap pak, dhe grupe të kontrolluara rreptësisht mund të vizitonin disa rajone të Republikës Popullore.¹⁹ Shteti i kontrollonte të gjitha projektet. Sidomos në rajonin e Adenit kishte infrastruktura turistike si rrugë, hotele dhe restorante.

Në fillim të viteve 80 u themelua „Yemen Company for Tourism“ nga të dy qeveritë për të dy vendet jemenite. Bashkë me „Tourist Corporation“, kjo organizatë promovoi para së gjithash turizmin ndërkombëtar.²⁰

¹⁶ Shih Tatro Earleen Fisher, op. cit., f. 23.

¹⁷ Shih Motahar Al-Haifi, „Tourism: In The Beginning ... And Now“, *Alsiyaha*, vol. 3, 1995, f. 57.

¹⁸ Shih Motahar Al-Haifi, „The Need for a Tourism Culture in Yemen“, *Alsiyaha*, vol. 4, 1996, f. 16-18.

¹⁹ Shih Alain Rouaud, „Homo Turisticus per felicem Arabiam“, *Le Bulletin de l'Association des Anciens Elèves de l'Institut National des Langues et Civilisations Orientales*, 1995, f. 39.

²⁰ Shih Abdulhadi Al-Hamdani, *The economic importance of tourism in the Yemen*, 1982, f. 14 f.

Prej ribashkimit të Jemenit më 1990, turizmi në Jemen përjeton një bum. Më 1992 u arrit pika kulmore me 72.169 turistë, prej të cilëve 70% ishin evropianë. Të ardhurat e përgjithshme nga turizmi për atë vit ishin 147 milionë dollarë. Por lufta e Gjirit dhe lufta e vitit 1994 si dhe rrëmbimet e turistëve bënë që numri i vizitorëve të zvogëlohej dukshëm. Megjithatë, tendenca afatgjatë është pozitive. Në krahasim me vende të tjera arabe si Egjipti, Tunizia ose Jordania, pjesa e turizmit në prodhimin e përgjithshëm kombëtar është shumë i ulët me 0,04% në vitin 1994.²¹

Kërkesa turistike

Megjë Jemeni nuk ndodhet shumë larg prej Evropës dhe meqë ka fluturime direkte nga Roma, Frankfurti, Amsterdami dhe Parisi, më 1995 dy të tretat e udhëtarëve (41.477) ishin evropianë. Në krye janë gjermanët, në radhë të dytë francezët, pastaj italianët.²²

Motivet e udhëtimit në Jemen janë: pejsazhi, para së gjithash malet dhe shkretëtira; kultura, pra arkitektura, historia dhe feja, por edhe veçoritë e jetës së përditshme; si dhe kontakti me popullsinë vendase dhe me jetesën e saj. Në përgjithësi, njerëzit udhëtojnë në Jemen nga interesi për kulturën, i cili u ngjallet nga librat, ligjeratat ose rrëfimet nga të afërmit dhe miqt e tyre.

Në një vend si Jemeni, mund të udhëtohet pothuajse vetëm në grup. Arsyja nuk është shmangia e vetmisë, por dëshira që dikush tjetër të merret me të gjitha problemet organizative. Një specialist duhet të programojë sa më shumë përjetime të bukura. Sipas buxhetit, turistët mund të ndahen në tri kategori.

Turistët me buxhet të madh flenë vetëm në hotelet më të mira. Për udhëtime brenda Jemenit e përdorin avionin. Janë njerëz nga shtresa e lartë, prej të cilëve shumë pensionistë. Bëjnë disa herë pushime në vit, kanë udhëtuar nëpër gjithë botën dhe rrinë një a dy javë në Jemen.

Turistët që paraqiten më shumë në Jemen janë ata me buxhet të mesëm. Kërkojnë autenticitet në një vend tjetër dhe një kohë tjetër („si në mesjetë“). Kanë nevojë për pushime sepse nuk i durojnë më kushtet e punës dhe të shoqërisë moderne.²³ Paguajnë më pak se kategoria e parë, por kërkojnë shërbime më të mira, nuk janë të përgatitur mirë dhe dëshirojnë të fotografojnë gjithçka.

Turistët me buxhet të ulët ose „backpackers“ janë të përgatitur mirë. Është një përzierje mes udhëtimeve individuale dhe atyre të organizuara.

²¹ Shih A b d u l a c S a m i r, Raporti për Unescon 1996.

²² Shih Republic of Yemen, *Statistical Report for the year 1995*, Table No. 5-6.

²³ Shih D e a n M a c C a n n e l l, *The Tourist: A new Theory of the Leisure Class*, 1976.

Ata turistë shpenzojnë

Numri madhe në s (prill) ka pak hotele t me pesë yje Sana'a (dy) vitin 1995 Strehimoret 13 qarqet ac qarqe: Sana kapacitetit), strehohen ve periferi të kontrollit.

Udhë deri 20 pjes Në Jemen, kulturor. Të përqark duke Saloon“, ku gjithë hotelet gjata dhe të

Organ Jemen me r gjithë turist përjashtim t prej tyre n praktikisht p mund të ha mëdha të h personelit p jemenasve o shkollë të v

Proje nale në San hen ndërtim në vend që t

²⁴ Shih Repu

Ata turistë flenë në hotele të thjeshta ose në çadra. Ngaqë synojnë të shpenzojnë sa më pak, bëjnë pazar dhe shfrytëzojnë mikpritjen e jemenasve.

Oferta turistike

Numrit në rritje të vizitorëve të huaj nuk i përgjigjet një ofertë më e madhe në sektorin e strehimit. Sidomos në sezonin turistik (dhjetor/janar dhe prill) ka pak vende të fjetjes. Në krahasim me shtete të tjera arabe, Jemeni ka pak hotele të kategorive të larta sipas standardeve ndërkombëtare: tri hotele me pesë yje në Aden dhe Sana'a (dy) si dhe gjashtë hotele me katër yje në Sana'a (dy), Hadramavt (dy), Hudeidah dhe Mareb (1995). Nga ana tjetër, në vitin 1995 kishte 38 hotele me tri, 47 me dy yje dhe 77 me një yll. Strehimoret „publike“ zëvendësohen gradualisht me hotele me një yll. Në të 13 qarqet administrative kishte gjithsej 201 hotele (të përqëndruara në pesë qarqe: Sana'a, Aden, Taiz, Hudeida dhe Hadramavt me 87% të gjithë kapacitetit). 103 hotele gjendeshin në Sana'a (51%). Turistët në grup strehohen vetëm në hotelet me tri deri pesë yje.²⁴ Ndërtohen shumë hotele në periferi të qyteteve, me një yll apo dy yje, që vetëm pak i nënshtrohen kontrollit.

Udhëtimi organizohet zakonisht nga agjencitë në grupe të vogla (dy deri 20 pjesëmarrës). Janë ende të rrallë turistë të pashoqëruar individualë. Në Jemen, ende nuk ka turizëm çlodhjeje ose plazhi, por mbizotëron ai kulturor. Turistët i vizitojnë monumentet e ndryshme gjatë udhëtimeve përçark duke ndjekur pak a shumë rrugët e njëjta. Udhëtohet me një „Toyota Saloon“, kurse disa agjenci marrin avionin për distanca të largëta. Meqë të gjithë hotelet ndodhen në qytetet më të mëdha, disa distanca janë mjaft të gjata dhe të mundimshme.

Organizimi bëhet ose në Evropë në mënyrë gjithëpërfshirëse ose në Jemen me një agjenci vendase. Shumica e agjencive është në Sana'a, ku të gjithë turistët fillojnë udhëtimet e tyre. Shoferët dhe ciceronët vendas (me përjashtim të disave të gjuhës spanjolle dhe frënge) janë nga veriu, shumë prej tyre nga rajoni Sana'a. Agjencitë mund t'i organizojnë udhëtimet praktikisht pa kontroll, dhe njerëz të pasur me kontakte të mira me qeverinë mund të hapin një agjenci. Hotelet janë kryesisht pronë e kompanive të mëdha të huaja (Taj-Sheba nga India, Sheraton, Mövenpick). Shumica e personelit përbëhet nga pakistanezë dhe indianë. Arsyja është krenaria e jemenasve dhe sidomos mungesa e personelit të kualifikuar: ka vetëm një shkollë të vogël hotelerie në Aden.

Projektet ndërkombëtare merren me mbrojtjen e arkitekturës tradicionale në Sana'a dhe Shibam si dhe në disa fshatra. Në zona të tilla nuk lejohen ndërtime të reja, dhe riparimet financohen pjesërisht, kështu që vendasit, në vend që të ndërtojnë shtëpi moderne, të rrinë në ato të vjetra.

²⁴ Shih Republic of Yemen, *Statistical Report for the year 1995*, Table No. 12-13.

Imazhi i turistëve për Islamen, arabët dhe Jemenin

Stereotipet e evropianëve ndaj arabëve dhe ndaj Islamit nuk kanë ndryshuar në thelb prej mesjetës. Imazhi i vendeve arabe është negativ; arabët konsiderohen si armiq, si dembelë, të paaftë për të planifikuar dhe pa prirëje për teknikë. Nëpër mediat jepet zakonisht një imazh negativ, që i vazhdon stereotipet. Meqë shumë vende muslimane ishin ose janë të përfshira në ndonjë luftë, rajoni paraqitet si i pasigurtë dhe popullsia si luftarake dhe e rrezikshme. Sidomos kohëve të fundit, Islami lidhet ngushtë me terrorizmin dhe fundamentalizmin, pa pasur parasysh larminë e kulturave, traditave dhe mentaliteteve të vendeve islame.

Ka edhe një stereotip tjetër, pozitiv: orienti i romantizuar ekzotik. Ky imazh bazohet vetëm mbi perceptimin estetik dhe ndikohet edhe nga kërkimet orientale. Shfrytëzohet nga reklama turistike në broshurat, librat dhe agjencitë turistike.

Përfaqësimi i Jemenit në reklamin turistik është një mjet shitjeje. Prandaj jepet vetëm një imazh pozitiv, që përputhet me pritjet e udhëtarëve dhe që vetë i formon këto pritje. Kjo do të thotë se hapësira e prezantuar është një hapësirë imagjinare. Në kundërshtim me jetën e komplikuar në Evropë (si dhe me jetën reale të jemenitëve), hapësira jemenite është e thjeshtë dhe idilike. Turisti i beson imazhit mesjetar të shitur nëpër broshura dhe është i gatshëm të injorojë të gjitha shenjat kundërshtuese.

Në broshura, Jemeni paraqitet si vend që vetëm para pak kohe i është hapur turizmit dhe që pjesërisht është ende i panjohur. „Arabia Felix“, „mbretëresha e Sabës“, „njëmijë e një netë“ janë klishetë përrallore me të cilat bëhet reklamë. Në fotografi shihen deve dhe beduinë në shkretëtirë, burra arabë në kostumin tradicional dhe gra me fërxhe, monumente të famshme arkitektonike si dhe pamje idilike të natyrës. Popullsia vendase paraqitet si primitive, e pacivilizuar dhe e lidhur me traditat dhe natyrën. Përveç aspekteve folkloristike, mungojnë informata realiste për vendin, për problemet ekologjike dhe sociale. Normaliteti do ta mërziste konsumatorin ose do ta trondiste. Përshkrimi, kuptimi dhe besueshmëria janë të pamundur sepse nuk shitet vetëm një vend, por një „state of mind“²⁵.

Reagime ndaj mjedisit dhe infrastrukturës

Atraksioni kryesor është pejsazhi duke përfshirë një klimë të këndshme sidomos në dimër dhe ajër të freskët në malësinë e Jemenit. Kjo natyrë e papjekur lidhet me imazhe pseudo-autentike të jetës „mesjetare“ ose bile „biblike“: Pejsazhe, qytete të lashta, agrikulturë me tarraca. Banorët

²⁵ Barbara Kirschenblatt-Gimblett, „Authenticity and Authority in the Representation of Culture: The Poetics and Politics of Tourist Production“, *Kulturkontakt, Kulturkonflikt: Zur Erfahrung des Fremden*, ed. Ina-Maria Greverus et al., Frankfurt 1988, f. 67.

vendas d
elemente
sipas shi
arkitektu

Tu
dhe qetës
si në një
fshatrave
e së kalu
imazh idi
elektrike
vend me
Para së gj

Nd
socioekon
interesuar
inq shumë
kësaj të p
dëmtton tu

Për
mëdha në
pranohen
është të m

Ndë
restorante
standarde
janë ndarë
për frymë
tradicional
e huaj. My
pasur mun

Në
banjo. Pre
mirëpo sfo
Turistët sh
njëjtën ko
mungesa e

²⁶ Ueli G
der Tourism

vendas dhe kultura e tyre, për shembull muezini dhe bujqtë, perceptohen si elemente të pejsazhit, si aktorë të pjesës artificiale që shfaqet për turistët sipas shijes së tyre. Në çdo bisedë përmendet larmia e pejsazheve dhe e arkitekturës urbane dhe rurale.

Turistët interesohen për fshatrat „e paprekura primitive“ me bukurinë dhe qetësinë e tyre. Është lehtësim të shihet një vend ku njerëzit jetojnë ende si në një epokë të mëhershme. Kjo do të thotë se sidomos gjatë vizitave të fshatrave të vjetra si Thula, Shibam, Djibla, turistët marrin vesh se një pjesë e së kaluarës së tyre rishfaqet dhe përdoret prej vendasve. Megjithatë, ky imazh idilik prishet nga elemente moderne si antena satelitore dhe kablllo elektrike dhe telefoni. Udhëtarët ndihen të bezdisur gjithashtu kur gjejnë një vend me shumë turistë, ku moderniteti ka rindërtuar një „vend të rremë“. Para së gjithash i pengon në këtë skenë autentike ndotja e mjedisit.

Ndotjen e mjedisit turistët nuk e shpjegojnë me anë të rrethanave socioekonomike, por me karakterin e banorëve: jemenasit nuk janë të interesuar për rend dhe pastërti. Shumë turistë nuk kishin menduar se kishte aq shumë plastik dhe plehra në Jemen. Pas zhgënjimit të parë për shkak të kësaj të papritur, përpiqen të gjejnë zgjidhje. Theksojnë se papastërtia e dëmton turizmin.

Përndryshe, pengesat dhe vështirësitë e udhëtimit, siç janë distanca të mëdha nëpër rrugë të paasfaltuara, kalimi i shkretëtirës, fjetja në çadër, pranohen me mirë nga turistët. Mundimet janë pjesë e udhëtimit; kryesorja është të mos humbet asgjë nga programi.

Ndër temat më të pëlqyera bisedimesh midis turistëve radhiten hotelet, restorantet, ushqimi. Në Sana'a, turistët lëvizin në një botë artificiale të standardeve evropiane. Hotelet me pesë yje me restorante, parqe dhe pishina janë ndarë nga popullsia lokale me anë të mureve dhe gardhnajeve, ndërsa për frymën ekzotike kujdesen tekstili, piktura dhe produkte artizanate tradicionale. Kështu hotelet janë ishuj pasurie, prej nga përjashtohet gjithçka e huaj. Mysafirët mund të ndihen si në shtëpi në këtë botë familjare, por pa pasur mundësinë për t'iu afruar kulturës së vendit.

Në rrugë, turistët ankohen shpesh për mungesë higjene, sidomos në banjo. Presin një shërbim pothuajse të njëjtë me standardin perëndimor, mirëpo sfondi duhet t'i përshtatet asaj që mbahet për kulturë jemenasve. Turistët shprehen shpejt të pakënaqur me ushqime të panjohura, por në të njëjtën kohë ankohen edhe për „ushqimin unikat turistik“²⁶. Kritikohet edhe mungesa e personelit të kualifikuar jemenas në hotele dhe restorante.

²⁶ Ueli Gyr, „Touristenkultur und Reisealltag. Volkskundlicher Nachholbedarf in der Tourismusforschung“, *Zeitschrift für Volkskunde*, 84, numri 2, 1988, f. 236.

Kontakte me faktorë aktivë (shoferi, ciceroni, personeli i shërbimeve)

Turistët në Jemen gjenden në një izolim kulturor, në një fluskë mbrojtëse duke gjetur siguri sepse organizatorët evitojnë çdo destinacion dhe çdo situatë ku turisti mund të ndihet i pasigurtë dhe i pambrojtur. Kështu hiqet një vijë e padukshme kufiri mes turistëve dhe vendasve. Rrjedhimisht, Jemeni mbetet një vend imagjinar, që u përshtatet pritjeve të turistëve, kurse kontakte autentike janë gati të pamundura për shkak të gjuhës së huaj dhe për shkak të paragjykimeve etnike, kulturore dhe sociale.

Pra ekziston kultura e turistëve, një perceptim idilik i kulturës së popullsisë (faktorë pasivë) si dhe një kulturë e devijuar e shërbimeve (faktorë aktivë), që është ndërtuar nga strukturat pritëse për t'i plotësuar nevojat e turistëve.

Kontaktet e turistëve në grup me jemenasit janë të rralla dhe zakonisht të kufizuara për shoferin, ciceronin, personelin e hoteleve, tregtarët, nëpunësit e aeroportit e të ngjashëm.

Shoferët janë vendasit që i shoqërojnë turistët gjatë gjithë udhëtimit. Deri para pak, i përkasinin shtresës së mesme, më të arsimuar, ndonëse nuk flisnin asnjë gjuhë të huaj. Sot shumica e shoferëve i përkasin një shtrese më të ulët sepse fitojnë shumë më pak dhe sepse rruga pothuajse është dyfishuar duke përfshirë edhe udhëtimin e mundimshëm për në jug. Makina është blerë ose marrë me qira nga gjithë farefisi. Disa shoferë kanë pak përvojë me turistët dhe veturat. Megjithatë, zakonisht merren vesh shumë mirë me turistët. Pas disa ditësh, asnjëri nuk dëshiron më ta ndërrojë shoferin dhe zhvillohet njëfarë miqësie. Komentime negative i drejtohen vetëm agjencisë perëndimore.

Një aktor aktiv shumë i rëndësishëm dhe i nevojshëm është ciceroni, shoqëruesi i turistëve, që ndërmjetëson mes të dy kulturave. E ka përgjigjen për të gjitha problemet sepse flet gjuhën e vendasve dhe atë të udhëtarëve.²⁷ Nuk përcakton vetëm ngjarjet, por si „culture broker“²⁸ i informon dhe orienton turistët. Kujdeset për gjithçka: dhomat, ushqimin, ujin deri tek banjot. Nuk konsiderohet vetëm si udhëheqësi i grupit, por si njeriu më kompetent sa i përket vendit dhe banorëve. I kontribuon pasurimit të

²⁷ Shih Erik Cohen, „The Tourist Guide: The Origins, Structure and Dynamics of a Role“, *Annals of Tourism Research*, vol. 12 (1), 1985, f. 5-29, dhe J. Christopher Holloway, „The Guided Tour. A Sociological Approach“, *Annals of Tourism Research*, vol. VIII (3), 1981, f. 377-402.

²⁸ Dennison Nash, „Tourism as a form of Imperialism“, *Hosts and guests. The anthropology of Tourism*, ed. V. Smith, Philadelphia 1989, f.45.

botëkuptim
Ciceroni r
Turistët n
kulturën e
kështu që u

Mir
përshtatsh
bashkë me
italishtfolë
Djbuti. K
shumë nega

Takin
blerjeve K
gjithmonë
autentike,
mikpritjes t
kontakt i k
„vërtetë“, p
në përgjithë
nuk reagojn
sjelljet „pri
konsiderohe
konflikteve.

Turist
gjuhësore, n
vërtetë turis
marrin përsi
Nganjëherë,
integruar në
reklamën tur
Ancient Mus
vendasit janë

²⁹ Shih Hel
Tourismussozi
515-521.

³⁰ Shih Ch
London / New

³¹ Dieter
Tourismus mit

³² Shih Bert

botëkuptimit, mirëkuptimit të kombeve dhe zvogëlimit të paragjykimeve.²⁹ Ciceroni ndihmon për të krijuar një përjetim autentik (të programuar). Turistët ndiejnë nevojën të hyjnë në kontakt me dikë që e përfaqëson kulturën e huaj, dhe ciceroni ose shoferi janë njerëzit më të përshtatshëm, kështu që udhëtarët të ndihen si mysafirë dhe miq dhe jo vetëm si turistë.³⁰

Mirëpo, një pjesë e madhe e ciceronëve nuk kanë formimin e përshtatshëm. Shumë prej tyre, sidomos ata nga Evropa, udhëtojnë në Jemen bashkë me grupin duke e njohur vendin vetëm gjatë udhëtimit. Ciceronët italishtfolës vijnë nga Somalia, Etiopia ose Eritreja, frëngjishtfolësit nga Djibuti. Kjo i përforceon paragjykimet sepse jojemenasit kanë një mendim shumë negativ për Jemenin.

Takimi me disa vendas të tjerë ndodh në hotel ose në rrugë gjatë blerjeve. Kjo do të thotë se ky kontakt është i komercializuar dhe pothuajse gjithmonë në grup. Qëllimi i blerjes së suvenirëve është gjetja e trofeve autentike, por jo një kontakt i mirëfilltë me bujqtë ose tregtarët. Format e mikpritjes tradicionale zëvendësohen nga një „mikpritje marketingu“³¹. Ky kontakt i komercializuar nuk është një variant i „gabuar“ i mikpritjes së „vërtetë“, por një realitet i ri kulturor. Ndaj personelit të shërbimeve, turistët në përgjithësi janë miqësorë. Në rast gabimesh të vogla dhe pengesash tjera, nuk reagojnë menjëherë agresivisht, por i komentojnë infrastrukturën dhe sjelljet „primitive“. Nga njëra anë, vendasit admirohen, nga ana tjetër konsiderohen si „primitive“ dhe „mesjetarë“. Kjo ndihmon në shmangien e konflikteve, kështu që janë të rralla rastet e arrogancës dhe racizmit të hapur.

Kontakte me faktorë pasivë (popullata)

Turisti dëshiron të zhytet në kulturën autentike jemenite, por barrierat gjuhësore, mungesa e kohës dhe stresi i bëjnë kontaktet të vështira. Në të vërtetë turisti prodhon një botë të re sikur një pjesë teatrale, ku vendasit marrin përsipër rolin e aktorëve, ndërsa turistët janë shikuesit kureshtarë. Nganjëherë, kur përjetojnë rrugët dhe skenarët e njëjtë si aktorët, ndihen të integruar në këtë shfaqje interaktive.³² Një imazh tjetër, që përdoret në reklamën turistike të qeverisë jemenase, është muzeu: „Yemen: the Living Ancient Museum“. Turistët shetiten në tërë vendin si nëpër një muze, ku vendasit janë objektet e ekspozuara.

²⁹ Shih Helmer Vogel, „Reiseleiter, Reiseführer“, *Tourismuspsychologie und Tourismussoziologie*, ed. Heinz Hahn dhe H. Jürgen Kagefmann, München 1993, f. 515-521.

³⁰ Shih Chris Ryan, *Recreational Tourism: a social science perspective*, London / New York 1991, f. 36.

³¹ Dieter Kramer, *Aus der Region - für die Region. Konzepte für einen Tourismus mit menschlichem Mass*, Wien / München 1997, f. 70.

³² Shih Bertram, op. cit., f. 67.

Ndonëse turisti dëshiron të ndihet njëloj me vendasit dhe zakonet e tyre, është gati e pamundur të sillet si vendasit, sidomos duke pasur parasysh që turisti jeton në një botë virtuale, turistike, të ëndërruar.³³ Fantazitë e turistëve e ngatërrojnë depërtimin virtual në botën e jemenasve me një kontakt të mirëfilltë.³⁴

Gjatë këtyre kontakteve, turistët zakonisht janë shumë të kujdesshëm dhe të rezervuar ngaqë nuk dinë mjaft për kulturën e huaj jemenase, prandaj u duket edhe e pakuptueshme dhe e rrezikshme. Mbrohen duke u izoluar nga realiteti social. Pra ekziston një tension midis tendencës për t'iu afruar jemenasve ekzotikë dhe tendencës për t'u mbrojtur në rehatin e kulturës artificiale të shërbimeve.

Shumë turistë ndiejnë mëshirë për kushtet e vështira të jetesës kur shohin jemenas që punojnë punë të rëndë. Nga ana tjetër e idealizojnë varfërinë si „parajsë të humbur“, ku gara për statusin material gjoja ende nuk luan rol. Fëmijëve jemenas, që i rrethojnë turistët, u jepen bonbona, monedha, stilografë, tullumbace dhe sapun.

Ekzistojnë edhe kontakte negative. Turistët bezdisen sidomos në treg (suk) kur ndonjë fëmij mund të qëllojë turistët me gurë. Për këtë ciceroni luan rol shumë të rëndësishëm pozitiv.

Fotografimi

Këto tensione e bezdisje zhvillohen shpesh përreth temës së fotografimit. Meqë 90% të udhëtarëve marrin fotografi, ky ritual është i lidhur ngushtë me udhëtimet, ndonëse ka aspekte problematike.³⁵ Turisti e rrit prestigjin e vet nëpërmjet fotografimit, që shërben si dëshmi që në të vërtetë e ka bërë këtë udhëtim. Si suvenirët, fotografitë janë diçka konkrete, materiale, që mbesin nga pushimet e shtrenjta. „Përjetimi nuk është ngjarja, por dokumentimi i ngjarjes. Ngjarja ndodh vetëm në qoftë se dokumentohet. Përjetimi është fotografia“.³⁶

Fotografohen motivet e standardizuara ekzotike, që mund të gjenden edhe në kartolinat dhe që nuk ekzistojnë në jetën e përditshme të turistëve.

³³ Shih Claus-Dieter Rath, „Notizen zur Psychoanalyse des Reisens“, *Reisen und Alltag. Beiträge zur kulturwissenschaftlichen Tourismusforschung*, ed. Dieter Kramer dhe Roland Lütz, Frankfurt 1992, f. 47.

³⁴ Shih Bertram, op. cit., f. 69.

³⁵ Shih Birgit Schneider, „Fotografieren auf Reisen als Annäherung verschiedener Kulturen?“, *Psychologie und multikulturelle Gesellschaft*, ed. Thomas Alexander, Göttingen / Stuttgart 1994, f. 295.

³⁶ Ingrid Thurner, „Die Rezeption des Fremden in der touristischen Fotografie“, *Konsequenzen des Tourismus. Ein Reader mit Beispielen aus Entwicklungs- und Schwellenländern*, ed. Nicole Häuser dhe Klaus Rieland, Göttingen 1994, f. 56.

Preferohen pjesë e kë përditshme. Por duhet shembull a pa pyetur kohë.

Jeme autenticitet fotografuar „Fotografir gjithnjë e Kamera sh fotografimi

Foto ara. Zyrtar spitale, ura veçanërisht të grave. A dhe paralaj

Turi posaçme, l atë që ndo vendet e l ëndrrat e t ta zbulojn grafi të bu të qëllim t shirë të m interes vet

Meo aspekti i l çaste frag dhe situat Në krahas kontakt m vetëm me

³⁷ Schne

³⁸ Shih Er Revue, vol

Preferohen pejsazhet dhe bukuritë arkitektonike, por edhe vendasit janë pjesë e këtij skenari. Kërkohen çaste unike dhe situata autentike të së përditshmes jemenase: një festë, vallet, shtëpia e shoferit, puna bujqësore etj. Por duhet të zhduken të gjitha elementet, që e prishin këtë autenticitet, për shembull antenat satelitore mbi shtëpitë nga argjila. Fotografohet menjëherë, pa pyetur për lejen dhe pa e kuptuar mirë situatën, sepse për këtë nuk ka kohë.

Jemenasit janë këtu elemente të nevojshme, që i japin pejsazhit autenticitet. Fotografi hyn në sferën private dhe në lirinë e njerëzve të fotografuar, që nuk respektohen si individ, por përveçshtohet si objektë. „Fotografimi nuk do të thotë kuptueshmëri, afërsi, kontakt, por nënkupton gjithnjë edhe një hendek pushteti mes fotografit dhe të fotografuarit“.³⁷ Kamera shërben edhe si mburojë kundër së panjohurës. Aspektin kërcënues fotografimi e kontrollon duke e mbajtur në distancë.

Fotografimi bëhet më problematik kur fotografohen objekte të ndaluara. Zyrtarisht është e ndaluar të fotografohen ndërtesa shtetërore, shkolla, spitale, ura, objekte ushtarake dhe ushtarë. Në vendet islame si në Jemen dhe veçanërisht në fshat, tradita Islame ndalon fotografimin e njerëzve, sidomos të grave. Atëherë disa turistë fotografojnë fshehurazi, me gjithë shpjegimet dhe paralajmërimet e ciceronit se disa burra mund të reagojnë me dhunë.

Rezultatet e studimit

Turizmi i organizuar, i „institucionalizuar“³⁸, krijon një hapësirë të posaçme, ku turisti gjendet në një „korridor të mbrojtur“ duke vizituar vetëm atë që ndodhet afër vendit e strehimit dhe ushqimit ose pranë itinerarit. Në vendet e largëta ekzotike si në Jemen, turistët shpresojnë se do të realizojnë ëndrrat e tyre (që janë vështirë për t'u realizuar). Qëllimet e tyre janë: e para, ta zbulojnë vendin me pejsazhin, historinë, kulturën dhe të kihehen me fotografi të bukura; e dyta, ta gjejnë veten dhe ta ndërtojnë personalitetin. Për këtë qëllim të dytë, unit i duhet konfirmimi nga të tjerët. Turistët shprehin dëshirë të madhe për një kontakt me popullatën vendase, por mjedisi për ta ka interes vetëm për aq sa i kontribuan drejtpërdrejt ndërtimit të personalitetit.

Meqë turizmi zhvillohet në një „lluskë mbrojtëse“, pak qëndron nga aspekti i huaj jemenas për shkak të të cilit u bë udhëtimi. Ka vetëm disa çaste fragmentare, shikime të shpejta. Konsumohen me ngut vende, pejsazhe dhe situata pa pasur kohë për ta parë shumëllojshmërinë e realitetit vendas. Në krahasim me kohën e kaluar në xhip ose në hotel, koha që mbetet për kontakt me vendasit është shumë e kufizuar, dhe ky kontakt ndodh pothuaj vetëm me „faktorët aktivë“, domethënë me kulturën e shërbimeve.

³⁷ Schneider, op. cit., f. 297.

³⁸ Shih Erik Cohen, „Who is a tourist: A conceptual Clarification“, *Sociological Revue*, vol. 22, 1974, f. 527-555.

Në fund të udhëtimit, turisti është i entuziazmuar nga bukuria e Jemenit, por nuk ka zhvilluar një marrëdhënie më të thellë me vendin, sepse pothuajse nuk është e mundur që në rrethanat turistike të përjetohet realiteti i tij i ndërlikuar.

Udhëtimet në grup zakonisht mbeten selektive dhe të përcipta. Kështu turizmi në formën e tij ekzistues nuk zhvillon mirëkuptim për vendet dhe kulturat e huaja, por forcon paragjyqime dhe pikëpamje të paravendosura.

Informacione më të plota për udhëtime më të mira

Nëpërmjet kanaleve të zakonshme të sistemit turistik nuk është e mundur të krijohen kontakte të mirëfillta. Për t'i kontribuar në të vërtetë mirëkuptimit të popujve, duhet të bëhen përgatitje të tjera për të arritur që turistët të heqin dorë nga ndjenja e superioritetit e bazuar mbi paragjyqime etnocentriste.

Në radhë të parë duhet ofruar vetëm udhëtime që nuk konsiderohen nga qeveria ose nga popullsia jemenase si të papërgjegjshme. Pastaj duhet një gatishmëri mendore për ta vënë në pyetje kulturën e vet, normat dhe sjelljet e veta dhe për t'i kapërcyer kufijtë personale. Ideale do të ishin udhëtime më të gjata, sepse zhvillimi i njohurisë dhe përvojës së mirëfilltë të një vendi kërkon kohë.

Një rol kryesor e luajnë informacionet. Meqë pjesëmarrësit në turizmin e largët vijnë nga shtresat më të larta, kanë më shumë mundësi (kohore, financiare dhe për nga arsimimi) të informohen rrënjësisht për problematika të ndryshme të vendit, që shkojnë përtej bukurive natyrore dhe arkitektonike dhe klisheve kulturore. Pra organizatorët e udhëtimeve mund të vënë në dispozicion edhe informata socioekonomike dhe politike. Kështu mund të evitohen edhe konfliktet mes turistëve dhe vendasve që shkaktohen nga mosnjohja. Organizatat që merren me lidhjet mes turizmit dhe zhvillimit si dhe Shoqata Gjermano-Jemenase dhe të ngjashme mund të furnizohen me material shkencor.

Në vet Jemenin, këto çështje mund të shpjegohen nëpërmjet shembujve konkrete, si mungesa e ujit, papunësia dhe probleme të tjera ekonomike. Informacione të thelluara duhet të jenë në dispozicion edhe nëpër hotelet. Për shkak të rolit kyç të ciceronit, atij duhet t'i ofrohen një formim i themeluar dhe kualifikime të mira të mëtejshme.

„Ajo që na duhet në radhë të parë nuk janë udhëtime të ndryshme, por njerëz të ndryshuar. Vetëm një shoqëri e ndryshme dhe kushtet e ndryshme të jetës së përditshme do të nxjerrin në pah një turizëm tjetër“.³⁹

Përktheu: *Silke Liria Blumbach-Prizren*

³⁹ Krippendorf, op. cit., f. 175.

Diese ethnologische unter ethnologischen sich mit "Tourismus kleiner" um wird, insbesondere Verallgemeinert betrachtet. und Eutführung Kontakten und Vermittlungen er Dies non reisen Tagen wird

Mr. Fabrizio Poretti

**JEMEN AN LEBENDES EINE ETHNOLOGISCHE ANALYSE
DES TURISMUS IM JEMEN**

zusammenfassung

Diese Studie ist die Zusammenfassung einer Abschlussarbeit am ethnologischen Institut in der Universität Bern. Es ist selten, dass Tourismus unter ethnologischen Gesichtspunkten erforscht wird und dass eine Ethnologe sich mit Tourismus beschäftigt. In einer Zeit, in der die Welt auf einer Seite "kleiner" und verbundener wird, aber auf der anderen Seite des Hasses größer wird, insbesondere als die muslimanische Welt Ziel der Vorurteile und Verallgemeinerungen ist, wird Tourismus als Mittel für die Vollerversöhnung betrachtet. Leider sind Touristen in letzter Zeit Ziele terroristischer Angriffe und Entführungen geworden. Trotzdem wird erwartet, dass mittels direkter Kontakte der Menschen aus weit entfernten Ländern realistischere Wahrnehmungen erzeugt werden und das Versehen des jeweils anderen größer wird.

Diese These wird kritisch betrachtet, indem exemplarisch eine Gruppe von Reisenden im Jemen untersucht wird, einem Land, das sich in diesen Tagen wieder in den Weltnachrichten befindet.

*Dr. Ismail
Fakulteti*

*"D
cilët janë n
është shpat*

*"M
gjuhën e ve*

Glo
informaci
tërësisht i
përvojë k
e vogël d
ngjarjeve.
më të afër

Pje
pjesërisht
futen në
cilat i gje
drejtë në
suksesshë
realitetin

Si r
bashkëko

¹ Hafizov
"Znakovi V

² Faruqi,

³ Swidler
6, f. 125-1

Dr. Ismail Bardhi, Shkup -
Fakulteti i shkencave Islame

HUMANIZMI ISLAM – THEMEL PËR DIALOG NDËRRELIGJIOZ

"Dhe me ithtarët e Librit diskutoni në mënyrë më të mirë, përveç atyre të cilët janë mizorë, dhe thuani: 'Ne besojmë në atë që na shpallet neve dhe në atë që u është shpallur juve, se Zoti ynë dhe Zoti juaj është – Një, dhe ne Atij i dorëzohemi'".
(Kur'an, el-Ankebut, 46)

"Musliman i vërtetë është vetëm ai i cili nuk i shqetëson njerëzit tjerë me gjuhën e vet dhe me veprimet e veta."

Hadith i Muhammedit a.s.

Globalizimi ka bërë që sot të jetojmë në një fshat global, ku informacionet dhe shpejtësia e komunikimit i zvogëlojnë apo madje edhe tërësisht i fshijnë kufijtë e hapësirës dhe kohës. Kjo sigurisht që është një përvojë krejtësisht e re për llojin njerëzor, meqë lë përshtypjen, se bota është e vogël dhe e mbyllur, dhe se është e pamundshme të ndryshohen rrjedhat e ngjarjeve. Mirëpo pikërisht këtu para nesh paraqitet nevoja për komunikim më të afërt, për dialog dhe mirëkuptim.

Pjesërisht për shkak të rëndësisë pluraliste të botës bashkëkohore, e pjesërisht edhe për shkak të natyrës së tyre, muslimanët sot janë të thirrur të futen në dialog me ithtarët e Librit – *Ehli Kitabin* dhe lëvizjet pozitive të cilat i gjejmë në botën bashkëkohore e me qëllim të ndërtimit të shoqërisë së drejtë në mjedisin dhe kohën konkrete historike ku jetojnë ata.¹ Për të qenë i suksesshëm dialogu ndërreligjioz doemos duhet të "korrespondojë me realitetin dhe të jetë i lirë nga figurizimi i absolutizuar skriptural"²

Si një themel i këtij dialogu global³, ndërfetarë, me botën dhe kulturën bashkëkohore do të mund të ishte humanizmi islam, pikërisht për shkak të

¹ Hafizović, Reshid, *Tolerancija i kultura dijaloga u perspektivama Islama*, në "Znakovi Vremena", Sarajevë 2000, v. 3, nr. 9-10, f. 187-188.

² Faruqi, Ismail, Raji, *Islam and Other Faiths*, Leicester 1998, f. 242.

³ Swidler, Leonard, *Doba globalnog dijaloga*, në "Dijalog", Sarajevo 1996, nr. 6, f. 125-127.

asaj se nocioni i humanizmit është njëra nga përmbajtjet më të popullarizuara në vetëdijen e njeriut bashkëkohor.⁴

Humanizmi islam është një përmbajtje e organizuar mendimesh dhe pasqyrimesh rreth njeriut dhe rolit të tij në botë. Edhe pse humanizmi islam është mënyrë konkrete e të kuptuarit të botës, megjithatë ai nuk duhet kuptuar si model i një përmbajtjeje politike-shoqërore, që do të duhej të jetësohet në kushte konkrete historike.

Me humanizëm në përgjithësi do të mund të kuptohej çdo qasje e arsyeshme ndaj realitetit të krijuar, ku njeriu, falë strukturës së tij ontologjike, domethënies historike, me tiparet e veta intelektuale-shpirtërore, zë vend të veçantë. Një përkufizim i këtillë i përgjithshëm kushtimisht dëshiron të krijojë gjerësinë e nevojshme të shikimit mbi format e ndryshme të humanizmit, të cilat mund t'i gjejmë në historinë e shoqërisë njerëzore. Megjithatë, nuk mundet përmbajtësisht të mendohet për cilindo aspekt të botës së krijuar, pa raportin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj njeriut.

Shtimi i epitetit *islam* nuk ka për qëllim diskreditimin e formave të tjera të humanizmit, por vetëm konkretizimin dhe përkufizimin e qartë të veçorisë dhe rëndësisë së këtij humanizmi, i cili ka qenë i pranishëm gjatë tërë historisë islame dhe që është pasqyruar me qëndrimin e muslimanëve ndaj ithtarëve të Librit dhe pakicave të tjera. Kjo veçori konkrete gjithmonë duhet përkufizuar në raport me Zotin dhe me të Dërguarin e Tij.⁵

Veçoria tjetër e humanizmit islam që buron nga botëkuptimi i tij është pohimi, se njeriu mundet plotësisht të kuptohet vetëm në raportin e tij ekzistencial ndaj Zotit, ndaj njerëzve, personave të tjerë dhe ndaj botës së krijuar.

Kjo e vërtetë e relativizon antropocentrizmin e humanizmit islam dhe atë e vë në vendin të cilin ai me të vërtetë duhet ta zërë. Antropocentrizmi këtu nuk është kuptuar si teori e kundërt me teocentrizmin, apo si ide e cila do ta mohonte teocentrizmin. Në të njëjtën mënyrë antropocentrizmi nuk është kuptuar si dominim absolut i njeriut në botën e krijuar. Njeriu është qenie dhe pjesë e botës së krijuar, ndërsa Zoti është Krijues. Kjo jep platformë të përbashkët për dialog me ato grupacione shpirtërore të cilat kritikojnë vënien e theksit të tepëruar mbi njeriun.⁶ Sipas të konceptit islam,

⁴ Kur'ani është bazë themelore për aspektet etike të jetës së njeriut, duke përfshirë këtu humanizmin, dashurinë ndaj njeriut, njeriun si të tillë dhe sjelljet e tija të brendshme dhe të jashtme ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve. Shih p.sh.: Smailagiq, Nerkez, *Leksikon Islama*, Sarajevo 1990, f. 351-353.

⁵ Sejid Husejn Nasr, *Religjia i religjije: Izazov zivljenja u multireligijskom svijetu*, në "Ljudska prava u kontekstu islamsko-zapadne debate", FOD, Sarajevo 1996, redaktor Enes Kariq, f. 18-21.

⁶ Shih p.sh., Kur'ani, esh-Shūra, 8; el-Huxhurat, 13.

njeriu nuk
mëkëmbës

Gati
njëkohësis
drejtësia,
Edhe pse
vlefshme
vetëm në c
vendit të p
Për
përmendej
ashtu siç j

1. Mos ki

2. Mos i l

të gëdhen

3. Mos e

tënd;

4. Respe

tënde që t

5. Mos vr

6. Mos kr

7. Mos vi

8. Mos dë

tënd;

9. Mos la

mos lakm

10. Mos

tënd.

Sip

Urdhëresa

Muhamm

Urdhëresa

cilat mbës

Në

është një

njerëzore

⁷ Kur'an-

⁸ Karic,

2002, RIZ

⁹ Sabuni

njeriu nuk është zotëruar absolut i botës së krijuar, por ai vetëmse është mëkëmbës i Zotit në botë (*halifetull-llahi fi-l-erd*).⁷

Gati të gjitha vlerat të cilat humanizmi islam i pranon si të vetat njëkohësisht janë edhe vlera të përgjithshme njerëzore, si p.sh. liria, drejtësia, paqja, bashkëjetesa paqësore në shoqëri, solidariteti, toleranca etj. Edhe pse ekzistojnë disa vlera të përgjithshme të cilat janë universalisht të vlefshme për të gjitha gjeneratat, megjithatë humanizmi mund të kuptohet vetëm në çastin konkret historik dhe me sfidat historike të çastit të dhënë dhe vendit të pasqyrit mbi humanizmin dhe formën e tij konkrete.

Për ta pasqyruar sa më mirë të lartshënuarën mendoj se këtu mund të përmenden Dhjetë Urdhëresat (*el-Vesaja el-'Ashr* apo Dekalogu), dhe atë ashtu siç janë të prezentuara në Dhjetë e Vjetër dhe në Kur'an⁸:

Dhjetë e Vjetër

1. Mos kij zotëra të tjerë pos Meje;
2. Mos i bëj vetes idhuj të derdhur apo të gëdhendur;
3. Mos e përmend kot emrin e Zotit tënd;
4. Respekto babain tënd dhe nënën tënde që të jetosh gjatë mbi tokë;
5. Mos vrit;
6. Mos kryej adulteri;
7. Mos vidh;
8. Mos dëshmo rrejshëm për të afërmin tënd;
9. Mos lakmo shtëpitë e të afërmit tënd, mos lakmo gratë e të afërmit tënd;
10. Mos lakmo asnjë send të të afërmit tënd.

Kur'ani

1. Ndalimi i politeizmit (shirkut), urdhëri për të besuar në Një Zot;
2. Sjellja e mirë ndaj prindërve;
3. Ndalimi i mbytjes së fëmijëve për shkak të varfërisë;
4. Ndalimi i adulterisë, amoralitetit;
5. Ndalimi i vrasjes (mbytjes)
6. Kujdesi për pronën e jetimëve;
7. Matja e drejtë me masë dhe peshojë;
8. Dëshmimi i drejtë, madje edhe nëse është kundër të afërmit;
9. Plotësimi i zotimit të dhënë Allahut;
10. Ndjekja e rrugës së drejtë të Zotit.

Sipas teologut të njohur musliman, Mahmud Sheltutit, Dhjetë Urdhëresat paraqesin thelbin e besimit në Monoteizmin e pastër, ndërsa sipas Muhammed Ali Sabunit, "Zoti i Gjithëfuqishëm i përmend Dhjetë Urdhëresat rreth të cilave pajtohen të gjitha Shpalljet Hyjnore, dhe mbi të cilat mbështetet lumturia e njerëzimit".⁹

Në botën pluraliste në të cilën jetojmë dialogu në nivele të ndryshme është njëra nga mënyrat më të përshtatshme për ndërtimin e shoqërisë njerëzore, në të cilën bashkëjetesa e qetë do të ishte e themeluar mbi

⁷ Kur'an-i, el-Bekare, 30.

⁸ Karic, Enes, *Deset zapovjedi u novijim komentariima Kur'ana*, në "Takvim" 2002, RIZBH, Sarajevo 2001, f. 91-101.

⁹ Sabuni, Muhammed Ali, *Saffatu-t-Tefasir*, Rojad 1981, v. 3, f. 107.

solidaritët dhe respektimin e vlerave pozitive të çdo anëtarit apo grupi të shoqërisë konkrete.

Parimi i dialogut është pranuar si njëri nga themelet më të rëndësishme të bashkëjetesës në botën pluraliste të religjioneve të ndryshme, vlerave të ndryshme shoqërore, grupeve dhe botëkuptimeve të ndryshme. Dialogu si i tillë rekomandohet në kontakt me religjionet tjera, me botën bashkëkohore, botën e shkencës dhe të artit. Se dialogu është më se i nevojshëm në këtë botë tregon edhe fakti i prezentimit për fundin apokaliptik dhe katastrofal të historisë dhe përplasjes së qytetërimeve dhe kulturave.¹⁰

Nëse me vëmendje e studiojmë historinë atëherë pa problem do të mund të vërejmë, se si ky rregullë i dialogut shumë qartë na drejton në fushën e kulturës, sepse dialogu gjithsesi është fenomen kulturor apo kultural: ai është fryt i veprimit të arsyeshëm njerëzor e jo rastësi.¹¹

Ato kultura të cilat nuk kanë mundur t'u hapen vlerave të kulturave të tjera, që nuk kanë mundur t'i inkulturojnë vlerat e reja, apo t'i ndryshojnë të vetat me kulturat e reja apo të fqinjëve, respektivisht ato që janë izoluar nga kulturat dhe popujt tjerë, shpejt kanë stagnuar dhe në fund janë shkatërruar. Dialogu i zhvilluar me arsye të shëndoshë dhe pa frikën e panevojshme nga humbja e identitetit personal, shkakton forcimin dhe kristalizimin e qëndrimeve personale, të ideve personale. Në sferën shpirtërore nuk ka mjet më të mirë për forcimin e identitetit personal se në takimin me të tjerët. Që këtu dialogu nuk duhet të jetë tradhëti e qëndrimeve personale, ai pranon qëndrimin e tjetrit apo të tjerëve, përvojën e tyre si dhe në mënyrë pozitive përfshin mundësinë e pranimit, asimilimit apo inkulturimit të përmbajtjeve të vlefshme të qëndrimeve dhe kulturave të tjera.¹² Gjithashtu dialogu nuk është i kufizuar vetëm në komunikimin gojor dhe shkëmbimin e mendimeve, por i njëjti mund të marrë edhe forma tjera.

Këtu mund t'i përmendim disa forma të marrëdhënieve në dialog: dialogu i jetës, i cili realizohet në marrëdhënien e përditshme të përfaqësuesve, të botëkuptimeve dhe kulturave të ndryshme. Forma tjetër e

dialogut është kulturore së humanizimit takohen dhe dhe vlerat k shkencor n pasurimit të

Theme Zot-Engjëll- paraqet dialo Zoti dëshiro Hyjnore, si krijuar, apo

Bota l në pikëpam fuqishëm në informativ a filozofike-te bashkëkohor sipas religjio apo paradig këtë horizont kulturën e ve ngurra të s përvojës reli kërkim të sh nëpërmjet d njerëzimit n bashkëjetesë

¹⁰ Këtyre tezave nga shumë anë i kanë arritur përgjigje dhe reagime pozitive, në të cilat shprehet shpresa e thellë se njeriu është në gjendje historinë e vet ta krijojë në dialogun interkulturor. Ky dialog krijon themelet e bashkekzistimit paqësor të të gjitha kulturave dhe popujve mbi faqen e dheut. Është krejtësisht e mundshme që libri *The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order* dhe tezave të paraqitura në të nga Huntingtoni të japin një fotografi tepër të thjeshtësuar të botës sonë, mirëpo si pozitive nga kjo vepër mund të pranohet ajo se autori ka vërejtur se kultura apo qarqet kulturore sot kanë rol të madh në botën bashkëkohore, dhe se në ardhmëri ky rol do të jetë akoma më i madh. Për më gjerë shih, Bardhi, Ismail, *Dialog mes qytetërimesh – tradita muslimane e ekumenizmit*, "Perla", Tiranë 2000.

¹¹ Hafizović, Rešid, *Ibid*.

¹² Faruqi, Ismail, *Ibid*.

¹³ Kultura d dialogut në metodat univ *Arasi Dialog*

¹⁴ Kur'ani është gjithë pejs

¹⁵ Çështja e bashkësitë fe kohëve të fu ndryshme kje

¹⁶ Legenha 132; Susnjic iskustvo raz

dialogut është kur përfaqësuesit e qarqeve dhe bashkësive të ndryshme kulturore së bashku realizojnë projekte të ndryshme, i cili ka për detyrë humanizimin e shoqërisë. Një formë tjetër është kur individët apo bashkësitë takohen dhe zhvillojnë shkëmbim të mendimeve për qëndrime të ndryshme dhe vlerat kulturore. Mund të përmendet edhe forma në të cilën pasqyrimi shkencor ndërlidhet me ndryshimin e përvojave kulturore me qëllim të pasurimit të pjesëmarrësve në dialog.¹³

Themelet teologjike të dialogut do të mund t'i gjenim në komunikimin Zot-Engjëll-Pejgamber, ose Zot-Pejgamber, komunikim ky që në vete paraqet dialog. Vetë shpallja e Zotit është vetëm reflektim i këtij dialogu, kur Zoti dëshiron t'u shpallet krijesave të Tij. Kulmi i kësaj është Shpallja Hyjnore, si shprehje më e lartë e komunikimit dhe dialogut me botën e krijuar, apo me njeriun dhe kulturën konkrete.¹⁴

Bota bashkëkohore në vete nuk është areligjioze, ajo është pluraliste në pikëpamjet e saj religjioze, kulturore, artistike, shoqërore, edhe pse fuqishëm nën ndikimin e synimit postmodern apo globalizues të faktorëve informativ apo ekonomik. Pikërisht për shkak të kësaj nevojitet një analizë filozofike-teologjike-sociale e realitetit të tërë.¹⁵ Siç duket, bota jonë bashkëkohore duhet vlerësuar jo sipas paradigmes së shekullarizimit, por sipas religjiozitetit të diferencuar dhe qasjes ndaj realitetit religjioz. Qasja apo paradigma e diferencuar nënkupton thjeshtë se bota bashkëkohore në këtë horizont kulturor kërkon që vetë ta krijojë stilin e vet, ritet e veta, kulturën e vet dhe për shkak të kësaj dëshiron të çlirohet nga disa struktura të ngurta të së kaluarës. Nga ana tjetër diferencimi shkakton shpërndarjen e përvojës religjioze, dukuri të cilën do të kishim mundur ta përshkruajmë si kërkim të shpëtimit në vlerat e përbotshme. Natyrisht se humanizmi islam nëpërmjet dialogut këtë çështje e bën sa më të afërt, duke i ndihmuar njerëzimit në përgjithësi për forcimin e religjiozitetit të tij, tolerancës dhe bashkëjetesës.¹⁶

¹³ Kultura dhe tradita islame nuk njohin ndarjen e interpretimit të humanizmit, dialogut në atë të kufizuar nga raporti vend-komb-fe. Ajo lirisht shërbehet me metodat universale të temave në fjalë. Shih, p.sh., Aydin, Mehmet, Prof. Dr., *Dinler Arasi Dialog ve Hosgörü* (tekst i pabotuar), Konya.

¹⁴ Kur'ani është përplot shembuj dialogu të ketillë, si Fjalë, Libër, fleta, mrekullitë e të gjithë pejgamberëve.

¹⁵ Çështja e dialogut të ne një kohë të gjatë ka qenë temë "tabu", madje edhe bashkësitë fetare kanë qenë involvuar shumë pak, mos them aspak. Edhe tani, kur kohëve të fundit vërehen nismat e para në këtë drejtim, tek besimtarët e feve të ndryshme kjo shihet me një skepsë dhe frikë kinse fjala është për "mashtrim".

¹⁶ Legenhausen, Mohammad, *Islam and the Religious Pluralism*, London, f. 132; Susnjic, Djuro, *Religija II*, Beograd 1998, "Vjerski dijalog i tolerancija – iskustvo razlike" f. 323-338.

Duke pasur parasysh se çdo person ka kulturë, se ai mundet pjesërisht ta krijojë kulturën dhe identitetin e vet personal, atëherë mund të themi se njeriu është qenie kulturore.¹⁷ Nga ky aspekt, mund të thuhet se edhe kultura mund të jetë kulturë e individit, e grupit, e shoqërisë apo e tërë kombit, duke pasur parasysh se një kulturë e tillë si kjo e fundit mund të përmbajë në vete nënkultura të ndryshme, të cilat deri-diku e formësojnë edhe vetë atë. Rrjedhimisht me këtë edhe religjionet e ndryshme kanë kulturat e tyre specifike¹⁸, me çka kur flitet për dialogun ndërreligjioz automatikisht bëhet fjalë edhe për dialogun ndërkulturor.

Kultura është mënyrë konkrete e jetës, mënyrë në të cilën një grup i caktuar njerëzish e organizon jetën e vet, me qëllim që racionalisht të zhvillohet në hapësirën jetësore në të cilën e ka vendosur Zoti. Me këtë nënkuptohet e gjithë ajo që është pjesë e ekzistencës së atij grupi të caktuar duke përfshirë edhe religjionin.

Ky përshkrim i kulturës, i cili bazohet më tepër në veçorinë e grupit konkret dhe në ato vlera të cilat në mënyrë vendimtare e përkufizojnë një bashkësi, apo person, si qenie kulturore e ndryshme nga të gjitha qeniet tjera, duhet plotësuar me kuptimin e kulturës në mënyrën në të cilën theksi vihet mbi atë që i lidh kulturat, që është e përbashkët për ato, me një fjalë mbi çdo gjë të dukshme dhe të padukshme në njeriun që vendos për të, si raporti i tij ndaj Zotit, ndaj vetes, ndaj njerëzve të tjerë dhe ndaj mjedisit. Në veprimin e tij, në mënyrën e tij të jetesës, në veprimtaritë e ndryshme njeriu, apo bashkësia, thjesht japin pasqyrimin e "kulturës" së vet, mënyrës së vlerësimit dhe realizimit të ekzistencës dhe individualitetit të vet.

Ajo që sot e bën kulturën të sëmurë, apo jo të shëndoshë, është mungesa apo mospasja e të përtijmës, më saktësisht e elementit hyjnor në të. Pa këtë dimension transcendent të kulturës, njeriu i dorëzohet lakmisë së madhe të parave dhe pushtetit, suksesit dhe kënaqësive. E tërë kjo shkakton pakënaqësi të thellë ekzistenciale, humbje të kuptimit për vlerat morale dhe pasiguri para ardhmërisë. Kjo ngjan për shkak se kulturat sipas natyrës së tyre janë të hapura ndaj transcendentës, të përtijmës.¹⁹

Nuk duhet humbur nga shikimi vetinë e rëndësishme të çdo kulture se ajo gjithmonë është një realitet dinamik, i cili kurrë nuk rri, dhe lirisht mund

¹⁷ Ibn Haldun, *Uvod u Mukaddimu*, në "Znakovi Vremena", v. 4, nr. 11, f. 18-34; *Enciklopedija političke kulture*, f. 565-578, "Kultura".

¹⁸ Holt, P.M.; Lambton, Ann K.S. & Leëis, Bernard, *The Cambridge History of Islam*, Cambridge 1995, Volume 2B, "Religion and Culture", f. 571-575.

¹⁹ Lidhur me këtë mënyrë të interpretimit të kulturës, njohjes së saj, e cila është shumë e rëndësishme për harmonizimin e mjedisit ku jeton individit dhe bashkëjetesës brenda grupit apo komunitetit, Bashkësia Islame në Maqedoni ka mundësi ta luajë rolin e duhur, si p.sh.: në shkollë, në media, në shtyp, në aktivitete sportive etj.

të themi se I
të mund të t
Çdo kulturë
pranimi të e
apo shoqëria
të reja kultu

Një d
vërehet është
tyre, pa mar
bashkësitë fe
kulturës së s
sipas parime

Feja, r
që sot, siç d
lemi, se kur f
njerëzit të c
mendoj në pë

Bartës
bashkëpunoj
met në shoq
më të njerëz
sot, sigurisht
në një botë të

²⁰ Në botë gj
rrezikon kultu
e kulturës kon
reagim negati
nacionalizmit,
këto dukuri ja
gjithashtu janë
reja, se unive
ndryshimeve s
distancim nga
Kroz prizmu ri

²¹ Oferta e pa
është normativ
shoqërorizimi
në brez, por u
mëvonshme të
vlerash. Famil
morale, deri d

të themi se kurrë nuk do ta arrijë atë shkallë të zhvillimit apo të formës që të mund të thuhet se cila shkallë apo formë e kulturës do të ishte më e mira. Çdo kulturë posedon një dinamikë të brendshme të zhvillimit, aftësinë e pranimit të elementeve të reja, asimilimit, inkulturimit, autenticitetit. Njeriu apo shoqëria është në gjendje të krijojë forma të reja të kulturës ose simbole të reja kulturore, t'i plotësojë ato me përmbajtje të reja.²⁰

Një dukuri tjetër e përhapur në botën bashkëkohore që mund të vërehet është, se gjithnjë e më shumë njerëz pavarësisht vendosin për jetën e tyre, pa marrë parasysh parimet morale e religjioze të cilat i predikojnë bashkësitë fetare. Vetëvendosja dhe vetëpërcaktimi janë pjesë përbërëse të kulturës së sotme. Vetëm një pjesë e vogël e popullatës e çon jetën e vet sipas parimeve të fesë.²¹

Feja, me shekuj e ka pasuruar kulturën, ka qenë bartëse e kulturës, gjë që sot, siç duket, mund ta realizojë gjithnjë e më pak, sepse paraqitet problemi, se kur flitet për fenë apo për Zotin, a flitet me gjuhën e kuptueshme për njerëzit të cilëve u drejtohet? Aq më tepër a kuptohemi edhe mes vetes, mendoj në përfaqësuesit e religjioneve të ndryshme dhe lëvizjeve pozitive?

Bartësit e humanizmit islam dëshirojnë që në frymën e dialogut të bashkëpunojnë me të gjitha forcat pozitive, grupacionet, idetë dhe humanizmet në shoqërinë konkrete, me qëllim të pjesëmarrjes në ndërtimin e botës më të njerëzishme, botës së denjë për njeriun. Detyra e humanizmit islam, sot, sigurisht se nuk duhet të jetë izolimi, por ndërtimi i shoqërisë njerëzore në një botë të sigurtë dhe të pastër për jetesë, të drejtë dhe solidare.

* * *

²⁰ Në botë gjithnjë e më tepër po zhvillohet një e a.q. kulturë universale e cila i rrezikon kulturat e pakicave apo popujve më të varfër. Fjala është për uniformizimin e kulturës konsumuese që arrihet përmes mediave, mjeteve të komunikimit masiv. Si reagim negativ ndaj këtij uniformizimi të kulturës mund ta vërejmë forcimin e nacionalizmit, proteksionizmit ekonomik, kthimit "rrënjëve nacionale". Duket sikur këto dukuri janë shenja të qarta se bota është në proces të ndryshimeve, se kulturat gjithashtu janë në fazën intenzive të asimilimit, inkulturimit, pranimit të vlerave të reja, se universalitet kulturore sot marrin forma të reja. Shpejtësia e madhe e ndryshimeve gjithsesi shkakton pasiguri e cila mund të shprehet në synimet për distancim nga "ndikimet e këqija" të botës së zhvilluar. Shih p.sh.: Trstenjak, Anton, *Kroz prizmu rijeci*, Đakovo 1998, f. 183-190.

²¹ Oferta e pasur në tregun religjioz dhe etik shkaktoi ato që sot asnjë rregullë nuk është normative, porse njeriu mund të zgjedhë atë që i konvenon. Prandaj edhe shoqërorizimi i fëmijës nuk kryhet më sipas traditës së bartur në familje, nga brezi në brez, por u është lënë çerdheve, foshnjoreve dhe fëmija lihet i lirë për moshën e mëvonshme të pjekurisë kur të mundet lirë të vendosë për ndonjë formë sjelljeje apo vlerash. Familja, xhamia dhe institucionet tjera të cilat më parë caktonin vlerat morale, deri diku e kanë humbur atë domethënie për caktimin e masave.

Inkurajimi më i plotë i dialogut mes përfaqësuesve të bashkësive të ndryshme fetare në vendin tonë, por edhe më gjerë, në dimensionin e vet më të plotë mund të arrihet vetëm nëse ithtarët e të gjitha ideplogjive dhe feve bëhen pjesëmarrës të barabartë në atë, që bota bashkëkohore e quan humanizëm, të drejtat e njeriut, drejtësi sociale dhe liri për të gjithë. Nëse nuk arrihet kjo, atëherë pavarësisht nga përpjekjet e bëra për dialog të çfarëdo lloji, ato do të mbeten pa rezultat.

Ne e dimë se feja është strehim i vetëm i sigurt për njeriun dhe vetëmse feja e mëson atë që pa marrë parasysh acarimet e brendshme, ofendimet e madje edhe shkatërrimet e vendeve të shenjta, njerëzit duhet t'i tejkalojnë të gjitha këto për hir të vetvetes dhe brezave të ardhshëm. Me gënjeshtër kurrë nuk do të arrihet deri te e vërteta, e as me dhunë deri te siguria.

Izolimi i cilësdo bashkësi fetare nga ndryshimet që zhvillohen në shoqëri dhe në shtet, pa marrë parasysh dëmin të cilin e kanë përjetuar më parë, duhet shmangur dhe ato patjetër duhet të kalojnë në atë fazën në të cilën do t'u bashkangjiteshin bashkësive fetare në botë që të jenë sa më dominante në çdo lëvizje kulturore, politike e shoqërore.

Ne gjithsesi duhet të jenë në shërbim të Zotit, e jo të politikës, sepse në të kundërtën do të bëhen robër të njëri-tjetrit e jo rob të Zotit.

Dr. Ismail Bardhi

Islam Humanism – foundation for inter religious dialogue

Summary

Religion has always conveyed culture. Subsequently, the carriers of Islam humanism cultivate the spirit of dialogue with all the forces that foster positive ideas in arelevant society.

The most successful dialogue between different religious communities in general and in our country will take place only then, when the retentionists of religious communities are equal participants in the so called humanism by the modern world. This implies freedom and justice for all. Deceits and violence do not ensure security.

Dr Gazme
Akademia

PËRFYT

She
perso-iran
re "Kamu
detyruar a
të pasqyro
të qytetëri
gjithësues

Vle
grafiko-hi
mbështetu
përshkrim

Me

hapsirë e
midis detri
lashtësi, p
Ndërsa në
pjesët që
Horosanit
në popull.
Irani është
islame.¹

Mja
sipërfaqja

Sht

me dhe ku
të Madari
dalje. Ndë

¹ Iran (Pers

*Dr Gazmend Shpuza - Tiranë,
Akademia e Shkencave e Shqipërisë*

PËRFYTYRIMI GJEOGRAFIK I SAMI FRASHËRIT PËR IRANIN E KOHËS SË TIJ

Kontribut për gjeografinë historike

Shemsedin Sami Frashëri u ka kushtuar një vend të rëndësishëm botës perso-iraniene, kulturës dhe qytetërimit të këtij vendi në veprën e tij madhore "Kamusu-l-A'lam". Ka qenë vetë madhështia e këtij universi ai që e ka detyruar autorin e kësaj vepre enciklopedike që të ndalet me mijëra herë dhe të pasqyrojë përmes zërash të shumtë vende, njerëz, dukuri dhe përmendore të qytetërimit perso-iraniian. Këtë e dëshmojnë edhe zërat përmbledhës e përgjithësues kushtuar këtij vendi dhe populli me kulturë të lashtë.

Vlen të theksohet që në krye të këtij përshkrimi që përfytyrimi gjeografiko-historik që na jep Samiu për Iranin është një përshkrim shkencor, i mbështetur në arritjet më të fundit të dijes në këto fusha, aso kohe. Mjaft përshkrime të tij i qëndrojnë kritikës shkencore dhe sot e kësaj dite.

Me emrin Persi (Iran) në kohë të lashta, shkruan Samiu, mbulohej një hapsirë e gjerë, e cila shtrihej midis lumenjëve Dixhle dhe Senduxhejhun, midis detrave Azer (Kaspik), Gjirit të Basrës dhe Detit të Amanit. Në të, në lashtësi, përfshiheshin Iraku Perëndimor, Afganistani dhe Beluxhistani. Ndërsa në kohën e Samiut, sipas përshkrimit të tij, ky vend përbëhej nga pjesët që përfshijnë vendet e Axhemit Irakian, të Farsit, të Germanit, të Horosanit, të Mazanderanit, të Gilanit dhe të Azerbajxhanit. Përgjithësisht, në popull, vëren autori, njihet me emrin Axhemistan. Në vijim, ai thekson se Irani është një nga shtetet e pavarur më të mdhenj të Azisë dhe të vendeve islame.¹

Mjaft i hollësishëm jepet nga Samiu dhe pozicioni, kufinj të dhe sipërfaqja e Iranit.

Shteti i Iranit, sipas tij, ndodhet në anën perëndimore të Azisë së Mesme dhe kufizohet me Azinë Perëndimore. Duke u rrethuar nga malet e larta të Madarit, mesi i tij përfaqëson një pellg të brendshëm, që ngrihet, pa rrugëdalje. Ndërsa në Veri dhe në Jug kufizohet nga detet. Kufizohet në Veri me

¹ Iran (Persia), *Kamusu-l - A'lam*, 2. Cild, Ist. 1899, s. 1129 - 1130.

Kaukazin dhe Horezmin, që sot, domethënë në kohën e Samiut, ndodhen në duart e Rosisë si dhe me brigjet jugore të Detit Kaspik që ndodhet midis këtyre dy vijave kufitare. Nga Lindja kufizohet me Afganistanin dhe Beluxhistanin; nga Jugu me Detin e Amanit dhe Gjirin e Basrës. Ndërsa nga Perëndimi kufizohet me Shtetin Osman, domethënë me Irakun Perëndimor dhe Kurdistanin. Shtrihet midis 25° e 30' gjerësi veriore dhe 44° dhe 64° e 30' gjatësi lindore. Cepi më verior dhe më perëndimor është në shpatin jug-lindor të malit Agri që i përket Iranit, i cili ndodhet në pikën e bashkimit të kufirit rus me atë osman në rrethinat e Bajazidit. Ndërsa cepi më jugor ndodhet në skaj të Beluxhistanit, në brigjet e Detit të Amanit. Gjatësia më e madhe midis këtyre dy cepave shkon nga veri - perëndimi në jug - lindje dhe është afërsisht 2250 kilometra. Ndërsa gjerësia më e madhe, e cila arrin në 1300 kilometra, shtrihet nga Veriu në Jug, domethënë nga kufiri i Horezmit deri te brigjet e Detit të Amanit dhe të Gjirit të Basras. Vendi më i ngushtë shtrihet midis Detit Kaspik dhe Gjirit të Basras dhe arrin vetëm deri në 730 kilometra. Ndërsa sipërfaqja është 1 648 190 kilometra katrorë.

Edhe përsa i takon formave të reliefit të Iranit po ia lëmë përsëri fjalën Samiut.

Siç u tha më sipër, anët e Iranit dhe, sidomos, pjesët veriore, perëndimore dhe jugore, janë të rrethuara me male, mesi dhe vendet në afërsi të kufirit lindor formojnë një gropë pa rrugëdalje, pa të dala. Malet më të larta të Iranit, janë vargmalet Elbruz, që shtrihen në pjesën veriore. Ata, pasi arrijnë në Istirdaba, duke u shtrirë drejt Veriut, gjatë brigjeve të Detit Kaspik, bashkohen me rajonin malor të Kaukazit. Pjesa veriore e tyre në zonën e Horosanit, duke u ndarë në disa degëzime, pasi arrin në Afganistan me emrat Guhguristan dhe Guhbilur, përbën një nga pesë rremat (Hinduguh), pjesë e vargmaleve të Himalajave, që janë territori më i lartë i rruzullit tokësor. Maja më e lartë e vargmaleve Elbruz është një vend mineral (Demavend) që ndodhet në lartësinë 4600 metra. Ajo është njëkohësisht maja më e lartë e të gjithë Iranit. Në zgjatimin e Elbruzit, domethënë në vendin ku ky bashkohet me Kaukazin dhe takohet edhe me një vargamal tjetër, formohen malet Sevalan dhe Sehand në Azerbajxhan. Më tej, duke u zgatur drejt juglindjes këto bashkohen me disa degë në vijat e Luristanit, të Axhemit të Irakut, të Hozistanit, të Farsit, të Germanit; dhe arrin deri në Tamkeran dhe në Beluxhistan.

Me që ky vargamal i madh nuk ka një emër të përgjithshëm, në çdo vend, shënon Samiu, thirret me një emër të veçantë. Krahas me ngrohjen e klimës që vjen nga ulja e lartësisë së vargmaleve të Elbruzit, ka dhe maja të mbuluara me borën e përjetshme. Lartësinë më të madhe e ka në German (Guhihëzër), e cila arrin në 4572 metra. Lartësinë e dytë e ka në malin Zina që ndodhet në vargun e maleve të Farsit, 3656 metra; ndërsa maja e tretë është në malin Elvend, që ndodhet mbi Hemandan dhe është 3350 metra. Përveç këtyre dy vargmaleve ndodhen dhe kurorat e maleve të Guhistanit që shtrihen në Jug të Horosanit, të cilat janë të lidhura me malet e Afganistanit.

Megj
janë të mbu
na e fusha t
malit të Elb
famshme pë

Midis
e përbërë n
e Madhe). I
shkretëtirë t

Në pë
interes lidh
bërë fjalë p
se përse në

Me që
shpatet e ty
rat që rrjedh
arrijnë të zg
ka lumej të

Vendi
gje ujëmbled
Gjirit të Bas
shkretirave t

Ujrat
prej tyre, A
nëpër Rusi,
rishtazi në t

Detit të sipë
xhan rrjedh
të Jug - Lind
kalon përm
jugore të tij,
lumejve që d
putet në një
në brigjet e t

Më të
menjtë Gerh
është lumi r
duke zbritur
hyjnë në ven
i dyti në peri

² Po aty.

Megjithëse disa male të Iranit janë me shkëmbinj dhe të thatë, disa janë të mbuluar me pyje dhe me kullota; dhe midis tyre përfshihen dhe luginat e fusha të lulëzuara dhe pjellore. Klima, veçanërisht, në shpatet veriore të malit të Elbruzit dhe në shkallë të dytë në Fars dhe në Azerbajxhan është e famshme për ajrin e pastër dhe prodhime të shumta.

Midis Axhemit të Irakut dhe Horosanit ndodhet një shkretëtirë e gjerë e përbërë nga një tokë dhe rërë e kripur me emrin Desht-i Kebir (Shkretëtira e Madhe). Edhe në juglindje të saj, midis Germanit dhe Guhistanit ka një shkretëtirë të dytë me emrin (Desht-i Lut).²

Në përshkrimin gjeografik të Iranit Samiu hyn dhe në arsyetime me interes lidhur me dukuri dhe fenomene gjeografike vendase. Kështu, duke bërë fjalë për lumenjtë dhe liqejtë e këtij vendi, ai shpjegon dhe arsyet bindëse se përse në këtë territor nuk ka lumenj të mëdhenj.

Me që malet e Iranit ndodhen në pjesët anësore, ujrat që rrjedhin nga shpatet e tyre të brendshme, thahen nga shkretëtirat dhe zhduken. Ndërsa ujrat që rrjedhin nga shpatet e tyre të jashtme, me që nuk kanë hapsirë, nuk arrijnë të zgjerohen. Për këtë arsye Irani, konkludon me të drejtë autori, nuk ka lumenj të mëdhenj.

Vendi i Iranit është i ndarë në tre vija ujëndarëse, pra, dhe në tre pellgje ujëmbledhëse. Njëri prej këtyre është Deti Kaspik, i dyti është pellgu i Gjirit të Basrës dhe i Detit të Amanit, ndërsa i treti është pellgu pa dalje i shkretirave të brendshme.

Ujrat që derdhen në Detin Kaspik përfaqësohen nga tre lumenj. I pari prej tyre, Arasërmak, duke ardhur nga tokat e Perandorisë Osmane, kalon nëpër Rusi, dhe përsëri kapërcen kufirin midis Rusisë dhe Iranit, duke hyrë rishtazi në tokat e Rusisë, derdhet më së fundi në brigjet perëndimore të Detit të sipërpërmendur. Lumi i dytë Sefidrud, nga burimet e tij në Azerbajxhan rrjedh me shumë zik zake në drejtim të Veri - Lindjes, pastaj në drejtim të Jug - Lindjes dhe së fundi përsëri në drejtim të Veri - Lindjes, dhe pasi kalon përmes një gryke të maleve Elbruz, derdhet në detin Kaspik, në brigjet jugore të tij, midis Resht -it dhe Lahxhanit. Lumi Etek (Terek), i treti midis lumenjve që derdhen në detin Kaspik, buron nga malet e Horosanit. Pasi shkapet në një distancë të madhe nga kufijtë e Rusisë, derdhet në Detin Kaspik në brigjet e tij lindorë.

Më të mëdhenjtë nga lumenjtë që derdhen në Gjirin e Basras, janë lumenjtë Gerh dhe Kârûn, të cilët i përkasin pellgut të lumit Shat-el-Arab, i cili është lumi më i madh që derdhet në Gjirin e Basrës. Që të dy këta lumenj, duke zbritur nga malet e Luristanit, ndahen në vijën e Hozistanit dhe, pasi hyjnë në vendet osmane, derdhen në lumin Shat al Arab, i pari në Krane dhe i dyti në periferi të Muhamere, në anët e larta të Basrës.

² Po aty.

Nga malet e Farsit në Gjirin e sipërpërmendur derdhen shumë lumenj, dhe në krye të tyre, duke filluar nga perëndimi janë lumenjtë Sitargjan, Dejurud, Peristar dhe Abhur. Nga këto dy lumenjtë e fundit, i pari zbrit nga malet që ndodhen përmbi Shiraz, dhe i dyti i bashkëngjitet Gjize-së që ndodhet përballë ishullit të Gjish-it.

Lumenjtë që zbresin nga Germani dhe Mekerani dhe që derdhen në Detin e Amanit, janë të parëndësishëm. Shumica e tyre gjatë verës thahen dhe shndërrohen në përrenj. Midis lumenjëve që rrjedhin nga shpatet e brendshme të maleve të Iranit dhe që zhduken në gropën qëndrore të tij, ka dhe disa lumenj të mëdhenj dhe të rëndësishëm. Më kryesorët janë: Absarrud (revd), i cili rrjedh në anën jugperëndimore të Teheranit dhe përbëhet nga tri degë që vijnë nga Hemdani, Sulltanabadi dhe Huansari. Këto, pasi bashkohen me Abhur-in, humbasin në Desht-i Kebir (Shkretëtirën e Madhe). Lumi Guhistan, duke zbritur nga Gjuhistani, pasi bashkohet me ujrat që vijnë nga Germani, humbet në Shkretëtirën e Lutit. Ndërsa lumi Herirud, pasi kalon kufirin e Iranit, duke ardhur nga Herati, zbrit nga malet e Horosanit dhe kalon Sherurud-in nga ana e Nishapurit, duke humbur, i tharë në Desht-i Kebir (Shkretëtirën e Madhe).

Në Iran me që shumica e ujrave janë të kripur, gjenden disa liqene të tillë. Më të mëdhenjtë midis tyre janë Ermih, që zgjatet midis Azerbajxhanit dhe Kurdistanit. Ndërsa, i dyti, i quajtur Hamun, apo, siç njihet ndryshe me emrin Zere, shtrihet në kufi me Afganistanin. Edhe midis maleve të Farsit dhe të Germanit ndodhen disa liqene. Midis tyre janë liqeni i Tibrizit afër Shirazit, dhe liqeni Bahtegjanit që ndodhet në German.³

Shemsedin Sami Frashëri pasi vijon të përshkruajë hollësisht pamje të tilla të gjeografisë së Iranit si klima dhe ajri, një vend të veçantë i kushton dhe gjeografisë ekonomike të këtij vendi, duke bërë fjalë hollësisht për prodhimet bujqësore dhe blegtorale si dhe veprimtarinë ekeonomike të tij apo për burimet pasurimit, siç i quan ai.

Më tej ai ndalet dhe bën fjalë për demografinë e Iranit në fundin e shekullit të kaluar dhe në fillim të këtij shekulli, duke u ndalur në aspekte të tilla si popullsia, racat, gjuha dhe besimi.

Autori ynë vëren, që në Iran, deri në kohën e tij, nuk është bërë asnjë përpjekje për të bërë regjistrimin e banorëve të tij dhe, për rrjedhim, nuk ka të dhëna të sakta për popullsinë e këtij vendi. Në këto rrethana, nga ana e gjeografëve janë bërë të njohura shifra të ndryshme midis 5 dhe 16 milionësh. Më e përafërta, midis tyre, sipas Samiut, duhet të jetë shifra prej 9 milionësh. Deri në 7 milion prej tyre janë iranianë të mirëfilltë, domethënë i përkasin racës (familjes) farse; ndërsa 2 milion janë turq, arab, kurd, armen dhe izraelit. Pas racës farse më të shumtë në numër janë turqit. Këta përbëhen nga fiset turkmene, të cilat janë të vendosura në pjesën veriperëndimore

³ Po aty, 1131.

të Iranit, d
arrijnë afë
trima dhe
Mesjetës, j
i përkiste t
së Samiut
janë shtegt
Azerbajxh
Gjuha e kë
Pas
de. Arrijnë
Azerbajxh
Arm
po ashtu d
Meg
kur Irani i
dhe u vend
e kohës, h
Gjirit të Ba
Me
nëve nën s
lejoj atyre
tyre kombë
Meg
farse të Ira
paruar në s
rim. Edhe
ishte dhe m
Vën
diktoheshi
nuk ishin t
tat e tij të
ardhmen e
Fare
është disa
mos në Ge
pakuptuesh
të fisëm gj
miu, e buk
Në I
ruar, kishte

⁴ Po aty, 11

të Iranit, domethënë ndodhen në anët e Azerbajxhanit dhe të Taberistanit dhe arrijnë afërsisht në 800000 vetë. Për shkak të cilësive të tyre, me që ishin trima dhe guximtarë, shteti dhe Sulltanati iranian, që në kohët e periudhës së Mesjetës, janë ndodhur në duart e tyre. Ashtu sikurse dinastia e Nadir Shahut i përkiste fiseve turkmene të Afsharit edhe dinastia e sundimtarëve të kohës së Samiut i takonte fiset Kaçar, po nga fiset turkmene. Shumica e tyre dhe sot janë shtegtarë që jetojnë në çadra. Megjithëse jetojnë në formën e fiseve, në Azerbajxhan janë të përzjerë me popullsinë vendase, pasi janë vendosur aty. Gjuha e këtij vendi është turqishtja.⁴

Pas turqve, mëdis popullsive të Iranit më e përqëndruar është raca kurde. Arrijnë afërsisht në gjysëm milioni dhe janë të vendosur në anët jugore të Azerbajxhanit, për rreth liqenit Ermih dhe në Ardllandasa.

Armenët kryesisht janë në rrethinat e Tebrizit dhe në qytetet e mëdha, po ashtu dhe izraelitët janë po në këtë gjendje të shpërndarë.

Megjithëse në periudhën e përhapjes së Islamit dhe më pas, në kohën kur Irani ishte në dorën e hilafetit Emevij dhe Abbasij në këtë vend erdhën dhe u vendosën shumë arabë, këta, duke u përzjerë me iranianët, me kalimin e kohës, humbën dhe gjuhën e tyre. Në gjendjen e sotshme vetëm për rreth Gjirit të Basrës janë disa mijëra vetë, të cilët e flasin gjuhën arabe.

Me shumë interes janë mendimet që jep Samiu për pozitën e iranianëve nën sundimin osman. Sipërania kulturore dhe niveli i qytetërimit pers u lejoi atyre të ruanin dhe të zhvillonin gjuhën amtare, letërsinë dhe kulturën e tyre kombëtare.

Megjithëse me forcë dhe me luftë turqit arritën ta mundin popullsinë farse të Iranit, shkruan Samiu, iranianët, që i përkisnin racës fars ishin të përparuar në shkollim, në zejtari, në tregti, në shkencë, në letërsi dhe në qytetërim. Edhe pse shteti ishte në duart e bijve të turqve, gjuha zyrtare dhe letrare ishte dhe mbeti farisishtja.

Vënia në pah dhe theksimi i këtyre konstatimeve nga ana e Samiut diktoheshin nga pozita e rëndë e popullit shqiptar nën sundimin osman. Ato nuk ishin thjesht një pasqyrim i realitetit iranian. Ata buronin dhe nga aspiratat e tij të fuqishme për lulëzimin dhe konsolidimin e kombit të tij, për të ardhmen e popullit të vet, për lulëzimin dhe zyrtarizimin e gjuhës amtare.

Faresishtja që flitet në Iran, vijon Samiu në kumtimet e veta të pasura, është disa llojesh, në çdo vend ka një dialekt apo të folme të veçantë. Sidomos në Gejlan dhe në disa pjesë të zonave veriore, përdoren disa gjuhë të pakuptueshme midis popullsive. Megjithatë midis njerëzve të arsimuar dhe të fisëm gjuha që lexohet dhe shkruhet kudo është gjuha, siç e thekson Samiu, e bukur farisishte.

Në Iranin e kohës së Samiut, sipas informacioneve që ai kishte siguruar, kishte deri në 300 000 të krishterë, afro 10 000 izraelitë si dhe deri në

⁴ Po aty, 1132.

8000 gëber, domethënë zerdeshi. Pjesa tjetër e popullsisë janë tërësisht muslimanë. Sekti i tyre është shiit, vetëm një pjesë e kurdëve dhe e arabëve janë suni.

Në fundin e shekullit të kaluar Irani ndahej nga ana administrative në 11 provinca (ejalete), dhe secila prej tyre ndahej, në disa prefektura (kaza). Qendrat e ejaleteve ishin: Teheran (Akhemi Irakian), Amel (Taberistan), Sarë (Mazanderan), Desht (Gejlan), Tebriz (Azerbajxhan), Germanshah (Kurdistan), Shoster (Hozistan), Shiraz (Fars), German (German), Shehristan (Gjuhistan), Meshhed (Horasan).

Kjo ndarje administrative përputhej, sipas Samiut, me ndarjen gjeografike dhe natyrore të Iranit. Ndërsa qendra e natyrshme e Axhemit Irakian është qyteti Isfahan. Teherani, duke qenë me kohë kryeqytet i Iranit, dhe duke u zgjedhur kryeqytet edhe nga dinastia e atëhershme në pushtet, qendra e tij kaloi nën administrimin e Axhemit Irakian, dhe rajoni i Rejt, shënon Samiu, nuk u caktua si provincë (ejalet) e veçantë.

Irani ka shumë qytete dhe qyteza të mëdha, të favorizuara si nga ana e pozicionit gjeografik ashtu dhe nga pikëpamja tregtare. Megjithëse shumica e tyre, vëren Sami Frashëri, janë në rënie dhe në shkatërrim, mjaft prej tyre janë të populluar dendur. Më tej në Enciklopedinë e Samiut shënohen qytetet më të mëdhenj së bashku me numrin e popullsisë:

Teherani (210 000), Tebriz (170 000), Isfahani (90 000), Meshhedi (70 000), German (48 000), Desht (41 000), Kazvin (40 000), Jezid (40 000), Hemdan (35 000), Germanshah (32 000), Shiraz (32 000), Dizkull (30 000), Kâshan (30 000), Shuster (27 000), Bender Bushir (27 000), Jezd - i Xherd (20 000), Kom (Kum, Kavm) (20 000), Naster Abad (15000).

Samiu në vijim të përshkrimit të tij nuk mungon të shënojë qytetet e lashta të Iranit. Qyteti i Tusit, i cili në kohë të lashta ka qenë shumë i njohur dhe kryeqytet, ndodhej në rrethinat e Dizfullit. Pranë qytetit të Shirazit gjendeshin ende rrënojat e qytetit të lulëzuar të Istehr-it në kohët e para të Islamit. Po ashtu, disa qytete të cilët në periudhën islame kishin qenë të lulëzuar dhe shumë të njohur, si Nishapuri, Bestam, Maraga me rënie e tyre u shndërruan në qyteza të vogla, ndërsa qyteti i Tusit në Horosan, u shkatërrua krejtësisht.⁵

Jo rastësisht, Samiu ndalet me mjaft hollësi te forma e regjimit, dhe te mënyra e qeverisjes së Iranit të kohës së tij, për të vijuar më tej me sistemin financiar dhe organizimin e forcave ushtarake. Në këtë çështje qoftë dhe në mënyrë të tërthortë hiqen paralele midis Iranit dhe Perandorisë Osmane, në të cilën bënte pjesë dhe atdheu i Samiut, Shqipëria.

Shteti i Iranit është në dorën e një sundimtari të pavarur, të emërtuar me titullin "shah", sulltanati (mbretërimi) megjithëse kalon nga i ati tek i

⁵ Po aty, 1133.

biri, nënku
dëshiron.

Venc
ejaleteve (p
hut ose nga
e drejtësis
gjyqësore
Dijetarët e
Profetit ka

Të a
lira osmane
administrin
shpenzimet
ka borxhe,
shpenzimet
bël. Këtu
gjendjen fi
anglezë du

Pra,
son një kur
dorinë Osn

Ush
thënë 5470
5000 artilie
dhe 97 kor
ushtarë jo
bashku bëj
ushtarët jo
të Farsit, v
të tipeve të

Ësht
nomik - sh
Ai ndalet c
për nivelet
prej kohës
vetën të ve
u pranuan

Gjul
juar mbi b
me veprat
Saadi, erd
Më t
tërimin isla

biri, nënkuptohet, më i madhi, shahu mund t'ia lejë trashëgimin djalit që dëshiron.

Vendi drejtohet nga një këshill ministror. Shumica e drejtuesëve të ejaletëve (gubernatorët) caktohen nga persona që i përkasin familjes së shahut ose nga radhët e ministrave të liruar nga detyra e tyre e parë. Në çështjet e drejtësisë, megjithëse baza e ligjeve është Sheriati, shumica e veprimeve gjyqësore kryhen, thekson Samiu, mbi bazën e të drejtës zakonore vendase. Dijetarët e zotë në interpretimin e ajeteve të Kur'anit dhe të haditheve të Profetit kanë një forcë dhe ndikim të madh.

Të ardhurat dhe shpenzimet vjetore të Iranit janë, të përllogaritura në lira osmane, së paku, rreth 2 milion. Me që taksat janë të pakta dhe mënyra e administrimit të tyre është tepër e thjeshtë, të ardhurat janë të ulta. Por dhe shpenzimet, nënvizon Sami Frashëri, janë në përputhje me ta. Përveç që nuk ka borxhe, me që ka një ndryshim deri në 3 apo 4 milion frangash midis shpenzimeve dhe të ardhurave, në thesarin shtetëror ka dhe të holla disponibël. Këtu Samiu bën fjalë për një realitet që kontraston fuqimisht me gjendjen financiare të Perandorisë Osmane të mbytur në borxhe te bankierët anglezë dhe francezë.

Pra, përshkrimi i bilancit pozitiv të buxhetit të shtetit iranian përfaqëson një kundërvënie të hapur ndaj gjendjes së mjerruar të financave në Perandorinë Osmane.

Ushtria e rregullt e Iranit aso kohe përbëhej nga 78 batalione, domethënë 54700 këmbësorë, 2 regjimente me 1000 kalorës, 20 bateri artilerie me 5000 artilierë, të cilët që të gjithë bashkë bëjnë 60700 vetë. Përveç tyre, janë dhe 97 kompani me 24250 kalorës, dhe 24 batalione me 16800 këmbësorë, ushtarë jo të rregulltë (rezervistë), të cilët, në regjistrat zyrtarë, të gjithë së bashku bëjnë 101750 ushtarë. Ushtarët më të vlefshëm janë kalorësit. Edhe ushtarët jo të rregullt që nxirren nga malet e Horosanit, të Mazanderanit dhe të Farsit, vijon në shënimet e tij Sami Frashëri, janë trima. Armët e tyre janë të tipeve të vjetra. Flotë nuk ka.

Është për t'u vënë në pah që S. Frashëri përshkrimin e zhvillimit ekonomik - shoqëror të Iranit e fillon me parashtrësën rreth arsimit dhe kulturës. Ai ndalet dhe flet, duhet thënë, me kompetencë për historinë e gjuhës farsie, për nivelet në të cilat arriti letërsia e konkretisht poezia persiane. Irani që prej kohësh të lashta ka, thekson autori i "Kamusiu-l- A'lamit", një letërsi të vetën të veçantë. Libri Avesta është shkruar në gjuhën Zend. Pas Islamizimit u pranuan shkronjat e arabishtes.

Gjuha farsie filloi të shkruhej në fillimet e Islamizimit. Me që ishte krijuar mbi bazën e letërsisë dhe të qytetërimit të lashtë iranian, me daljen dhe me veprat e poetëve të mëdhenj si Firdusi, Rudaki, Enveri, Nizami dhe Saadi, erdhi në shkallën e gjuhëve, thekson Samiu, më të përsosura poetike.

Më të mdhenjtë shkencëtarë islamë në kohën më të shkëlqyer të qytetërimit islam dolën, thekson S. Frashëri, në Iran. Qytetet Tus, Nishapur, Kaz-

vin, Isfahan, Shiraz, Maraga, dhe të tjerë qenë shndërruar në qendra shkencore. Pas kësaj dhe për pesë - gjashtë qind vjet megjithë rënien, që u vërejt, e cila nuk mund të mohohet, në Iran zhvillimi i shkencës dhe i arsimit nuk u ndërpre, edhe sot e kësaj dite ka plot dijetarë. Porse me që të rejtat e shkencës dhe zbulimet e fundit nuk janë përkthyer dhe plotësuar në gjuhën farsije, nuk kemi përparimet e pritura në fushën shkencore. Përkundrajt kësaj, Shteti Iranian kohët e fundit kishte hapur në Teheran një universitet, dhe kohë pas kohe kishte filluar të dërgonte studentë për studime në Europë. Kurse nëpër shkollat kishte filluar mësimi i veçantë i shkencave në gjuhën arabe dhe i letërsisë iraniane.⁶

Përsa i takon shkallës së zhvillimit ekonomik të vendit Samiu thekson prapambetjen e Iranit. Ai, me të drejtë, konstaton mungesën e industrisë së re dhe fabrikave. Megjithëse shumë zejtari të vjetra kishin rënë, vijonin të ushtroheshin mjaft zeje tradicionale. Më e para dhe më e rëndësishmja prej tyre mbetej zeja e prodhimeve prej mëndafshi. Halitë, qylymat, sexhadet dhe shallat e Iranit janë të mirënjohur. Si në endjen ashtu dhe në ngjyrosjen e tyre iranianët tregonin një zotësi të veçantë, për këtë arsye këto prodhime pëlqeheshin dhe vlerësoheshin lart nga europianët dhe vijonin të eksportoheshin me shumicë.

Edhe prodhimet iraniane të lëkurëve, të armëve, të vazove dhe të tjera si këto ishin të mirënjohur. Siç prodhoheshin cohra të pambukta në Isfahan, qarqe cilësorë të armëve në Horosan, kishte dhe punishte të posaçme për prodhimin e cohrave të mëndafshta dhe të sheqerit në Jezid.

Iranianët, thekson S. Frashëri, kanë një prirje dhe aftësi të jashtëzakonshme për tregti. Ata, sipas tij, zotëronin monopolin e shkëmbimeve tregtare të vendit, si në eksport ashtu dhe në import. Ashtu sikurse i transportojnë dhe i shesin me një herë në të katër anët e botës prodhimet e Iranit, edhe mallrat e huaja tregtare i transportojnë dhe i sjellin vetë në Iran. Porse, përkundrajt pozitës së favorshme të Iranit midis Indisë dhe Kinës, nga njera anë, dhe Azisë Perëndimore dhe Europës, nga ana tjetër, autori i Kamusit vë në pah, se prapambetja e rrugëve dhe e vendkalimeve, mungesa e sigurisë në Iran, bëheshin pengesë për një zhvillim të tregtisë në përpjestim me aftësitë e popullsisë në këtë fushë dhe në raport me mundësitë që ofronte pozicioni gjeografik.

Mbi bazën e këtij konceptimi të kushteve natyrore gjeografike Sami Frashëri jep në veprat e tij dhe mbarë zhvillimin historik e kulturor të Iranit në shekuj duke u ndalur në veçanti në autoritet shkencore e sidomos letrare iraniane në shekuj.

⁶ Po aty, 1334.

Dr. Gazmend Shputza

Geographical imagination of Sami Frasheri of Iraq of his time

Summary

In his six volume encyclopaedia "Kamus al - a lam", Sami Frasheri provides us with very important information for many different countries of the world. Here we will present the data that Sami Frasheri provides for Iran. In this encyclopaedia article, he gives a comprehensive description of Iran considering the historical and geographical aspect as well as the economic, cultural and strategic one. He also describes the configuration and Iran's role during history.

Shtet
1326) dhe
konsolidua
të tjerë turq
Me kalimin
osman, në l
atyre ngjarje
e rëndësishr
shënon hum
rend të parë
në këto troje
në raportet e
është përshk
XV, XVI e X

Interes
sidomos nga
atëherë, për
popullore e
Betejës së K
historike, qo
imponuar re
atë ngjarje. U
perëndimore
të Betejës së
për Betejën e
krahasuar bu

¹ Lidhur me k
gjërësisht për
boju, Glasnik s
viti 1389 në h
Filologiju, nr. X

BETEJA E KOSOVËS E VITIT 1389 NË HISTORINË E IDRIS BITLISIT

Shteti i ri osman në periudhën e dy sulltanëve të parë, Osmanit (1290 - 1326) dhe birit të tij të guximshëm, Orhanit (1326 - 1360), pasi që u konsolidua dhe u forcua, duke i zgjeruar kufijt e vetë në llogari të bejlerëve të tjerë turq në Azi të Vogël, ai në planin e tij luftarak u drejtua kah Ballkani. Me kalimin e çetave osmane në truallin Ballkanik deri te forcimi i pushtetit osman, në këto vise ndodhën shumë ngjarje të rëndësishme. Në vargun e atyre ngjarjeve, Beteja e Kosovës padyshim ka qenë më vendimtarja dhe më e rëndësishmja në historinë e vendeve dhe popujve të Ballkanit. Ajo ngjarje shënon humbjen e pavarësisë politike të pjesës më të madhe të Ballkanit, në rend të parë të popullit serb, dhe fillimin e sundimit shumë shekullor osman në këto troje. Sëkondejmi kjo ngjarje, edhe pse pak, me kujdes është shënuar në raportet e bashkëkohasve të Lindjes dhe të Perëndimit, por më detajisht është përshkruar në veprat e historiografëve turqë dhe evropianë të shekujve XV, XVI e XVII.

Interesimi më i madh shkencor për Betejën e Kosovës ka filluar sidomos nga viti 1889, d.m.th. nga pesëqind vjetori i asaj ngjarjeje. Deri atëherë, përshkrimi i kësaj ngjarje është bazuar më shumë në traditën popullore e më pakë në lëndën burimore. Në vitet e përmendura studimit të Betejës së Kosovës i bëhet qasje duke u mbështetur mbi themelet e burimeve historike, qoftë nga evropianët, qoftë nga turqit. Natyrisht, studimi i tillë ka imponuar rëvidimin dhe përmirësimin e shumë koncepteve të gabuara për atë ngjarje. U gjetën me dhjetëra historianë, të cilët duke shfrytëzuar burimet perëndimore dhe turke kontribuan shumë në ndriçimin dhe studimin kritik të Betejës së Kosovës.¹ Në mesin e tyre kujdes të veçantë meriton studimi për Betejën e Kosovës i Aleksej Olesnickit, në të cilin ai ka analizuar dhe ka krahasuar burimet e vjetra dhe të reja turke për Betejën e Kosovës

¹ Lidhur me këtë, në botime të ndryshme, kanë shkruar shumë historianë tanë. Më gjërësisht për këtë shih studimin: Aleksej Olesnicki, *Turski izvori o kosovskom boju*, Glasnik skopskog naucnog drustva, Skoplje, 1934. (Punimi Beteja e Kosovës e vitit 1389 në historinë e Idris Bitlisit, është huazuar nga revista *Prilozi za Orientalnu Filologiju*, nr.XIV-XV, 1969, Sarajevo)

(Iskendernamen e Ahmedit, Tavarihi Ali Uthman të Uruxhit, Tarihi Ali Uthman të anonim, Behxhatut - tavarihi të Shukrullahit, Tavarihi ali Uthman të Ashik Pasha Zades, Kitabi xhihan numa të Neshriut, Tagut-tavarihi të Sadudinit, Muneshatus-salatin të Ferid Ahmedit)². Mirëpo, asnjë hitorian sllav deri më tash nuk e ka shfrytëzuar përshkrimin e Betejës së Kosovës në veprën Hesht Behesht - historinë e madhe të Perandorisë Osmane, e cila përfshinë sundimin e tetë sultanëve të parë osmanë (nga Osmani deri te Selimi I, d.m.th. nga viti 1290-1512). Veprën e ka shkruar Idris Bitlisi, historiograf i njohur osman nga fundi i shek. XV dhe fillimi i shek XVI, kronist i oborrit mbretëror (Vak'a-i nuvis) të Bajazidit II.³ Shkaku kryesor përse ky burim nuk është shfrytëzuar, gjithsesi është se dorëshkrimet e pakta të Hesh Beheshtit në kohën e shqyrtimit të problemit të përmendur nuk kanë qenë të njohura tek ne.

Në vitin 1942 arriti një ekzemplarë me vlerë, në dorëshkrim, i kësaj vepre në Arkivin Shtetëror të Zagrebit. Aty e deponuan trashëgimtarët e të ndjerit Franc Ottenfels, ish-pronar i dorëshkrimit dhe dikur përfaqësues diplomatik austriak në Stamboll.⁴ Edhe Olesnicki nuk ka qenë në gjendje që ta përdor në punimin e vet, prandaj nuk ka mundur as t'i vërej të gjitha lidhjet e ndërsjella në mes të burimeve të vjetra dhe të reja. Si shembull mund ta theksojmë konkludimin e gabuar të Olesnickit, se "Saduddini vetëm në mënyrë romantike me stil elegantë, i ka spjeguar raportet e Neshriut". Mirëpo, sot, kur kemi mundësi që ta shfrytëzojmë veprën e Bitlisit, arrijmë në konkludim krejt tjetër. Në të vërtetë, kur është fjala për Betejën e Kosovës, Saduddini e ka shfrytëzuar, pikërisht, veprën Hesht Behesht të Bitlisit dhe e ka përcjellë si në pranimin, shfaqjen e faktorëve dhe ngjarjeve kryesore, në komponimin dhe radhitjen e kumtesave të atyre të dhënave. Kjo përputhshmëri është e madhe, mund të numërohen në gishtërinj dallimet e vogla që ekzistojnë në mes tyre.⁵

² Ibid.

³ Më gjërsisht për Bitlisin shih: Salih Trako, Bitlisijev opis Balkanskog poluostrva, POF, XII-XIII, Sarajevo, 1965, str. 209-218.

⁴ Shih: Sulejman Bajraktarević, Ottenfelsova orijentalisticka zbirka u Zagrebackom drzavnom arhivu, Zbornik Historijskog instituta Jugoslavenske akademije, vol. 2, Zagreb, 1959, str. 75-77.

⁵ Përveç tjerash, Saduddini përmend edhe një Argun (?), i cili ka qenë në anën e ushtrisë krishtere bashk me princin Lazar, si edhe ushtarakun Levendoglu (?), i cili ka qenë në anën e majt të frontit, bashk me mbretin boshnjak (?) ndërsa Bitlisi këta nuk i përmend fare. Në vazhdim, Saduddini, krahas Çekëve përmend edhe Polkaët, për të cilët Bitlisi nuk flet. Në anën tjetër Bitlisi përmend Inxhexhik Balabanin dhe Tivuxh Balabanin si prijës ushtarakë të formacioneve osmane, kurse Saduddini përmend vetëm Tivuxh Balabanin.

Këtë konsiderohet edhe shkrimi i hen edhe në shkrimet e cilin e ofron pyetja: me përgjigje të është shërb dhe kumti transmetue të gjitha ja ndaj burim mëhershme edhe tregi Kosovës, d 120 vjet p mundur, së është shërb krahasues t më shumë për Betejën tjerë të he pranë detaj ato në kron e Bitlisit, t vërtet, i pa

⁶ Historiogra tuar dhe ka dhe Selimit Tarihi ali u gjërsisht sh

⁷ Hoxha Sa shekullit I sultanëve, III (1595-1 boll, në vit pædie des

⁸ Për Koxh dur në Sara tin 1636, H Në karrierë

Këtë e themi që të konstatojmë se Bitlisi, i cili në historiografinë turke konsiderohet burim par excellence, hedh dritë të re mbi këtë ngjarje. Andaj edhe shkrimet e historiografëve të tjerë, duhet patjetër nganjëherë të vëzhgohen edhe nga këndi tjetër. Në qoftë se e krahasojmë shkrimin e Bitlisit me shkrimet e autorëve të tjerë të vjetër, do të shohim se ai përveç shkrimit të cilin e ofron Neshriu, është më i gjerë dhe më komplet. Mund të shirohet pyetja: me çfarë burime është shërbyer Bitlisi? Vetë autori nuk na jep përgjigje të qartë. Në hyrje të veprës, ai flet, jo qartë për burimet me të cilat është shërbyer në veprën e vet dhe pohon se, për "shumë ngjarje vërtetësin dhe kumtimin nuk e ka dëgjuar drejtpërdrejtë, as nuk i ka mësuar nga transmetues i sigurt, ose që nuk është parë a konfirmuar nga librat e sigurt, të gjitha janë injoruar dhe i janë lënë harresës".⁶ Pra, Bitlisi qartë na thotë se ndaj burimeve sillet me sy kritik. Nga kjo kuptojmë se për ngjarjet e mëhershme, Bitlisi ka konsultuar vepra të shkruara, e për të mëvonshmët edhe tregimin e sigurt gojor. Përsa i përket përshkrimit të Betejës së Kosovës, duhet patur parasysh, se Bitlisi veprën e vet e ka shkruar diku rreth 120 vjet pas Betejës së Kosovës, andaj është vështirë të besohet se ka mundur, së paku nga dora e dytë, të marrë lajme gojore për atë ngjarje; pra, është shërbyer me burime të shkruara. Mirëpo, pa studim më të thellë krahasues të veprës së tij është vështirë të thuhet se cilin nga autorët e vjetër më shumë e ka vlerësuar dhe e ka imituar. U konstatua se shkrimi i Bitlisit për Betejen e Kosovës është më i gjerë dhe më komplet se sa të autorët e tjerë të hershëm të njohur sot, (përveç shkrimit të Neshriut). Përveç kësaj, pranë detajeve identike a të ngjashme në shkrimin për Betejën e Kosovës me ato në kronikat e njohura ekzistojnë edhe dallime. Sidomos bie në sy e dhëna e Bitlisit, të cilën para tij nuk e ka ofruar asnjë historiograf i njohur. Ai, në të vërtetë, i pari, e sipas tij edhe Saduddini,⁷ e më vonë edhe Koxha Hysejni⁸, e

⁶ Historiografi turk Mehmed Neshri, prejardhja e të cilit nuk është fort e qartë, ka jetuar dhe ka punuar si profesor në Bursë në kohën e sultanëve osmanë Bajezidit II dhe Selimit I, kur edhe, në vitin 1520 ndërroi jetë. Ky ka lënë veprat historiografike *Tarihi ali uthman*, që është një pjesë nga vepra *Xhiban numa*, e cila është humbur. Më gjërësisht shih veprën: Mehmed Neshri, *Kitab-i xhiban numa*, I cilt, Ankara, 1949.

⁷ Hoxha Saduddin b. Xhan, historian turk i periudhës osmane nga gjysma e dytë e shekullit 16. U lind në Stamboll në vitin 1536. Ka qenë mësues dhe këshilltarë i dy sultanëve, Muratit të III (1574-1595) dhe djalit dhe trashëgimtarit të tij Mehmetit III (1595-1603). Ka qenë edhe Shejhu-l-islam, në moshë të shtyrë. Vdiq në Stamboll, në vitin 1590. Ky është autor i veprës njohur *Taxhu-t-tevarih*. Shih: *Enziklopedie des Islam*, II, s.1034-5.

⁸ Për Koxha Husejnin, të njohur me llagapin Muerrih, dimë fort pak. Ky është i lindur në Sarajevë, ku i shërbentë babai si rojtar i bibliotekës Gazi Husrev Beg. Në vitin 1636, Husejni gjendet në përcjellje të sultan Muratit IV në ekseditën për Bagdad. Në karrierën e tij arriti të bëhet reis-l-kutab, kryeshef i zyrës së sultanit. Vdiq në

ofron si fakt, se Sulltan Murati e ka prit gjallë lthimin e princit Bajazid, i cili kishte shkuar ta ndjek kundërshtarin në arrati, që në biseden e drejtpërdrejtë ia dorëzoi pushtetin perandorak. Kjo shpie në përfundimin se disa burime të vjetra, me të cilat është shërbyer Bitlisi, me kohë janë zhdukur dhe janë bërë të panjohura.

Duke e vazhduar punën e nisur të informimeve për shkrimet e ngjarjeve të rëndësishme nga veprat e Bitlisit, atyre që kanë të bëjnë me historinë e popujve ballkanas, këtu e japim në përkthim shkrimin për Betejën e Kosovës, duke i lënë vende-vende vetëm ato pjesë të tekstit që paraqesin barrë të rëndë, një formë e stilit mesjetar oriental, me të cilin shpesh janë shkruar edhe veprat shkencore, sepse ka qenë modë letrare e asaj kohe, por esencialisht nuk kanë ndikim në të kuptuarit e tekstit. Në këtë mënyrë kjo materie e rëndësishme historike do të bëhet më e afërt për historianët, që gjithsesi do të paraqes një kontribut për ndriçimin e asaj ngjarje.

Në faqen 337 të dorëshkrimit zagrebas të Hesht Beheshtit fillon shkrimi për Betejën e Kosovës kështu:

Dastan XVIII

Tregimi për ekspeditën më të madhe ushtarake të Sulltan Gaziut, në vendin në të cilin ishin tubuar shumica e sundimtarëve të vendeve të Rumelisë dhe të Evropës, për suksesin dhe fitoren e fesë së vërtetë dhe shkatërrimin e udhëheqësve pabesimtarë, për vdekjen heroike të sulltanit, pas fitores së plotë ndaj ushtrive dhe sunduesve pabesimtarë, për mënyrën se si e bëri vrasjen një rob pabesimtarë, pasi ishte arratisur ushtria e pabesimtarëve dhe tërësisht ishte shkatërruar blloku i kriminelëve.

Në një hadith të Muhammedit a.s. transmetohet, se ai është betuar në Zotin me fjalët: "Pasha Atë, në duart e Të cilit është shpirti i Muhammedit, dëshiroj të luftojë në rrugën e Zotit dhe të vritem, pastaj sërish të luftoj dhe sërish të vritem". Nuk është fshehtësi për ata që i kuptojnë edhe parashikimet e fshehta të fjalëve të Pejgamberit, si dhe për ata që kanë aftësi për t'u thelluar në fenomene psikologjike. Qëllimi më i lartë i ekspeditës së ushtrisë shpirtërore kundër ushtrisë fizike, kufizohet me frytin e njohjes hyjnore dhe përkryeshmërinë shpirtërore në botën e dukshme. Qëllimi përfundimtar i vendosjes dhe i kultivimit të fatëkeqit dhe fatëlumit, bazohet në grumbull-

vitin 1644. Deri vonë është menduar se vepra e tij Bada'iu-l-veka'i është humbur. Mirëpo, në vitin 1950 në koleksionin e dorëshkrimeve të fondit të Lenjngradit në Institutin për popujt e Azisë është zbuluar edhe vëllimi i dtë i historisë së tij që i kushtohet historisë perandorisë Osmane. Bashkëpunatori shkencor i Institutit, Anna Stjepanovna Tveritinova përgatiti për botim tekstin e posazbuluar të dorëshkrimit dhe e pajisi me një hyrje studioze prej 20 faqesh, dhe e botoi me faksimile në dy vëllime me titullin: Husejn, Bada'iu-l-veka'i (Udiviteljenie sobitija), Izdanie teksta, vvedenie i obscaja redakcija A.S. Tveritinovoj. Annotirovanoe o glavlenie i ukazatelji Ju. A Petrosjana, Moskva, 1961.

min dhe si
i nështrhe
e vërteta l
adhurojnë"
shoqërisë,
hije të Gji
bashkësia
dhe arritja
teve të dev
votshmëri.
dhe më të r
të gjitha de
fetare dhe
nuar te Zot
rore. Mirëp
shërbimit r
dëgjueshm
përcaktuar
vet". Gjith
në atë lutje
Argumenti
"Ata që lu
nderuar te
në të jenë
si të devot
mund të je
Zotit xh.sh
për punën
fetare, ata
në momen
hid është a
poet
Oj z
Sep

Për
mirat e kë
Zotit xh.sh
epsheve v
së, është a
S'ka dysh
është pran
Kjo është

min dhe sistematizimin e shoqërisë njerëzore nga individët në bashkësinë që i nështrohet vetëm Zotit. Argumenti për vërtetësinë e këtij pohimi janë fjalët e vërteta kuranore: "Edhe xhinët edhe njerëzit i kam krijuar vetëm të më adhurojnë". Mbase, nuk i ka hije të Fortit dhe të Gjithëdijshmit, rregullimi i shoqërisë, në të cilën, të gjitha pjesët e saj janë tërësisht të ndara; nuk i ka hije të Gjithfuqishmit rregullimi i marrëdhënieve njerëzore, në atë mënyrë që bashkësia të jetë e ndarë dhe e përçarë. Pasi, devotshmëria ndaj Zotit xh.sh. dhe arritja e trimërisë dhe e lumturisë, janë të varura nga plotësimi i kushteve të devotshmërisë ndaj Zotit xh. sh. dhe jetës së përditshme, në atë devotshmëri. Pa dyshim, secili njeri i lumtur, që i kryen obligimet më të mëdha dhe më të rëndësishme ndaj Zotit xh. sh. dhe kujdeset që përherë t'i plotësojë të gjitha detyrat e devotshmërisë, ai, do të bëhet i denjë për pozitë të lartë fetare dhe shtetërore; dhe kur ajo devotshmëri të jetë e përfilluar dhe e pranuar te Zoti xh.sh., do të arrij në shkallën më të lartë të madhësisë shpirtërore. Mirëpo, shkallët e lëvizjes në lartësi të ndryshme të devotshmërisë dhe shërbimit në rrugën e Zotit xh.sh., janë me vlera të ndryshme. Për secilën dëgjueshmëri dhe shërbim në rrugë të Zotit xh.sh., ekziston edhe shkalla e përcaktuar e vlerësimit të Zotit xh.sh. sepse: "Secila çështje të Ai ka vlerën e vet". Gjithsesi lutja që bëhet me trup dhe me zemër dhe shpirt të singertë dhe në atë lutje flijohet edhe jeta, e, edhe kjo botë, kjo të secili ngjall admirim. Argumenti për saktësinë e këtij pohimi madhështor, është fjala kuranore: "Ata që luftojnë në rrugë të Zotit me pasuri dhe me jetë, kanë vendin më të nderuar të Zoti, e mjafton Zoti për dëshmitarë". Për njerëzit, të cilët dëshirojnë të jenë të zgjedhur te Zoti xh.sh dhe, që kanë për qëllim të Ai të pranohen si të devotshëm të vërtetë. Është e qartë se asnjë vepër e devotshmërisë, nuk mund të jetë më e përkryer se lufta në rrugë të Zotit xh.sh. Asnjë shërbim për Zotin xh.sh. nuk mund të llogaritet më i denjë se sa flijimi vullnetar i jetës për punën e rëndësishme në rrugën e Zotit xh.sh. sepse luftetarët për çështje fetare, ata që ecin rrugës së vërtetë, e dinë se patjetër i pret flijimi i jetës që, në momentin e parë. Për këtë flet edhe hadithi i Muhammedit a.s.: "Muxhahid është ai që lufton vet me epshet e veta".

poeti thotë:

*Oj zemër, mos kërko dobi nga epshi për takim me personin që e do,
Sepse ndodhi e parë, në këtë takim, është dëm për jetën tënde.*

Përballë sakrificës së luftetarëve, në fushën e xhihadit, të gjitha të mirat e kësaj bote janë të pavlefshme. Është shumë e qartë, lufta në rrugën e Zotit xh.sh. për të me pabesimtarët dhe plangprishësit, është si lufta kundër epsheve vetiake. Qëndrueshmëria në rreziqe dhe në luftëra me armiqtë e fesë, është argument dhe konfirmim, se luftetarët vullnetarisht po sakrifikohen. S'ka dyshim se heroizmi është shahadetullëku, e kjo është shenjë e qartë se është pranuar xhihadi, flijimi i jetës dhe i pasurisë në rrugën e së vërtetës. Kjo është gjithmonë traditë e njeriut të lumtur te Zoti xh.sh., i Cili sheh të

metat më të fshehta njerëzore, i di fshehtësitë e zemrës dhe të shpirtit, lutje e cila është shumë e vlefshme dhe e çmuar. Shërbimin dhe veprat e këtilla Zoti xh.sh. ua përshkruan besimtarëve të sinqertë. Një sjellje e këtillë edhe te njerëzit që kanë dashuri të sinqertë ndaj Zotit xh.sh. është shumë e dashur.

Në poezinë vijuese thuhet:

Një ditë do të të pres me mirëseardhje, atje ku është pushteti i përherëshëm,

Sepse ti do të vdesësh duke korrur fitore mbi vetëvetën.

Në qoftë se të ndodh ndonjë e padëshiruar dhe sprovë, kënaqu

Sepse nganjëherë ndodh të hasish në vështirësi nga e cila nuk ka mbrojtje.

Mbase, përmes të mirës së përgjithshme dhe kësaj të mire të madhe, sulltanët osmanë dhe perandorët e besimtarëve të vërtetë, kanë përparësi ndaj perandorëve të tjerë në botë. Kjo është argumentuar qartë në shqyrtimet dhe theksimet e mëhershme. Për vlerën e plotë të xhihadit, lumturisë dhe sundimit në perandorinë e gjerë, flasin fjalët kuranore: "Atyre që kanë bërë mirë, u takon si shpërblim bamirësia, edhe më shumë se ajo". Në harmoni me këtë sqarim, në këtë "dastan" (poezi luftarake) do të tregohen lajmet për sulltanin muxhahid, Gazi Sulltan (Muratin). Esenca e gjithë referimit të hollësishtëm dhe baza për ta theksuar dhe për t'i dhënë përparësi dinastisë osmane ndaj të tjerëve është kjo:

Pa dyshim mëkëmbësi i Zotit xh.sh. me pozitë të lartë, e të merituar në tokë dhe i merituar të sundojë dhe të udhëheqë mund të jetë vetëm ai, i cili nga mirënjohja që i është dhënë dhurata e fuqisë dhe sundimit perandorak dhe nga mirënjohja për dhuntitë e fitoreve të përhershme, përgjithmonë qëndron në shërbim të Fesë islame, lufton për të dhe për të kujdeset; ai që ditë e natë kujdeset se si t'i udhëheqë punët, dhe kujdeset si t'u hakmerret armiqëve të Zotit xh.sh., duke heq dorë nga gjumi dhe pushimi. Sepse, të tregosh injorim dhe pakujdesi ndaj punëve të fesë dhe bashkësisë muslimane, e të jesh në pozitën e mëkëmbësit dhe sunduesit, do të thotë të jesh hije e madhështisë dhe forcës së Zotit xh.sh. është shumë keqë; të bjerrësh kot kohën e nevojshme për udhëheqjen e punëve të nevojshme, në argëtime dhe punë të ndaluar, për perandorin, është e padenjë dhe e mallkuar.

Duke menduar kështu, dhe pas konsultimeve me këshilltarët, dhe pas përgatitjeve të mjeteve të rëndomtë luftarake, dhe të rezervave, sipas dëshirës së Zotit xh.sh., pasi i kishte vënë nën sundim vendet e Shishmanit dhe ato ia kishte bashkëngjitur vendeve islame, dhe në përpjekje që t'u hakmerret sundimtarëve të tjerë pabesimtarë, të cilët treguan kokëfortësi dhe qëndrueshmëri - vendosi që t'i ndëshkojë. Njëri nga ata ka qenë Llazari, sunduesi i Serbisë, i cili ka pasë dhënë fjalën për besnikëri dhe dëgjueshmëri, por përsëri filloi të shfaq rrebelim dhe padëgjueshmëri. Të njëjtë ishin edhe mbreti i

Bosnës dhe Lala Shahinë. Përveç dosën për edhe ushtri me të siguri miqëve krye edhe asaj i kohe, nxitës dhe pabesimtarë e luftëtarë të ndëshkoj neveri nga sin e shpat llim, në vit verë të jetë brengë e v vetëm për shqetësim kishte pëp vetë në të fesë së Me

vendosur kalorësinë time, do t'ritetit të v miri është ushtarake, vehem pa dhe vende në rugën trimërinë

Sip mbi të gjithë ka takuan

Ati një e më për të nd nxitës i L bele dhe

Me sa du Osman.

Bosnës dhe sunduesi i Iskenderisë (Shkodrës) shqiptare, të cilët në luftën me Lala Shahinin i përgjakën duart me gjakun e 10 - 15 mijë trimave muslimanë. Përveç kësaj, u morën vesht për luftë kundër sulltanit musliman dhe vendosën për shkatërrimin e vendeve muslimane, e për këto kishin grumbulluar edhe ushtri. S'ka dyshim se edhe sipas ligjit dhe logjikës u bë e domosdoshme të sigurohet që të mos përsëritet sërish turbullira dhe rrebelimi i atyre armiqëve kryeneç.⁹ U zhvillua luftë e ashpër për pushtet dhe fe nga të dy anët; edhe asaj islame, edhe asaj të pabesimatrëve. Turbulluesi më i madh i asaj kohe, nxitësi kryesor i kryengritjeve, udhëheqësi i atyre popujve të mbrapsht dhe pabesimtarë u tregua Llazari. Zemrat e muslimanëve, sidomos të prisave e luftëtarëve muslimanë, kishte kapluar urrejtja, hakmarrja dhe dëshira që ai të ndëshkohet për të gjitha veprat e këqija dhe fjalët fyese. Ta largosh atë neveri nga dryri i zemrave të lënduara të besimtarëve, madje vetëm me çelësin e shpatës pushtuese të tyre. Sulltan Gaziu për këtë arsye dhe me këtë qëllim, në vitin e përmendur, e kaloi dimrin në qytetin e Plovdivit, që në pranverë të jetë më lehtë të nis ushtrinë në vendet e pabesimatrëve. Në atë dimër brengë e vetme ka qenë grumbullimi i materialit luftarak dhe preokupimi vetëm për ekspeditën e luftës. Llogorimi i sulltanit në Plovdiv shkaktoi shqetësim të të gjithë sunduesit pabesimtarë, sepse u pa qartë, se sulltani kishte përgatitur ushtri të madhe. Llazari për këtë arsye i dërgoi delegatët e vetë në të gjitha vendet e pabesimatrëve dhe i lajmëroi të gjithë sunduesit e fesë së Mesihut për ngjarjen që po përgatitej: "Padishahu i muslimanëve ka vendosur që ta shkatërrojë sundimin dhe autoritetin tim dhe ta shkatërrojë kalorësinë dhe ushtrinë time. Kur t'i marrë vendet e mija, të marrë pasurinë time, do t'u vij rradha sunduesve të tjerë dhe secili sipas pushtetit dhe autoritetit të vet do ta shijojnë dhembjen e pashërueshme dhe mjerimin. Më së miri është që ju të gjithë të bëni aleanc me mua dhe sipas mundësive të tuaja ushtarake të më ndihmoni. Sa më përket mua, unë me siguri do t'i kundërvehem padishahut musliman dhe shpresojmë që ushtrinë e tij ta shkatërrojmë dhe vendet e tija t'i pushtojmë, Rumelinë t'ia kthejmë përsëri krishterimit dhe në rrugën e fesë së zotit. Kësaj here me zemër dhe me shpirt, të tregojmë trimërinë"-kishte porositur Llazari.

Sipas autoritetit, respektit dhe forcës ushtarake, mbreti i Bosnjës ishte mbi të gjithë të tjerët. Atij sipas ceremonisë së fronit mbretëror dhe traditës, i ka takuar vendi i parë në mesin e sunduesve të krishterë.

Atij kjo armiqësi dhe gjakderdhje kundër luftëtarëve muslimanë, gjithnjë e më shumë ia ka forcuar urrejtjen ndaj tyre dhe e ka shtuar përpjekjen për të ndërmarrë masa për luftë. Mbreti i Bosnjës që nga fillimi ka qenë nxitës i Llazarit, për të mos u nënshtruar, të nisë kryengritje, për vepra rrebele dhe për shkaktimin e ngatërresave. Duke e parë këtë problem tregoi

⁹ Me sa duket autori mendon se princi Lazar ka treguar padëgjueshmëri ndaj sulltanit Osman.

qëndrueshmëri të madhe për arritjen e atyre dëshirave. Sidomos u bë i njohur për shkak të fitorës në luftën, në të cilën e shpartalloi ushtrinë e trimave musliman. (aludimi në betejën e Bileqës të vitit 1388). Prandaj, këta dy turbullues, komandantë të kalorësisë së pabesimtarëve, u bënë nxitës të sundimtarëve të vendeve të tjera për armiqësi dhe kryengritje kundër sultanit. Sundimtarët e Evropës, Hungarisë, Vllahisë, Shqipërisë, Bogdanskut dhe popujve sllavë, të cilët tani quhen polakë dhe çekë, të gjithë u treguan të gatshëmi (për luftë). Regjistruan ushtarë, rreth 200 000 njerëz të atyre viseve. Pasi përgatiti materialin luftarak tërësisht dhe ngriti flamurin e dhunës dhe të armiqësisë, që të tregoj shkëlqimin dhe forcën, Llazari dërgoi një të deleguar me përcjellje të sultanit në Plovdiv. Ai i shkroi letër sultanit me përmbajtje, e cila fliste për qetësinë dhe paqen. Por, qëllimi i tij ishte përplot tirani. Sulltanin e quan vëlla dhe gjithë tekstin e kishte shkruar me tonë vëllazëror, kështu: "Kam dëgjuar së vëllau im ka ardhur në kufi të vendit të vet dhe se ka për qëllim të përtërijë armiqësinë dhe luftën. Ne kemi përgatitur dhe grumbulluar mjetet e nevojshme luftarake që ta shkatërrojmë sundimin dhe forcën e juaj. Tash do të ishte trimëri që as vëllau im assesi të mos e injorojë grumbullimin e ushtrisë dhe materialin e përgatitur luftarak. T'i marrë të dy djemtë në luftë dhe asnjë shtetasi të vetë të mos i lejojë mungesë. Sepse edhe unë në këtë luftë do të vij me bijtë e mi dhe do t'i sjellë të gjithë ndihmëtarët e mi; prandaj (pas luftës), ose vëllaut tim t'i hiqet tërësisht gjallja për këtë anë dhe le të vendoset pushteti i fortë i një ane, ose rrënjën e tij, trashëgimtarët e tij dhe pasuesit nga toka Rumeli t'i çrrënjosim dhe t'i pastrojmë këto vise nga mësimet dhe ligjet e fesë së Muhammedit dhe t'i rregullojmë sipas rendit të vjetër.

Sulltani e pranoi të deleguarin e Llazarit, tregoi kujdes të madh për të, e pyeti shumë për Llazarin dhe bisedoi gjërësisht me të. Porosisë së Llazarit, sulltani iu përgjigj ashtu siç e kërkonin rrethanat: "Nëse lejon Zoti xh.sh. posa të jap pranvera shenjat e veta të ringjalljes dhe me ushtrinë e trandofilave dhe bozilokëve të shpartallojë ushtrinë armike të borës dhe të ftohtit, unë do të vij me ushtrinë muslimane dhe bijtë trashëgimtarë në Fushën e Kosovës që ta komandoj luftën më të ashpër me atë vëlla pabesimtarë dhe kusarë. Do t'ia plotësoj dëshirën atij mbreti të fuqishëm, ashtu siç është përcaktimi i Zotit xh.sh. Tani edhe vëllau im le të përpiqet si di dhe mundet ta shtoj ushtrinë e vetë; le të kërkoj aleatë, të cilët do t'i ndihmojnë qoftë me shpatë qoftë me këshillë; le ta përgatit ushtrinë kryeneqe si duhet dhe le të vij në mejdan. Me siguri do të ndodh ajo që është përcaktuar nga Zoti xh.sh. Gjithsesi çështja më e rëndësishme e komunitetit njerëzor, do të vendoset dhe do të zgjidhet në dobi të njerës anë". Ai pastaj delegatit i jep dhurata perandorake dhe e përcolli prap.

Pasi u kthye i deleguari, e lajmëroi Llazarin për takimin e tij me sulltanin duke i treguar për krenarinë, trimërinë dhe bindjen e sultanit në ndihmën e Zotit xh.sh. Në këtë situatë Llazari filloi grumbullimin e ushtrisë

dhe përgatiti për rezultat simtarë, u ngjarje të dhe fetar m ushtritë e trima dhe Bajazit, i shigjetë që ndriqon po Çelebiu, i Zotit xh.sh. ishte simbo gimtar të fa rendin dhe merre pjesë të gjithë be njohtoi të Isfendiarbeg nes, Mentese simtarë, të marrin pjesë krahinat që qytete i erd Anadulli dhe ushtritë e ty rimi, sulltan caktuar për ishte më e n mane. Mirë muslimane i pakalueshë

Duke pararojen e Jahshi Be rojen e përc me vndet e gjithë krahin madhe, dhe ve për t'u iku

Kur an gjakpirës që shigjeta hel

dhe përgatitjen e mjeteve të luftës. Të gjithë sundimtarët i njoftoi me shkrim për rezultatin e misionit të të deleguarit të vetë. Të gjithë sundimtarët pabesimtarë, u obliguan të vijnë në luftë. Ditë e natë ishin të shqetësuar për këto ngjarje të madhe, andaj nuk bënë gjumë të rahatshtëm. Sulltani largpamës dhe fetar menjëherë urdhëroi që ushtria muslimane të filloj përgatitjet, si dhe ushtritë e sundimtarëve të tjerë aleatë të tij. Ai i fton edhe dy bijtë e vetë trima dhe trashëgimtarë fatbardhë. Njëri nga ata ishte princi trim, pushtuesi Bajazit, i cili në syrin e armikut dukej si vetëtimë nga Lindja dhe si shpatë e shigjetë që sjellin fatkeqësinë, i cili në flakën e luftës luftoi si rrufe e cila ndriqon porsia meteor i flaktë e i ndritshëm. Trashëgimtari tjetër ishte Jakup Çelebiu, i cili në komandimin e ushtrisë ishte plot fat si flamur i ndihmës së Zotit xh.sh., ndërsa në takim me njerëzit, për shkak të bamirësisë së madhe ishte simbol i mëshirës dhe mirësisë së Zotit xh.sh. Sulltani këta dy trashëgimtar të fatbardhë i pat caktuar si mëkëmbës të tij në Anadoll, për ta ruajtur rendin dhe qetësinë në popull dhe në shtet. Pasi në këtë betejë duhej të merrte pjesë i gjithë populli i aftë për luftë, dhe pasi kjo luftë u bë brengë për të gjithë besimtarët, sulltani përkundër traditës, bijtë i solli në kamp dhe i njoftoi të gjithë sunduesit muslimanë përreth si: sunduesin e Kastamonit, Isfendiarbegun, sunduesin e Germijanës, Jakup Begun, sunduesit e Saruhanës, Mentesh ilin, Ajdin ilin, Hamid ilin, si dhe të gjithë sundimtarët pabesimtarë, të cilët kishin pranuar sovranitetin e sulltanit dhe ishin të obliguar të marrin pjesë në ekspeditat luftarake. Sulltani dërgoi fermanin në të gjitha krahinat që t'i ftoj në luftë. Në të vërtetë, shumë trima nga shumë krahina dhe qytete i erdhën në ndihmë ushtrisë muslimane. Nga të dy anët e detit, nga Anadulli dhe nga Rumelia, në kampin ushtarak të sulltanit arriten emirët me ushtritë e tyre. Posa arriti pranvera dhe koha u nxe, tokën e mbuloi gjelbërimi, sulltani dëshiroi të kaloj lumin Maricë dhe sa më shpejtë, në afatin e caktuar për betejë, të shpaloj flamurin e fitorës. Edhe pse ushtria e armikut ishte më e madhe numerikisht, ai vednosi ta nisë pararojen e ushtrisë muslimanë. Mirëpo, pasi lumi Marica kishte shumë ujë dhe ishte i ftohtë, ushtria muslimane nuk mundi ta kalojë. Ai lumë për shkak të vërshimeve ishte bërë i pakalueshëm dhe dukej sikur kishte bërë përmytjen e botës.

Duke pritur disa ditë pranë Pllovdivit, sulltani në shpejtësi formoi pararojen e ushtrisë muslimane, prej 5.000 luftetarëve të rinj nën komandën e Jahshi Begut, i biri i Timurtashit dhe të disa komandantëve trima. Pararojen e përcolli në drejtim të Shehirkojit (Pirotit), i cili në atë kohë ishte kufi me vëndet e pabesimtarëve. Ata kalorës të lehtë me shpejtësi kaluan nëpër të gjithë krahinën duke plaçkitur banorët nomadë dhe bujqit, fituan plaçkë të madhe, dhe sërisht me shpejtësi u tërhoqën dhe shpëtuan grykave të bjeshkëve për t'u ikur mashtruesve dhe sulmeve të pabesimtarëve.

Kur arriti ky lajmë te Llazari, nga zemërimi përgatiti 15.000 kalorës gjakpirës që t'ua mbyllin kalimet e rrezikshme luftetarëve muslimanë, që me shigjeta helmuese t'i shkatërrojnë kalorësit e paarmatosur muslimanë dhe

plaçkitësit, t'i nxjerrin robërit dhe në vend të tyre t'i kapin luftëtarët muslimanë dhe t'i lidhin. Mirëpo, fjalët (e Kur'anit) përmbajtja e të cilave është e vërtetë: "Mashtrimi i pabesimtarëve të shpie vetëm në lajthitje" u vërtetuan. Derisa pabesimtarët arritën në grykat malore, ushtria muslimane natën kreu sulmin dhe sikur era e agimit që bartë fletet e trandofilit dhe bozilokut, ajo zuri shumë robër e robërësha, ndërsa pabesimtarët nga ndërmarja e tyre përjetuan pendim dhe pikëllim. Kur u kthye ushtria fituese në kampin e sulltanit, sulltanit ia paraqiti gjithë plaçkën që e kishin fituar në atë ekspeditë. Natyrisht, pas kësaj ngjarje u krijuan shumë arsye për luftë. Nga pluhuri ngatërrestar dhe alarmi që u ngrit nga kontesti i luftës, arriti dhe përfundoi me luftën fyt për fyt. Sulltani u nis me ushtrinë fitimtare dhe vendosi kampin e tij në fushën e Ihtimanit. Kishte llogaritur se më së miri është të shpejtojë dhe sa më shpejtë të hyjë në luftë me armiqtë. Me ndihmen e Zotit xh.sh. hyjnë shtëpi për shtëpi për ta larguar armikun. Nga dy drejtime që çonin drejt qëllimit, njëri përmes Sofjes e tjetri përmes Konstantinit (krahina e Konstantin Dejanoviçit), sulltani e zgjodhi këtë të dytin, për shkak se Konstantini, sundues i krahinës e kishte njohur sovranitetin e sulltanit. Në kohën e këtyre ngjarjeve sunduesit pabesimtarë (që kishin njohur sovranitetin e sulltanit) nuk iu shmangën rrugës të nënshtruarve, por sipas rregullave të njohura u pajtuan t'i kryejnë urdhërat e sulltanit. Kur flamujt fitimtarë të sulltanit arriti te kufiri i vendit të tij, Konstantini dërgoi suiten e nderit që t'i shprehë respekt sulltanit me llojloj dhuratash për të dhe për anëtarët përcjellës të sulltanit. Në të gjitha qytetet, fshatrat dhe në tërë krahinën e tij i përgatiti mirëseardhje dhe në shenjë respekti sulltanit i ofroi lloj-lloj dhuratash e shpërblime perandorake. Vetë ai së bashku me ushtrinë, iu bashkangjiti sulltanit dhe ushtrisë muslimane. Këto shprehje respekti i pëlqyen shumë sulltanit, andaj edhe sulltani ndaj tij tregoi respektin perandorak dhe e shpërbleu shumë. Kur pabesimtarët dëgjuan se sulltani është nisur me ushtrinë muslimane dhe se ushtria e sulltanit është vendosur në afërsi të malit Rile (ريلىه), edhe pse sunduesit pabesimtarë nuk kishin qenë të papërgatitur as për nga numri i ushtrive as të mjeteve luftarake, sepse në taborrin e tyre u gjeten shtatë sundimtarë të fortë pabesimtarë, si dhe çeta të shumta të armatosura mirë. Kishte komandantë, si ndihmë Llazarit, nga sundimtarët e tjerë, megjithatë forca e fesë islame dhe frika nga forca e ushtrisë muslimane, e cila numerikisht nuk ka qenë as sa një e katërta e ushtrisë së pabesimtarëve, ndikuan shumë në zemrat e tyre dhe i shqetësuan. Sipas premtimit të vërtetë (ajetit kuranor): "*Ne futem frikën në zemrat e pabesimtarëve përshkak se janë politeist*", dhe në zemrat e tyre të errëta hyri plotësisht shqetësimi. Lajmi se sulltani është nisur në ekspeditë luftarake mori dhenë si stuhi dhe i shqetësoi shkëndiat fatëzeza. Zëri hakmarrës i luftëtarëve musliman ishte si ulurimë e tmerrshme e luanëve që shpartallojnë grumbullin e gomarëve ose shtazëve të imëta me klysh të tyre. Dasht e padasht, sunduesit pabesimtarë u detyruan të takohen për t'u këshilluar dhe për t'u marrë vesh për taktiken e luftës me

sulltanin m
më të dobi
argumente,
sulltanin. I
vogël, por
ishte num
sa do që s
e domosd
betejës, t'i
ndërsa me
së muslim
fanatizmin
vend kalin
fitore mbi
dhe dërgua
me mburrj
dorëzoi po
pushtim të
humbasësh
dhe te trim
fjalë të en
sikur rrezë
para emis
sulltanit k
frikësoj,
paturpësi,
ushtrinë r
shumë dhe
madhe e r
sasia e m
përparimit
kurrë nuk
Faleminde
numerikisht
që ecin r
emisarit p
Kosovë. I
shkatërrim
përcaktuar
mënyrën e
në ditën e
pari iu d
komandua

sulltanin musliman. Secili prej tyre mendimin e vet të gabuar e konsideronte më të dobishmin dhe më të domosdoshmin dhe për rezonimin e vetë sillte argumente. Disa shprehën mendimet se duhet menjëherë të hyhet në luftë me sulltanin. Niseshin nga ajo se ushtria muslimane, numerikisht ishte më e vogël, por numri i saj gjithnjë shtohet, ndërsa ushtria e pabesimtarëve, e cila ishte numerikisht më e madhe, për shkak të mungesës së gjërave ushqimore sa do që shtohet aq edhe zvogëlohet. Disa shprehën mendimin se është mëse e domosdoshme ta ndalin ushtrinë e vetë për të mos arritur në sheshin e betejës, t'i qortojnë muslimanët për vonesen dhe ikjen nga arena e betejës, ndërsa me dërgimin e emisarit të njihen me gjendjen dhe numrin e ushtrisë së muslimanëve. Në këtë mënyrë ata të pala muslimane do ta ndeznin fanatizmin fetar dhe sakrificimin heroik, do t'i bënin për vete dhe kështu në vend kalimet e ngushta dhe në kodrat, veshitë të kalohen, do të korrnin fitore mbi muslimanët. Përfundimisht vendosën të pranojnë mendimin e dytë dhe dërguan emisarin të sulltani. Duke e qortuar për ikje nga lufta i dhanë me mburrje dhe qortime porosi. Kur emisari pabesimtar arriti te sulltani ia dorëzoi porosin e pakëndëshme. Përveç të tjerash, kur thërret në luftë dhe në pushtim të vendeve pse vonohesh në sheshin e betejës; nëse nuk dëshiron të humbasësh kohën kot dhe t'i ikësh luftës, porosisin ata, në do të vijmë te ti dhe te trimat e tu t'u tregojmë zemrën e trimit dhe përvojën e luftës. Në këto fjalë të emisarit sulltani zemërohet shumë, nxorri shpatën, e cila shkelqeu sikur rrezet e diellit. Që të tregoj forcën, sulltani urdhëron rivistën ushtarake para emisarit të pabesimtarëve. Emisari pabesimtarë gjatë rivistës i tha sulltanit këto fjalë: "Në qoftë se kjo rivistë e ushtrisë ka për qëllim të na frikësoj, ushtria jonë numerikisht është më e madhe se e juaja". Në këtë paturpësi, mendjemadhësi dhe kundërvënie të emisarit, i cili krekosej me ushtrinë më të madhe të krishterëve dhe të injorantëve, sulltani zemërohet shumë dhe i përgjigjet: "Po të sillte numri fitore, përse ushtria numerikisht e madhe e mushkonjave dhe e mizave po i nënshtrohet erës lindore! Sikur sasia e materialit të luftës dhe mendjehtësia rinore të ishin shkak i përparimit të përhershëm, degët e hapura të kaqubës së bukur të trendafilut kurrë nuk do të shkatërroheshin nga era vjeshtore dhe sulmet dimërore. Faleminderit Zotit, që, ata të cilët janë në rrugën e vertetë, edhe pse numerikisht më pakë, ndërsa armiku më shumë, gjithnjë ngadhëjnë mbi ata që ecin rrugës së shtrembër..." Pas këtyre bisedave trimëruese sulltani emisarit pabesimtarë, i lejoi të kthehej dhe i tregoi takimin luftarak në Fushë Kosovë. Pas përcjelljes së emisarit gjithë kujdesin e përqendruan në shkatërrimin e armikut. Për fillimin e kësaj beteje të përgjakshme ishte përcaktuar afati. Sulltani filloi të këshillohet me këshilltarët dhe trimat për mënyrën e taktikës së luftës dhe rradhitjen e aradhave luftarake dhe çetave në ditën e betejës. I ftoi të gjithë komandantet në mbledhje te sulltani. Së pari iu drejtua Evrenos Beut: "Ti ke fituar në beteja me armiqtë, ke komanduar luftën kundër të gjithë pabesimtarëve, andaj çka mendoni, në

g'mnyrë duhet të luftohet me armiqtë e fortë të këtillë"? Evrenos Beu u përgjigj: "Pasi koha dhe vendi për luftë me pabesimtarët janë afruar tani duhet, sa të është e mundur më shpejtë të nisemi për në sheshin e luftës dhe të zëmë pozitën që është më e mira. Në konfliktin me atë ushtri në ditën e betejës duhet filluar me dinjitet dhe qetë, shkallë - shkallë të kalohet në sulm, sepse ushtria e pabesimtarëve është e rënditur në radhë lufte si kodër hekuri, sikur diga nga hekuri i fortë. Fitorja ndaj çetave dhe aradhave të tyre nuk është e sigurt paraprakisht; nuk është assesi lehtë të shkatërrosh digën e hekurt me një të rënë shpateje. Mirëpo, pasi disa nga ata mendojnë se do të thyhen disa aradha të tyre pikërisht nga ndikimi i ushtrisë (osmane), vendosmërisë së saj në luftë, me ndihmë të Zotit xh.sh. humbja e tyre është e paevitueshme". Rezonimi i këtillë sulltanit dhe të gjithë titullarëve të tjerë muslimanë iu duk i drejtë. Në bazë të kësaj sulltani vendosi dhe urdhëroi që ushtria në mëngjes të niset. Për pararojë me disa ushtarë musliman u caktua Evrenos Beu dhe Jigit Pasha, të cilëve iu caktua për detyrë që të sigurojnë rrugën e cila shpiente përmes grykës. Kur të lartpërmendurit arriten në grykën, nëpër të cilën duhej të kalonte ushtria, aty qëndronin tridhjetë titullarë pabesimtarë - mbrojtës të grykës dhe secili me kujdës vëzhgonte kundërshtarin. Evrenos Beu ka qenë më i vendosuri nga të gjithë që armikun ta shfarosë. Nga ana e kundërt, po ashtu u lajmëruan disa kundërshtarë trima. Kur në mes tyre filloi lufta, Evrenos Beu, që ishte i ushtruar mirë në gjuajtjen e shigjetës e nxorri shigjetën dhe e qëlloi armikun në gjokës. Shigjeta e përbiroi dhe ai menjëherë u rrëzua për tokë i vdekur. Pas këtij u paraqit tjetëri pabesimtarë. Edhe ky për një qast ra i vdekur. Arritën edhe trimat e tjerë. Me ndihmen e muxhahidëve rrëzoi për tokë tetë pabesimtarë, e të tjerët ikën. Robërit i sollë para sulltanit dhe iu bashkëngjijtë pararojës. Kështu, ky kalim i rrezikshëm u bë i kalueshëm për muslimanët. Në mënyrën më të lehtë kaluan përmes kësaj gryke të rrezikshme. Pastaj, duke kaluar përtej lumit Morava me tërë përcjelljen vendosë kampin në një vend të përshtatshëm. Luftëtarët para syve të armiqtëve demonstironin trimëritë. Kur sunduesit pabesimtarë panë pozitën e ushtrisë fituese muslimane filluan t'i nënqmojnë dhe t'i përqeshin. Secili e lavdëronte vetveten dhe premtonte fitore në sheshin e betejës. Kështu, Vuk oğlu, i cili ishte djalë motre i Llazarit edhe me trimëri a edhe me numër të ushtarëve, njëri nga anëtarët e këshillit të sundimtarëve të krishterë, në të cilin këshill gjendeshin edhe sunduesi i Bosnjës, i Shqipërisë, komandanti suprem i forcave evropiane, pastaj komandantët kryesor të Bogdanskës, të Vllahisë, të Hungarisë, u besatua se në ditën e betejës, që në fillim vetë me ushtrinë e tij do ta sulmoj sulltanin. Llazari në Këshillin e lart deklaroi: "Kush e kap padishahun musliman e konsideroj të denjë për t'ia dhënë vajzën time dhe dhjetë këshijtjella me lokalitetet përcjellëse (tevabi)". Sunduesi i Bosnjës për këtë tha: "Unë ia jap pesë këshijtjella me rrethinat", dhe secili nga sunduesit pabesimtarë në këtë rast u obliguan për shpërblime. Ushtarët e vet i ngriten

në shkallët i
motivojnë pë

Gazi S
të vëzhgojë
pozicionin e
hudhën shik
grumbull me
dhe hetuan
deklaroi: "Ne
bullojmë një
luftarake pë
me atë armi
përafërta të
të ushtrisë së
Kjo zgjoi m
për planin d
ushtria e pab
së tyre të ç
radheve të d
luftë. Kur ku
të ikin anash
shpinën pab
detyrë e trim
tesha të hek
shpinës.

Sullta
mbyllur me
deroj Zotin.
gjithmonë
shtetit. Asn
mesh, por k
Cili gjithm
sekreti i Zo
me bekimin
gajb) të hap

Kjo d
madhe sullt
Atëherë me
sulltani kërk
me ushtri,
rradhitën p
që të pritët
sigurt se ed

në shkallët më të larta të hierarkisë ushtarake, pozita komanduese që t'i motivojnë për luftë dhe trimëri.

Gazi Sulltan (Murati) me princin Bajazit, doli në një kodër të lartë, që të vëzhgojë ushtrinë armike dhe të vlerësojë numrin e ushtarëve dhe pozicionin e saj. Ata vlerësuan numrin e ushtarëve dhe armatimin e tyre. Kur hudoën shikimin kritik në atë masë dhe në atë forcë ushtarake, vërejtën një grumbull më të madh se grumbulli i insekteve dhe zvarrënikëve të shkretinës dhe hetuan një pamje trishtuese, më trishtuese se nata e errët. Sulltani deklaroi: "Ne kosiderojmë se kemi bërë përpjekje të mëdha që të grumbullojmë një ushtri të madhe dhe të përgatisim mjete të jashtëzakonshme luftarake për në sheshin e betejës. Mirëpo, ushtria muslimane në krahasim me atë armike është sikur planetet përballë yjeve. Sipas vlerësimeve të përafërta të sulltanit dhe antërëve të këshillit perandorak, numri i ushtarëve të ushtrisë së pabesimtarëve ishte pesë herë më i madh se i asaj muslimane. Kjo zgjoi mendimet e tyre për luftë. Zhvilluan bisedime dhe u konsultuan për planin dhe radhitjen në ditën e betejës. Disa më me përvojë deklaruan se ushtria e pabesimtarëve ka kuaj që ikin nga devet, sepse i frikësohen pamjes së tyre të çuditshme, prandaj para ushtrisë duhet të rënditen devetë. Pas radheve të deveve, duhet të rënditen kalorësit dhe këmbësoret të gatshëm për luftë. Kur kuajtë e ushtrisë së pabesimtarëve të trembur nga devet, të fillojnë të ikin anash, është e sigurt se të gjithë do të ikin nga lufta. Po sa ta kthejnë shpinën pabesimtarët, ushtarët tonë le t'i ndjekin dhe të kryejnë atë që është detyrë e trimit. Pasi pabesimtarët nga koka deri në thembër janë të veshur me tesha të hekurta, të gjithë do të vdesin në qoftë se i rrahim me shkopinjtë shpinës.

Sulltani iu drejtua Bajazitit: "Çka mendon ti, si do ta hapte këtë rezë të mbyllur mençuria jote?" Princi (Bajaziti) babës së vetë iu përgjigj: "Falenderoj Zotin, që në rrugën e fesë, që moti (nga babai te i biri) kemi luftuar dhe gjithmonë me ndihmën e Zotit kemi fituar ndaj armiqëve të fesë dhe të shtetit. Asnjëherë në sheshin e luftës nuk jemi shërbyer me kësi mashtrimesh, por kemi qenë nën mbrojtjen e Zotit dhe nën ndihmën e Fisnikut, i Cili gjithmonë ndihmoi të mundet armiku. Edhe tani mund të shpresojmë se sekreti i Zotit do ta ruaj ushtrinë muslimane nga të këqijat e armikut dhe se me bekimin e Muhammedit e me dorën e trimave të padukshëm (merdani gajb) të hapen dyert e fitorës.

Kjo deklaratë trimëruese e princit Bajazitit ishte përkrahje dhe ndihmë e madhe sulltanit, dhe ky e uroi duke i dëshiruar jetë të gjatë dhe lumturi. Atëherë me të njëjtën pyetje i drejtohet vezirit - Ali pasha. Pas Ali pashës, sulltani kërkoi këshilla nga Timurtash Beu. Pasi ai e njihte mirë komandimin me ushtri, në këtë u përgjigj: "Edhe pse duket me vend plani që devetë të rradhiten para ushtrisë së tyre dhe kuajve për t'i friksuar, megjithatë, sa do që të pritët se kuajt e tyre do të frikësohen dhe do të ikin anash, një është e sigurt se edhe devetë do të frikësohen dhe do të ikin të trembura nga ushtarët

e veshur me rroba hekuri dhe nga krisant e mëdha të pushkëve dhe të topave të tyre. Në qoftëse, ruana Zot, fillojnë devetë të ikin, me siguri ato do të kthehen prapa dhe në këtë mënyrë do t'i shpartallojnë radhet e ushtrisë muslimane. Nëqoftë se në ndërkohë, papritmas, i drejtohen arenës dhe radheve ushtrake armike, gjithsesi do të pendohemi për shkak të rradhitjes së tillë strategjike dhe nuk do të kishim gatishmëri luftarake. Në atë luftë do të na dilte nga dora kontrolla"

Shkurt, të gjithë anëtarët e Këshillit perandorak vendosen të niseshin në luftë gjoks për gjoksi dhe në ditën e dytë, sipas traditës, u nisën në luftë. Atë natë, në prag të agimit, kur u vendos për fillimin e luftës dhe kur flamujt e ndritshëm musliman, u ngritën dhe shkëlqyen para ushtrisë pabesimtare, sulltani u thellua në mendime se si ta largojë dhe ta shkatërroj këtë kryengritje të madhe kundër pushtetit dhe fesë dhe të përgatit mbrojtjen nga sulmet e pabesimtarëve. Në terrin e natës sulltani i ndritur kërkoi shpëtim nga terri i mërziës. Nga ajo valë e cila u ngritë nga thellimi në mendime, vetëdija e tij gjeti shpëtim në anijën e lutjeve drejtuar Zotit xh. sh. Mirëpo, një natë nga erërat e ftohta të ngatërsesës dhe pluhurit të madh të hapësirës së kohës u paraqitën gjurmat e territ të dëshprimit. Mërzia, për shkak të numrit të madh të ushtrisë armike ndikoi që në zemrën e sulltanit të bie pluhur. Dyert e bisedimeve u mbyllen me dryrin e heshtjes në vetmi. Për këtë ishte shumë i hutuar. Sepse dita e nesërme e betejës do të kërkoj që nga shtrëngata, e cila atë natë kishte filluar të fryjë dhe nga terri i vranësirave që ishin shtrirë në fushën e urrejtjes dhe hakmarrjes, të valojë flamuri i fitoresë dhe lumturisë së muxhahidëve dhe do të jetë shkaktare që të valojë flamuri i Fesë Islame para syve të miqve. Me këtë brengë sulltani u drejtua kah xhamia nën mbrojtjen hyjnore dhe me fytyrë të përvuajtur në sezhde, duke u lutur sinqerisht për shpëtim nga humbja dhe shkatërrimi dhe për udhëzim se si të arrihet qëllimi përfundimtar dhe dëshira, fitorja e trimave për fe, dhe pabesimtarët të mbesin duarthatë dhe të nënçmuar në armiqësinë dhe në hakmarrjen e tyre. Atë natë të errët ai u vetmua në tendën e vetë, me dorë të vetë mbylli derën e mvarshmërisë trupore dhe luksit perandorak. Pjesët e jashtme të trupit i zbukuroi me pastërti sikur që është pastërtia e zemrës së ndritur e besimit të tij.

Pas faljes së namazeve të parapara dhe atyre vullnetare i shtrini dhe i zgjati duart, duke iu drejtuar me lutje mëshirës së Zotit me fjalët: "O Zot, Ti je sundues, në të cilin mbështeten të gjithë robërit, pabesimtarët dhe muslimanët, Ti je strehim i njerëzve në gëzim e hidhërim, në mjerim dhe në lumturi. Miqve mos ua shkurto mëshirën Tënde, dhe sikur që gjithmonë ke ofruar, tregoje mëshirën Tënde ndaj këtyre besimtarëve të shqetësuar. Mundëso që të ngriten flamujt e të vërtetës islame në hapësirën e fitoresë, merre nën mbrojtjen Tënde ushtrinë shpirtërisht të rraskapitur dhe të paafitë dhe mbroje atë nga e keqja e armiqve të vrazhdë. Gjithë dituria Jote përfshinë edhe shërbëtorin e mjerë, të cilit ia ke caktuar për detyrë që t'i shërbej fesë dhe të cilin e ke bërë komandant të kalorësisë muslimane që çdokund dhe

gjithmonë të vendet, ndër dimtar dhe perandorak i mmedit a.s. e fesë islam hemi këtyre periudhën e grup kaq i në të lashtë nuk

Për ku

i madh nga r mijëshit dhe në mes të dy pluhur. Për e tar nga ai m dhe u friksua erërat fryjnë fortë; dhe si ushtrisë vare shme i ofron sulltani zgja te Atë t'i lar O Zot, në en Sheriatit dhe bërë fytytrat pikëllo fytyr të besimit të gojnë me re xh.sh. është atje ku është respekti Ju cili konsider gosur dhe z ushtrive luft cili me vite tarëve në me kompenzimi mos e ç'vesh hudh flamur Deri s ritmas, e mo ti. Për shka

gjithmonë të kryej obligimin luftarak dhe që në secilën ekspeditë t'i zgjeroj vendet, ndërsa pabesimtarët dhe mendjemëdhenjtë përuli. Si qëllim përfundimtar dhe dëshirë kam pasur arritjen e kënaqësisë Tënde dhe nga ky fron perandorak kam menduar në plotësimin dhe ndjekjen e mësimëve të Muhammedit a.s. I vetmi qëllim në këtë ndërmarrje është që të ngritim autoritetin e fesë islame dhe se për të mirën dhe interesin e përgjithshëm t'i kundërvehem këtyre idhujtarëve. Ka kaluar kohë e gjatë nga shekujt e kaluar në periudhën e mbretërisë muslimane se në asnjë betejë nuk ka marrë pjesë grup kaq i madh i armiqve të fesë dhe kurrë e askund sytë e ndritur të qiellit të lashtë nuk kanë parë konflikt të tillë në mes të vërtetës dhe të pavërtetës".

Për kundër faktit se numri i ushtrisë së armiqve të fesë ishte shumë më i madh nga numri i luftëtarëve musliman, mbase dallim më i madh se në mes mijëshit dhe qindëshit, hapësria e vendosjes së ushtrisë dhe e sheshit të luftës në mes të dy ushtrive në konflikt ka qenë hapësirë me terren të butë dhe me pluhur. Për shkak të pluhurit të madh nuk mund të dallohej ushtari pabesimtar nga ai musliman. Për këtë sulltanin e përfshiu pluhuri i këtij shqetësimi dhe u friksua mjaft; sepse lufta është e lehtë në një ditë të tillë me pluhur, kur erërat fryjnë nga ana e kundërt dhe janë të pafavorshme, pranë ushtrisë më të fortë; dhe sipas përvojës të ushtarëve me përvojë, përparësia dhe fitorja e ushtrisë varet edhe nga era e favorshme. Ushtrisë së krishtere, erërat e favorshme i ofronin forcë dhe siguri. Për shkak të kësaj situatë të disfavorshme sulltani zgjati duart dhe i bënte lutje Zotit, me përulje dhe me lot në sy e luste Atë t'i largojë këto të padëshiruara dhe t'ia plotësoj dëshirat dhe nevojat: "O Zot, në emër të respektit të krijesës tënde fisnike dhe në emër të bekimit të Sheriatit dhe të atij të dashurit dhe të mikut Tënd, në sheshe të luftës mos i bërë ftytrat e këtyre luftëtarëve në rrugë të Zotit të shqetsuara dhe as mos i pikëllo ftytrat e ndritura të këtyre luftëtarëve të armatosur të së vërtetës dhe të besimit të fortë, as ballin e ndritur në këtë arenë lufte. Në qoftë se i vëzhgojnë me respekt e kujdes e lartësoj me fitore! Edhe pse pavarësia e Zotit xh.sh. është më e madhe se forca e pabesimtarëve mbi atë të besimtarëve, atje ku është pavarësia dhe madhështia, vallë a mund të pritët vështrimi dhe respekti Juaj ndaj besimtarëve? Këtë robë të paafte dhe të mjerë të Zotit, i cili konsiderohet se sundon mbi shumë njerëz, i cili gjithmonë është i brenjosur dhe zemërthyer, kur i ke caktuar për detyrë komandimin ndaj kaq ushtrive luftarake, këtë të edukuar nga mëshira e Jote në mesin e njerëzve, i cili me vite bartë titullin e lartë 'gazi' (heroj) dhe luftetarë kundër pabesimtarëve në mesin e muslimanëve, tani në këtë kohë vendimtare sakrifikojë për kompensimin e muslimanëve (fidayi muslimin). Sipas rregullit dhe ligjit mos e ç'vesh nga mëshira e kahmotshme e Juaj, jepi rastin të flijohet. Mos e hudh flamurin musliman kësaj radhe me përbuzje në tokë".

Deri sa sulltani në atë natë të errët me lutje i drejtohej Krijuesit, papritmas, e mori në një çast gjumi dhe shpejt e lëshoi kokën në gjunjë dhe flejti. Për shkak të zemrës së pastër dhe bindjes së sinqertë iu hapen dyert e

fshehtësive; për shkak të sinqeritetit, karakterit gazmor dhe dashurisë së pastër shpirtërore, në një moment shikimi i tij u drejtua në botën shpirtërore dhe pa se si një engjëll zbriti nga qiejt, me siguri ai ka qenë engjëlli që i janë besuar të reshurat ose engjëlli është caktuar për punë të tjera të rëndësishme dhe i tha sulltanit: "Lutjet tua të janë pranuar te i Lrtmadhërishti; kërkesat tua në të gjitha nivelet tërësisht janë miratuar". Sulltani në këtë ëndërr (me këtë përmbajtje shpirtërore) nga madhështia e Zotit dhe gëzimi që kishte arritur atë që kishte dëshiruar, u zgjua nga gjumi dhe pastaj tërësisht iu dorëzua Zotit. Kur u zgjua dhe i hapi sytë e pa se pjesërisht dëshirat e tij që i kishte drejtuar me lutje tani ishin realizuar. Qielli nga dhëntia e Zotit filloi të sjell shi, i cili tërësisht e largoi pluhurin e bregave të frikës që kishin përfshirë zemrat dhe shpirtërat. Sulltani u bind se lutja e tij që ishte pranuar në atë që kishte kërkuar është shenjë e lumturisë dhe pjesë e asaj ëndrre të këndëshme, dhe se kto janë hapat e parë të fitores, është argument i realizimeve dhe të arriturave të qëllimit përfundimtar të të gjithëve (besimtarëve).

Në mëngjes sulltani doli nga tenda dhe ngrii flamurin e shkëlqyeshëm luftarak. Fusha e betejës ndriqohej nga vizllima e shigjetave dhe shpatave të të dy palëve ndërluftuese, ushtritë e të cilave ishin radhitur në radhë lufte, të vendosura t'i provojnë forcat në luftë dhe njëra tjetrën ta asgjësojnë. Në mbremje, në prag të fillimit të betejës, sunduesit e armiqve, në mesin e të cilëve gjendeshin shtatë sundues me autoritet, u takuan në mbledhje dhe e analizuan gjërësisht mënyrën e udhëheqjes kundër ushtrisë muslimane. Ata, sipas traditës së vjetër të pabesimtarëve, përgatitën solemnitet me alkool dhe në mungesë të plotë, a të pjesërishtme të vetëdijës, bsideuan njëri me tjetrin dhe u konsultuan për luftë. Lazoviqi (Lasoglu)¹⁰, i cili u dallua në mesin e tyre me seriozitetin e të rezonuarit dhe të planifikimit, dhe i cili sipas rangut ishte më autoritativ dhe më i rëndësishmi, në të njëjtën natë, kur gazi sulltani në vetmi ishte drejtuar me lutje Zotit, ai u këshillua me udhëheqësit e mashtruar tjerë të pabesimtarëve kështu: "Propozoj që sonte ta sulmojmë ushtrinë muslimane. Ushtria e tyre në krahasim me tonën, është më e vogël, natën duhet t'i hutojmë dhe t'i shpërndajmë". Shumica e sunduesve pabesimtarë e konsideruan të drejtë këtë rezonim të gabuar të tij dhe të gjithë u pajtuan me këtë. Vetëm njëri nga ata shtatë shtetarët pabesimtarë me emrin Jorgi *جورگی*¹¹, i cili komandonte ushtrinë me 50.000 ushtarë, duke u

¹⁰ Bitlisi, sikur edhe paraardhësit e tij Urukh b. Adil dhe dervishi anonim i Edrenes, Lazarin më së shpeshti e quan gabimisht Lazoglu (d.m.th. Lazoviq), e në disa vende e shënon korrekt Las. Ashtu vepron edhe Saduddini, i cili Bitlisin e ka pasë shembull-model.

¹¹ Tash për tash nuk dihet se kush do të ketë qenë Jorgi, i cili sipas Bitlisit ka komanduar një ushtri prej 50.000 vetash. Shihet, pra, vetëm ajo se ai ka qenë personalit i fuqishëm. Këtë e përmendin me të njëjtën formë edhe Saduddini dhe Koxha Husejni. A Olesnicki, i cili në studimin e përmendur, shih fusnotën nr.1. ka shfrytëzuar 168

mbështetur
sulmonim
shpëtonin
bjeshtë dhe
dreke për
egërsirën

Për s
të pakujdes
shtyjnë fil
komandant
Llazoviqin

shoqërie të
trinë qendr
shumti lav
pabesimtar
majtë të us
rë, shqiptar
rrësit e mal
manë. Trin
kak të të d
rruar gotat
thë udhëhe
rëve të vetë
aq largë sa

veprën e Ne
komandant i
të cilët e lex
1949.

¹² Në ekzempl
atribut për e
mit të kësaj
veçant, për
shtere. Shih:
rih, xhild-i
1961, list 84

¹³ Bitlisi, e s
misht, e qua
kaq, Neshri,
has kësaj për
vëllau apo m

¹⁴ Këtu del
njërin anë, o

mbështetur në nurmin e suitës dhe shërbyesve, në atë këshillim tha: "Sikur të sulmonim natën nën mbrojtjen e territ të natës, shumica e muslimanëve do të shpëtonin nga asgjësimi, robërimi dhe nga shpata hakmarrëse, duke ikur në bjeshkë dhe djerrina. Kjo ushtri e mjerë e muslimanëve është vetëm një shujt dreke për këta peshkaqej të Detit të Zi. Përse me duart tona të lëshojmë egërsirën nga kurthi të kërcenj dhe të shpëtoj!?"

Për shkak të vetëbesimit të madhe mashtrues në numrin e ushtrisë dhe të pakujdesisë së madhe, paditurisë dhe mos nënshtrimit caktimit të Zotit, e shtynjë fillimin e betejës deri në mëngjesin e ditës së ardhshme, e për komandant të ushtrive në të gjitha pozitat caktuan nga një sundimtarë të tyre. Llazoviqin të egërsuar (لاسل اوغلي), i cili ishte sundimtari më autoritativ i asaj shoqërie të mallkuarish dhe të mashtruarish, uninimisht e caktuan në ushtrinë qendrore.¹² Vukoviqin, i cili ishte djali i Llazarit (!) dhe i cili më së shumti lavdërohej për trimëri, e caktuan në krahun e djathtë të ushtrisë së pabesimtarëve.¹³ Mbretin e Bosnjës Levent Ogllin e caktuan në krahun e majtë të ushtrisë së atyre vendeve.¹⁴ Udhëheqësit hungarezë, vllahë, bullgarë, shqiptarë dhe çek, në të dy anët fatzeza. Të gjithë ziliqarët dhe hakmarrësit e mallkuar i pinë gotat e verës me dëshirë dhe të etur për gjakun muslimanë. Trimërinë e rrejshme dhe krenarinë, e cila trotullohej në kokë përshkak të të dehurit, pozitës dhe pushtetit, e të cilën e shprehnin duke i cakërruar gotat e verës, konsideronin se është aftësi e vërtetë dhe trimëri. Të gjithë udhëheqësit pabesimtarë a premtuan me kryelartësi shërbëtorëve, ushtarëve të vetë, të paafitëve dhe fëmijëve robërit dhe plaçkat muslimane. Shkuan aq largë sa që vendosën që secili kalorës të përgatit litarin e fortë për lidhjen

veprën e Neshriut, ekzemplarët e Vienës dhe të Parizit, ku thotë se Juga ka qenë komandant i 9000 ushtarëve, me çka përmirson gabimin e Behnauerit dhe të Brliqit, të cilët e lëxonin këtë numër 900.000. Shih: Neshri, Kitab-i xhihan numa, I, Ankara, 1949.

¹² Në ekzemplarin e dorëshkrimit që kemi në të Hesht behesht, fjala "argun" vjen si atribut për emrin e Lazarit, kurse Saduddini për të cilin kemi thënë se gjatë përshkrimit të kësaj ngjarje është mbështetur te Bitlisi, këtu përmend Argunin si një person të veçant, për të cilin thotë se ka qëndruar përkrah Lazarit, në qendër të ushtrisë krishtere. Shih: Neshri, Kitab-i xhihan numa, I, Ankara, 1949; Saduddin, Taxhu-t-tevarih, xhild-i evvel, Istanbul, 1862-3, s.120; Husejn, Badayi' u-l-vakayi', I, Moskva, 1961, list 84a.

¹³ Bitlisi, e sipas tij edhe Saduddini, si edhe Koxha Husejnit Vuk Brankoviqin, gabimisht, e quajn Klkoglu (Vukoviq) dhe thonë se është nip i Lazarit, nga motra. Ndërkaq, Neshri, Vuk Brankoviqin me të drejtë e konsideron dhëndër të Lazarit, por krahas kësaj përmend edhe personalitet (emrin e tij nuk e përmend) si nip të Lazarit nga vëllau apo motra (yegen).

¹⁴ Këtu del në pah dallimi ndërmjet rrefimit të Bitlisit dhe të Koxha Husejnit, në njërin anë, dhe të Neshriut dhe Saduddinit në anën tjetër.

e robrit, pasi t'i kapin luftëtarët musliman t'ua shesin me çmim të lartë evropianëve (mardumi farangistan) dhe që me ato para të blejnë gota dhe në kokteje nga ato të pijnë.

Njëri nga ushtarët e tyre që ishte i njohur si shakaxhi, me shakat e zgjedhura në shoqërinë e sundimtarëve të popullit të vetë, tregonte shaka dhe mprapshti të ndryshme. Në lidhje me përgatitjen e madhe të litarëve dhe mjeteve të tjera për kapjen e muslimanëve, ai në tubim thoshte: "Në bazë të asaj që shumëherë kemi parë dhe që jemi bindur, si dhe në bazë të asaj që sa herë e kemi dëgjuar nga njerëzit që i transmetojnë dhe i komentojnë ngjarjet e mëhershme, e dijme se ushtria osmane për shkak të guximit dhe të trimërisë përherë i ka lidhur me zingjir dhe litar njsitë e robëruara të pabesimtarëve (tavaifi kuffar). Njerëzit kurrë nuk i kanë parë luftëtarët osmanë në prangat e pabesimtarëve. Për këtë nuk është çudi që vetë po i thurni litarët për shkatërrimin e juaj".

Ushtria e sultanit, sipas radhitjes tradicionale nga lufrat e tjera, përcaktoi radhitjen në batalione. Të dy bijtë e sultanit, emirët dhe komandantët e tjerë (erkanë) u radhitën në secilën çetë luftarake që t'ia hapin derën fitores. Çaushët qëndruan në anën e majtë dhe të djathtë të radhëve, ndërsa komandantët shpalosen flamujt me ngjyra. Sulltani në qendër të ushtrisë ngriti flamurin e luftës. Anën e djathtë e zbukuroi me yllin fatlum dhe flamurin e perandorisë, me pasardhësin e vetë fisnik Jëlldërim Bajazidin, si dhe me disa emirë siç ishte Saruxha pasha e të tjerë. Në anën e majtë e vendosi djalin tjetër Jakub Çelebiun me disa emirë të tjerë, sikur që ishte Inxhexhik Ballabani dhe Tivuxh Ballabani. Gazi Evrenos Begun e vendosi në krahun e djathtë para atyre muxhahidëve besnikë. Ejne beg Subashin, i cili ishte njëri nga emirët e mëdhenjë e caktoi në krahun e majtë që u ngriste moralin ushtrisë.

Të gjithë i mori në fushëbetejë. Pushtetarët muslimanë (hukkami islam) ishin krenar që si përcjellje të sultanit u grumbulluan rreth qendrës së ushtrisë në afërsi të sultanit, sikur yjet e radhitur shkëlqyeshëm në Zodiak. Në anën e djathtë të sultanit si këshilltar (naibi sahib-i-ra'y) dhe dora e tij e djathtë i qëndronte në ndihmë veziri Ali pasha, ndërsa në anën e majtë ndihmës e kishte Timurtash begun, emir i rangut të lartë (emir-i ali mikdar). Ushtria jeniqere e armatosur me topa, me pushkë dhe me topa të mëdhenjë (kazganhaj-i ra'ada) e stabilizuar qëndronte para kalit të sultanit sikur rreshti i pijonëve, të cilët qëndrojnë si mburoj heroike e mbretëreshës dhe oficerëve (në tablen e shahut), dhe kështu në pararojën ushtarake kishin formësuar murin mbrojtës, të cilin as elefanti mamut nuk do të ishte në gjendje të kaloj nëpër atë rend të ushtrisë së blinduar.¹⁵ Sulltani i luftëtarëve muslimanë e

¹⁵ Këtu autori aludon në sultanin gaznevij Mahmud Gaznevi (sundoj 999-130) themeluesin e shtetit gaznevit, i cili në shumë beteja ushtarake në Indi, sipas legjendës, në ushtrinë e tij kishte në disponim edhe elefantë. Shih më gjërësisht Sh.Sami Frasherit, Kamusu-l-a'lam, VI, s.4228; Enziklopaedie des Islam, III, p.143.

përforcoi
orditë dhe
vendosen
ishin dalla
ushtrisë dh
tu konsid
përvojë ko
sinë e man
pa mundë
shpatë, pë
ashtu ishir
tyre ishte
sopatës së
që armiqte
me shigjet
Kur shigje
shpërndajn
shigjetarët
shigjeta ng
luftës me
thirrur mux
sulmojnë a
se e rrëzua
kishin vend
atë çrregull
llue sikur ç
sulmuan sh
shtrënguan
rresht usht
llomin dhe
grupe u tërh
limane i kis
shte ngjitur

Po as
pylli i dend
më ushtarë
madhe e ga
komandant
Bajazid me
presionin e
shin e luftë
flakërimi i s
sikur ndriçit

përforcoi flamurin e lumturisë pranë tendës sulltanore. Kuajt, përcjelljen, orditë dhe materialin tjetër luftarak (muta'a l-lakat) të ushtrisë luftëtare, i vendosen në vend të sigurt prapa ushtrisë. Dymijë të rinjë shigjetarë, të cilët ishin dalluar dhe dekoruar në sheshin e trimave, u caktuan në pararojë dhe ushtrisë dhe këtë njëmijë në krahun e djathtë, dhe njëmijë në të majtën. Kështu konsideronin se është e përshtatshme dhe e *dobishme*, sepse luftëtarët me përvojë konsideronin se ushtria armike nuk ka sukses, as aftësi në shkathtësinë e manovrimit me shigjetë. Përkundrazi ata janë të veshur me rroba hekuri pa mundësi të madhe manovrimi dhe nuk kanë mundësi që me shtizë apo shpatë, përveq lëvizjes përpara, të bëjnë lëvizje djathtaas apo majtas. Ata ashtu ishin të shtrënguar në prangat e veshjeve prej hekuri, andaj trupat e tyre ishte e pamundur të rrëzohehin nga kali pa përdorimin e shpatës ose sopatës së vogël. Mund të përfundohet se për muslimanët është e *dobishme* që armiqët nga të gjitha anët të sulmohen me shigjeta përbiruese, t'i plagosin me shigjeta të mprehta dhe vdekjeprurëse (الممرغ) dhe kështu t'i shkatërrojnë. Kur shigjetat përbiruese t'i çrregullojnë radhet e forta të armiqve dhe t'i shpërndajnë, ndërsa ushtarët e veshur me rroba hekuri t'u vijnë në ndihmë, shigjetarët do të sulen nga të gjitha anët e çetave dhe radhëve të luftës, sikur shigjeta nga harku dhe të kryejnë hakmarrjen heroike në shesh. Në fillim të luftës me leje të sulltanit i pari në luftë doli Haxhi Evrenozli dhe duke i thirrur muxhahidët, i u mundësoi shigjetarëve që me shigjeta përbiruese t'i sulmojnë armiqët. Në këtë mënyrë pararojë e armikut me shigjeta përbiruese e rrëzuan për tokë, ndërsa kuajt dhe kalorësit i vranë me heshta, sikur të kishin vendosur parayamore (jeleka hekuri) në trupin e secilit luftëtarë. Në atë çrregullim, ushtria armike e veshur me rroba hekuri u përzie dhe u turbullue sikur çarja e Detit të Kuq. Armiqët të sulmuar me shigjeta menjëherë i sulmuan shigjetarët në krahun e majtë dhe duke i përqëndruar heshtat e veta i shtrënguan fortë radhet e anës së majtë të ushtrisë muslimane. Rresht për rresht ushtritë muslimane i menjanuan para veti sikur vërshimi i ujit që bartë llomin dhe kështu e shkatërruan. Kalorësia dhe këmbësoria muslimane grupe-grupe u tërhoqën dhe u vendosen në prapavijë të kaloërësve. Pasi ushtria muslimane i kishte lidhur devetë dhe mushkat njëri-njëri për tjetrin edhe barrët i kishte ngjitur njëri-për njërin, kalimi nëpër atë grumbull ishte shumë i vështirë.

Po ashtu, prapa ushtrisë muslimane, kuajve dhe zinxhirëve, gjendej pylli i dendur, ndërsa kalimi nëpër mal ishte gjithashtu i pamundshëm. Shumë ushtarë pabesimtarë dhe musliman u vranë në atë konflikt. Një aradhë e madhe e gazive arriti shkallën e sakrifikimit (shehidllukut), kurse shumë komandant të tyre u tërhoqën të përgjakur. Kur princi energjik Jëlldërëm Bajazid me sy të vetë e pa humbjen në këtë krah të ushtrisë muslimane, nën presionin e forcës së vet dhe krenarisë islame, nuk mundi të frenoj në sheshin e luftës kalin e shpejt dhe arriti në mesin e luftëtarëve të pafat. Kur flakërimi i shpatës jemenase të Jëlldërëmit vërbëroi pamjen e besimtarëve, sikur ndriçimi i meteorit në errësinë e pluhurit të betejës, u shkaktua rrëmuje

në mesin e armiqve. Flaka e zjarrit nga xixat e patkonjve të kuajve të shpejtë dhe nga vizëllimi i shpatave të trimave të ushtrisë së Jëlldërëm hanit kaploi shpirtin e pabesimtarëve. Flaka e pshtjellimit dhe e ngatërrimit, që u dhezë nga shpatat dhe heshtat e atyre pabesimtarëve (bulehebani zaman) u shuajt me ujën e shpatës së princit ngadhënjimtar, madje u shua tërësisht.

Kur emirët tjerë dhe sipashallarët (komandantët dhe oficerët) panë këtë akt të guximshëm të princit, të gjithë i liruan frenjtë e kuajve dhe u sulën në rradhën luftarake të armikut, duke i ardhur në ndihmë Jëlldërëm hanit. Evrenoz Beu, Jahshi Beu, biri i Timurtashit, Lala Shahini, Isa Beu, Saruxh pasha, Ejne Beu, Subashi Karamuk bili, Inxhixhik Ballabani, Tibuxha Ballabani, Jahja Shirmerdi, Mustexhabi- subasha dhe komandues të tjerë të reparteve ushtrake u sulën në atë situatë në armikun nga të gjitha anët. Nga ajo masë e madhe e ushtrisë së armike me të sjellur të shpatës së zjarrtë ngritën pluhurin e shkatërrimit në zemrat e pabesimtarëve të nënçmuar dhe të hutuar. Për një çast u ngirtën në maje të heshtave kokat e përgjakura të armiqve, të cilat dukeshin si majet e sukuqura në kuroren e tulipanëve të Rumelisë. Në një sulm të furishëm të trimave i rrëzuan dhe i picingulën flamujtë e armiqëve, të cilët morën pamjet e hijeve të drunjve që vërehen në ujë. I mundën të gjithë sundimtarët shpirtkëqinjë pabesimtarë; për një afatë të shkurtër shkapërderdhën këtë masë të madhe ushtarake, i lidhën në pranga robërit dhe sërish i grumbulluan. Në gjerësinë e asaj fushe, nën qiellin e kaltër ngritën shumë kodrina nga trupat e komandantëve të vrarë të armiqëve. Shumë pabesimtarë fatkëqinjë, të cilët u mbështetën në forcën dhe qëndrueshmërinë e kuajve të tyre, ikën nga beteja pa gjurmë. Ata, kalorësia muslimane me përvojë, me kuaj të shpejtë i arritën dhe një nga një, apo grupe grupe i therën me shpata. Cilin e konsideronin të përshtatshëm e vendosnin nën prangat e robërisë. Sundimtarët e armiqve i sollën para sulltanit. Me të njëjtët litarë që pabesimtarët i kishin përgatitur për t'i lidhur luftëtarët muslimanë ua lidhën të gjithëve duart dhe qafat. Ata dukeshin të frikësuar, sikur egërsirat që kanë rënë në kurth. Nga secila anë dëgjohej ky zë: "Rreth secilës këmbë mbështillet vepra e tij". Kështu kaloi koha nga ikindia deri afër akshamit. Kjo fitore e madhe e muslimanëve e gëzoi shumë gazi sulltan Muratin. U plotësuan premtimet dhe u realizuan dëshirat për të cilat i qe lutur Zotit xh.sh. Ai vetë ishte zhytur në mendim të thellë, për atë se si u plotësuan shumë lutje dhe dëshira, të cilat atë natë në vetmi ia kishte kërkuar me lutje të dëvotshme Zotit xh.sh. Mirëpo, askund nuk e kishte parë asnjë shenjë të qartë që do të tregonte për dëshirën e tij, që të arrij fatin dhe nderin e shehidit. Përkundrazi, gjërat e rëndomta, d.m.th. fitorja mbi ushtrinë e pabesimtarëve, e edhe rrjedha, kohë zgjatja e betejës shpejtë iu afruan fundit dhe u kryenë. Në ato shqetësime dhe mendime të ndryshme ze, mra e tij asesi nuk mund të qetësohej, derisa nga bota e fshehtësisë nuk i tregojë dukuria e parëndomtë - Zoti i Madhëruar, sipas përcaktimit të vetë kishte paraparë të ndodhte ngjarja e parëndomtë:

Poezia:

*Kur të vie koha që momenti i vdekjes të afrohet, në kujtesë
Lajmërohen gjërat e fshehura prapa perdeve.
Nisu, se kur nisesh, me siguri arrinë!
Imagjino, sikur kurrë nuk e ke parë këtë botë.
Përse je ngujuar në këtë tendë!?
Liroje qafën nga litari i yt i fortë
Nga vuajtjet shpëton çdo kush që i mbyll sytë,
Në këtë mënyrë edhe papagalli ka shpëtuar nga kafazi.*

Tregimi për përfundimin dhe përfundimi i tregimit për sulltan Murat Hanin se si e ka arritur lumturinë dhe bekimin e të flijuarit (shehidit) me kalimin e vetë në botën e vërtetë të xhennetit, me largimin nga oborri perandorak i kësaj bote në afërsi të mëshirës së Zotit.

Në fate të çuditshme dhe në ngjarje të rralla, të cilat u ndodhin sulltanëve në fushën e betejës, derisa zhvillohet beteja bënë pjesë edhe ky:

Në ditën e fitorës, pas humbjes a rënies në robëri të atyre sundimtarëve pabesimtarë, sulltan Gaziu akoma qendronte i qetë dhe me urtësi në krye të ushtrisë muslimane dhe si fitimtarë ndaj armiqëve dhe kundërshtarëve të fesë dhe të shtetit. Vështronte grumbujt e të vvarëve dhe të robëruarve. Princat dhe shumica e emirëve edhe ushtria, pasi kishin filluar ndjekjen e armiqëve që iknin, e kokat e udhëheqëve pabesimtarë i kishin ngritur në maje të heshtave që të tregonin forcën në këtë botë, i kapën dhe i robëruan grup pas grupi armiqtë e fesë. Një pabesimtarë nga udhëheqësit më të mëdhenjë pabesimtarë, njëri nga ata të shtatë luanët e mëdhenj, njëri nga sunduesit e atij populli shpirtkeqë, njëri nga ata që në luftë kishte qenë komandant i ushtrisë së të mashtruarve, ose siç i quajnë pabesimtarët, njëri nga velmozhët (bajan) dhe mbretërit pabesimtarë në atë kohë ishte i njohur me emrin Millosh Nikolla.

Atë, trimat muslimanë, gjatë betejës e kishin rrëzuar nga kali dhe ngrehur rrëshqanë nëpër pluhur dhe të përgjakur e kishin lënë gati të vdekur. Askush nga muslimanët nuk e ka njohur. Pasi në atë situatë flamuri fitues i sulltanit gjendej afër Milloshit të mallkuar, ndërsa ai vetëvetën e kishte flijuar dhe gjykuar me vdekje. Vendosi që të arrijë famë të përfaqësuesit e drejtë, dhe në mesin e luftëtarëve dhe trimave të betejës të sigurojë autoritet të madh.

Kokën dhe fytyrën e fërkonte me dhe, dhe gjak, dhe duke u dridhur në agoni, sikur zogu i patherur, u nis të flamuri i sulltanit, qajti dhe duke u lutur tha: "Unë jam bërë musliman, kam për t'ia thënë një të fshehtë sulltanit dhe që ta lëshoj fytyrën time të zverdhur para fytyrës ndriquese të sulltanit".

Sa do që çaušet u përpoqën ta ndalin dhe ta kthejnë, as me të rënat e kamxhikut, as me mundimet, e as me nënqimim nuk mundën ta kthejnë nga ajo rrugë. Meqenëse sulltani ishte i njohur në masat popullore me tiparët e

veta dhe mirëpritjen, kjo d.m.th. mëshira ka qenë e domosdoshme dhe veti e natyrshme e sulltanit, në harmoni me mëshirën e tij të përgjithshme, e cila nën hijen e mëshirës së Zotit xh.sh. është shprehur njëloj edhe ndaj pabesimtarëve sikur edhe ndaj muslimanëve. Ai (sulltani) i pengoi çaušet dhe ata që e mbanin pabesimtarin e mallkuar, dhe e lejoi që ai t'ia puth dorën dhe ta shpreh dëshirën e vetë. Ai hipokriti i vjetër, pamja e drejt të mallkuar, e kishte me veti të fshehur nën mangë thikën e helmuar, dhe kur u afrua që ta puthë këmbën e sulltanit me një të rënë të fortë ia nguli në barkë thikën e sulltanit. Edhe pse ai pabesimtarë kokëfortë, sipas bindjes së tij të gabuar me këtë vepër i bëri nam vetit dhe u bë i njohur në mesin e pabesimtarëve, ai në atë edhe sulltanin e luftetarëve musliman e ngriti në shkallën heroike (shehid) në mesi i sunduesve të botës. Sulltani fatlum - hero, në çastet e kalimit në jetën e amshueshme ishte shumë i kthjelltë, i gëzueshëm dhe i pabrennga përkundër lëndimeve të rënda vdekjeprurëse. Nuk i ndiente dhimbjet e ndarjes së përhershme nga fëmijët, shtetit dhe të mirat materiale, por me gjuhë e lutete Zotin për mëshirë, sepse në atë natë të madhueshme kur i qe drejtuar Zotit, në natën e plotësimit të shumë dëshirave dhe të lutjeve, në dëgjim të zemrës, arriti lajmi nga "Sulltani" dhe "Padishahu", i cili është pakurfarë kërkesash dhe ndihmëtar, dhe ajo zemër që pranoi lajmin e gëzueshëm, e frymëzuar nga kjo botë, ksihte dëgjuar për dy ngajrje të fshehta, që i kishte dëshiruar dhe i kishte kërkuar: marrë tërësisht premtimi dhe lajmi i gëzueshëm u plotësua përgjithësisht. Sa do që dëshira ka qenë përcaktuar (që të plotësohet) me ndihmën e Zotit me të njëjtin rend siç ishte lutur në lutjet e mëhershme, u plotësua në mënyrën më të mirë.

Fundi i shkakut dhe pasojat e kësaj përpjekje dhe mundi janë këto fjalë të sulltanit: "Zoti i Gjithmëshirshëm edhe këtë rob të paafitë e bëre krenar dhe të famshëm në tërë popullin, veçanërisht në mesin e sulltanëve të mëdhenj të botës me atë që i dha nder dhe forcë që të luftojë me kundërshtarët kokëfortë. Ai (Zoti) e shpuri deri te dëshirat e fundit dhe qëllimet, d.m.th. deri tek fitorja mbi sundimtarët pabesimtarë dhe vënia nën sundim i tokave e qyteteve të reja. Zoti xh.sh. e shpërbleu dhe bëri që në vitet e fundit të jetës së vetë ta ndihmojë ushtrinë muslimane dhe t'i mbrojë muslimanët. Mirëpo, Zoti xh.sh. i dha në pjesën e parë të jetës, d.m.th. të jetës së kalurshme të kësaj bote të arrijë fatin e shehidit, e radhiti në radhën e besimtarëve të vërtetë, në shoqërinë e atyre që, me siguri do të jenë afër pejgamberëve, besimtarëve të sinqertë, shehidëve dhe njerëzve të ndershëm mbi të cilët Zoti xh.sh. ka shtirë mëshirën dhe mirësinë e vetë; kjo do me thënë nder dhe krenari në të dy botërat. Këtë shërbetor të thjeshtë e bëri të tillë që të popullarizohet me shërbime të vlefshme për fenë islame, ndërsa në pjesën tjetër të jetës (në ahiret) ta radhisë në radhën e shehidëve fatlum në jetën e amshueshme dhe t'u bashkëngjitet halifëve dhe udhëheqësve në rrugën e drejtë të Muhammedit a.s. O Zoti! fshehurazi kam menduar dhe jam brengosur se çfarë do të dëgjoj nga engjëlli, që sjell lajme të gëzueshme për mëshirën e Zotit xh.sh.

dhe si do të
mëzim, të e
kam ndier t
me mirësin
qëllim përf
"Zoti vërte

Strof
Secil
Sipas

Pasi
lum, gjatë
në bazë të
fronin sullt
tarët e kës
vdekjes, an
gimin e fro
halifëve të
të Pacenus
hapësira e
përgjigj me
mbretëror i

Strof
Shah
Përve
U bë
Gjeti
Vdek
I lum
Le të
Shpir

dhe si do të ndodh gjith kjo. Tash falenderoj Zotin e madhëruar që këtë frymëzim, të cilin ma kishte dhënë para kësaj ngjarje dhe për atë që në shpirt e kam ndier u realizua sipas dëshirës së Zotit të gjith madhrrishëm. Më në fund, me mirësinë dhe mëshirën e madhe të Zotit xh.sh. ajo që kemi pasur si qëllim përfundimtar, Zoti xh.sh. na lëshoi në duar të zgajtura gjatë lutjeve. "Zoti vërtetë nuk i ndryshon premtimet e veta".

Strofa:

*Secili trim, që në momentin e dhënë flijohet për dashuri,
Sipas fesë të të dashurëve bëhet "shehid" dhe "gazi".*

Pasi sulltan Bajazid Jallëdërëmi, trashëgimtar i fronit të sulltanit fatlum, gjatë gjithë kohës së asaj ngjarje qëndroi afër flamurit të sulltanit dhe në bazë të urdhërit të sulltanit e sipas aftësive dhe meritave që të vij në fronin sulltanor, të cilat i shprehi si komandant i luftetarëve muslimanë, anëtarët e këshillit sulltanor e sollën Jëlldërëmin para të atit, i cili ishte paravdekjes, andaj ai në takimin dhe në bisedën e drejtpërdrejtë i dorëzoi trashëgimin e frontit. Dorëzimin e pushtetit e bëri sipas rendit dhe traditës të katër halifëve të parë dhe sulltanëve të mëparshëm. Pastaj në thirrjen e Apelusit të Pacenueshëm: "Shpejtoni me pendimin ndaj Sunduesit tuaj dhe në xhennet, hapësira e të cilit është si hapësira e qiejve dhe e tokës", me devotshmëri iu përgjigj me fjalët: 'Të përgjigjem dhe të nënshtrohem, o Zot', dhe ky pallat mbretëror i kalueshëm u zëvendësua me bukurinë hyjnore.

Strofa:

*Shah gazi Murati, pushtues (i tokave)
Përvetësoi edhe fenë edhe pushtetin e kësaj bote
U bë i lumtur në lëmin e fesë,
Gjeti përrhershëmri në botën e padukshme,
Vdekja heroike e zuri në tridhjetenjë vjet të sundimit
I lumi ai perandor që arrin këtë fat
Le të jetë i përrhershëm në hapësirat e xhennetit
Shpirti i tij i bekuar, që është si virgjërësja e ndritshme e xhennetit.*

Përktheu: Ismail Rexhepi

The battle of Kosova in the history of Idris Bitlisi

Summary

This study presents a translation of the description of the Battle of Kosova in a big history of the Ottoman Empire in the period of the first eight sultans (of Osman to Selim I 1290-1512). The author of which is Idris Bitlisi a well-known court historian Sultan Bayazid II, from the end of XV ct. and the beginning of XVI ct.

The Battle of Kosova represents the crucial moment for further historical developments at the Balkans. This battle was especially important for destiny of the Southern Slaves, because it ment loss of the political independence of the Balkans peoples and the beginning of the centuries long the Ottoman rule in this parts.

The Battle of Kosova was described contemporaries or later chronics writers and according to those descriptions it was treated in our historiography. The exception in those documents presents a history by Bitlisi, wich in its account and analysis of the battle was not used by our historians. This book is otherwise considered to be first-rate source. The introduction of this source will present a contribution towards more reliable view all essential facts of the Kosovo event and towards its tower better and more objective understanding.

This translation is given on the basis of the only manuscript of Idris Bitlisi. This work in our country can be found in the State Archives in Zagreb. This volume was copied in 1571, less than 60 years after the completion of the original work, from the Bitlisi manuscript. Because of this fact the book has great value as the source.

Në ke
veta me një
në Beograd
për xhamin
për Beogra
XIX,⁴ se pë
është rrënu
Pamja e saj
Ali Pashës,
hungarez L
e poshtëm
minaresë ë
BELGRAD
xhamia nuk

Pasi
net e ndërte
me. Pasi n
dy katëshe
xhamisë, p

¹ Muzej grad
njohjen e xh
filologiju, n

² Lj. Nikić
206 - skraćen

3. Plan varoš
je objavljene
ustanak, pose

⁴ G. Elezo
novine LV, 1

⁵ Lj. N i
VII, 1960, s

⁶ Nikić I, s

KONTRIBUT PËR NJOHJEN E XHAMIVE TË BEOGRADIT

Në kohët e fundit Muzeu i Qytetit të Beogradit i pasuroi koleksionet e veta me një skicë, e cila zgjidh çështjen e pamjes së xhamisë të Ali Pashës në Beograd.¹ L. Nikiqi, me siguri njohësi më i mirë i xhamive të Beogradit,² për xhaminë e Ali Pashës di vetëm aq se është e skicuar në planin e Brushit për Beogradin nga viti 1789³ dhe në planin turk nga vitet e 60 të shekullit XIX,⁴ se përmendet në arkivat e dokumenteve turke nga viti 1801,⁵ dhe se është rrënuar në vitin 1863 sipas vendimeve të Konferencës në Kanlixhë. Pamja e saj deri më sot nuk ka qenë e njohur. Skicën me tush të xhamisë së Ali Pashës, e cila tani për herë të parë po publikohet, e ka punuar inxhinieri hungarez Llupa Peter. Kjo shihet nga nënshkrimi në anën e djathtë në këndin e poshtëm (A teleysenek rajz Lupp Peter, mernök).⁶ Në lartësinë e majës së minaresë është shkruar me shkronja të shtypit: ALI-PASHA MESCET, - BELGRADON - (Xhamia e Ali Pashës; -Beograd). Viti se kur është skicuar xhamia nuk është shënuar.

Pasi skicën e ka punuar inxhinieri, patjetër duhet besuar në proporcionet e ndërtesës, andaj mund të konkludohet se xhamia ka qenë mjaftë e pashme. Pasi në skicën e theksuar para xhamisë ekziston një ndërtesë ndihmëse dy katëshe, nuk mund të konkludojmë se çfarë forme ka pasë themeli i xhamisë, por mund të themi se ajo, pjesa e poshtme e ndërtesës, është mjaftë

¹ Muzej grada Beograda, inv. br. U. 921 - format 18,5 x 26 cm. (Punimi *Kontribut për njohjen e xhamive të Beogradit*, është huazuar nga revista *Prilozi za orijentalbu filologiju*, nr.XV-XVI, 1969, Sarajevo)

² Lj. Nikić, *Džamije u Beogradu*, Godišnjak grada Beograda, V. 1958, str. 151 - 206 - skraćeno: Nikić I. 418.

³ Plan varoši Beograda s kraja XVIII veka. Izradio FR. foni Bruš, potporučnik. Plan je objavljen kao prilog uz knigu D. Pantelića, *Beogradski pašaluk pred prvi serpski ustanak*, posebna izdanja SAN CXLVI, Beograd, 1949.

⁴ G. Elezović P. Popović, *Dva turska plana Beograda*, Beogradske opštinske novine LV, 1937, str. 64 - 68, 250 - 252 + tri plana.

⁵ Lj. Nikić, *Prilozi istoriji Beogradski džamija*, Godišnjak grada Beograda, VII, 1960, str. 145 - skraćeno: Nikić II

⁶ Nikić I, str. 163.

e lartë, sepse lartësia është e barabart me lartësinë e ndërtesës që gjendet para saj, së bashku me kulmin, që gjithsesi arrinë lartësinë mbi 7 metra. Në këtë vend themeli i xhamisë kalon në tetëkëndësh e pastaj në formën rrethore, që në fund të përfundoj me një rreth gjysmësferik. Në pjesën tetëkëndëshe, secila faqe ka nga një dritare të ngushtë me hark. Duke u nisur nga ajo se ndërtesa e përmendur është e lartë shtatë metra, maja më e lartë e gjysëmshënës metalike do të gjendet në lartësi 14 - 15 metra. Proporcionalisht me këtë lartësi, faqja e bazës do të ishte me gjatësi 8 - 9 metra. Minareja është e tipit standard, çfarë i gjejmë edhe në xhamitë e tjera të Beogradit. Nga skica nuk mund të konkludojmë se, a është skicuar xhamia nga rruga apo oborri. Në anën e djathtë të skicës e shohim murin në perspektiv, me hark të çuditshëm dhe me dy hapje. Në mesin e murit është llulla nga e cila rrjedh uji.

Pasi tash e dimë se si duket xhamia e Ali Pashës, do të ishte interesante të studiohet një skicë e Dorçollit (lagje e vjetër e Beogradit), që e ka punuar Eduart Brauman (Eduart Braumann) në vitin 1846. Para se gjithash duhet të dijme kush është E. Brauman. Ka qenë litografi i parë në Serbi, i cili këtu kishte ardhur në vitin 1846 dhe kishte themeluar litografinë - gurëgdhendjen e parë serbe dhe me të ka udhëhequr deri në vitin 1850. Pastaj u kthye në Gjermani dhe në Citavë themeloi litografinë dhe tregtinë e vet. Beogradin sërish e vizitoi pas 50 vjetësh dhe me atë rast premtoi se Muzeut Popullor do t'ia dërgoj të gjitha kopiet e litografisë, të cilat i ka punuar në Serbi, premtin të cilin e plotësoi.⁷ Në mesin e atyre litografive gjendet edhe skica e Dorçollit, të cilën pakë më parë e përmendëm. Skica është nënshkruar në këndin e poshtëm të majtë: Nach Natur gez. 1846. v. E. Braumann (Sipas natyrës e ka skicuar në vitin 1846 E. Brauman). Për herë të parë është publikuar në revistën "Nova Iskra", nr. 4, për vitin 1899.⁸ Ndërsa herën e fundit në Vjetarin e Muzeut të Qytetit të Beogradit, për vitin 1955.⁹

Skica paraqet pamjen e Dorçollit dhe në një largësi shihen muret e kështjellës së Beogradit, Sahat kulla e njohur dhe xhamia e Sulltan Mahmudit, në pjesën e Epërme të qytetit me minaren e rrënuar.

Duke e parë për herë të parë skicën e xhamisë Ali Pasha të inxhinierit hungarez, na u kujtua se njëra nga xhamitë në skicën e theksuar të Braumanit i ngjanë kësaj xhamie. Kjo ka qenë xhamia nga fundi në anën e djathtë. Mirëpo, nën këtë skicë të publikuar në Vjetarin e Muzeut të Qytetit të Beogradit gjetëm nënshkrim të këtitillë : "F. 4 - e Brojman (Braumann), nga Beogradi i vjetër: Dorçolli. Punimi sipas natyrës, të vitit 1846. Xhamia në fund

⁷ Beležka Poklon Narodnom muzeju, Nova iskra, 1899, br. 8, str. 142 - 143

⁸ Nova iskra, 1899, br. 4, str. 59

⁹ Godišnjak Muzeja grada Beograda, II, 1955, str. 106

178 *Studime orientale* 2/02

djathas ë
krahasimin

Para

deri te ky

Sinxhirli x

1870,¹⁰ dh

mani. Vë

konstatojm

po, propor

bukur, d.m

sa të njëjta

Në v

është Sinx

Pasi

janë punu

xhamitë e l

që duke sh

djathtë. Nu

Mirë

është ajo e

tojmë, pun

në cilin ve

caktuar kë

skicë (përv

xhamia e

xhamia e L

që shihen n

Por,

Braumani c

Dorçollit?

E d

lëshohet ta

kështu has

sektorin pë

këtë plan,

të qëndroj

breg, i ng

perëndim t

¹⁰ Godišnjak

¹¹ Plan Beog

¹² Muzej gra

djathtas është Sinxhirli Xhamia". Kjo nuk përputhej me supozimin dhe krahasimin tonë, prandaj ia filluam analizës në detaje të skicës.

Para se gjithash, mendojmë se autori i sqarimit të kësaj skice ka arrijt deri te ky konstatim duke e krahasuar pamjen e kësaj xhamie me pamjen e Sinxhirli xhamisë, skicën e së cilës e ka punuar A. Kovaçević në vitin 1870,¹⁰ dhe e cila mund të ngjajë në skicën e xhamisë të skicuar nga Braumani. Vërtet, ashtu siç e dimë tani, edhe xhaminë e Ali Pashës, mund të konstatojmë se arkitektura e të dy xhamive është shumë e ngjajshme. Mirëpo, proporcioni i ndërtesave ndryshon. Xhamia e Ali Pashës është më e bukur, d.m.th. raportet e saj të lartësive ndaj gjatësive janë më të mëdhaja se sa të njëjtat raporte me Sinxhirli Xhaminë.

Në vazhdim si pyetje e parë shtrohet: në qoftë se ajo e fundit djathtas është Sinxhirli xhamia, cilat janë xhamitë e tjera në skicë?

Pasi u nisëm nga supozimi se as skica e Brushit, e as plani turk nuk janë punuar me matje të sakta në vendin e ngjarjes, i skicuam të gjitha xhamitë e Dorçollit në një plan bashkëkohor¹¹ 1:1 dhe e kthyem në atë formë që duke shikuar kah kështjella Sinxhirli, xhamia të na mbetet në anën e djathtë. Nuk mundem të identifikojmë në skicë asnjërin xhami.

Mirëpo, në qoftë se presupozojmë se xhamia e fundit në të djathtë është ajo e Ali Pashës, pasi tani kemi skicën e saj, me siguri mund ta vërtetojmë, puna është fare e lehtë. Kështu mundemi, bile edhe të konstatojmë se në cilin vend ka qëndruar Braumani derisa e ka bërë skicimin. Duke përcaktuar këtë vend me ujdishjen e katër xhamive, minaret e të cilave shihen në skicë (përveç xhamisë në Qytetin e Epërm) janë (nga e djathta në të majtë): xhamia e Ali Pashës, xhamia e Sulltan Mustafës, Sinxhirli Xhamia dhe xhamia e Lazogllit. Xhamia e Reis Efendisë do të gjendej diku pas rrënojave që shihen në plan të parë.

Por, tani shtrohet edhe pyetja e dytë: Në çfarë lartësie ka qëndruar Braumani që të mundte nga lartësia të përfshijë kaq hapësirë të madhe të Dorçollit?

E dimë se ky vend ka qenë i pandërtuar dhe se terreni drejt Danubit lëshohet tatëpjet. Për këtë iu drejtuam planeve të vjetra të Beogradit dhe kështu hasëm në: "Planin e Beogradit" - me shkallën 1:4000 i hartuar në sektorin për kanalizim në vitin 1903,¹² në të cilin janë vizatuar izohipset. Në këtë plan, përafërsisht në vendin në të cilin kemi presupozuar se ka mundur të qëndrojë Braumani me rastin e punimit të skicës gjendet i vizatuar një breg, i ngritur kota e të cilit rreth mesit është 76,6 m., ndërsa kota në perëndim të atij bregu (d.m.th. kah kalaja) në largësi prej 20 m. është 72.1 m.

¹⁰ Godišnjak Muzeja grada Beograda, II, 1955, str. 107

¹¹ Plan Beograda, izrada i reprodukcija "Geokarta", Beograd, 1963

¹² Muzej grada Beograda, inv. br. Ur. 3869

Pra, Braumani e ka shikuar Dorçollin nga largësia mbi 4 m. dhe kështu na ka lënë dokumentin me vlerë shumë të çmueshme për pamjen e kësaj pjese të Beogradit në gjysmën e shekullit XIX.

Pyetja e tretë dhe e fundit, që na ka interesuar është: çfarë janë këto gërmadha në plan të parë në skicën e Braumanit?

Që të përgjigjemi në këtë e morëm planin e Brushit. Përafërsisht në vendin nga plani i vitit 1904, për të cilën konstatuam lartësinë prej 4 m. edhe Brushi ka skicuar një mur të trashë të ngritur që ka kaluar rreth Beogradit. Në qoftë se tani mendojmë të qëndrojmë në këtë vend ku kemi presupozuar se ka qëndruar Braumani dhe shikojmë në drejtim të kalasë, pamja do të na jetë edhe më e qartë, dhe do të vijmë në dy konkluzë. Konkludimi i parë zgjidh pyetjen tonë të tretë, sepse shohim që ajo është xhamia e lënë pasdore, e vizatuar para murit në atë vend në planin e Brushit, gërmadha e jonë në plan të parë në skicën e Braumanit. Konkludimi i dytë është se në saktësinë e planit të Brushit mund të mbështetemi.

Në planin e Brushit vetëm xhamia e Lazogllit nuk është skicuar. Ajo është e skicuar në planin e përmendur turk, andaj, L. Nikiçi¹³ mendon se në kohën e Brushit ka qenë e rrënuar dhe më vonë është rindërtuar. Në qoftë se e skicojmë në të njëjtin vend ku është skicuar në planin turk, atëherë ajo do të ishte xhamia e fundit majtas në skicën e Braumanit.

Skica e Braumanit më tutje na vërteton se xhamia e Ali Pashës ka qenë më e bukur se ajo Sinxhirlit, por ka qenë me dimensione më të vogla. Paraqitja e xhamisë së Ali Pashës në skicën e Braumanit është identike me paraqitjen e saj në skicën e Llupa Peterit, vetëm se, sigurisht e shikuar nga anë të ndryshme. Paraqitja e kubesë së xhamisë Sinxhirlit të Braumani është identike me skicën e arkitektit Konstatin Jovanoviç, e publikuar në artikullin e L. Nikiçit.¹⁴

Xhamia e Këzllar Agës është njëra nga xhamitë e vjetra të Beogradit. Pamja e saj na është ruajtur nga viti 1860 në skicën e Steva Todoroviçit, e cila shumë herë është publikuar në literaturë.¹⁵ Mirëpo, është ruajtur edhe fotografia e kësaj xhamie (foto. 1.),¹⁶ por e një periudhe diç më të vonshme, gjithsesi pas ngajrjes 1862, sepse në të nuk shihen dyertë përforcuese rreth policisë turke, të cilat i hasim në skicën e Steva Todoroviçit. Fotografimi është bërë nga ndërtesa e kapetan Mishës, pra nga poshtë, kështu që xhamia

¹³ Nikiç I, str. 184

¹⁴ Nikiç I, str. 177, v.3.

¹⁵ Nova iskra, 1905

¹⁶ Muzej grada Beograda, inv. br. P. 279/3.



në fotografi
fotografisë,
fotografi është
Këzllar Agës
pjesë të Do
1941, para
largësi deri
për herë të p

Në li
Bodies që i
fotografinë e
Çarshisë së
bukur e ma
kujtohet në
manifestimi
ka qenë, sa
vëllait tim
kundër bull
fotografi ko
xhandarmeri
kornizuar dh
apo pas Luft
dy këto foto
dihet ku gj
kancelaritë e



Foto 1. Xhami "Kézllar Aga" në Beograd, foto nga viti 1860.

në fotografi shihet më mirë se sa në skicën e përmendur. Duke gjykuar sipas fotografisë, ajo i ngjanë shumicës së xhamiave të Beogradit. Mirëpo, kjo fotografi është e rëndësishme si dokument jo vetëm për pamjen e xhamisë së Kézllar Agës, por edhe për pamje më të gjërë të rrethinës së saj dhe të një pjese të Dorçollit. Djathtas shihet një ndërtesë përdhese e rënuar në vitin 1941, para xhamisë një pjesë e parregulluar e sheshit Studentski Trg, e në largësi deri te Danubi, pjesa e Dorçollit ende e pandërtuar. Fotografia tani për herë të parë publikohet.

Në lidhje me këtë fotografi janë interesante kujtimet e Dimitrije Bodies që i ka publikuar në revistën "Pravda", të vitit 1931: "E kam pasur fotografinë origjinale të kazermës policore turke dhe një pjesë të hapësirës së Çarshisë së madhe të asaj kohe. Në atë fotografi është parë edhe një pjesë bukur e madhe e Dorçollit të vjetër. Atë fotografi ia kam dhuruar, siç më kujtohet në vitin 1941, me akt përcjellës Komandës policore me rastin e një manifestimi fetar që ta ketë për kujtim. Atëherë komandant i xhandarmarisë ka qenë, sa më kujtohet, kolonel Vukasoviç, ndërsa komandir i çetës djali i vëllait tim kapiten Mihajllo N. Bodi, i cili është vrarë në luftën e vitit 1913 kundër bullgarve në Govedarnik, si komandir i një çetë këmbësorie. Këtë fotografi komanda e ka dhënë për ta smadhuar dhe në një manifestim xhandarmerik për ditën e të vdekurve atë fotografi të smadhuar e kam parë të kornizuar dhe të varur në tribinë. Nuk më kujtohet mirë se a ka qenë kjo para apo pas Luftës së Parë Botërore. Pasi u intersova për këtë, jam njohtuar se të dy këto fotografi (origjinali dhe e smadhuarja) janë futur diku dhe se sot nuk dihet ku gjenden, ndërsa është dashur që komanda t'i ketë si raritet në kancelaritë e veta, si kujtim".

Është interesant se edhe Muzeu i Qytetit të Beogradit disponon me dy fotografi identike të xhamisë së Këzllar Agës. Njëra është origjinale, me dimensione 7 x 5,8 cm. dhe gjendet në posedim të Muzeut që nga viti 1947 (nr. inv. p. 279/3), ndërsa tjetra është e smadhur 39 x 29 cm. dhe është blerë në vitin 1948 (nr. inv. p. 312/5). Sipas të gjitha gjasave këto dy fotografi janë identike me fotografitë të cilat i përmend D. Bodi. Xhamia e Këzllar Agës është identifikuar në librat e inventarit të Muzeut nga viti kur fotografitë janë pranuar. Gazetat komunale beogradase në vitin 1939 kanë publikuar si shtesë letërsie në tri vazhdimë shkrimin "Tri pamje të Shën Premtës" (autori më vonë e ka botuar si libër të veçantë), titulli i të cilit nuk tregon se aty mund të gjenden të dhëna shumë të bukura, të gjëra dhe shumë interesante për Beogradin e shek. XIX.¹⁷ Autor është Nikolla Trajković, paraardhësit e të cilit ishin qytetarë të vjetër të Beogradit.

Poshtë titullit të veprës është shtypur: Fragmente historike të një familje beogradase - (vepra nga letërsia e bukur - është shpërblyer në konkursin për letërsi të Kryesisë së qytetit të Beogradit, në vitin 1939, e moto e saj është: "Babait tim të dashur Millan, i cili në pleqërinë e tij të thellë 85 vjeçare, më dha shenimet për këtë tregim". Gjatë tregimit autori sqaron se gjyshi i tij nga babai kishte qenë tregatar beogradaş nga Çarshia e Savës, se ka qenë me autoritet, përparimtar për atë kohë dhe se gjatë kohës së lirë, pasi që kishte ditur shkrim-lexim "ka lexuar fletoret e trasha të Shoqatës së dijetarëve Serb."

Në vazhdimin e dytë të tregimit është dhënë një ngajrje nga viti 1862 lidhur me xhaminë në Skele (liman),¹⁸ për të cilën dihet vetëm pakë. L. Nikić¹⁹ ka gjetur vetëm një burim ku përmendet kjo xhami. Mirëpo, tani për herë të parë dimë vendin e saktë të xhamisë në Skele, e pamja e saj, përmes përshkrimit detal, na bëhet tërësisht e qartë. Trajkovići së pari na tregon hanin e quajtur "Liman", i cili ka ekzistuar pikërisht në vendin ku nga ana e beogradit mbi lumin Sava ka filluar ura e madhe me zinxhir, e cila në Luftën e Dytë Botërore u rrënuar.²⁰ "Pikërisht pranë hanit, pranë breglumit ka qenë e ngritur xhamia e vjetër nga guri i fortë i granitit me grila hekuri me dyer e dritare. Është muruar që në kohën e sulmeve të para osmane në këto treva dhe ka pasur minare të fortë dhe të lartë...", e pakë më tutje: "Nga xhamia... e deri te brraka Venecia, kanë ekzistuar shumë shtëpiza të vjetra...", dhe sërish: "Para xhamisë ka qenë një shatërvan paksa i madh, përherë i mbushur me ujë i nevojshëm për abdest gjatë ditës". Pra, nga ky përshkrim mund të

¹⁷ N. Trajković, *Tri videnja svete Petke*, Beogradske opštinske novine, 1939; br. 5, str. 258 - 264; br. 6 - 7, skraćeno: Trajković.

¹⁸ Trajković, str. 384.

¹⁹ Nikić I, str. 198

²⁰ Trajković, str. 384

konkludojmë
Vëllezërit
është i saktë

Është
me këtë xh
pastaj fillu
të Beograd
gratë dhe f
patën suks
shtëpitë e t
regionin e
luftimet u a
turqëve, ng
Skeles. Situ
u grumbull
Mirëpo, nu
mbrojtur. M
nxëjnë fryr
sukses, sep
të kundërt.
gjatë natës,
dhe turqit p

Në k
pamjen e p
edhe të dis
kësaj në Sk
e Larne në
ndërtesës s
të premtë v
është e vet
rrugën e D
minaresë sh
bërë dritë g
sotem. Ka
dhe jashtë
Batall, e ca
nga ana e k
kishin dem
jashtme, po

²¹ Plan Beog
uz knjigu J.

²² Trajković

konkludojmë se xhamia në Skele ka qenë përafërsisht aty ku sot fillon rruga Vëllezërit Krsmanović, madje edhe nëse ky lokalizim i kësaj xhamie nuk është i saktë në planin e Dedincit.²¹

Është interesant edhe përshkrimi i ngjarjes së vitit 1862 që ka të bëjë me këtë xhami. Kur ka ndodhur incidenti i njohur në Çukur çeshme dhe pastaj filluan luftimet në qytetin e Beogradit, sikur që turqit nga pjesët tjera të Beogradit, ashtu edhe turqit nga Çarshia pranë lumit Sava, së bashku me gratë dhe fëmijët e tyre ikën dhe u mbyllën në kështjellë. Megjithatë, nuk patën sukses apo nuk dëshiruan që të gjithë të ikin, një pjesë qëndroi në shtëpitë e tyre. Numri më i madh i atyre që qëndruan, veçanërisht ata në regjionin e lumit Sava kishin marrëdhënie miqësore me serbët. Mirëpo, kur luftimet u ashpërsuan, rreziku iu kërcënua edhe atyre. Kështu, pjesa tjetër e turqëve, nga Çarshia e lumit Sava arriti më në fund të strehohet në xhaminë e Skeles. Situata për ta edhe më tej u ashpërsua, andaj një grup i madh serbësh u grumbulluan rreth xhamisë dhe tentonin t'i vrisnin turqit brenda xhamisë. Mirëpo, nuk mundën të dëpërtojnë brenda për shkak se ajo ishte mirë e mbrojtur. Me rastin e tentimit të dytë, u përpoqën ta djegin xhaminë, apo t'ua nxëjnë frymën turqëve në të me tym. Mirëpo, as kjo përpjekje nuk pati sukses, sepse muret e xhamisë ishin prej guri, ndërsa era fryente në drejtim të kundërt. Ra muzgu, dhe sulmi kryesor u shty për të nesërmen. Megjithatë, gjatë natës, me insistimin e tregtarëve të vjetër serbë, u bë një marrëveshje, dhe turqit përmes Skelës hipën në trapa dhe u strehuan në kështjellë.²²

Në këtë pjesë të tregimit të Trajkoviçit ka edhe shumë të dhëna për pamjen e pjesës më të madhe të Beogradit të asaj kohe. Kemi përshkrimin edhe të disa xhamive beogradase: "Në atë kohë në qytet ekzistonin, pranë kësaj në Skele, edhe xhamia të tjera më të mëdha e më të bukura, si: Xhamia e Larne në vendin e ish-kafiterisë "Proleqe" (përtej rrugës së Parkut dhe ndërtesës së Xhokej Klubit); Bajrakli Xhamia në minaren e së cilës për çdo të premtë valonte flamuri i gjelbërt i pejgamberit Muhammed (ajo edhe sot është e vetmja që u shërben besimtarëve musliman); Sinxhirli Xhamia në rrugën e Dushanit, në vendin ku sot është banjoja publike, ka patur rreth minaresë shumë zinxhir të varur, në të cilët kanë qenë të varur kandilët për të bërë dritë gjatë tërë natës; ka qenë edhe një paksa më e madhe nën Teatrin e sotem. Ka qenë edhe një shumë e madhe, e cila ka ekzistuar jashtë qytetit dhe jashtë mureve e portave mbrojtëse. Ajo është xhamia e njohur me emrin Batall, e cila u ka shërbyer muslimanëve deri në çlirimin e parë të Beogradit nga ana e Karagjorgjit më 1806, sepse serbët gjatë rrethimit të qytetit atë e kishin dëmtuar shumë. Ata e kishin rrënuar minaren dhe disa mure të jashtme, por kubën qendrore nuk kanë mundur asesi ta rrënojnë, sepse ka

²¹ Plan Beograda od 1815 - 1830. Izradio Radoje Dedinac. Plan objavljen kao prilog uz knjigu J. Vujić, Putošestvije po Srbiji I, Beograd, SKZ, 1901.

²² Trajković, str. 384 - 393

qenë e murosur mjaftë fortë. Nga ajo kohë turqit edhe pse u kthyen në Beograd nuk dëshiruan ta rindërtojnë dhe ashtu qëndroi deri në vitet e '70 të shek. XIX, e "batalluar" dhe e lënë, andaj vetë turqit atë e quajtën "Batall Xhamia". Sot në vendin e saj është Kuvendi Popullor."

Siç shihet nga citati, disa të dhëna për xhamitë, mbase janë të njohura, por ne hasim edhe në disa shenime të reja.

Xhamia Defterdare këtu, p.sh. për herë të parë përmendet si xhamia e Larme.²³

Të dhënat për xhaminë Bajrakli janë të njohura.

Për Sinxhirli Xhaminë ofrohet lokacioni i njohur, por sqarimi i emrit të saj është ri. Edhe këtu fillohet nga ajo se sinxhir domethënë zinxhir, por afrohet tjetër sqarim se ku janë gjetur ata zinxhir, që mund të jetë, por jo domosdoshmërisht, e saktë. Gjuzepo Barbanti - Brođano²⁴, të cilin L. Nikiqi nuk e përmend si udhëpërshkrues, i cili ka përshkruar disa xhami beogradase nga viti 1876, ofron sqarimin e njohur për zinxhirët në Sinxhirli Xhaminë: "... në sheshin e madh është xhamia gërmadhë dhe pranë saj mbeturinat e bunarit turk është quajtur Singirgiami, nga singir, zinxhir dhe giami, xhamia, për shkak se sikur dyert e disa kishave tona (serbe-vër. e përkth.) ka qenë e rrethuar me zinxhir të lidhur për hunjësh".

Për Batall xhaminë, u tha ajo që ka mbetur si tregim te beogradasit e vjetër, të cilin autorit ia ka treguar babai, i cili të njëjtin e ka dëgjuar nga babai, e që historikisht nuk është tërësisht e saktë.²⁵

Mirëpo, është interesant pohimi se "ka ekzistuar nën Teatrin një xhami e madhe". Me këtë rast dëshirojmë të themi diç më shumë për këtë xhami. L. Nikiqi në hulumtimet e veta për xhamitë e Beogradit²⁶ ka arritur gjer te konkludimi se nën Teatër kanë ekzistuar dy xhami: njëra Kara Xhamia në qoshen e rrugëve të Dositëut dhe Braça Jugoviq, e cila është bërë e përdorshme, në gjendje gërmadhë dhe jo me dimensione të mëdha, e cila në vitin 1869 është shndërruar në fabrikë të gasit për Teatrin Popullor; dhe tjetra Xhamia e Bajram Begut në bllokun e ndërtesave në mes rrugëve të Dositëut, Siminit, Francuskës dhe Gospodar Jevremit, e cila ka qenë monumentale dhe e ndërtuar nga guri i gdhendur, e rrënuar "pa dyshim diku në fillim të viteve të '70 të shekullit XIX". Do të përpiqemi të argumentojmë se ky pohim i L. Nikiqit nuk është i saktë.

Në Muzeun e Qytetit të Beogradit ekziston (pa dyshim jo komplet) koleksioni i fotografive të Beogradit nga viti 1876 i korrespondentit ushtarak

²³ Nikić I, str. 171

²⁴ Đ. Barbanti-Brodano, Garibaisinci na Drini 1876, Beograd, SKZ, 1958, str. 127.

²⁵ Nikić I, str. 166

²⁶ Nikić I II

rus - fotografi panoramën ndërtesës së djathtas, në "Garibaldin" ka qenë i gase askush dhe fotografia ditë posa kis rrugëve janë vërtetohet s Dositëut, pr Mirëpo, sip Kara Xhamia edhe vetë rrugëve Dositëut përsëjash të

Në planin dy ndërtesa kompleksi (veç). Njëra, saj është shkëlqimor. katrore pa kili planin teatral, gjende kompleksin skicën e cila Dobraqina. por në realitet rreth 20 metrin e ndërtesës planit të Jos pranë xham

²⁷ Muzej gra

²⁸ E. Josim što leži u šar

²⁹ B. Nestić grada, III, 19

³⁰ Muzej gro Zarić, inžinir

rus - fotografit Groman. Në një rën prej atyre fotografive,²⁷ e cila paraqet panoramën e Beogradit, të fotografuar nga ndërtesa e Kapetan Mishës përtej ndërtesës së Hotelit të atëhershëm "Makedonija" shohim krejtësisht në fund djathtas, në largësi, një xhami. Edhe pse kjo fotografi ka qenë e publikuar në "Garibaldinci na Drini" të vitit 1876, e koleksioni i fotografive të Gromonit ka qenë i gatshëm për të interesuarit në Muzeun e Qytetit të Beogradit, duket se askush deri më tash nuk e ka vërejtur në fotografi këtë xhami. Në qoftë se fotografia studiohet mirë dhe nëse dihet se rregullimi i asaj pjese të Beogradit posa kishte filluar (që shihet edhe në fotografi, sepse ndërtesat ndërmjet rrugëve janë rrethuar drejtë dhe me rrethoja druri), mundet saktësisht të vërtetohet se xhamia gjendet diku rreth këndit të rrugëve Braçe Jugoviq dhe Dositeut, pra në vendin ku L. Nikiqi ka konfirmuar se gjendet Kara Xhamia. Mirëpo, sipas përshkrimit të saj nga L. Nikiqi, kjo xhami nuk ka mund të jetë Kara Xhamia. Xhamia në fotografi është tërësisht e ruajtur, e ruajtur është edhe vetë ndërtesa, si dhe minareja e saj. Pra, në vitin 1876 në këndin e rrugëve Dositeji dhe Braçe Jugoviq ka ekzistuar xhamia plotësisht e ruajtur, përsëjashtrimi nuk vërehen kurrfarë meremetimesh.

Në planin e Emilian Josimoviçit nga viti 1867²⁸ nën Teatër ekzistojnë dy ndërtesa me bazë katrore nga materiali i fortë (Ai në plan të parë përveç kompleksit të ndërtesave ka skicuar edhe ndërtesat me material të fortë veç e veç). Njëra, ajo më afër Teatrit, ka një zgjerim që tregon minarenë e pranë saj është skicuar edhe një ndërtesë shumë më e vogël nga materiali i fortë ndërtimor. Tjetra, për një kompleks ndërtesash më poshtë, ka vetëm bazën katrore pa kurrfarë zgjerimi. Ndërtesa e epërme, xhamia, sipas Josimoviçit, i cili planin e vet e kishte hartuar në mënyrë shumë të saktë nga aspekti katastrofal, gjendet në qoshën e rrugëve Dositeji dhe Braçe Jugoviq, por jo në kompleksin në mes rrugëve Francuska dhe Dositeji, çfarë është skicuar në skicën e cila i përshkruhet Bugarskit²⁹, por në mes rrugëve Dositej dhe Dobraçina. Mirëpo, Josimoviçi, vendin e xhamisë e ka skicuar saktësisht, por në realizimin e planit të tij rregullimi i rrugës Dositej është shtyrë për rreth 20 metra kah rruga Dobraçina, prandaj xhamia ka mbetur në kompleksin e ndërtesave prapa Teatrit. Kjo mund të konstatohet me krahasimin e planit të Josimoviçit me planin e Zariqit nga viti 1878.³⁰ Ndërtesa e vogël pranë xhamisë gjithsesi është tyrbe, të cilën e përmend Gjorgje Maletiqi,

²⁷ Muzej grada Beograda, inv. br. Ur. 3752

²⁸ E. Josimović, Objašnjenje predloga za regulaciju onoga dela varoši Beograda što leži u šancu, Beograd, 1867, sa 1 kartom

²⁹ B. Nestorović, Narodno pozorište u Beogradu, Godišnjak muzeja grada Beograda, III, 1956, str. 308, sl. 3.

³⁰ Muzej grada Beograda, inv. br. Fur. 278 - Plan grada Beograda; sastavio Stevan Zarić, inžinir; izdanje Državne štamparije 1878

bashk me xhaminë.³¹ Nga plani i Josimoviçit akoma mund të maten anët e xhamisë që kanë patur gjatësinë e bazës katrore rreth 15 metra, e cila plotësisht përputhet edhe me matjet në skicën e Bugarskit. Pranë kësaj, pozita e skicuar e minares plotësisht i përgjigjet vendit të minares në fotografinë e Gromonit. Ndërtesa e poshtme, me material të fortë ndërtimor nuk ka minare, por gjykuar sipas bazës katrore gjithsesi është ndonjë ndërtesë muslimane e karakterit fetar. Nga gjithë kjo që theksuam mund të nxjerrim konkludimin: në vitin 1867 nën Teatrin Popullor ka ekzistuar vetëm një xhami, e cila ka patur minare. Ajo ka ekzistuar në këndin e rrugëve Braça Jugoviç dhe Dositej, në kompleksin e Teatrit, dhe ka patur bazën me dimensione 15 x 15 m. Pranë saj ka ekzistuar një tyrbe e vogël.

Edhe në planin e theksuar turk të Beogradit rreth vitit 1860 është skicuar nën teatër vetëm një xhami, ajo e poshtëmja, me emrin Bajram Beg.³² Nikiçi mendon se e Epërmeja nuk është skicuar për atë se ka qenë "në gjendje gërmadhe dhe rrënim". Mirëpo, argumentuam se pikërisht xhamia e Epërme, madje shumë vonë ka qenë në gjendje të mirë. Këtu ekziston padyshim edhe gabimi i dytë i paqëllimit i Nikiçit. Ai, sipas numrave të objekteve të planit turk, konstaton se xhamia e Bajram Begut ka ekzistuar nën Teatër, në kompleksin e ndërtesave në këndin e rrugëve Simina dhe Gospodar Jevremi. Mirëpo, me rastin e skicimit të planit nga gazetata komunale beogradase, ka ndodhur një gabim në përshkrimin e numrave në rrethe, kështu që numri 165 duhet të vijë në vendin e numrit 168, e numri 166 në vendin e numrit 165 (këtu ka edhe gabime të tjera, por neve, tash për tash, nuk na interesojnë). Me përmirësimin e kësillë të numrave, Xhamia e Bajram Begut do të gjendej në kompleksin e ndërtesave në mes rrugëve Braça Jugoviç dhe Simini, për afërsisht aty ku është skicuar në planin e Josimoviçit, nën ndërtesën e Teatrit, me material ndërtimor të fortë, me bazë katrore, pa bazë të minaresë. Atje ku ka menduar Nikiçi se gjendet xhamia, në të vërtetë ka ekzistuar teqeja e Sheh Hafiz Mehmedit. Gjithsesi, edhe këtu hasim në një xhami dhe në një ndërtesë të karakterit fetar në anën e poshtëme të xhamisë. Mbase vendet e këtyre dy ndërtesave nuk përputhen me vendet e tyre në planin e Josimoviçit. Këtu mund të jenë në pyetje dy gjëra: ose ai që ka punuar në planin turk ka gabuar në lokalizimin e këtyre dy ndërtesave, sepse e dimë se plani turk nuk është punuar mbi bazën e matjeve të përpikta, ose mund të jetë bërë gabim edhe me rastin e përshkrimit nga origjinali për publikimin e parë, sepse sikur në vendin ku është shënuar Mahalla e Bajram Begut të ishte xhamia e Bajram Begut, e në vendin e xhamisë Teqeja e përmendur, gjithçka do të përputhej me planin e E. Josimoviçit, e njëjtë edhe

³¹ Đ. Maletić, Grada za istoriju Serpskog narodnog pozorišta u Beogradu, Beograd 1884, str. 445 - 447.

³² Lj. Nikić, Ko je autor turskog plana Beograda iz XIX veka, Godišnjak grada Beograda, VII, 1960, str. 153

me planin mbështetur poshtme nga fundi më vonë është

Këtu është Xhamia e pohoj për xhamia në edhe një, që është më i terreni lësh Nikiçi ka ndërtesave pasqyrojë s vetmja xhami diç djathta neve të dy mund të jetë shiqohet në ndërtesë. Përqendrore, e bazë të planit e karakterit edhe vendin

Xhamia në të cilën publikuara qenë menjë e ulëta është këtë fotografi dhe në skicën

Edhe sotem, e cilës siguri, rrënim

³³ Muzej grada

³⁴ R. Perović

³⁵ J. Erdeljanović, Srpski I, Beograd

³⁶ Roden je

me planin Fr. Brushit, në të cilin sikur që konstatoam më heret, mund të mbështetemi saktësisht. Vetëm se në planin e Brushit edhe ndërtesa e poshtme është skicuar si xhami, mirëpo, pasi e dimë se plani i Brushit është nga fundi i shekullit XVIII, me siguri ajo ndërtesë atëherë ka qenë xhami, e më vonë është shndërruar në ndërtesë me karakter tjetër.

Këto konkludime tona i vërteton edhe skica e Kun Kvicovit nga viti 1856.³³ Xhaminë në Stamboll Kapi në Beograd, L. Nikiqi e konsideron se është Xhamia e Bajram begut. Mirëpo, parasegjithash, Kvicovi nuk mund të pohoj për xhaminë e cila është mjaftë larg nga Stamboll Kapia, se ajo është xhamia në Stamboll Kapi, sidomos kur më afër Portës (Kapisë) ekziston edhe një, qoftë edhe në gjendje gërmadhe. Pastaj, nga skica shihet se xhamia është më lart, se para saj ekziston një oborr i madh i rrafshhtë, dhe se pas saj terreni lëshohet, e larg saj, poshtë, gjenden xhamiat dhe ndërtesat tjera. Pasi Nikiqi ka konstatuar se xhamia e Bajram Begut gjendet në kompleksin e ndërtesave mjaft poshtë kah Danubi, skica në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojë si duket ajo. Pra, tani me siguri mund të pohojmë se kjo është ajo e vetnija xhami menjëherë nën Teatër dhe se është skicuar diku nga një vend diç djathtas prej Stamboll Kapisë ku hyhet në qytet. Në bazë të dimensioneve të dy turqëve që janë vizatuar para xhamisë, dimensionet bazore të saj mund të jenë 15 metra (në asnjë mënyrë më të vogla). Në qoftë se skica shiqohet më mirë, bie në sy djathtas në gielbrim një kulm interesant i një ndërtese. Format gjithsesi i takejnë arkitekturës fetare islame. Shihet kubeja qendrore, e rreth saj katër kube më të vogëla. Në qoftë se kemi vërtetuar, në bazë të planeve të lartëtheksuara se pranë xhamisë ka ekzistuar një ndërtesë e karakterit fetar, kjo ndërtesë mund të ishte ajo që plotësisht i përgjigjet edhe vendit të saj duke e shikuar ashtu sikur Kvicovi.

Xhami nën Teatër shihet edhe në fotografinë e Musilit nga viti 1868³⁴, në të cilën është edhe shtëpia e Dositejit. Nga dokumentet origjinale të publikuara në librin e theksuar të R. Peroviçit shihet se shtëpia e Dositejit ka qenë menjëherë nën Teatër. Edhe për këtë xhami L. Nikiqi pohon se ajo më e ulëta është xhamia e Bajram Begut, që sërish gabon. Pamja e xhamisë në këtë fotografi plotësisht i përgjigjet pamjes së saj në fotografinë e Gromonit dhe në skicën e Kvicovit.

Edhe Erdelanoviç³⁵ e di se ka ekzistuar "një xhami nën Teatrin e sotem, e cila është rrënuar para disa viteve", (shkruan në vitin 1901). Ai, me siguri, rrënimin e saj e ka përjetuar³⁶, ashtu që edhe Dedinci e ka skicuar

³³ Muzej grada Beograda, inv. br. I 1410

³⁴ R. Peroviç, Prilozi za istoriju prvog ustanka, Beograd, narodna knjiga, 1954, sl. 3.

³⁵ J. Erdelanoviç, Beograd oko 1826, Prilog uz knjigu: J. Vujić, Puteševlje po Srbiji I, Beograd SKZ, 1901

³⁶ Rođen je 1874. Enciklopedija Jugoslavije

përafërsisht aty ku edhe ne konstatuam se ka ekzistuar. Edhe Trajkoviçi, sipas tregimit të babait, pohon pikërisht mu "nën Teatër ka qenë një xhami paksa e madhe".

Nga gjithë kjo që theksuam, mund të konstatojmë se në çerekun e tretë të sheklullit XIX nën Teatër ka ekzistuar vetëm një xhami paksa e madhe dhe se ajo ka ekzistuar në kompleksin e Teatrit Popullor në këndin e rrugëve Braça Jugoviq dhe Dositej. Atë mund të gjejmë në këtë vend në të gjitha planet, skicat dhe fotografitë e asaj kohe. Pamja dhe dimensionet e saj të përafërta tani na janë të njohura, por nuk mund të vërtetojmë emrin e saktë të saj, kohën kur është ndërtuar dhe kur është rrënuar. A është në të vërtetë ajo xhamia e Bajram Begut, apo ajo teqeja, pak më poshtë, dikur ka qenë xhamia e Bajram Begut, ne nuk e dimë. A është quajtur ajo më vonë Kara Xhamia, edhe këtë nuk e dimë. Mund të jetë quajtur Tyrbe xhamia, siç thotë A. Haxhiçi³⁷, pasi pranë saj ka ekzistuar edhe një tyrbe. Në qoftë se ajo është xhamia e Bajram Begut, atëherë gjithsesi mund ta kuptojmë përcaktimin e Evlija Çelebiut, nga viti 1860,³⁸ se kjo ka qenë lartë, sepse vërtetë ka ekzistuar në platonë e Stamboll Kapisë, e prej aty terreni zbret kah Danubi. Kjo pra do të ishte njëra ndër xhamiat më të vejitra beogradase, e ndërtuar para vitit 1860. Për herë të fundit e shohim në fotografinë e Gromanit nga vitit 1876, ndërsa Erdeloviçi pohon se ka qenë e rrënuar në vitet 20 të shekullit XIX.

Mirëpo, në lidhje me xhaminë nën Teatër shtrohen edhe disa pyetje.

Skica e Kara Xhamisë nga Kanici si centralë për nxemjen e Teatrit³⁹ assesi nuk i përgjigjet pamjeve të tjera të xhamisë nën Teatër në fotografi, në skica e në plane. Kara Xhamia e Kanicit është ndërtesë e vogël, siç e ka vërejtur edhe L. Nikiçi.⁴⁰ Në raport me njeriun e vizatuar, e cili kalon pranë saj mund të thuhet se dimensionet e saja të bazës katrore janë diku 5 - 6 metra, që gjithsesi dallohen nga dimensionet e xhamisë nën Teatër, të cilën e ka matur Emilian Josimoviçi dhe Aleksander Bugarski. Edhe vetë arkitektuara e ndërtesës së tij është e ndryshme. Dritaret janë të tjera, ndërsa baza e kubesë është me proporcione të tjera. Ndryshon nga baza e ndërtesës së xhamisë nën Teatër. E vetmja gjë që me këtë rast mund të supozohet si e vërtetë është se Kara xhamia e Kanicit në të vërtetë është tyrbeja pranë xhamisë nën Teatër. Dimensionet e bazës në planin e Josimoviçit përafërsisht i përgjigjen dimensioneve në skicën e Kanicit. Po ashtu e dimë se për ngrohtoren e teatrit është riparuar edhe xhamia e edhe tyrbeja.,

³⁷ A. Hadžić, Bajrakli džamija u Beogradu, Godišnjak Muzeja grada Beograda, IV, 1957, str. 93

³⁸ Evlija Čelebija, Putopis, Sarajevo, Svjetlost, 1958, k. I.

³⁹ F. Kanitz, Srbien, Leipzig, 1904, str. 40

⁴⁰ Nikić I, str. 177

prandaj është
Xhami. A
gjendet ndo

Xhami
publikuar r
paraqitjeve
originale t
mbajnë vet
shënuar, m
xhamia e B

Pas l
skicë e ark
Nikiçit si x
karakter fet
cila në plan

⁴¹ Nikić I,

⁴² Nikić I,

prandaj është e mundur që tyrbeja me oxhakun e zi të jetë quajtur Kara Xhami. A është kjo pikërisht kështu, mund të vërtetohet vetëm pasi të gjendet ndonjë dokument për ne, tash për tash, i panjohur.

Xhamia e Bajram Begut nga skica e arkitektit Konstatin Jovanović e publikuar në artikullin e L. Nikićit "Xhamitë në Beograd"⁴¹, nuk i ngjanë paraqitjeve tjera të xhamisë nën Teatër. Pasi kemi patur rast t'i shohim skicat origjinale të xhamive beogradase të arkitektit K. Jovanović, të cilat vetëm mbajnë vetëm datat dhe janë të nënshkruara e emrat e xhamive nuk janë shënuar, mund të themis se L. Nikić ka gabuar kur këtë xhami e ka quajtur xhamia e Bajram Begut.

Pas këtyre shqyrtimve tona, mbase do të mund të identifikohet një skicë e arkitektit K. Jovanović e publikuar në artikullin e përmendur të L. Nikićit si xhami e lënun pas dore⁴². Kjo me siguri do të ishte ndërtesa me karakter fetar pranë Teatrit, kulmi i së cilës shihet në skicën e Kvicit, dhe e cila në planin turk është shënuar si Teqeja e Sheh Hafiz Mehmedit.

Përktheu: Ismail REXHEPI

⁴¹ Nikić I, str. 165

⁴² Nikić I, str. 162.

Beilage Zur Kenntnis von Belgrader Moscheen

Zusammenfassung

In seiner Arbeit veröffentlicht und stellt der Autor zum erstenmal eine Zeichnung der Ali Pascha Moschee dar. Diese Zeichnung wurde von ungarischem Ing. Lupe Peter usugearbeitet und löst die Frage des Aussehens der erwähnten Moschee. Nacher, auf Grund dieser Zeichnung, beschreibt der Autor das Aussehen derselben Moschee.

Der Autor gibt auch das Resultat seiner Studien einer Zeichnung von altem Dorçol. Diese Zeichnung wurde von Eduard Braumann im Jahre 1846 ausgearbeitet und ist ein Dokument vom unschätzbarem Wert zur Kenntnis des Aussehens dieses Teiles von Belgrad in der Mitte des vorigen Jahrhunderts.

Nachdem der unbedingt erforderliche Angaben über denselben Braumann gibt, korrigiert der Autor ältere unrichtige Meinungen, dass auf dieser Zeichnung als die letzte Moschee rechts die Sinxhirlı Moschee dargestellt ist und stellt fest, dass die tatsächlich die Moschee von Ali Pascha ist. Dann stellt er die übrigen Moscheen fest, welche in dieser Zeichnung eingezeichnet sind, schliesslich sogar die vor der Mauer auf dem Plan von Braunsingezeichnete, welche die Ruinen in vorderem Plan von Braunszeichnungen darstellt. Er schliesst dass der Plan von Bruscheingezeichnete, welche die Ruinen in vorderem Plan von Braunszeichnungen darstellt. Er schliesst dass der Plan von Bruscheingezeichnete, welche die Ruinen in vorderem Plan von Braunszeichnungen darstellt.

Nacher stellt er dar und veröffentlicht eine Photographie welche das Aussehen von Kizlar Aga Moschee, ihrer Umgebung und eines Teiles des Dorçol etwas nach dem Jahr 1862 gibt. Weiterhin stellt der Autor fest, dass die Moschee auf dem Liman befand sich ungefähr da, von wo heute die Strasse von Bruder Krsmanović abgeht und dass die Lokation dieser Moschee auf dem Plan von Dedinc nicht richtig ist.

Er gibt einige wichtigere Einzelheiten über diese, sowie über diese Moschee von Defterdar, Bajraklı, Sinxhirlı und Batal Moschee.

Der Autor stellt einige weitere unrichtige Behauptungen im Bezug auf die Frage der sogenannten Karaxha Moschee, sowie die Ubikation von Bajrambeg Moschee richtig.

Fati
ardhjen e
Rusia në l
mishit, këte
panortodo
ndryshme
shohin vet
nonte mbi
përjetoi sh
Serbia dhe
zgjërue e
pushtuan
kolonizim
Abdulham
Osman.

Du
mobilizim
dhe si arr
miti II arr
gjitha rac
Boshnjake
përgjithës
dësitë. Në
duket që
shtetit Os
Oxford, l
Shqiptare
të cilën S
agresionit
proteste

¹ C.E.Fa
Ottomanic

ROLI I ALEANCËS PANORTODOKSE BALLKANIKE NË DIVORCIN E SHQIPTARËVE NGA SHTETI OSMAN

Fati i Perandorisë multietnike Osmane u vendos në shekullin 19. Me ardhjen e Sulltan Abdulhamitit II në pozitë, shteti Osman përjetoi disfatë nga Rusia në luftërat Ruso- turke të viteve 1877-1878 dhe kjo e solli, përfundimisht, këtë Perandori në rrugën e shkatërrimit. Nën sulmet imperialiste Ruso panortodokse, Angleze, Franceze dhe më pas Italiane, shtetet dhe etnitë e ndryshme muslimane, që jetuan nën këtë Perandori me shekuj, filluan ta shohin veten e tyre nën zgjedhën koloniale, që Evropa e krishterë po impononte mbi pjesët e mbetura të Perandorisë së sakatosur. Megjithë rëniet që përjetoi shteti osman pas luftës Ruso-Turke, si rezultat i të cilave luftëra, Serbia dhe Mali i Zi u zgjeruan në Illogari të tokave shqiptare, gradualisht u zgjerua edhe Bullgaria, Rumunia u pavarësua, Bosna dhe Hercegovina u pushtuan nga Austro-Hungaria, Qiproja nga Britanikët, dhe më në fund me kolonizimin e Egjiptit nga Britanikët, të Tunizisë nga Francezët etj. Sulltan Abdulhamit II arriti që të sigurojë njëfar stabiliteti të brendshëm për shtetin Osman.

Duke e përqëndruar pushtetin në duart e tij dhe duke përdorur mobilizimin panislamist si armë frikësuese ndaj fuqive grabitçare Evropjane, dhe si armë mobilizuese për popujt Islamë të Perandorisë,¹ Sulltan Abdulhamit II arriti që të mobilizojë në mbrojtje të Perandorisë së tij pothuajse të gjitha racat që jetonin nën këtë Perandori. Ashtu si me Arabët, Kurdët e Boshnjakët, edhe Shqiptarët si komb musliman që ishin, i qëndruan, në përgjithësi, besnikë pushtetit Hamidian dhe i shërbyen atij me të gjitha mundësitë. Në fakt, Abdulhamit, në ditët e fundit të ekzistencës së tij si Sulltan, duket që t'i ketë dhënë shumë përparësi elementit Shqiptarë në kornizat e shtetit Osman. Sipas Prof. J.Landau në librin "Politika Pan-Islame" (Oxford, 1990, pp.48-49) Lidhja Shqiptare e Prizrenit që u krijua nga paria Shqiptare me 1878, ishte një nga organizatat e para të mobilizimit Panislami, të cilën Sulltan Abdulhamit u mundua ta krijojë në shtetin e tij kundër agresionit Evropian. Lidhja Shqiptare e Prizrenit, që u formua në shenjë proteste nga populli Shqiptarë kundër agresionit panortodoks, të cilin

¹ C.E.Farah, Reassessing Sultan Abdulhamid II's Islamic Policies, *Archivum Ottomanicum*, nr.14, 1995-96, pp.192.

agresion Kongresi i Berlinit e legjitimoi në trevat Shqiptare, përveç kërkesave Shqiptare për ruajtjen territoriale, nuk harroi që të vej në dukje karakterin Islam Shqiptarë, duke vënë në dukje dëshirën e Shqiptarëve për besnikëri ndaj Sulltanit osman dhe ligjeve të Sheriatit.² Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk i shkëputi lidhjet me Portën e Lartë të Stambollit, dhe një gjeneratë më vonë, gjatë kohës së agresionit Italian në Libi, me 1911, demonstrata prosulltaniane u shfaqën nëpër Shqipëri në mbështetje të Sulltanit – Halif, duke shprehur gadishmërinë Shqiptare për të luftuar të pafatë (Italianët) që pushtuan Libinë.³

Një kooperim të gjerë të elementit Shqiptarë nën suazat Hamidiane, ne e shohim edhe te truprojat e Sulltan Abdulhamitit, që ishin malësorë Shqiptarë, me në krye Isa Boletinin. Sekretarë të tij u bënë shumë Shqiptarë, si Ismail Qemal Bej Vlora e Mareshal Rexhep Pasha, kushëriri i Ismail Qemalit, Ferid Pashë Vlora i cili ishte edhe Kryetar i Shoqërisë Shqiptare të Stambollit, u bë kryeministër i shtetit Osman nga S.Abdulhamiti në vitin 1903⁴ Shemsuddin Sami Bej Frashëri, përveç themelimit të gazetës Sabah, Terxhuman-i shark, botimit të Kamusu-la'lami, etj., u inkuadrua nga Sulltan Abdulhamiti, gjithashtu në politikën Osmane, si anëtarë i Këshillit të Inspektoratit të Ushtrisë Osmane.⁵

Fuqizimi i lëvizjes Xhon-turke në shtetin Osman i mbështetur fuqishëm nga qarqet që kërkonin reforma në Perandori, duke përfshirë këtu edhe shumë grupe Shqiptare, dhe sponsorizimi masiv që Donmet⁶ Selanikase i dhanë agjentëve anti-hamidian pushtetin e S. Abdulhamitit e solli buzë greminës në pranverë të vitit 1909. Me 13 prill të vitit 1909, pas revoltës së truprojtës Shqiptare të S. Abdulhamitit me qëllim të mbrojtjes së tij në Stamboll, bënë që forcat Xhon-turke të ardhura nga Selaniku ta shtypin këtë revoltë pro-Hamidiane dhe ta rrëzojnë Abdulhamitin duke e përdorur shqiptarin Esad Pashë Toptanin.⁸

Rënia e pushtetit të Abdulhamitit dhe dalja e Xhon – turqëve në skenë nuk sollën rezultate të mira për minoritetet në shtetin Osman. Edhe pse lëvizja Xhon-turke pati si liderë të saj Shqiptarë si Ibrahim Temon dhe Ahmet Njaziun. Pas rënies së Abdulhamitit ajo u mundua që të Osmanizojë

² Sh. Ballvora, La "Ligue de Prizrend" et la question de l'autonomie de l'Albanie, pp.50

³ Turkei nr.198, vol.7, German Consul Gerhard von Mutius to Reichskanzler Bethman Hollweg, Selanik, 8.10.1911.

⁴ J.Swire, Albania, The Rise of a Kingdom, pp.78.

⁵ S. Shaw, History of the Ottoman Empire and Modern Turkey, vol.II, pp.254

⁶ Cifuteria e konvertuar në Islam në shtetin Osman njihej me emrin " donme"

⁷ Si nr. 5, pp.265.

⁸ Ibid, pp.90.

të gjithë s
ndaluan ab
shtetin Os
nxitë lider
nacionaliz

Ak
Shqiptare,
Shqiptarë
mitit, kriju
tepër refor
krijimin e
shqiptarët
personale
prohamidia
turk (në sh
Xhavit Paz
drejt divorc
en për pesë

Në t
acarimin k
ankth e me
viti 1910
Malazezët
sa të veta.
malësorët
qëllim krye
Shqipëri.¹¹
min malaze
të Veriut, r
të kundërve
forcat mala
shqiptarë, e
sorët katol

⁹ Ibid, pp.28

¹⁰ Ibid.

¹¹ Histori e S

¹² Po aty, f.4

të gjithë subjektet e këtij shteti multietnik. Megjithatë Xhon – turqit nuk i ndaluan aktivitetet e klubeve nacionaliste, në fillim të udhëheqëjes së tyre në shtetin Osman, ata filluan propagandën e tyre për Pan-osmanizëm, gjë që nxiti liderët nacionalistë Shqiptarë që kësaj ideje t'i përgjigjen me atë të nacionalizmit Shqiptarë.

Aktiviteti i Ismail Qemalit nëpër Stamboll si përfaqësues i interesave Shqiptarë, bashkëpunimi i tij me Unionin Liberal dhe revolta e ushtarëve Shqiptarë kundër masave që ndërmoren Xhon-turqit, në kohën e Abdulhamitit, krijuan keqkuptime midis Xhon-turqëve dhe Shqiptarëve.⁹ *Për më tepër reformat që bënë Xhon-turqit më vonë në shtetin Osman, duke ndaluar krijimin e shoqërive nacionale, mbajtjen e armëve dhe lirive të tjera, të cilat shqiptarët i kishin pasur me shekuj revoltuan Shqiptarët*¹⁰ Madje edhe inatet personale që Xhon-turqit, si duket, i kanë pasur me shumë ish-mbështetës prohamidian, kryengritjeve që organizoi Isa Boletini kundër pushtetit Xhon-turk (në shumë raste i shtyrë nga serbët) dhe masakrave që Shefqet dhe Xhavit Pasha ndërmoren kundër malësorëve Shqiptarë, i shtynë Shqiptarët drejt divorcit përfundimtar me Osmanët dhe Devletin në të cilin ata shërbyen për pesë shekuj me radhë.

Roli i aleancës Panortodokse në copëtimin e Shqipërisë

Në të njëjtën kohë, kur marrëdhëniet Shqiptaro – Turke kishin arritur acarimin kulmorë, fuqitë grabitçare panortodokse Ballkanike, i shikonin me ankth e me dëshirë këto përplasje. Pas shuarjes së kryengritjes Shqiptare të vitit 1910 dhe arratisjeve të shumë kryengritësve Shqiptarë në Mal të Zi, Malazezët u munduan që përplasjet Osmane-shqiptare t'i përdorin për interesa të veta. Për këtë, në pranverë të vitit 1911 Kral Nikolla i Malit Zi, i shtiu malësorët shqiptarë që të ngriten rishtazi kundër Turqëve, duke pasur, për qëllim kryesorë që këto kryengritje ta përdorte për qëllime ekspansioniste në Shqipëri.¹¹ Mali i Zi duke përdorur bajraktarë si Sokol Baci, që ishin në shërbimin malazez, synonte që të organizojë rrebelim të masës katolike në Malësi të Veriut, rrebelim i cili me fanatizmin e vet nxiti muslimanët e Shkodrës që të kundërveprojnë ndaj këtyre veprimeve. Duke shfrytëzuar fanatizmat fetare forcat malazeze arritën që të vejnë bashkëpunim të plotë me rrebelët katolikë shqiptarë, dhe në shtator të vitit 1912 repartet malazeze sëbashku me malësorët katolikë hynë në luftë kundër forcave shtetërore Osmane¹² dhe

⁹ Ibid, pp.288.

¹⁰ Ibid.

¹¹ *Histori e Shqipërisë*, vëllimi II, 1984, fq.450

¹² Po aty, f.488.

shqiptare. Lufta e tyre në shumë raste pati karakter primitiv, ajo ishte luftë mes fisesh¹³ për të larë me këtë rast haqet e vjetra.

Fillimi i luftës Italo-Turke, dhe situata në Shqipërinë e Veriut, nuk ia jasht dore as Greqinë dhe Bullgarinë, të cilat filluan të afrohen me njëra tjetrën për të vepruar në ngjarjet që ato i përjetonin me rrëzimin e shtetit Osman. Lufta Italo-Turke që filloi në shtator të vitit 1911, u tregoi forcave panortodokse në Ballkan se shteti Osman nuk kishte fuqi që t' u bëntë ballë sulmeve të tyre të organizuara.

Greqia, në të njëjtën mënyrë si Mali i Zi, e mbështeti fuqishëm revoltën Shqiptare në Malësi të Veriut. Për këtë Greqia dërgoi Ioannis Gryparin, ministrin e jashtëm grek që ta mbështesi luftën e Malësorëve në Veri nëpërmjet agjunkturës së tij, dhe në të njëjtën kohë, të ketë kujdes që kjo kryengritje të mos kalinte në Shqipërinë e jugut. Grekët besonin se nacionalistët Shqiptarë kishin plane që kryengritjen e tyre anti Osmane ta përhapin edhe në Epir dhe sanxhakun e Korçës, në mënyrë që ta fusin Greqinë në luftë me Turqinë dhe ta deklaronin Epirin tokë Shqipëtare¹⁴ duke minuar Megali Idenë greke për atë zonë.

Në këtë kohë kur Shqipëria e Veriut ishte e trazuar, qeveria Austriake mbështeste idenë për krijimin e një Shqipërie Autonome-etnike, e cila do të ballancohte fuqinë Serbe e Bullgare në Ballkan. Austriakët besonin se një Shqipëri autonome, me Selanikun, të cilin ata e shihnin si një qytet që duhej t'i përkiste Turqisë, do të kishin rrugë të lirë për në Lindje. Për këtë arsye Austria gjatë gjithë jësaj periudhe punoi me agjunkturën e saj, që në Ballkan medoemos të krijohet një shtet Shqiptarë i fuqishëm, i cili do të minonte Serbinë në Adriatik dhe në gadishull. Jo më kot, Faik Konica pati thënë se: "Të mos ishte Austria, sllavët dhe grekët do ta merrnin për 24 orë Shqipërinë... Frika e Austrisë i mban armiqt tanë; ata që s'e kuptojnë këtë janë gomarë."¹⁵

Por, ideja e një Shqipërie etnike autonome refuzohej, fuqishëm, nga Greqia, Bullgaria e Serbia. Për këtë arsye, në Tetor të vitit 1911, kryeministri bullgar Geshov dhe ai serb Millovanoviq, filluan bisedat dhe planet e tyre, për ta minuar këtë ide. Në bisedat që pati Geshovi me kryeministrin serb Millovanoviq, ky ia bëri të qartë Geshovit se solucioni më i mirë për interesat serbe në Ballkan do të ishte pushtimi i Shqipërisë së Veriut dhe sigurimi i një rruge detare për të dalë Serbia në Adriatik, dhe pushtimi i Shqipërisë së Jugut nga Greqia.¹⁶ Në këto bisedime, Serbia me Bullgarinë

¹³ Si shenimi nr.4, pp.142.

¹⁴ Letër e Ministrisë së Jashtme Greke, dërguar Konsullatave në Shqipëri dhe Epir. Athinë, 25,prill,1911, nr.10193.

¹⁵ Sh. Delvina, *Pa pavarësi Fetare nuk ka pavarësi kombëtare*, 1998, Tiranë, f.102.

¹⁶ I.E.Geshov, *The Balkan League*, London, s.a. pp.15.

ranë dako
të Kosovë
të kishte t

Me
për një S
duke rën
Ruse, ish
gjenin gj
mars 191
Ballkanit
për luftë
dakort që
marrjen e
Bullgaria
perendim
Kosovën.
Struma d
më vonë
merre nj
merre vi
Vardar të

Gj
mes dy z
Italian, d
Ballkan
Megjitha
komandë
organizoj
zyrtarisht
me Libia
që ta dol
dërgimin
Shqipëri
ishite vën
Austriak

¹⁷ Shih sh

¹⁸ Ernst

¹⁹ Shih: n

²⁰ Shih: n

ranë dakort që Serbia të kishte të drejtë të plotë mbi vilajetin e Shkodrës dhe të Kosovës, që ndodhej në Veri të Bjeshkëve të Sharrit, ndërsa Bullgaria do të kishte të drejta mbi vilajetin e Adrianopojës – Edrenes.¹⁷

Me këto traktate të fshehta panortodokse, në Ballkan planet Austriake për një Shqipëri Etnike u shkelmuan nga Bullgaria dhe nga Serbia, të cilat duke rënë dakort mbi të ardhmen e territoreve Shqiptare, nën udhëzimet Ruse, ishin udhëzuar nga qendrat oanortodokse të Rusisë, që pas kësaj të gjenin gjuhë të përbashkët me Malin e Zi dhe Greqinë.¹⁸ Kështu që me 12 mars 1912, nën komandën Ruse u përfundua aleanca e parë panortodokse e Ballkanit ndërmjet Serbisë dhe Bullgarisë. Të dy vendet, pasi që u pajtuan për luftë të përbashkët kundër Turqisë dhe territoreve Turke në Ballkan, ranë dakort që në rast fitoreje, Serbia do të njihte të drejtën e Bullgarisë për marrjen e territoreve në Lindje të maleve Rodope dhe lumit Struma, ndërsa Bullgaria të njihte të drejtën e Serbisë që ta shtrij sundimin e saj deri në perëndim dhe veri të maleve të Sharrit, duke përfshirë këtu të gjithë Kosovën. Mirëpo për zonën që mbetej ndërmjet maleve të Sharrit, lumit Struma dhe Liqenit të Ohrit duhej të formohej një shtet autonom. Po nëse më vonë do të vendosej që ky territor të ndahej mes tyre, atëherë Serbia do të merrte një rrip të territorit në Maqedonin veriore, kurse Bullgaria do të merrte viset përreth Ohrit. Një zonë e lirë që do të lihej në të dy anët e lumit Vardar të sipërm, do të ishte nën administrimin e Car Nikollës II të Rusisë.¹⁹

Gjatë luftës Italo-Turke të vitit 1911 në Libi, pushteti Osman u gjend mes dy zjaresh. Nga njëra anë ata duhej që të mbronin Libinë nga agresioni Italian, dhe në anën tjetër ata duhej që të merreshin me kryengritjet në Ballkan që sponzorizoheshin nga Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Italia. Megjithatë pushteti osman dërgoi në Libi disa përforsime të vogla nën komandën e Mustafa Kemal Beut (Ataturkut) dhe Enver Beut që të organizojnë rezistencë ndaj agresionit Italian. Edhe pse Italianët deklaruan zyrtarisht pushtimin e Libisë me 4 Nëntor 1911, rezistenca Osmane (bashkë me Libiasit) vazhdoi në formë guerile përbrenda vendit. Italia duke dashur që ta dobësojë pushtetin Osman sa më shumë që të jetë e mundur, filloi dërgimin masiv të armëve dhe vazhdoi t'i nxiste acarimet anti-Osmane në Shqipëri dhe Mal të Zi,²⁰ nëpërmjet spiunazhit dhe agjenturës së saj. Ky fakt ishte vënë re që më parë dhe spiunazhi serb pati vënë re se përveç agjenturës Austriake agjentët italian po punonin intensivisht në Shqipëri dhe

¹⁷ Shih shenim 11, f.486.

¹⁸ Ernst Helmreich, *The Diplomacy of the Balkan Wars 1912–1913*, pp.32-33.

¹⁹ Shih: nr.16, pp.53-55.

²⁰ Shih: nr.5, pp. 290.

parashikohej që nga ata të nixtej një revoltë e madhe në pranverë të vitit 1912.²¹

Patriotët shqiptarë duke përfituar nga kaosi, që po përjetonte shteti Osman, u munduan që këtë lojë ta luajn në interes të tyre. Shqiptarët Arbëresh të Italisë, në bashkëpunim me spiunazhin Italian, në këto kohë kaluan në krah të Italisë, përkundër planeve Austro-Hungareze, apo, shteteve sllave ndaj Shqipërisë.²² Duke parë rrjedhën e ngjarjeve në Perandori, deputetët shqiptarë në parlamentin Osman i kërkuan qeverisë që të garantonte reforma politike, ekonomike dhe kulturore për Shqipërinë. Përë këtë, Hasan Prishtina e paralajmëroi Portën e Lartë se nëse këto dëshira nuk përmbushen, Shqipëria do të revoltohej.²³ Në të njëjtën kohë Hasan Prishtina shkoi në Shkup dhe u përpoq të hynte në bashkëpunim me Organizatën e Brendshme Maqedone, të organizonte rezistencë në Maqedoni. Por ky bashkëpunim nuk u arrit me Maqedonët, pasi që qeveria Bullgare ua ndaloi atyre të hynin në negociata me shqiptarët.

Mirëpo Serbia vepronte ndryshe. Ajo i furnizoi shqiptarët me armë dhe mezi priste shpërthimin e luftës, që do të prishte status quo-në e Ballkanit, ku shqiptarët do të vriteshin me Osmanët. Pasi që do të dobësoheshin të dyja palët, fituese do të dilte Serbia dhe liga Panortodokse Ballkanike.²⁴ Prandaj Serbia dërgoi shumë agjentë të saj në mesin e shqiptarëve, dhe në veçanti të Isa Boletini, për t'i bindur ata që të luftojnë kundër regjimit Xhon-turk. Dimitrijeviq Apis, kryetari i organizatës serbe Cerna Ruka (Dora e zeze), ishte një nga agjentët më të suksesshëm serb që arriti ta bindëte Isa Boletinin, se serbët dhe shqiptarët duhet ta çlironin tokën e tyre nga turqit.²⁵

Në maj të vitit 1912, një aleancë tjetër panortodokse, ngrehu telat e saj për uzurpimin e trojeve Shqiptare në Ballkan. Ajo ishte aleanca Greko-Bullgare. Marrëveshja Greko-Bullgare, ishte një marrëveshje e fshehtë, defansive, e vlefshme për tre vjet, e cila synonte mbrojtjen dhe luftën e përbashkët Greko-Bullgare kundër Turqisë. Sipas marrëveshjes në fjalë, në rast se një nga shtetet në aleancë sulmohet nga Turqia, atëherë shteti tjetër duhet t'i shpallte luftë, dhe në këtë luftë të dy shtetet do të vepronin si një trup i vetëm kundër Turqisë dhe Fuqive të Mëdha. Në këtë aleancë, Greqia me Bullgarinë futën, si pjesë të traktatit të tyre, përveç ambicjeve të tyre kundër Turqisë kontinentale, edhe interesat grabitqare greke ndaj Qipros.²⁶ Edhepsë Greqia me Bullgarinë kishin mosmarrëveshje të tyre në lidhje me

²¹ BD., vol. IX, pjesa I, nr.540, Barclay to Grey, Beograd, 16.01.1912.

²² Shih: nr. 11, fq.329.

²³ Po aty.

²⁴ Po aty.

²⁵ Shih: nr 4, pp. 128.

²⁶ Shih: nr. 16, pp.133.

geshtjen M
kthyen në r

Meg

ishin shum

marrëveshj

Shqiptarët.

lidhje me re

trazirat shq

tyre ogurze

të toka ve të

Mirëp

që t'i impor

nga Shqipta

nxitën fuqit

antishqiptar

Tahsin Pash

interes për k

dërgoi minis

mëdha ta in

ndërhyrjet a

Greqinë, Se

Shqiptarë.

Ndaj

kryqzatës a

shqiptare, G

një aleancë

koncesionet

grekëve. Gre

refuzimin e

Koromilla, i

'përmirësimi

ata duhet që

Pas sh

Greqia kaloi

Shkodrës, I

amnistisë që

përgjigjen po

²⁷ B. Kondis.

²⁸ Shih: nr. 4.

²⁹ Athinë, 20 g

³⁰ T. Zavalan

çeshtjen Maqedone, ata i lanë anash këto zënka dhe marrëveshjen në fjalë e kthyen në një marrëveshje plotësisht anti-turke.

Megiithatë, marrëdhëniet Greko-Bullgare edhe pas kësaj marrëveshje ishin shumë të dyshimta. Secila palë kishte dyshim dhe frikë rreth ndonjë marrëveshje të fshehtë, që Greqia, apo Bullgaria mund ta bënte me Shqiptarët. Në të njëjtën kohë Greqia dhe Bullgaria ishin të shqetsuara në lidhje me revoltën në Shqipëri, dhe secila palë kishte frikë se mos po kalonin trazirat shqiptare në Maqedoni dhe në Epir, gjë që do të minonte planet e tyre ogurzeza mbi zonat e përmendura²⁷ duke mobilizuar shqiptarët si t'zot të toka ve të tyre.

Mirëpo sukcesi i shqiptarëve, me 9 gusht të vitit 1912, kur ata arritën që t'i impononin Turqisë kërkesat e tyre për autonomi, reforma dhe kontroll nga Shqiptarët e vilajeteve të Kosovës, Janinës, Manastirit dhe Shkodrës i nxitën fuqitë panortodokse Ballkanike që të shpërthejnë në amok të egër antishqiptarë. Greqia, në veçanti, kaloi në një amok të paparë, kur Hasan Tahsin Pasha u bë Vali i Janinës,²⁸ kapitalit të Çamërisë, Austria që kishte interes për krijimin e shqipërisë, duke parë rrezikun panortodoks në Ballkan, dërgoi ministrin e jashtëm Kontin Leopold Berchtold që t'u kërkojë fuqive të mëdha ta inkurajojnë Turqinë që të decentralizojë administratën e saj, por, ndërhyrjet austriake dhe koncesionet e tyre ndaj shqiptarëve në gusht, për Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë ngjallën frikën ndaj krijimit të shtetit Shqiptarë.

Ndaj këtij fakti që po kryhej, Greqia ndërmoi hapin e parë të kryqzatës antishqiptare. Me 18 gusht kur Turqia u pajtua me kërkesat shqiptare, Greqia i kërkoi Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi që të formonin një aleancë katërpalëshe kundër Shqipërisë dhe shqiptarëve me qëllim që koncesionet e propozuara nga Austria të kthehen në favor të sllavëve dhe grekëve. Greqia ushtroi protestë²⁹ porse Turqia e injoroi këtë protestë. Me refuzimin e kërkesës greke nga turqit, ministri i jashtëm grek Llabro Koromilla, i kërkoi shteteve ortodokse të Ballkanit që nëse Turqia nuk bënte 'përmirësimin' e menjëhershëm të gjendjes së krishterëve në shtetin Osman, ata duhet që të hidheshin në luftë.

Pas shpalljes së autonomisë së Shqipërisë, Mali i Zi, ashtu edhe Greqia kaloi në amok. Edhe pse malësorëve katolikë iu dërgua Peshkopi i Shkodrës, Imzot Serreqi³⁰, që t'iu spjegonte çeshtjen e autonomisë dhe amnistisë që e pritnin, ata të shtyrë nga Mali i Zi, kësaj nisme nuk iu përgjigjën pozitivisht. Për këtë, ata u kërkuan malësorëve që të vazhdojnë

²⁷ B. Kondis, *Greece and Albania*, pp.72-74.

²⁸ Shih : nr. 4, pp.124.

²⁹ Athinë, 20 gusht, 1912, letër Ambasadës në Stamboll.

³⁰ T. Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, fq. 215.

luftën e tyre për paravarësi deri në fund. Mali i Zi u afrooi malësorëve shqiptarë armë e municion që të vazhdonin luftën. Urrejti e katolikëve për turqit, i bëri ata që të verbërohen e të mos e kuptojnë hipokrizinë malazeze. Në shtator, disa udhëheqës malësorë morën udhëzime nga Cetinja dhe revolta u ndez përsëri. Austrohungaria duke i kuptuar lojrat malazeze refuzoi t'u vinte në ndihmë malësorëve katolikë. Por, malësorët sulmuan Plenicën. Fisi i Kelmendëve, nën udhëheqjen e Dedë Sokolit përparuan kah bregu i Matit për t'ia prerë rrugën përforcimeve që po vinin në ndihmë të Shkodrës nga Tirana me rrethe. Më 8 tetor, malazezët hynë në lojë, duke i shpallur luftë të shenjtë (kryqëzatë) Turqisë dhe nisën pushtimin e tokave shqiptare.³¹

Me përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Ballkan dhe formimin e shtetit autonom shqiptar, fuqitë panortodokse të Ballkanit nuk patën zgjedhje tjetër përveç luftës. Kështu që me 26 gusht 1912, Bullgaria vendosi të marshojë drejt luftës kundër Turqisë. Me 5 shtator 1912, qeveria Bullgare e njoftoi Greqinë se Serbia dhe Bullgaria kishin vendosur për të shkuar në luftë kundër Turqisë dhe për këtë dëshironin mbështetjen greke.³² Kryeministri grek Eleftherios Venizelos i gjetur përballë kësaj kryqëzate antishqiptare, nuk mbeti pasiv, por e shtyri Greqinë në luftë kundër Turqisë. Me 13 tetor, Greqia, Bullgaria dhe Serbia i paraqitën ultimatum Portës së lartë që të respektojë të krishterët e shtetit të saj. E gjendur përballë terrorizmit panortodoks Ballkanik, me 17 tetor, Turqia u detyrua që t'i përgjigjet ftesës panortodokse me shpallje lufte kundër Bullgarisë dhe Serbisë. Me 18 tetor, Greqia iu bashkangjiti ligës panortodokse dhe i shpalli luftë Turqisë,³³ me çka filloi lufta e parë Ballkanike.

Pas pushtimit që i bënë trevave autonome Shqiptare ushtritë panortodokse Ballkanike, çeshtja e ardhmërisë së kombit shqiptarë vehej në pikepyetje. Malazezët, të cilët përkrah malësorëve katolikë të Dedë Sokolit, me 22 shtator kishin filluar pushtimin e Veriut të Shqipërisë,³⁴ me 8 tetor i shpallën luftë Turqisë dhe me 28 tetor rrethuan Shkodrën.

Me 10 nëntor, grekët pasi kishin pushtuar Selanikun, rrethuan Janinën. Më pas pushtuan Sazanin dhe Himarën.³⁵ Në Himarë, ishte ngritur në revoltë qysh me 5 nëntor kolona e pestë e grekofilit Spiro Milos duke luftuar kundër vullnetarëve shqiptarë dhe trupave turke. Me 20 nëntor, nën komandën e gjeneralit Damianos u pushtua Korça.³⁶ Serbët pushtuan Kosovën me 23 tetor dhe bashk me malazezët, pasi thyen forcat Osmano –

³¹ Shih: nr. 4 pp.134.

³² Panasi ndaj Koromiliasit, Sofia, 5.09.1912.

³³ Shih: nr. 4, pp.134.

³⁴ Ibid, pp.133.

³⁵ Shih: nr. 11, fq.493.

³⁶ P. Ruches, *Albania's Captives*, pp.66

shqiptarë në
Bej Qemali,
gjendjen me
princin mal
pavarësinë e
posedimet e
Qemal Pash
qeverinë Tu

Pas ke
pavarësi për
panortodoks
konsideronte
tarët e tij, u
1912 shpall
dokse e Ball
hirë të intere
panortodoks
'vendosën' p
trinë në grin
Londineze.³

Status
nuk kishte
vilajetet ata
të mëdha, s
greko-malaz
shqiptarë, e
në Ballkan.
përjetoi lind
gjithnjë vigj
tërë shekulli

³⁷ Shih: nr.5.

³⁸ Shih: nr. 4.

³⁹ Si shenimi

shqiptare në Kumanovë, u drejtuan drejt Prishtinës dhe Jenipazarit.³⁷ Ismail Bej Qemali, i cili në këtë kohë po shkonte për në Stamboll për ta shqyrtuar gjendjen me kabinetin Osman, gjatë rrugës u pengua dhe nuk u takua me princin malazez Mirko, në Triest. Mirkoja i kërkoi Ismailit, që ai të shpallte pavarësinë e Shqipërisë, duke e shpallë Ismailin mbret dhe duke i njohur posedimet e Malit të Zi në Veri të Shqipërisë. Në të njëjtën kohë veziri Qemal Pasha i kërkoi Ismailit që të bënte dhe të merrte një post ministror në qeverinë Turke, por Ismail Qemali këtë e refuzoi.

Pas kësaj, ai u kthye në Shqipëri dhe në Durrës kërkoi që të shpallte pavarësi për tokat shqiptare, të cilat akoma nuk kishin rënë nën pushtimin panortodoks. Por, popullsia e Durrsit, Ismail Qemalin dhe shokët e tij i konsideronte si 'agjentë dhe provokator'. Për këtë Ismail Qemali me veprimtarët e tij, u detyruan të largohen nga Durresi për në Vlorë dhe me 28 Nëntor 1912 shpalli pavarësinë e Shqipërisë³⁸ së sakatosur nga kryqzata panortodokse e Ballkanit. Italia dhe Austria e pranuan këtë pavarësi menjëherë për hirë të interesave të tyre në Ballkan dhe nga frika e përparimit të mëtejshëm panortodoks. Në konferencën e Ambasadorëve në Londër, fuqitë Evropiane 'vendosën' për kufijt e Shqipërisë, duke lënë, kështu vetëm Italinë me Austrinë në grindje për 'Princin' e mundshëm që duhej të udhëhiqte Shqipërinë Londineze.³⁹

Gjatë tërë kësaj ligjërate, autori është mbështetur kryesisht në ajete të Kur'anit, e rrallë herë edhe në hadithe të Muhammedit a.s.H.Ismet Dibra në këtë diskutim konstruktiv e konciz argumentimit të ekzistencës së Zotit xh.sh. i qaset sipas parimeve që ndjekin teologët islamë në bazë të katër metodave: *Meslek-i huduth, meslek-i imkanë, meslek-i gaje dhe meslek-i ihda ve-l-ihira*. Në këtë mënyrë autori hudh poshtë bindshëm teorinë e materialistëve, se bota është krijuar rastësisht me një incident që ka ndodhë në eter, nga i cili incident janë shpëputur yje të ndryshëm, trupa qiellor, si Dielli, Hëna dhe Toka. Ai i përkujton ata në bamuninë, se i bëri nuk mundet ta kuptojë dhe ta konkretizojë bërësin e vet, prandaj është meqenuri më e madhe t'i përmbahen hadithit të Muhammedit a.s. "*Mendoni gjërat që i ka krijuar All-llahu për ju dhe mos mendoni në formën se si është All-llahu*".

Lexusi këtu gjen edhe fakte, se numri më i madh i filozofëve me pikpamje materialiste, pas studimeve të tyre, kah fundi i jetës së tyre i afrohen të vërtetës, që do të thotë, binden, se mbi të gjitha fuqit natyrore është një fuqi jomateriale e cila drejton "... bërjen dhe zbërjen e çdo sendi". Dekarti, pas dyshimeve që shprehur në fillim, do të konstatojë "*Kur e shqyptoi fjalën Perëndi, kam për qëllim një fuqi absolute që asht e anshueshme, sovranë e plotpushtedhshme, din çdo gjë, ka krijue gjithsinë edhe mue...*" Ajo është "*Qënia e pasosur që e ka mbjellë këtë kuptim në ndërgjegjen t'eme që jam i sosun*" (f. 70). Ndërsa Njumi, pasi studjoi lëvizjen e trupave qiellor u shpreh "*Pra, kur shifur ky rregull artistik e ky kujdes, asht e pamundun të pranohet se s'ka pushtet hyjnuer*" (75)

Pikërisht këtu konstatime e arsyetojnë titullin që mban ky libër i L.Dibrës. Këtu duhet shtuar rolin e interpunkcionit. Kështu si

është në libër duket se po shprehet dyshim, sepse është shtruar me pikëpyetje, A KA DYSHIM NË QENËJEN E ZOTIT? Prandaj për një ribotim të kësaj veprë shumë të rëndësishme për lexuesin shqiptarë titulli duhet shkruar ndryshe dhe në fund të veht pikëpyetja dhe pikëçuditja, A NË ZOTIN KA DYSHIM?! që është më afër originalit: *Efi l-lah ish ekkun!*? ose

A DYSHOHET NË ZOTI?

Ky tekst i Hafiz Ismet Dibrës në kohën kur është botuar në revistë ka shërbyer si preventivë por të mos rënë opinionin shqiptarë në grackën e ateizmit. Megjithatë këto gracka e preken edhe popullin shqiptarë, me shumë institucionalisht se sa shpirtërisht. Kurse sot, pas gjashtëdhjetë vjetësh, ky tekst shërben si terapi për të shëruar ata që u infektuan qoft formalisht apo realisht nga ajo sëmundje. Është ilaçi më i mirë kundra të ashtuquajturit ateizëm që në fakt është formë e idhujtarisë moderne, sepse ai që nuk beson në një Zot, adhuron individë e idole të ndryshme.

Në libër është ruajtur originaliteti i tekstit ashtu siç ka qenë i botuar në revistën *Zani i Natës*, dhe përveç titujve ç'asht Kur'anit, A ka dyshim në Qënieën e Zotit dhe Përbajtja e versetit, nuk ka tjerë tituj, porse materia është e ndarë me yllëza pauze dhe numra romakë, të cilat në libër mund të kenë funksionin e kapitullit, dhe nëse e marrim kështu, ky libër përbëhet prej 12 kapitujve.

Teksti që po e prezentojmë dhe tekste tjera të asajë kohe janë me vlerë edhe për ndërtimin e terminologjisë islame shqiptare. Këtu e hasim: *Njitim* për termin *Tevhid*, *Dekret Hyjnor* për *Kur'anin*, *Testamenti Plak* për *Dhjata e Vjetër* etj. Mendoj se për *Tevhid* mund të përdoret edhe *Unikatësi*, kurse për *Kur'anin* mund të shprehemi se ai është Kod univerzal Hyjnor. Për të gjitha vler dhe meriton të diskutohet në nivel dhe subjekte me kompetencë profesionale e shkencore. Përdorimi i termit *profit* krahas atij *profet*, mund të jetë gabim rasti, sepse fjala *profit*, sot, nuk mbulon kuptimin e të dërguarit të All-llahut. Madje për *Ummet*, në këtë kontekst (f.25) duhet të përdoret termi pari ose *Ulema*.

Pavarësisht nga fakti, se gjuha e këtij libri është një gjuhë e para gjashtëdhjetë vjetësh, si edhe materia që trajtohet nuk është

aspak e tel
edhe sot të
sit shqiptarë
më i larti. I
që gjuha e
sipas norm
letrare.

Libri
meriton të lo
të veçantë,
Vehbi Isma
që e ruajtën
sit shqiptarë
nuk do ta kis

KATALO
OSM

ARNAVUTI
OSMANLI

OTTO
CATALOC
ARCHIVE

Viti 200
fushën e pasq
shkrimeve orien
Në këtë vit u
libri dokumente
shkrimeve osma
në tri gjuhë: tur
tim vëllimor pr
495 zëra. Një p
shkuj, që nxje
shkruajne shqip
manisht e që traj
ologji, filozofi, c
nika etj. në prozë
të Frëngjishtes,
arabisht-frëngjisht
Botimi para
thukëta, nga dy
kësaj fushe: Prof

⁶ Në fund të vitit
është organizuar pr

aspak e lehtë, Hafiz Ismat Dibra po arrin që edhe sot të komunikojë me sukses me lexuesit shqiptar prej nivelit mesatar e deri te ai më i larti. Për ndonjë ribotim vlen përpjekja, që gjuha e këtij libri të jetë e standardizuar sipas normave të gjuhës së sotme shqipe letrare.

Libri A ka dyshim në qenjen e Zotit? meriton të lexohet dhe të rilexohet me kujdes të veçantë, kurse Haki Sharofi dhe Imam Vehbi Ismaili meritojnë mirënjohje të lartë që e ruajtën deri sot dhe e përcollën të lexuesit shqiptarë. Pa kujdesin e tyre këtë libër sot nuk do ta kishim.

Dr. Feri Mehdiu

**KATALOGU I DORËSHKRIMEVE
OSMANE NË ARKIVAT E
SHQIPËRISË**

**ARNAVUTLUK DEVLET ARŞIVLERI
OSMANLI YAZMALAR KATALOGU**

**OTTOMAN MANUSCRIPTS
CATALOG OF ALBANIAN STATE
ARCHIVES, Ankara, 2001, pp. 211**

Viti 2001 shënoi një sukses të ri në fushën e pasqyrit të antikuarit të dorëshkrimeve orientale në arkivat e Shqipërisë. Në këtë vit u botua në Ankara të Turqisë libri dokumentar me titull "Katalogu i dorëshkrimeve osmane në arkivat e Shqipërisë"⁶, në tri gjuhë: turqisht-anglisht-shqip. Një botim vëllimor prej 211 faqesh, që përmban 495 zëra. Një periudhë që shtrihet në pesë shekuj, që nxjerr në dritë qindra autorë që shkruajnë shqip, arabisht, persisht, dhe osmanisht e që trajtojnë secili sipas profilit: teologji, filozofi, drejtësi, mjekësi, letërsi, kronika etj. në prozë dhe poezi. Ka edhe gjurmë të Frëngjishtes, siç janë fjalorët dy-gjuhësh: arabisht-frëngjisht, persisht-frëngjisht.

Botimi paraprihet nga dy parathëniet të thukëta, nga dy personalitete shkencore të kësaj fushe: Prof. Dr. Riza Ayhan, Rëktor i

Universitetit "Gazi" (Turqi) dhe Dr. Shaban Sinani, Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shqipërisë, i cili parathënien e tij e titullon: "Dorëshkrimet Orientale dhe tradita kulturore e Shqipërisë".

Në aparatën shkencore të këtij katalogu përfshihet edhe bibliografia (burimet) që e orientojnë hulumtuesin e interesuar për të gjetur burimet amë të kriterëve dhe metodave të ndjekura nga autorët në hartimin e katalogut dhe renditjen e tij si dhe në fund një fjalorësh shpjegues termash për të kuptuar dhe interpretuar drejtë nuancat kuptimore të fjalëve të përdorura në këtë botim.

Në hartimin e këtij katalogu me vlera të mëdha ka kontribuar edhe një grup specialistësh shqiptarë dhe turq.

Fondi i antikuarit që paraqitet në këtë "Katalog" përfaqëson një bibliotekë të tërë që i përgjigjet stadi kulturor të shtresës intelektuale shqiptare të shekujve XV-XIX. Ai disponon grupe të tëra teksteve shkollore të asaj kohe, edukatë dhe edukim fetar, ligje dhe interpretime ligjesh, krijimtari të mirëfilltë artistike, fjalorë të gjuhëve të orientit që i shërbenin intelektualëve, tekste të fushës së mjekësisë etj.

Në parathënien e tij "Dorëshkrimet orientale dhe tradita kulturore e Shqipërisë", që ndërthet një studim më vete në këtë drejtim, Dr. Shaban Sinani, ka paraqitur me një vizion të gjerë vlerat historike e dokumentare të këtij antikuarit, që përbën një pasuri të paçmuar në thesarin e kulturës sonë. Kjo parathënie shërben për studiuesit si një orientim. Prof. Dr. Riza Ayhan thekson se në mes materialeve që regjistron ky katalog, 38 sosh deri më sot janë kopje unike dhe paraqiten për herë të parë.

Në renditjen e materialit autorët nuk i përmbahen kronologjisë (siç bën p.sh. Dh. Shuteriqi në "Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850". Tiranë, 1967 ose Kasem Biçoku -Jup Kastrioti në "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu-Bibliografi 1454-1835. Tiranë, 1997). Ata nuk i përmbahen as grupimeve sipas fushës së cilës i përket dokumenti, as grupimit sipas gjuhëve në të cilën janë shkruar. Librat janë të rreshtuar njëri pas tjetrit me tituj, të cilët figurojnë të regjistruar vetëm në kolonën ku bëhet përshkrimi i materialit turqisht. Në kolonat e anglishtes dhe në ato të shqipes, titujt

⁶ Në fund të vitit 2001, në Nevshehir, në Turqi, është organizuar promovimi i këtij botimi.

nuk janë as të përkthyer, as të përshtatur për t'u lexuar. Ilustrimet nuk janë me digjiturë. Ato indeksohen sipas numrit rendor që ka vepra. Në disa raste mungon ky numër.

Autorët kanë ndjekur disa kriterë bazë brenda për brenda zbrit duke dhënë për çdo ksombël ose dokument pak a shumë këto karakteristika: titullin e librit (në kolonën turqisht), të dhëna të shkurtëra për përmbajtjen, emrin e autorit (ose autori nuk dihet), gjuhën në të cilën është shkruar dokumenti, vëllimi në faqe dhe formati në cm., vendi ku është shkruar (p.sh. është shkruar në Korçë, 103/41. Është përgatitur në Shqipëri 139/55 ose është shtypur në vitin 1871 në Stamboll dhe është transkriptuar nga G.Mustafa në vitin 1862 Nr. 143/57 etj.), viti që pasqyron vjetërsinë e materialit (p.sh. autori është Rustem Efendi nga Gorica. Dorëshkrimi është përgatitur në vitin 1035/1625, 150/59). Po japim disa shembuj: a. titulli i librit ose dokumentit p.sh.

1. *Kur'an-i Kerim*: 1, 5, 96, 109, 127, 133, 136, 137, 174, 175, 180, 197, 202, 205, 228, 247, 250, 305, 381, 386 (20 variante).

Për shumicën e Kur'aneve jepen të dhëna për vlerat e tyre: disa herë shekullorë në kohë, shkruar me zbulurime, punuar me shkronja ari, të dëmtuar nga shkaqe të ndryshme.

Në Nr. 1 ka edhe këtë shënim: "Dëmtimi i Kur'an-i Kerimit, si libër që i përkiste vakëfeve ka ardhur si rrjedhojë e luftërave dhe administrimit e drejtimit pa kujdes të këtyre institucioneve. Personat që i kanë përvehtësuar, për t'u shmangur proceseve gjyqësore kanë eliminuar faqen e parë dhe pjesën ku ka qenë i shkruar emri i autorit... Faqet e zbuluara me shkronja ari gjithashtu janë prerë dhe marrë për vlerat që ato mbartnin (fq. 2). ... tuj të njëllojtë në "Katalog" ka disa, si p.sh.: Kitab..., Mevlud..., Divan..., Konk..., Risale... etj.

b. Një grup tekstesh me interes është ai i autorëve shqiptarë që kanë shkruar gjuhën shqipe me alfabet arab. Ata i përkasin "Alhamiads shqiptare". Të tillë p.sh. në këtë katalog mund të rreshtojmë:

Nr. 144. Konk, që përmban poezi origjinale turqisht e shqip.

Nr. 145. Konk, që përmban poezi origjinale turqisht e shqip.

Nr. 150. Hikaye-i yusuf (A.S.) i autorit Rustem Efendi nga Gorica (Korça).

Nr. 355. Tomar-i Bektashian që përmban poezi origjinale turqisht-shqip etj.

Nr. 368. Konk, që ka disa poezi shqip etj.

Materialet e këtyre dokumenteve ndihmojnë për të njohur më mirë lëvizjen kulturore të atyre periudhave kur janë shkruar, parapëlqimet e tematikave që trajtojnë, zhvillimin e gjuhës dhe problemeve që dalin për sa i përket fjalorit, dialektit etj. Qendra si Shkodra, Berat, Kruja, Elbasani, Tetova, Manastiri, Korça, Prizreni etj. kishin një farë lulëzimi që mbahej në këmbë nga një numër jo i pakë intelektualësh që përbëhesh nga personeli i shkollave që funksiononin në këto qendra, nga paria Islame dhe nga punonjësit e tjerë.

c. Në këtë katalog figurojnë edhe libra në gjuhët klasike orientale të shkruar nga autorë shqiptarë, të cilët njihen si të tillë nga deklaratimet që bëjnë ata vetë, duke u lavdëruar me prejardhjen e tyre shqiptare. Këto lloj tekstesh, që aktualisht njihen fare pak, paraqesin interesa të veçanta për studim në dy aspekte: a. lidhur me nivelin artistik të kohës kur janë shkruar dhe të gjuhës në të cilën ata debutojnë dhe b. lidhur me elementin shqiptar ose të dhënat që japin për vendlindjet e tyre. Kjo nga ana historike si dhe nga të rejtat që sjell. Një libër i tillë p.sh. është:

Nr. 284. Gencineî Raz (Visari i fshesur) i autorit tashmë të njohur Jahja Bej Dukagjini (1496-1582)⁷, poet shqiptar i shek. XVI nga Plava. i cili pohon me krenari prejardhjen e tij në vargjet:

"Raca shqiptare është raca ime e ndritur, dhe më poshtë:

Të parët e mi kanë qenë princa të Dukagjinit".

Njoftimi se kjo vepër e këtij poeti shqiptar ndodhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë, në disa kopje, përbën përveç interesit të veçantë dhe një lehtësi për studiuesit. E dhënë tjetër interesante është edhe njoftimi se ky poet i përkiste Teqes së Korçës. Të gjitha këto na shtojnë të hulumtojmë dhe të ndriçojmë

⁷ Më gjerësisht shih: Prof. dr. Shefik Osmani, *Panteoni i tanian dhe iranologët shqiptarë*, Tiranë, 1998.

më mbi
shekullin
Ësht
llimit të
udhës së
495 libra
didaktikë
tronomi,
shkollat e
re ose nde
shumë do
periudhës
Nr.
faqesh,
Nr.
një vepër
vitit 1859
metodat e
tani për ta
nivelin die
periudhë k
Nr. 2
më 1684, b
Nr. 2
me 1842 m
Nr. 2
gramatikës
transkriptuar
vit botimi s
Nr. 4
titur nga M
mësuar gra
nga 1645 etj
Botim
ne në arkiva
dy parathën
me rëndësi
një kontribu
ruajtjen dhe
katalogimin
popularizim
Me gjuh
këto fonde
përsëri ekzist
në dokument
qoftë me anë
një shpërblin
depozohen n
sitë e ruajtje
llarizimit janë

më mbi lëvizjen intelektuale në atë rreth në shekullin XVI.

Është shumë marginale njohja e zhvillimit të arsimit në trevat shqiptare të periudhës së pranisë osmane. Në këtë fond prej 495 librash ka një tufë tekste mësimore: didaktikë, gramatikë, fjalorë dy-gjuhësh, astronomi, ilmihalet e tj. që janë përdorur në shkollat e asaj kohe. Vështrimi i thelluar i tyre ose ndonjë shënim anash do të na njohë në shumë drejtime lidhur me niveli arsimor të periudhës. Të tillë tekste p.sh. janë:

Nr. 3. Ilm-i Hal-Tekst mësimor 201 faqesh.

Nr. 108. Ta'lim'i-Muteal-lim. Është një vepër e dorëshkuar, sipas të dhënave të vitit 1859, me 13 kapituj që përshkruajnë metodat e mësimdhënies. Këto të dhëna, që tani për tani na i jep katalogu dëshmojnë për nivelin didaktik që kishte arsimit ynë në atë periudhë kohe.

Nr. 224. Mebde've'l-Mead. e shkruar më 1684, bën fjalë mbi krijimin e Tokës.

Nr. 226. Mecma-i Fevaid, e shkruar më 1842 me karakter enciklopedik.

Nr. 289. Fevaid'uz Ziyaiyye. Tekst i gramatikës arabe i autorit Molla Çami, i transkriptuar nga Ali bin Huseyin-148 faqe, vit botimi s'ka.

Nr. 447. Fevaid'uz Ziyaiyye, i përgatitur nga Molla Çami si tekst mësimor për të mësuar gramatikën e gjuhës arabe. Daton që nga 1645 e.tj.

Botimi i "Katalogut dorëshkrime osmane në arkivat e Shqipërisë" Ankara-2001, me dy parathënie të karakterit shkencor, lidhur me rëndësinë historike të këtij fondi, është një kontribut i vyer në shumë drejtime: në ruajtjen dhe restaurimin e dokumenteve, në katalogimin e materialit, në vlerësimin dhe popullarizimin e tij.

Me gjithë dëmtimet e mëdha që pësuan këto fonde gjatë fushatës ateiste të viteve 60, përsëri ekzistojnë arkiva private që disponojnë dokumente të tilla. Do të ishte e udhës që qoftë me anë të një grishjeje, qoftë kundrejt një shpërbllimi të mbliçhen këto fonde dhe të depozohen në Arkivin Shtetëror, ku mundësitë e ruajtjes, të mirëmbajtjes dhe të popullarizimit janë të mëdha.

Prof. Shefik Osmani

Dr. Muhamed Mufaku

الثقافة الألبانية في الأماجدية العربية

Ath-thakafetu-l-albanijjjetu fi-l-abxhedhijjeti-l-arabijjjetu Al maxhlisu-l-vatanijju li-ththekafeti va-l-fununi va-l-adabi, Al Kuvajt, 1983, fq. 212.

Dr. Muhamed Mufaku gjatë tri dekadave të fundit të shekullit 20 është shpesh i pranishëm në shtypin arab me kontribute për historinë dhe kulturën shqiptare.⁸

⁸ Pë për prezentimin e historisë dhe kulturës shqiptare në opinionin arab M. Mufaku ka herë tregoi interesim të madhë, dëshmojnë artikujt e tij në revistat më në zotë në botën arabe. Ndër prezentimet e tjera po përmendim disa prej tyre:

1. اللغة العربية في اللغة الألبانية. Al-arabijj nr. 187, Kuvajt 1976.

2. الدين والمسألة الدينية في ألبانيا. Al-arabijj Kuvajt 1978.

3. محاولة لكتابة الألبانية بحروف عربية. Al-ma'rife nr. 196. Damask 1978.

4. صلوات تفضلية بين اليمن وألبانيا في مطلع القرن العشرين. Al-arabijj nr. 263, Kuvajt, 1980.

5. الدين والمسألة الدينية في ألبانيا. Kuvajt 1978.

6. منشورات اتحاد الكتاب فلسطين الألبانية. العرب, Damask 1979.

7. الحاج عمر لطف باشا ريزي 1869-1929. Al-arabijj nr. 242, Kuvajt 1979.

8. كربلاء في الأدب الألباني. Al-arabijj nr. 213, Kuvajt 1979.

9. الألبانيون في سوريا و دورهم في الحياة السورية المؤتمر الدولي الثاني لتاريخ بلاد الشام 1939 - 1539, Damask 1979.

10. من الأدب الألباني - مع مقدمة في الصلوات الأدبية العربية - الألبانية. Al-arabijj nr. 3, 1980.

Autori Muhamed Mufaku me veprën *Ath-thakafetu-l-albanijeti fi-l-abshedijeti-l-arabijeti* (kultura shqiptare me alfabet arab) i jep një pasqyrë botës arabe për rrugtimin e alfabetit të gjuhës shqipe, e në veçanti shkrimin të gjuhës shqipe me alfabet arab.

Vepra *Ath-thakafetu-l-albanijetu fi-l-abshadijeti-l-arabijeti* përbehet nga parathënia, gjashtë kapituj dhe pashtënies.

Vepra fillon me parathënieën (5-9) ku flitet për përhapjen e shkrimit arab jashtë kufijve të botës arabe dhe konstaton se "shkrimi arab, pas atij latin, është më i përhapuri në botë" (fq.5).

Për përhapjen e shkrimit arab në vendet e Europës juglindore rol vendimtar ka luajtur Perandoria Osmane. Autori thotë se "shkrimi arab u përdor në Greqi, Shqipëri, Bullgari, Bosnjë, Poloni dhe Bjello Rusi", duke shtuar se "përdorim më të gjërë pati ndër shqiptarët dhe boshnjakët duke vazhduar gjër në gjysmën e parë të shekullit njëzet".

Autori konstaton se "alfabeti arab ndër popujt tjerë ishte alfabet i pakicës apo i bashkësive islame, ndër shqiptarët ka qenë alfabet i shumicës, meqë shqiptarët i vetmi popull i Europës, me shumicë e pranuan Islamit".

Në kapitullin e parë (11-37) autori flet për prejardhjen e popullit shqiptar si pasardhës të Ilirëve, kurse lidhjet e para arabo-shqiptare zëjnë fill gjatë perandorisë romake.

Mardhënieën arabo-shqiptare me depërtimin e Perandorisë Osmane në ballkan dhe me pranimin e Islamit nga ana e shqiptarëve vëhën lidhje indirekte me arëbët dhe kulturën arabe. Kjo lidhje vazhdon gjër në fillim të shekullit të gjashtëmbdhjetë kur edhe arabët hyn nën ombrellën e së njëjtës perandori dhe me këtë arabët dhe shqiptarët jetuan në një shtet të përbashkët.

Gjuha arabe, me pranimin e Islamit nga ana e shqiptarëve, u bë gjuhë e rregullt në të gjitha medreset në trojet shqiptare. Kjo lidhje direkte e shqiptarëve me gjuhën arabe ndërherit ishte edhe një për lidhje të shqiptarëve me vendet arabe, siç ishin Damasku,

Kairo, ku shqiptarët vazhdonin mësimet e mëturjesime.

Mufaku shton se me shtrirjen e Perandorisë Osmane edhe në trojet arabe një numër i madhë i shqiptarëve ishte në shërbime të ndryshme në këto troje të sapo përfshira në këtë perandori. Kjo ishte edhe një arsye më tepër për prezencën e shqiptarëve në tokat arabe. Prania e shqiptarëve në tokat arabe ka pasur ndikim të dukshëm në jetën e popullatës vendase, e në veçanti në Siri, Egjipt, Libi dhe Algeri. Pezencja e ushtarëve shqiptarë, sipas autorit, bëhet pjesë e historisë së këtyre vendeve.

Mardhënieën shqiptaro-arabe bëhen edhe më të forta pas pavarimit të disa shteteve arabe, e sidomos në fund të viteve pesdhjetë dhe në fillim të viteve gjashtëdhjetë. Tani kemi lidhjet e mardhënieve diplomatike mes shtetit shqiptar dhe vendeve arabe, siç janë Siria, Algjeria, Libani dhe Kuvajti. Ambasada e parë e shtetit shqiptarë në shtetet arabe ishte ajo në Egjipt, gjegjësisht në Kairo, në fund të viteve njëzet të shekullit të kaluar.

Kapitulli e dytë (38- 81) autori e titullon *Gjuha shqipe mes lindjes dhe europianizimit*. Në fillim njofton opinionin arab me historikun e shkrimit të shqipes duke thënë se "edhe pse populli shqiptar konsiderohet ndër popujt më të vjetër në Ballkan dhe në Europë, gjurmët e para të shkrimit të gjuhës shqipe i hasim tek në vitin 1462 me Formulën e Pagzimit të shkruar me alfabet latin".

Autori më tutje vazhdon se, të njëjtën kohë hasim edhe fillimin e "arabizimit" të gjuhës shqipe. Ky "arabizim" sipas autorit haset në: depërtimet e panumërta të fjalëve arabe në gjuhën shqipe; fillimi i shkrimit të shqipes me alfabet arab dhe shënjinim e disa tingujve arab në gjuhën shqipe. Ky fillim ka qenë rezultat i kontakteve të shqiptarëve me turqit dhe me gjuhën turke. Kjo lidhje bëhet edhe më e fortë me stabilizimit e administratës turke në trojet shqiptare që në shekullin e pesmbëdhjetë, pastaj me hapjen e mektebeve. Rol vendimtar në ndikim e gjuhës arabe në gjuhën shqipe kishte përhapja e Islamit në trojet shqiptare, kur një pjesë e intelektualëve shqiptarë filluan ta shkruajnë gjuhën shqipe me alfabet arab.

Me fillimin e shkrimit të shqipes me grafi arabe, shkrimin të shqipes i shtohet

11. مؤثرات مصرية في الأدب الألباني الحديث.

Al-arabij nr. 276, Kuvajt 1981, etj.

edhe një al
atij të grek
Autori

për poezinë
nga Muçi Z
Ibrahim Ne
tin, Sylejma
san Zyko K
Patën, Dali
Abdullah K
Çiçkon, Tah
Tahir Boshn
fak konstat
dhjetë alfab
prestigj shum

Sipas N
për hartimin
za të alfabet
më 1835, i
qisht në varg
Daut Boriçi.
ton abetaren
betin arab. Ke
sini, H. Ali U
Muhamed

rrjedhat e kon
çështja e alfab
bazë të alfabet
i alfabetit arab
Mirëpo, trojet
ende vazhduan
arab. Kjo ishte
rëve që ia shkri
tye antare nëp
të shqipes. Kjo
alfabet arab në
Shqipërisë vazh
shekullit njëzet.

Kapitulli
llon letërsia e
zbehjen e shkri
dhe orientimin
sinë shqipe me
fillon ta studioje
icli më 1854 në
nologjike përkit
gjuhën gjerman
letërsisë, sipas
një numër buku
është humbur.
shqipe me alfabe
ar revistat *Zani*

edhe një alfabet i tretë krahas dy të parëve, atij të grek dhe atij latin.

Autori në këtë kapitull jep informata për poezinë e parë të shkruar me alfabet arab nga Muçi Zade, për të vazhduar pastaj me Ibrahim Nezinin, Ibrahim Pashë Velebishin, Sylejman Naibin, Hysejn Dobrocin, Hasan Zyko Kamberin, Hysejn Shkodrën, Salih Patën, Dalip Frashrin, Shahin Shkodrën, Abdullah Konispolin, Ismail Floçin, Hazhi Çiçkon, Tahir Popovën, H. Ali Ulqinakun, Tahir Boshnjakun, Rexhep Vokën, etj. Mufak konstaton se në shekullin e nëntëmbëdhjetë alfabeti arab ndër shqiptarët gëzonte prestigj shumë të lartë.

Sipas Mufakut i pari që bëri përpjekje për hartimin e një alfabeti për shqipen në baza të alfabetit arab është Shemimi Shkodra më 1835, i cili përpiloi fjalorin shqip-turqisht në vargje. Pas Shemimi Shkodrës edhe Daut Boriçi, i cili më 1861 në Stamboll boton abetaren e parë të gjuhës shqipe me alfabetin arab. Kështu vazhdoi edhe Hoxha Tahsini, H. Ali Ulqinaku, Rexhep Voka etj.

Muhamed Mufaku më pastaj vazhdon me rjedhat e kongresit të Manastirit ku zgjidhet qështja e alfabetit të përbashkët të shqipes në bazë të alfabetit latin, dhe me kte fillon largimi i alfabetit arab nga përdorimi i gjithmbarshëm. Mirëpo, trojet e mbetura jashtë shtetit shpirt ende vazhduan ta shkruajn shqipen me alfabet arab. Kjo ishte e vetmja alternativë e shqiptarëve që ta shkruajn dhe ta kultivojnë gjuhën e tyre amtare nëpër mektebe dhe teqe e shkrimit të shqipes. Kjo traditë e shkrimit të shqipes me alfabet arab në trojet shqiptare jashtë territorit të Shqipërisë vazhdon deri në vitet e pesëdhjeta të shekullit njëzet.

Kapitulli e tretë (82-110) mban titullin *letërsia e re shqipe*. Këtu autori trajton zbehjen e shkrimeve shqipe me alfabet arab, dhe orientimin e saj nga perëndimi. Letërsinë shqipe me alfabet arab për herë të parë fillon ta studiojë albanologu gjerman Hahn, i cili më 1854 në punimin e tij *Studime albanologjike* përktheu disa poezi të Nezinimit në gjuhën gjermane. Injorimi i kësaj pjese të letërsisë, sipas autorit, është edhe shkak që një numër bukur i madh i kësaj krijimtarie është humbur. Interesim për krijimtarinë shqipe me alfabet arab, më vonë kanë treguar revistat *Zani i Natës* dhe *Kultura Islam*, si

edhe studiuesit Osman Myderrizi, Mark Krasniqi, Hasan Kaleshi dhe Muhamed Piraku, në fillim të viteve pesëdhjeta.

Letërsia shqipe me alfabet arab, sipas Muhamed Mufakut, në historinë e letërsisë shqipe njeherit paraqitet si letërsi e re qoftë përnga forma qoftë përnga përmbajtja. Kjo "letërsi e re" është rezultat i jetës së re të shqiptarëve që nga fillimi i shekullit pesëmbëdhjetë.

Në shekullin shtatëmbëdhjetë poezia filloi të lulzojë në Elbasanit, saqë udhëpërshkrueso turk Evlija Çelebiu këtë qytet do ta quaj *qyteti i poetëve* kurse në jug qyteti i Beratit bëhet i njohur për letërsinë e re. Letërsia shqipe filloi të pasurohet me gjini të reja letrare, siç është poezia lirike, poezia epike, këngë kreshnike etj., përkundër j letërsisë kishtare, e cila kryesisht bazohet në përkthime të literaturës fetare nga italishtja apo latinishtja.

Krijimtari shqipe me alfabet arab ishte frymëzimi kryesor i rilindjes kombëtare shqiptare.

Me këtë zhvillim të letërsisë shqipe shtrihet pyetja, cila është pozita e kësaj letërsie në historinë e letërsisë shqipe dhe rëndësia e saj? Përgjigjja do të ishte:

gjersa *letërsia katolike* ishte përhapur në një rreth të ngushtë katolik në veri të Shqipërisë, letërsia shqipe me alfabet arab shtrihet nga pjesa më veriore në atë jugore;

Vlerat e letërsisë shqipe me alfabet arab, megjë për herë të parë poezia lirike shqipe shkruhet me këtë alfabet;

Për herë të parë në letërsinë shqipe me alfabet arab paraqiten tregimet poetike dhe epopeja;

Për herë të parë letërsia shqipe, e shkruar me alfabet arab, delë jashtë kufijve të saj, e ndikuar nga letërsia arabe dhe ajo persiane;

Proza e rimuar në gjuhën shqipe për herë të parë shkruhet me alfabet arab;

Vezni arab për herë të parë nëpërmjet kësaj krijimtarie depërton në letërsinë shqipe;

Për herë të parë *mevludi* i shkruar me alfabet arab bëhet pjesë e letërsisë shqipe;

Me këtë letërsi krijuesit depërtojnë në masën popullore dhe me krijimet e tyre letrare bëhen pjesë e pa ndashme e popullit;

Fjalorët e shkruar në vargje me alfabet arab janë një vlerë e re, e cila ka rëndësi në studimin e historisë së gjuhës shqipe;

Kjo letërsi lidhet me ndikimet arabe qoftë për nga përmbajtja apo për nga forma, dhe paraqet një materie të pasur për studime krahasimtare shqiptaro arabe;

Kjo letërsi joarabe e shkruar me alfabet arab jashtë botës arabe, konsiderohet ndër përpjekjet më serioze dhe më gjithëpërfshirëse.

Kapitulli i katërti (111-134) mban titullin Letërsia e shekullit tetëmbëdhjetë. Muhamed Mufaku kanstaton se letërsia shqipe me alfabet arab kulminacionin e arrin në shekullin tetëmbëdhjetë. Poezitë mësoheshin përmendësh dhe barteshin prej një gjenerate në gjeneratën tjetër. Falë kësaj dhe përshkruesve të kësaj letërsie, historia e letërsisë shqipe sot ka njohuri për këtë krijimtari. Një pjesë bukur e madhe e këtyre shkrimeve nga mnskujdesi i institucioneve gjegjëse janë zhdukur.

Ndër poetët më të vjetër të kësaj periudhe është Nezim Frakulla, i cili poezitë e veta i shkruan me alfabet arab.

Në këtë kapitull autori Mufaku lexuesit arab i ofron informata të bollshme për jetën dhe veprën e Nezim Frakullës, i cili konsiderohet ndër poetët më të rëndësishëm, pastaj për Qytetin e Beratit, për institucionet kulturore dhe arsimore të asaj kohe në këtë qytet, për zhvillimet kulturore dhe për jetën kulturore në Berat. Pastaj përmend edhe Sylejman Naibin, Haxhi Ymer Kasharin, Hasan Zyko Kamberiu, e mandej, nga më të vonshmit Sheh Sulejman Temanin, Hysein Dobroçin.

Në kapitullin e pestë (135-162) Letërsia e shekullit nëntëmbëdhjetë, autori shton se kjo periudhë ishte ndër periudhat më frytdhënëse. Fillimi i shekullit nëntëmbëdhjetë, sipas autorit, është i lidhur ngusht me Muhamet Çamin, i cili i dhuroi letërsisë shqipe vepra origjinale. Sipas autorit, veprat e Muhamet Çamit ishin aq të njohura dhe aq me vlerë sa që poema e tij *Erveheja* ishte nga veprat më të dëshiruara dhe më të kërkuara gjatë Rilindjes Kombëtare. Ndër autorët tjerë të shekullit nëntëmbëdhjetë janë edhe Tahir Gjakovën, autorë i veprës *Vehbiye*, veprës së para të shkruar me alfabet arab në Kosovë, e pastaj vllazërit Dalip e

Shahin Frashërin, autorë të poemave *Al Hadikatu* dhe *Muhtarname*. Ndër krijuesit tjerë të këtij shekullit autori përmend Sheh Jonuzin, Abullah Konispolin, Ismail Floqin, Haxhi Çiçkon, H. Ali Ulqinakun, Tahir Popovën.

Nga këta emra shihet se, shekulli nëntëmbëdhjetë, sipas autorit, është një periudhë kur autorët shqiptarë fillon të shkruajnë për jetën dhe mu'zhizet e Pejgambrit a.s.

Kapitulli i gjashtë, i fundit, (162-188) është Letërsia e shekullit njëzet. Kapitulli e fundit autori, Muhamed Mufaku, e fillon me rrethanat e krijuara pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe zyrtarizimin e alfabetit latin nga qeveria e Shqipërisë. Mirëpo, siç thotë autori, jashtë kufijve të Shqipërisë së pamvaur mbetën gati gjysma e popullit shqiptar, shumica në shtetin e Jugosllavisë, e cila nuk ua njohte të drejtën e arsimimit shqipëtarëve në gjuhën e tyre amtare. Andaj, alfabeti arab mbeti alternative e vetme për krijimtarinë e shqiptarëve jashtë shtetit amë. Autori thotë se letërsia shqipe e shkruar me alfabet arab në trojet e Jugosllavisë ishte më së shumti me karakter fetar. Ndër autorët që përmend Mufaku nga këta krijuar janë Sheh Hasani, Sheh Maliqi, Hafiz Islam Bytyçi, Faik Maloku, Hafiz Imer Shemsiu etj. Me fillimin e luftës së dytë botërore, kur Kosova bëhet pjesë e Shqipërisë etnike, krijohen kushte për hapjen e shumë shkollave për arsimimin e popullit shqiptar në gjuhën amtare. Kjo traditë e shkrimit me alfabet latin vazhdon edhe pas luftës së dytë botërore.

Muhamed Mufaku këtë veprë shumë të çmueshme për kulturën dhe letërsinë shqipe të shkruar me alfabet arab, që i dedikohet opinionit arab, e përfundon me konstatimin se nga e gjithë kjo që u tha më lartë shihet se sa ndikim ka ushtruar alfabeti arab në krijimtarinë letrare të popullit shqiptar.

Autori veprën *Ath-thakafetu-l-albani-Jetu fi-l-abzhadijjet-i-arabijjjet-i* e përfundon me listën e literaturës së bollshme që ka konsultuar gjatë hartimit të kësaj vepre shumë të çmueshme për historinë e shkrimit të shqipes me alfabet arab, e që i dedikohet opinionit arab.

Nga e tërë kjo që u tha në këtë prezantim, duke lënë anash disa mangësi të veprës, siç është mungesa e indeksit të emrave dhe

titulli, që sipas në përmbajtje "Ath-thakafet

arabijjjet, p

jetë para fjala

lën autori e k themelor e k kohën e ndo

fjala — kupa

mjetin me të "Ath-thakafet arabijjjet" pa ta njohur op letrare shqipe.

Shpresoj faku do të vax timin e letërs dhe të arritura arabe.

Dr. Muhame NË BOTËN A

Dr. Muh tetur në burim tek ne ka prez nesh të rëndë shqiptarëve në rin në dhjetë ka Librin e l zë. Ai hapet m llimin e kësaj në hyrjen e libi e shqiptarëve vete, që është e që zgjojnë gj qarqeve shkenc

-E para: j arabe dhe roli dy popujve, dhe

-E dyta: j arabe si shemb shqiptar", pra, i

Autori ko në qysh para ilire-fenikase, t

titulli, që sipas mendimit tim, duke u bazuar në përmbajtjen e veprës, do të duhej të ishte "Ath-thakafetu-l-albanijetu bi-l-ebxhedijeti

alrabijjeti, pra në vend të parafjalës في të

jetë parafjala و — sepse parafjala في, të cilën autori e përdor në original, kuptimin themelor e ka për të shprehur vendin apo kohën e ndodhjes së veprimit, kurse para-

fjala — kuptimin thelor e ka për të shprehur mjetin me të cilin kryhet veprimi, vepra "Ath-thakafetu-l-albanijetu fi-l-ebxhedijeti arabijjeti" përqet një kontribut të madhë për ta njohur opinionin arab me krijimtarinë letrare shqipe me alfabet arab.

Shpresojmë se studiuesi Muhamed Mufaku do të vazhdoj edhe më tutje me prezantimin e letërsisë shqipe me alfabet arab si dhe të arriturat kulturore shqiptare në botën arabe.

Mr. Isa Memishi

Dr. Muhamed Mufaku, SHQIPTARËT NË BOTËN ARABE Prishtinë, 1990, f.180

Dr. Muhamed Mufaku, duke u mbështetur në burime të ndryshme, për herë të parë tek ne ka prezentuar një dizinë informacionesh të rëndësishme lidhur me praninë e shqiptarëve në botën arabe, duke e ndarë librin në dhjetë kapituj bazë.

Librin e ka ndarë në dhjetë kapitula bazë. Ai hapet me (f. 5-6) ku autori flet për qëllimin e kësaj vepre. Dr. Muhamed Mufaku, në hyrjen e librit (f. 7-12) parashtron praninë e shqiptarëve në botën arabe, si temë më vete, që është e lidhur ngushtë me dy çështje që zgjojnë gjithnjë më shumë interesimin e qarqeve shkencore:

-E para: prania e shqiptarëve në botën arabe dhe roli i tyre në marrëdhëniet midis dy popujve, dhe

-E dyta: prania e shqiptarëve në botën arabe si shembull karakteristik i "fenomenit shqiptar", pra, i pranisë shqiptare nëpër botë.

Autori konstaton se rënjtet e tyre datojnë qysh para erës së re, në marrëdhëniet liire-fenikase, të cilat u zhvilluan më shumë

kur të dy popujt u gjendën në një shtet, në Perandorinë Romake. Megjithatë, autori mendon se marrëdhëniet shqiptaro-arabe arritën kulminacionin në kuadër të Perandorisë Osmane. Në kuadër të kësaj Perandorie, shqiptarët e arabët patën aq shumë kontakte dhe fërkime, sa që krijuan një histori të përbashkët.

Për "fenomenin shqiptar" rëndësi të jashtëzakonshme ka bota arabe, por, përveç shkrimeve për Mehmet Ali Pashën, themeluesin e dinastisë shqiptare në Egjipt (1805-1952) nuk është shkruar fare. Për Mehmet Ali Pashën në gjuhën shqipe është shkruar fare pak, kurse në gjuhët tjera ka dhjetra studime e monografi. Mungesa e një studimi kompleks për praninë shqiptare në botën arabe ishte motivi kryesor për studiumin Mufaku.

Për praninë e shqiptarëve në botën arabe gjatë shekujve XVI-XVII autori i dallon shekujt XVIII-XX.

Në kapitullin e parë *Lidhja shqiptaro-arabe nëpër histori*, (f.13-29), bëhet fjalë për një traditë të pasur për prejardhjen e shqiptarëve nga Arabia. Kjo traditë përfshin legjendat e rëfime të ndryshme që hasen në burimet e shkruara të kohës.

Autori përmend turkologun e njohur Franc Babinger i cili për shqiptarët mendonte se disa kanë qenë nga Jemeni e të tjerët nga Egjipti, si dhe versionin e Evlia Çelebiut pa ndonjë qasje kritike.

Kapitula e dytë "Siria" (f. 30-48) i kushtohet pranisë së shqiptarëve në Siri prej gjysmës së dytë të shek. XVI. Autori Mufaku përmend disa figura të shquara shqiptarësh që kontribuan në Siri, Mustafa pashë Dukagjini, Lala Mustaf pasha, Sinan pasha, i biri i vezirit të madh Ajas pasha, Nasuh pasha, Kuçuk Sinan pasha, Mehmet pasha Kypryli, Ibrahim pasha i biri i Mehmet Ali pashës, i cili në historinë e Sirisë la gjurmë të thella. Shekulli i XIX është shekulli i shqiptarit Ibrahim pasha. Nga shqiptarët tjerë përmenden: Mehmet Sherif pasha, pastaj rilindësit shqiptarë Pashko Vasa Shkodrani e Ismail Qemal Vllora për të cilët autori flet më gjerësisht.

Kapitula e tretë "Libani" (f. 49-59), fillon me një histori të Libanit. Autori flet për Libanin duke u nisur nga shek. XVI. Edhe

këtu, duke synuar të ndriçoj pjesëmarrjen e shqiptarëve në viset arabe, flet për ngjarjet të rëndësishme historike lidhur me Libanin dhe shqiptarët atje. Në këtë kapitull paraqiten figurat dhe kontributi i pashallarëve të njohur shqiptar të kohërave të ndryshme si Ahmet pasha, Kara Mustafa pasha, Mehmet pashë Kopryly, Mehmet pasha Arnauti, i cili ishte në krye të Vilajetit të Tripolit, në kohën e lulzimit të tij në gjysmën e dytë të shek. XVII.

Ky ndërtoi një pallat afër burimit Rash'in. Përveç tij dallohen edhe shqiptarët Ibrahim pasha, Sherif pasha e Hasan Aga, të cilëve autori u ka kushtuar vëmendje të veçantë.

Autori flet edhe për një intelektual tjetër të madh shqiptar Osman Arnauti, i cili jetoi në gjysmën e dytë të shek. XIX. Ai përveç tjerash, ishte njohës i mirë i gjuhëve të huaja. Personalitet tjetër me rëndësi ishte Nexhib Arnauti, i cili u dallua si humanist dhe tregtar.

Në kapitullin "Palestina" (f.60-67) e katërt flitet për arkitektin e njohur shqiptar Mimar Sinan, i cili në gjysmën e dytë të shek. XVI, qëndroi në Palestinë. Ky ndërtoi disa objekte prej të cilave, në Jerusalem, përmendet një xhami, një medrese e një imaret. Në Jerusalem përmenden edhe disa qeveritarë tjerë shqiptar, që sunduan në shek. XVII, si Kara Mustafa pasha e Mehmet pasha Kopryly, për të cilët historiografia shqiptare ofron të dhëna të mjaftueshme. Dr. Mufaku është kujdesur që për figurat e shquara shqiptare të japë një pasqyrë sa më reale, por edhe për rolin e tyre në Palestinë gjatë shekujve.

Në kapitullin e pestë "Iraku" (f.68-78), autori sjell të dhëna të rëndësishme për historiografinë shqiptare dhe arabe. Në vitet e para të administratës osmane përmend shqiptarin shqiptarin Ajas Mehmet pasha, vall në Irak dhe Nasuh pasha, që ishte në krye të Vilajetit të Bagdatit. Në fund të shek. XIX, me 1889 në krye të Vilajetit të Bagdatit u emërua qeveritari shqiptar, Sirri pasha, kontributi i të cilit në fushën kulturës ishte shumë i madh. Autori, thekson se Sirri pasha ka shkruar 16 vepra me kritikë filozofike, historike, letrare. Është angazhuar për ndërtimin e shkollave, themelimin e shtypshkronjës së

parë në Basra, botimin e revistave dhe përkrahjen e shkrimtarëve dhe shkenctarëve të vendit. Për angazhimin e tij të në çështje të kulturës, Sirri pashën e kanë lavdërua edhe poetë të ndryshëm.

Kapitulli e gjashtë "Arabia" (f. 79-96), trajton çështjen e Hixhazit dhe Jemenit, praninë e shqiptarëve në këto vende. Në Meke dhe Medine shqiptarët paraqiten qysh nga shek. XV-XVII, për haxhillëk, kurse në forma tjera më vonë, sidomos gjatë shek. XIX dhe në fillim të shek. XX.

Kur flet për Jemenin, theks të veçantë i ka vënë problemit të ushtarëve që dërgoheshin në Jemen, ku detyroheshin të luftojn për ruajtjen e pushtetit osman në Jemen.

- Kapitullin e shtatë "Egjipti" (f. 97-130), bën fjalë për temat:

- Prania e shqiptarëve në Egjipt deri më 1805;

- Mehmet Aliu dhe dinastia shqiptare në Egjipt;

- Kolonia shqiptare në Egjipt

Në periudhën e parë të administratës osmane, shek. XVI-XVII, njihet një numër qeveritarësh shqiptar. Autori shkruan për valiu e parë shqiptar Sinan pashën të cilin e nga i Topojani.

Pastaj në fillim të shek. XVII, në vitet 1620-1622, në postin e valiu të Egjiptit erdhi shqiptari Ahmet pasha Tarhonxhi, i cili u bë vezir i madh, valiu Ibrahim pasha, i cili qëndroi në Egjipt gjatë viteve 1662-1663.

Nga figurat e shquara shqiptare, përmend Hysein be Arnautin, pastaj, në gjysmën e dytë të shek. XVIII u dallua në Egjipt udhëheqësi shqiptar, Ahmet Arnauti, adhurues i librit.

Si personalitete të rëndësishme autori përmend edhe një udhëheqës ushtarak shqiptar, Mehmet aga Arnautin dhe disa të tjerë. Prania e shqiptarëve në Egjipt e madhe. Kjo dëshimohet me pjesëmarrjen aktive të tyre në rezistencën kundër pushtimit francez në Egjiptit.

Fillet e kolonisë shqiptare në Egjipt janë të hershme por në gjysmën e dytë të shek. XIX kjo koloni u zhvillua dukshëm me shpërnguljen e shqiptarëve prej viseve të Toskërisë.

Kapitulli e tetë "Sudani" (f. 131-135), paraqet përpjekjet dhe dëshirën Mehmet

Allu për
Në
është "Z
histori u
se në Li
prania e
formale
të drejt
bejlerbej
lerbeu i
ishite një
Përveç k
shqiptari
na, Halil
Murat A
Rexhep j
e historia
Kap
gjeria"
kapitulli,
të shek.
historike
zërve shq
Këta ishi
për aktiv
gjërsisht
ve në Alg
ve të ndry
Lib
flet me
shkruan s
be është
të marrë
dhe mbyl
turës (f. 1
Mun
parë të pr
e karakter
rë të cilë
shumta ne
karakteriz
në shoqëri
mike, pol
cila periud
siderueshr
disa vende
Për
studimi, a
ve arab,
shqiptare
shqiptar të
autori ka

Alliu për mbrojtjen e Egjiptit,

Në kapitlinë e parafundit të këtij libri është "*Libia*" (f. 136-161) autori paraqet një histori të shkurtër të Libisë, duke potencuar se në Libi, sikurse edhe në Tunizi e Algjeri, prania e pushtetit të sultanit osman ishte më formale se sa në vendet tjera. Sulltani kishte të drejtë të emëronte një pashë me titull bejlerbej në krye të Vilajetit të Tripolit. Bejlerbeu i fundit që e ushtroi funksionin e tij ishte një shqiptar, Muhji apo Mehmet pasha. Përveç këtij shqiptari, autori përmend edhe shqiptarin Bali Çaushi, i cili ishte nga Janina, Halil pasha Arnautin, bejlerbe të Tripolit, Murat Arnauti, Hafiz pasha, vali i tripolit, Rexhep pasha, dhe Mahmud Naxhi politikan e historian i njohur i shek. XX.

Kapitina e fundit, e dhjeta, është "*Algjeria*" (f. 162-168). Që në fillim të këtij kapitulli, autori i veprës shkruan se në fillim të shek. XVI në Algjeri ndodhi një kthesë historike si pasojë e paraqitjes së katër vëllezërve shqiptarë me flotën e tyre në atë rajon. Këta ishin Uraxhi, Hajrudini, Isaku e Ijazit, për aktivitetin e tyre në atë rajon. Këta ishin Uraxhi, Hajrudini, Isaku e Ijazit, për aktivitetin e tyre në atë rajon. Këta ishin Uraxhi, Hajrudini, Isaku e Ijazit, për aktivitetin e tyre në atë rajon. Prania e shqiptarëve në Algjeri është karakteristike gjatë fazave të ndryshme të periudhës osmane.

Libri *Shqiptarët në botën arabe* mbyllet me "Përfundim" (169-171) ku autori shkruan se prania e shqiptarëve në botën arabe është një nga aspektet më të rëndësishme të marrëdhënieve historike shqiptaro-arabe, dhe mbyll me listën e burimeve dhe literaturës (f. 172-180).

Mund të përfundojmë se periudhën e parë të pranisë së shqiptarëve në botën arabe e karakterizon prania e qeveritarëve shqiptarë të cilët kanë lënë gjurmë dhe vepra të shumta në vendet arabe. Periudhën e dytë e karakterizon rritja e pranisë së shqiptarëve në shoqëri dhe ndikimi i tyre në jetën ekonomike, politike e kulturore të atyre vendeve, e cila periudhë dallohet edhe me prani të konsiderueshme të elementit etnik shqiptar në disa vende arabe.

Për realizimin e suksesshëm të këtij studimi, autori përdor kronika të historianëve arab, memoare të figurave evropiane, shqiptare dhe arabe, si dhe shtypit arabo-shqiptar të kohës. Përveç këtyre burimeve, autori ka shfrytëzuar edhe literaturë në gju-

hën: shqipe, serbokroate, arabe, angleze e osmane.

Gjatë përpilimit të kësaj vepre autori ka hasur në vështësi të ndryshme, për shkak se në literaturën arabe, ka raste kur i kanë dalluar figurat shqiptare prej të tjerëve. Shpeshherë ata i kanë identifikuar me "turq" ose me "greq", Sipas mendimit të M. Mufakut, kjo kishte ndodhur nga shkak i mungesës së informacioneve për shtrirjen e emikumit shqiptar nëpër vende e ishuj të cilët historianët të ndryshëm i kanë konsideruar si të Greqisë.

Dr. Bahtije Gërbeshi

Dr. Selçuk Eraydin, **TESAVVUFI DHE TARIKATET**, Tetovë, 2001. fq. 428.

Çështja e misticizmit islam, në botën islame e njohur me termin Tesavuf, është çështje shumë tërheqëse për studiuesit. Me të në fillim janë marrë kryesisht studiuesit e huaj -islamist e orientalistë e më vonë kjo temë ka zgjuar edhe interesimin e studiuesve muslimanë. Te shqiptarët tema e misticizmit islam vetëm tash vonë ka filluar të preket dhe të paktë janë studimet në këtë drejtim. Ndërsa, siç dihet një pjesë e madhe e poezisë shqipe me grafi arabe është poezi me tematikë mistike dhe e realizuar njëaft mirë artistikisht. Studim të veçantë për misticizmin islam në gjuhën shqipe pothuaj se nuk kishte deri tash, duke mos harruar librin e Baba Rexhepit "*Misticizma islame dhe bektashizma*" dhe një vështrim të mirë kësaj çështje të Salih Hajdarit në librin "*Poezia e bejlexhinjëve*". Prandaj, si shtet, për të gjithë ata që duan të mësojnë më shumë për misticizmin islam mund të merret libri "*Tesavufi dhe Tarikatet*" i studiuesit të njohur turk Selçuk Eraydin, i cili është një libër shumë i mirë në të cilin shtrohet gjithanshëm çështja e misticizmit islam nga një autor me renome në Turqi, si njohës i shkëlqyer i kësaj çështjeje. Libri është përkatitur për nevoja universitare dhe është një vepër shumë e kompletuar dhe e mirëpritur në Turqi. Në të shpaloset historiku i Tesavvufit në mënyrë kronologjike që

kur shfaqet si dukuri në Islam e deri në fazën më të re, dhe sidomos në hollësi është shtruar terminologjia e Tesavvufit, që ka rëndësi të veçantë për faktin se pa njohje të mirë të kësaj terminologjie është e pamundur të thellohesh në botën e misticizmit islam për ta kuptuar më mirë.

Meqë kjo është çështje mjaft komplekse dhe e rëndësishme për t'u kuptuar, duhet të jepen disa shpjegime themelore. Tesavvufi-misticizmi islam ekzistimin e vet e ka bazuar në interpretimin ezoterik të Islamit. Pra, Tesavvufi nisët nga egzogjeza ezoterike e Kur'anit dhe e traditës së profetit Muhammed (synneti) dhe vazhdon hermenautikën e njëjtë. Prandaj, mendohet se me rrymën e misticizmit i jepet thoks i veçantë kërkesës për meditim të thellë, të hapët e të lirë. Kështu pretendohet që Tesavvufi pos anës formale të fesë, merrtet me esencën e saj, me idetë, mendimet dhe kuptimet, me hulumtimin e të padukshmes, të fshehtës. Prandaj, tema që më së shumti meditohej në misticizëm padyshim që ishte përsiatja e njohja e Zotit të gjithëfuqishëm, i cili është krijuar i çdo gjëje dhe i cili është i përhershëm, përdërisa të gjitha ato gjallesa e krijesa të Tij, do të mbarojnë e shkatërrohen. Pra Tesavvufi synon ma'rifon, njohjen e të vërtetës absolute (hakikati). Dhe kjo njohje kërkon të njohesh me të vërtetën, pra të jesh një me Allahun. Ndërsa që të njihet Zoti, njeriu duhet të lirohet nga unë i tij. Dhe sipas Tesavvufit, organi me të cilin njeriu e njeh praninë e Zotit nuk është mendja, por është zemra. Dhe si mjet për t'u afruar Zotit është dashuria ndaj Zotit (ashk). Në këtë proces të dashurisë metafizike ndaj Zotit, janë me interes të veçantë aventurat shpirtërore të vuajtjes së mistikëve si metoda të të afuarit ndaj Zotit dhe këto edhe më së shumti tërheqin vëmendjen e studiuesve, pra etapat dhe gjendjet psikologjike që mistiku duhet t'i tejkaloj gjatë ngritjes së tij në udhëtimin shpirtëror të njohjes së Zotit, pra deri në atë kulmoren kur mistiku duke e vetëmuar ekzistencën e vet shkrihet, njësohet në ekzistencën e pambarrim të Zotit.

Por të gjitha këto do të shtrohen qartë në librin që me një përktim të mirë na e ofroi Metin Izeu i cili edhe vetë është njohës i kësaj materie.

Autori i këtij libri në hyrje bën një përshkrim të bukur se ç'është feja, i cili ndër të tjera thotë se "Feja është nevojë natyrore. Njerëzit të cilët nuk e plotësojnë këtë nevojë kërkojnë rrugë dhe ideale tjera për të kënaqur voten". Dhe pasi i përshkruan si të gabuara ato rrugë shkruan se "Qëllimi i fesë është kultivimi i njeriut me vese të bukura. Kjo vlerë është e mundshme vetëm me perceptimin e vërtetë të nënshtrimit në Allahun xh. sh. Besimi dhe dëshira e shprehur në frazën "unë jam i nënshtruar, jamë vetëm robi Yt" duhet të marrë formën e *ibadetit* (adhurimit) në të gjitha veprat tona". Dhe hyrjen e përfundon me çështjen e Imanit-besimit në një Zot.

Librin e tij "Tesavvufi dhe Tarikatet" Selçuk Eraydın e shtron në katër pjesë: *Historia e Tesavvufit*, (fq. 23-140), *Terminologjia e Tesavvufit*, (fq. 141-196), *Vahdet-i Vuxhudi (Njëlshmëria e Ekzistencës)*, (fq. 197-290) dhe *Tarikatet dhe rrymat sufike të përhapura në Anadollin dhe Horasan*, (fq. 291-413)

Kështu autori fillimisht shkruan se themelet kryesore të Tesavvufit islam janë sendërtuar nën segmentin e Kur'anit dhe Sunnetit. Ndërsa paraqitjen e Tesavvufit si një lëmi të posaçme e sheh si rezultat pas humbjes së intenzitetit në jetësimin e principeve parimore islame, si dhe pas dobësimit të botëkuptimit të Zuhdit (devotshmërisë, asketizmit). Autori i sjell definicionet e tesavvufit nga të cilët shihet se tesavvufi është prezentuar si nënshtrim në vullnetin absolut të Allahut xh. sh. dhe thekson se, nënshtrimi i plotë në Allahun xh. sh. mund të sendërtohet vetëm nëpërmjet të "sejri-sulukut" (rrugës shpirtërore). Për të arritur pjekurinë shpirtërore personi duhet t'u përmbahet disa principeve themelore dhe në vazhdim i shpjegon dhjetë principe të tilla, duke e përmbledhur se: principi themelor i tesavvufit është largimi prej gjërave që mundësojnë kënaqësinë e nefsit dhe dhënia në vlerat e jetës shpirtërore.

Pasi që shpjegon shkaqet dhe nevojën e paraqitjes së misticizmit në fetë dhe filozofinë tjera, autori shpjegon gjenezën e fjalës Tesavvuf. Kurse, Tesavvufin e përshkruan si një disiplinë e cila sqaron formën dhe mënyrën e pastrimit shpirtëror, ngritjes morale, ndritjes së brendshme dhe të jashtme me që-

llim që të
lumturia e p
Autori
tesavvufit e s
dhe këtë e il
ibadeter e M
tesavvufit m
dhe shkruan s
paraqitur në l
epokës së pa
dim kemi të d
e parë dhe sh
zuhdin, gjegjë
Në kreun
tesavvufit lexo
sohet si mjet i
mit. Baze e fes
Autori sh
njohjen e vetv
ngrit njeriun p
e krijesit. Në i
hut xh.sh. para
gjegjësisht shpi
vizjet trupore të
një gjendje të k
realitet ibadeti
trupore, por në
plotë në të vërtet
Tesavvufi k
pastrimit të zem
mësojnë që poth
tesavvufit (sohbeti
Zotit, halveti-vetr
dispozitat e Kur'a
cipe sipas trajtës d
se sipas frymës d
re. Ndërsa si rrug
autori thotë se janë
ja (muhasebe), frik
etj. si makamë shp
jojnë: drejtësia, sim
(udhëtari shpirtëro
Allahut, bëhet gn
ngritet në gradën të l
Eja në rrugë
është cilësi e besim
e kanë treguar peji
këtë gjë e kanë bërë
jetarët dhe murshid
kaq, siç dihet, tesavi
të spikatur dhe salik
sur në atë rrugë dhe

llim që të përfitohet pajtimi i Allahut dhe lumturia e përhershme.

Autori si fuzë të parë të paraqitjes së tesavvufit e shtronë atë të zuhdit (asketizmit) dhe këtë e ilustron me jetën modeste dhe me ibadetet e Muahmedit a.s. dhe si burim të tesavvufit numron Kur'anin dhe Sunnetin dhe shkruan se tesavufi për herë të parë është paraqitur në Basra, dhe se të gjithë sufijtë e epokës së parë kanë qenë asketë. Në vazhdim kemi të dhëna të mjaftueshme për sufijtë e parë dhe shpjegime si e kanë përjetuar ata zuhdin, gjegjësisht misticizmin islam.

Në kreun ku flitet për karakteristikat e tesavvufit lexojmë se ibadeti në islam vlerësohet si njëri i cili njeriun e afron afër qëllimit. Bazë e fesë është edukata shpirtërore.

Autori shkruan se jeta fetare fillon me njohjen e vetvetes. Në këtë mënyrë ajo e ngrit njeriun prej njohjes së vetes në njohjen e krijesit. Në fund duke iu nënshtruar Allahut xh.sh. paraqitet një proces psikologjik gjegjësisht shpirtëror i qetësisë së plotë. Lëvizjet trupore të cilat neve na mundësojnë një gjendje të këtyllë në qojmë ibadet. Në realitet ibadeti nuk është në këto lëvizje trupore, por në përkushtimin me shkrirje të plotë në të vërtetën.

Tesavufi kujdesin primar ia kushton pastrimit të zemrës së sufiut. Prandaj, kështu mësojmë që pothuaj se të gjitha principet e tesavvufit (sohbeti-biseda, dhikri-përkujtimi i Zotit, halveti-votmja) në brendi i përbijne dispozitat e Kur'anit dhe Sunnetit. Këto principe sipas trajtës dhe vendit janë trupore kurse sipas frymës dhe materies janë shpirtërore. Ndërsa si rrugë për t'iu afruar Allahut, autori thotë se janë: pendimi (tevbe) llogaritja (muhasabe), frika (havy), shpresa (rexha) etj. si makame shpirtërore të cilësive që vijojnë: drejtësia, sinqeriteti, durimi etj. Saliku (udhëtar shpirtëror) me këto cilësi i afrohet Allahut, bëhet gnostik dhe në këtë mënyrë ngritet në grada të larta.

Ecja në rrugë që çojnë drejt Allahut është cilësi e besimtarit të vërtetë. Këtë rrugë e kanë treguar pejgamberët, ndërsa më vonë këtë gjë e kanë bërë trashëgimtarët e tyre dijetarët dhe murshidët (udhërrëfyesit). Ndërkaq, siç dihet, tesavufi preferon udhërrëfyes të spikatur dhe saliku duhet të jetë i vendosur në atë rrugë dhe i dëgjueshëm. Ndërsa

siç thekson autori i këtij libri: Kontrolli i nefsit nga ana e fesë dhe shëndërimi i fesë në ndërgjegje të un-it është e mundshme vetëm nëpërmjet të *halit* (pozitës së lartë shpirtërore). Prandaj, thotë se, tesavufi nuk është shkencë e fjalës por e veprës. Shija dhe dashuria ndjehet në përfundimin e rrugës shpirtërore (sejri-suluk).

Natyrisht që rruga që shpie te Zoti është një. Por, siç thekson autori, prezentimi i rrugëve të ndryshme nga ana e dijetarëve të ndryshëm është për shkak të llojllojshmërisë së karakterit dhe kapaciteteve njerëzore. Kjo tregon se qëllimi i tarikateve është një. Në realitet të gjitha tarikatet pranojnë braktisjen e çdo gjëje vetëm për të përfituar pëlqimin e Allahut xh.sh. Mirëpo ky pëlqim varësisht nga koha, vendi, personi dhe pozita mund të jetë i ndryshëm.

Tarikatet fillojnë të krijohen si vëllazëri besimtarësh që nga shekulli XI-XII dhe emërtohen sipas amrit të themeluesve të tyre. Tarikatet, rol të veçantë kanë luajtur në përhapjen e islamit në trojet e reja, sidomos gjatë periudhës së hershme të Perandorisë Osmane, pra kanë luajtur rol të rëndësishëm edhe në sferën shoqërore, politike dhe ekonomike të shteteve të ndryshme dhe, siç thotë autori, janë orvatur që të gjithë njerëzit t'i bashkojnë në rrugën e Kur'anit.

Duhet të theksojmë se S. Eraydin, mjaft qartë e trajton çështjen e velisë (i afër, mik i Zotit) dhe të velajetit (afërsi, miqësi me Zotin) dhe çështjen e irshadit (udhëzimit) dhe të murshidit (udhëzuesit në rrugë të drejtë) koncepte shumë relevante në botëkuptimin e misticizmit islam. Dhe ndikimi i udhëtimit varet prej dashurisë, ngritjes dhe përkushtimit të udhëzuesit (murshidit). Ndërsa princip i tesavvufit është që shejhi (murshidi) të njoh Kur'anin dhe Sunnetin, të ketë cilësi të mira, moral të pastër dhe të jetë i larguar prej lakmive dhe pozitave të kësaj bote. Sufijtë rëndësi të posaçme i kanë kushtuar pastrimit shpirtëror, largimit prej kryelartësisë, dyfytësisë etj., furnizimit me sinqeritet, drejtësi, dashuri ndaj Zotit dhe Pejgamberit. Shejhët e tarikateve këto principe i kërkojnë prej të gjithë muridëve të vet.

Gjithashtu, për lexuesit e këtij libri joshës është kreu ku flitet për dhikrin (përkujtimi i Allahut) që e ushtrojnë si ceremoni të

gjithë tarikatet. Këtu mësojmë se sejr-i sultani (udhëtimi shpirtëror) i sufut sendërohet vetëm nëpërmjet dhikrit. Qëllimi i jetës së njeriut është arritja e përsosshmërisë dhe vështrimi i bukurisë hyjnore. Kjo përsosshmëri arrihet vetëm me ndihmën e dhikrit. Njerëzit që bëjnë dhikër dalëngadalë i braktisin kënaqësitë e kësaj bote dhe në zemër vendosin dashurinë në Allahun xh.sh. Njeriu i cili e përkujton Allahun xh.sh. me qetësi shpirtërore në fund arrin gradën e ihsanit (bërja e ibadetit sikur e sheh Allahun) dhe afërsinë me krijuesin.

Në vazhdim autori i shtjellon llojet e dhikrit, si ai i hapur dhe i fshehtë, dhikri me gojë dhe me zemër, dobite e dhikrit, bisedat shpirtërore, lidhjet (kontaktet) shpirtërore, halveti (vetmia, izolimi), semaja duke i shpjeguar kushtet si bëhen këto dhe pse bëhen.

Pjesa e dytë e këtij libri është shumë e rëndësishme për ata që duan të kuptojnë tesavvufin, përkatësisht për ata që duan të kuptojnë praktikën e tarikateve, ngase në të autori shpjegon terminologjinë e tesavufit. E siç dihet, tesavvufi u kushton rëndësi të posaçme disiplinave të brendshme për arritjen e përsosshmërisë shpirtërore. Prandaj, autori thekson se konceptet e tesavufit duhen të vlerësohen si mjete të përsosjes shpirtërore. Këto koncepte gjegjësisht terme mund të përmbledhen në tri grupe:

Makamet (gradat shpirtërore)

Ahval (halet) (gjendjet shpirtërore)

Tedhavvuk (kënaqësitë shpirtërore)

dhe pastaj autori i shpjegon një nga një këto koncepte -terme me nënndarjet e tyre, si makami (grada shpirtërore), (tebbe) pendimi, murakebe (vetëkontrolli), muhasebe (llogaritja e vetvetes), sidki (drejtësia), ihlasi (sinqeriteti), sabri (durimi), tevekkul (mbështetje në Allahun), shukr (falënderim Allahut), vera' (frikë dhe respekt i plotë në Zotin), zuhd (asketizëm, devotshmëri e tepërt), rida-ja (kënaqësia), fakr (skamje kuptimore, largim i zemrës prej pasurisë së kësaj bote), hal (gjendje shpirtërore), hajbet (frika maksimale), dhe uns (shprehja kuptimore), gajbet (humbja) dhe hudur (prezenca), xhem (bashkimi) dhe fark (ndajfe), vexhd (ekstazë), fena (shkriçje, zhyçje) dhe beka (qëndrim, përhershmëri), texhel-li (dukuri, reflektim)

dhevç (shije, pasion shpirtëror), ashk (dashuri hyjnore).

Koncepte dhe terme të rëndësishme të tesavufit shpjegohen edhe në pjesën e tretë të këtij libri ku autori flet për *vahdeti vaxhudin* (njëshmëria e qenësisë - ekzistencës). Dhe para se të futet në shtjellimin e kësaj qëstjeje shumë të ndjeshme, pra të botëkuptimit të njëshmërisë së ekzistencës, autori thekson se duhet të kihet parasysh se *vahdet-i vaxhudi* është disiplinë shpirtërore. Dhe se çdokush mund të diskutojë dukurinë hyjnore dhe format e saja mirëpo kënaqësinë e dashurisë e ndien vetëm i dashuruari i vërtetë.

Autori flet gjërë lidhur me *vahdet-i vaxhudin* dhe duke e rezimuar e përfundon këtë temë se sipas sufijve qenësia është një. Ajo është vetëm qenësia dhe qenia e Allahut xh.sh. Kjo qenësi emërtohet edhe si qenësi absolute dhe qenësi e pastër. Qenësia absolute nuk ka formë, trajtë, kufi, copëzim, mangësi por gjurmët e Tijja paraqiten në trajta të ndryshme në mendjen dhe shqisat tona. Gjithësia është një prej këtyre trajtave. Qenësia e pastër nuk dnyshon kurrë, kurse trajtat e këtilla pësojnë ndryshime. Qenësia absolute është e përhershme ndërsa trajtat janë kalimtare dhe të përkohshme.

Autori pastaj bënë dallimet e qarta të botëkuptimit të *vahdet-i vaxhudit* nga panteizmi duke iu kundërvënë filozofëve të ndryshëm dhe konstaton se "*Vahdet-i Vaxhudi* është disiplinë e përcjellur nga ana e Pejgamberit a.s. drejtpërdrejt prej burimit real gjegjësisht është prodhim i shpalljes. Ndërsa *panteizmi* bazohet në arsyen dhe njohuritë e përfituara prej dukurive natyrore". Pastaj shton se "*Vahdet-i Vaxhudi* nuk është disiplinë që njerëzit e mësojnë prej njëri tjetrit. Ajo është dija e cila formohet në to pas shkriçjes në Allahun (fena fil-lah) xh.sh. Ndërsa panteizmi është disiplinë e ngritur prej spekulimeve filozofike".

Të dhëna të dobishme autori na sjell edhe në kreun: "Sufijtë më me ndikim në histori" ku analizon veprimtarinë dhe krijimtarinë e sufijve shumë të njohur të cilët ndikuan në krijimtarinë poetike të misticizmit islam, si janë: Hallaxhi Mensur, Imam Gazaliu, Ibnu'l Arabiu, Imam Rabbani.

Gjithashtu, Selçuk Eraydin përkrauan rolin shoqëror të tarikateve duke numëruar të

gjitha tarikatet dhe në Hokatin Jesovetij si dhe si: Xhemal si: Melamij, Xpërkrauar këtyre tarikatit me të d e tyre dhe se tyre.

Roli d tërimin islam ka kontribuar njerëzor. Nd voçmas në p më e artiste kim të tesav tës. Dhe ky vvufti dhe Ta botëkuptimin mirë mund të rike dhe shpi libër mjaft n tesavufit dhe ve ngase auto lluar në detaj saj discipline.

Jashar Re: RENDET DI NË SANKHA Pejë, 1999, fq.

"Indocti periti"⁹

Kjo vepër gjyqit i ka 235 dhe përmbajtje si edhe ilustrim Vepra është cilës i parap

⁹ Ata që nuk dinë, le të gjejnë mult. poet dhe fil

gjitha tarikatat e përhapur në shtetin osman dhe në Horasan, dhe në veçanti flet për tarikatin Jesevit, Mevlevij, Nakshibendij, Halvetij si dhe për shumë degë të këtij tarikati, si: Xhemalij, Shabanij, Xherrahij, Bajramij, Melamij, Xhelvetij, Kadirij, Rifajij etj. duke përshkruar rregullat dhe karakteristikat e këtyre tarikateve, mënyrën e kryerjes së dhikrit me të dhëna të bollshme për themeluesit e tyre dhe shtrirjen gjeografike të përhapjes së tyre.

Roli dhe rëndësia e tesavufit për qytëtimin islam në tërësi është i çmueshëm dhe ka kontribuar në zhvillimin e mendimit etik njerëzor. Ndërsa rëndësia e tij në artin islam, veçmas në poezi është shumë e madhe. Shumë e artistë dhe poetë islam ishin nën ndikim të tesavufit dhe të përceptimit të tij botës. Dhe ky libër i Selçuk Eraydinij "Tesavufi dhe Tarikatat" kujtoj se e shtron mirë botëkuptimin e misticizmit islam, ku njaft mirë mund të njihet esenca shoqëro-historike dhe shpirtërore e tesavufit. Pra me këtë libër njaft mirë mund të njihet koncepti i tesavufit dhe rruga e vepërimit të së tarikateve ngase autori kërkon të duket e ka shpjeguar në detaje dhe me njohuri të larta të kësaj discipline.

Dr. Abdullah Hamiti

Jashar Rexhepagiqi, **DERVISHËT, RENDET DHE TEQET NË KOSOVË, NË SANXHAK E NË RAJONET TJERA**, Pejë, 1999, fq. 282.

"*Indocti discant et ament meminisse periti*"⁹

Kjo vepër e Akad. Dr. Jashar Rexhepagiqit i ka 235 faqe tekst, 13 faqe bibliografi dhe përmbajtje të lëndës, në tërësi 252 faqe si edhe ilustrimet.

Vepra është e ndarë në dhjetë kapituj së cilës i paraprinë hyrja fq.

⁹ Ata që nuk dinë le të mësojnë, ndërsa ata që dinë, le të gjejnë kënaqësi që të përkujtohen. Henault, poet dhe historian francez.

Në kapitullin e parë, fq. 15-23, autori flet për shtrirjen, rëndësinë dhe praktikën e tarikateve në këtë pjesë të Ballkanit i cili me shprehje ka qenë nën administrimin Osman (Kosovë, Sanxhak, Maqedoni, Shqipëri.)

Në kapitullin e dytë, fq. 25-79, autori flet për përcaktimet terminologjike dhe limitet e problemit, me akcent të posaçëm për thirrjet, rëndësinë, rolin e tarikateve si dhe themeluesit e tyre. Ndër tarikatat vën në pah: Bektashit, helvetit, kaderijt, sa'adijt, melamijt dhe nakshibendijt.

Në kapitullin e tretë, fq. 81-85, Dr. J. Rexhepagiq ven në pah metodologjinë dhe burimet mbi të cilat mësohet studimin e këtij problemi, problem tejet kompleks për të hulumtuar këtë temë të rëndësive të dervishëve, njaft specifike, posaçërisht të vepërimit të tyre, si bie fjala të bektashijve e të mevlive, të filozofisë mistike të Xhelaluddin Rumiut etj.

Akademik Jashar Rexhepagiqi këtij problemi i qaset në mënyrë empirike-analitike, duke ngritë problemin në rrafshin teorik, materie e vënë në diakroni dhe sinkroni; të paraqitjes së këtyre rëndësive në hapësirën e këtij nënqitulli ballkanik: Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, Vojvodinë, Kosovë, Sanxhak, Bosnje dhe Shqipëri.

Studimi përfshinë teqet, tyrbet (zavije) ribatitë, hanikahet; studion zanafilën e çdo tarikati, duke përfshirë aty dymbëdhjetë tarikatat kryesore dhe disa nëndegë të tyre.

Për të hulumtuar dhe studjuar tërë këtë materie, autori është dashur të konsultojë burime të mirëfillta të kulturës islame si edhe të gjuhëve në të cilat është krijuar dhe zhvilluar e tërë kjo kulturë. Autori për të ndriçuar një tematikë dhe materie aq komplekse vëzhgon, hulumton në terren duke mbledhur dokumentacionin e duhur, duke bërë verifikimin e tij për të arritur rezultate teorike, në ndriçimin e këtij problemi sa më objektivist. Për këtë është dashur qasje multidisiplinore shkencore. Autori ka përdor metodën induktive vëzhguese, të punëve dhe vepërimit të teqeve, të ritualeve të disa rëndësive, të shebëve si të rifaive, sadivo etj.

Për të arritur rezultate sa më të sakta, përveç metodës induktive vëzhguese ka zbatuar edhe metodën historike-shkencore, hulumtuese, teoriko-deduktive, analitiko-teo-

rike si edhe në komparative, gjë që është mjaft e shpeshatë në shqyrtimin e këtyre fenomeneve.

Metoda e ankerimit: bisedat dhe intervistat, qoftë për zhvillimin e këtyre institucioneve ose shuarjen e tyre në kohë dhe hapësirë, i mundëson autorit të bëjë krahasime, të rezonojë, të teoretizojë, të bëjë analiza, të nxjerrë sinteza dhe më në fund të përmbyllë me sukses këtë studim monografik. Autori gjatë punës së tij ka shfrytëzuar botime, dorëshkrime si edhe biseda gojore.

Meqë në botën orientale ekzistojnë shumë shkrime si edhe monografi të ndryshme, të cilat ruhen nëpër biblioteka të teqeve, si në Maqedoni, Kosovë dhe gjetiu, si edhe bisedat që autori ka bërë drejtpërdrejt, me institucionet ose individët e autorizuar-shehët, ka arritur të mbledhë informata me rëndësi të madhe kulturore-shkencore, fetare e filozofiko-historike dhe me vlerë letraro-gjuhësore.

Akademik J. Rexhepagiqi, përveç shtrirjes së këtyre rendeve në vendet ballkanike, flet lidhur me prejardhjen e rendeve (tarikateve) Babai, Bajramij, Bekiashi, Helveri, Kaderi, Melanij, Sasani dhe Zejni, të cilët kanë vepruar edhe në Turqi ku janë të njohur si interpretues të lirë të Kur'anit. Autori hedh dritë, gjithashtu, mbi njohjen e disa figurave të imamëve shiite, prej të cilëve më i rëndësishmi, për njohjen e gnosisë islame, është sufiu i Bagdadit Hal-laxhi, i njohur sipas deklaratës së tij "Ene-l-hakku" - (Unë jam e vërteta) dhe me mësimin e tij për njeriun universal, një sintagmë dominante në doktrinën sifiste. Njeriu universal, model i jetës shpirtërore "çka do të thotë të jeshë njeri"

Theks i veçantë është vënë tek veprimtaria e dervishëve në Shqipëri, ndikimi i tyre në Maqedoni - Tetovë, mandej në Kosovë - Gjakovë, etj., si edhe disa autoriteteve bektashiane në Frushër - Shqipëri dhe më në fund bëhet fjalë edhe për veprimtarinë e Babu Rexhepit në SHBA, Detroit.

Në këtë libër autori ndriçon edhe veprimtarinë e Bashkësisë Islame të rendeve të dervishëve të H. Aliut në Kosovë, të kryetarit të kësaj bashkësie Xh Shehut, me seli në Prizren, flet për statutin, detyrat dhe programin e tyre.

Në kapitullin e katërt, fq. 87-103, autori flet për shkaqet e shtrirjes së dervishëve,

ndikimin e tyre në Pushtetin Osman, paraqitjen e teqeve të para në Ballkan, ardhjen e tyre nga Anadoli, ndikimin e fesë islame dhe literaturës sufiste.

Kapitulli i pestë, fq. 105-111, bën fjalë për statutet e Meshihatit lidhur me teqet në Kosovë, Sanxhak.

Kapitulli i gjashtë, fq. 113-153, afron të dhëna për studimet e dëritashme, problemet dhe rezultatet që janë arritur në këtë fushë.

Në kapitullin e shtatë, fq. 155-218, flet për objektet, teqet në Kosovë, Preshevë, Bujanoc, Mal të Zi etj.

Kapitulli i tetë, fq. 219-234, i kushtohet teqeve dhe tyrbeve në Kosovë, regjistrimit të tyre si pasuri kulturore dhe mbrojtjes së tyre si përmendore me karakter historik.

Në kapitullin e nëntë, fq. 235-264, vëhen në pah anët pozitive, rezultatet si edhe mendimet e të tjerëve për dervishët: Trashëgimia pozitive dhe karakteri i dervishëve në lëmin e teologjisë, kulturës, shkrimit, filozofisë, sociologjisë, etikës, psikologjisë e posaçërisht në zhvillimin e letërsisë shqiptare. Këtu dallohen disa personalitete si Haxhi Ymer Lutfi Paqarizi, Sheh Maliqi (Mala) etj.

Në fund autori nxjerr përfundime dhe jep literaturën selektive.

Nga e tërë kjo që u tha deri tash, mund të përfundohet se autori J. Rexhepagiqi, me akribi shkencore, me njohuri të thellë të problematikës, terminologjisë së posaçme dhe semantizimit të saj, në planin diakronik dhe sinkronik; me një vështrim kritik objektiv, me metoda induktive, deduktive, si edhe me analiza të hollësishme ka arritur që të ndriçojë këtë lëmi komplekse dhe të pastudjuar sa duhet në qarqet tona shkencore ballkanike.

Vepra e Dr. Jashar Rexhepagiqit, *Dervishët, rendet dhe teqet në Kosovë, në Sanxhak e në rajonet tjera*, si një studim kompleks dhe me qasje serioze shkencore, është shkruar në mënyrë shumë koncize. Këtu studjohet, për herë të parë, gjërësisht dhe thellësisht, në trojet tona veprimtaria e rrymave të ndryshme sufiste. Kjo vepër është një bazë solide për të njohur një botë të tërë islame, sidomos rrymën shiite.

Prof. dr. Gjyltekin Shehu

Për p
(Islami dhe
botuar në B
rëndësishme
prezentim d
pa u vënë re
ideologjike
agresionit d
vinë, dhe e t
disa vlerave
bashkëkohore
një vështrim
tori është ori
se në atë fush
rem në Jugosl
Jugosllavi), se
të kundërta sa
tërësi bën fjal
Bosnjë e Herce
Libri Isl
një përmbledh
të hotuara ndër
janë: "Kultura
Bosnjë"? "Sa
e gjuhës sërbe
Islami, fqinjëve
Bosnjë e Herce
liter"? "Sërba
XX": Përse po
Islami në Ballk
të Ivo Andričić
man"; "Vaku d
"Rilindja politik
dërthënie e ne
mbledhura në lib
agresionit mbi B
sisht deri te mbu
Dejtonit, kështu
mësin e angazhim
talisti. Titulli i
kursesi i rastësis
titull - i cili në v
nga përmbajtja e l
niu e polarizimit
hore, kulminacion
rekomandojnë di
vlerën ideologjike

Darko Tanasković, *ISLAM I MI*, (Islami dhe ne), Partenon, Beograd, 2000, fq. 194.

Për prezentimin e librit, *Islam i mi* (*Islami dhe ne*) të autorit Darko Tanasković, botuar në Beograd, ka disa arsye shumë të rëndësishme të cilat na shtynë të bëjmë këtë prezentim dhe do të ishte gabim të mbelen pa u vënë re, apo të injorohen përpjekjet e tij ideologjike për justifikimin "shkencor" të agresionit dhe krimeve në Bosnjë e Hercegovinë, dhe e tërë kjo në kuadër të zhbërjes së disa vlerave themelore qytetëruese të botës bashkëkohore. Ndër shkaqet të cilat kërkojnë një vështrim të këtij libri është fakti, se autori është orientalist, gjegjësisht islamolog, se në atë fushë gëzon famë si autoritet suprem në Jugosllavi (për shumicë edhe në ish-Jugosllavi), se pikërisht si i tillë afirmon ide të kundërta sa s'ihuhet dhe se libri i tij në tërësi bën fjalë për ndodhitë tragjike në Bosnjë e Hercegovinë.

Libri *Islami dhe ne*, në të vërtetë është një përmbledhje tekstesh të D.Tanaskovićit, të botuara ndërmjet viteve 1991-1995. Këto janë: "Kultura islame apo muslimane në Bosnjë"?; "Sërbët e ligjit turk" apo "Turqit e gjuhës sërbe"?; "A janë Sërbët kundër Islamit, fqinjëve dhe Bosnjës"?; "Xhihadi në Bosnjë e Hercegovinë – imagjinatë apo realitet"?; "Sërbët dhe Islami nga fund i shek. XX"; "Përse po kamuflohet radikalizimi i Islamit në Ballkan"?; "Përceptimi i veprave të Ivo Andriçit në mesin jugosllav musliman"; "Vuku dhe Turqit"; "Fesi i kaltër"; "Rilindja politike e bashnjakizmit"; "Kundërthëniet e neobashnjakizmit". Tekstet e mbledhura në libër kanë lindur mu në prag të agresionit mbi Bosnjën e Hercegovinën afërsisht deri te mbarimi i tij me marrëveshjen e Dejtonit, kështu që mund të ndiqet vazhdimësia e angazhimit ideologjik të këtij orientalisti. Titulli i librit është simptomatik e kurrsesi i rastësishëm. Me fjalë të tjera, ky titull – i cili në mënyrë konsekuente rrjedh nga përmbajtja e librit – paraqet kulminacionin e polarizimit negativ të botës bashkëkohore, kulminacion ky, të cilin me decaenie e rekomandojnë disa orientalistë në botë, vlerën ideologjike të të cilit, tërësisht të kon-

taminuar e zberthën "rryma" e përfaqësuar me Edward Said-in.

Titulli *Islami dhe ne* në fakt shpreh, kinse një ballafaqim të ashpër, papajtueshmëri të "dy sistemeve me vlerë", apo dy rrethohe civilizuete, përkundër qëllimrësisë sintaksore të lidhëzës "dhe". Tanaskovići botën e klasifikoi në dy tabore: në njërin anë është Islami, e në anën tjetër jemi "ne" – pra, të gjithë ata që nuk janë pjesëtarë të Islamit. Funkcionaliteti konfrontues i përemrit "ne" këtu përmban edhe atë që në mesin e tij mbledhet solidariteti reciprok, i zhvilluar deri në fanatizëm fisnor dhe ekskluzivitet, gjë që shpreh një lloj të veçantë të intimitetit (ideologjik) të subjekteve, të përfshira në atë përemër, e poashtu paraqet një platformë për një pozicionim të tërësishtëm, kryesisht afektiv përballë dhe kundër asaj që është jashtë taborit të atij përemri – në rastin tonë kundër Islamit. Me fjalë të tjera, jashtë përemrit të taborit të autorit qëndrojnë Të tjerët, qëndron ai tjetri, i cili është karakteristik për diskursin orientalistik, i cili përcaktohet si trozik vdekjeprurës i fanatizmit fisnor, egoizmit ideologjik dhe përjashtueshmërisë së të përqendruarve në përemrin "ne".

Ky titull, pra, shpreh qartë gjoja gjendjen e pseudo-polarizimit dhe konfrontimit kulturor-civilizues, njëkohësisht shpreh qëndrimin e autorit, i cili e rradhit veten në mbrojtje të përemrit të zgjedhur, kështu që në instancë të fundit, ky titull anon në mënyrë perfide kah realizimi i qëllimit të tij prioritar, e ai është ta angazhojë lexuesin në anën e autorit dhe subjekteve të përemrit të tij. Duke analizuar lidhjen e titullit me përmbajtjen e librit, hetohet edhe diçka indikative. Me fjalë të tjera, titulli është plotësisht i përgjithësuar, i vendosur në nivelin planetar, ndërsa përmbajtja e librit – siç shihet edhe nga vetë titujt e teksteve – i përket ekskluzivisht "luftës" në B e H, gjegjësisht gjithë asaj çka autori sheh në atë luftë si "komponentë islame". Kuptohet, harmonizimi i këtyre i titullit me përmbajtjen e librit nuk është i rastësishëm, porse me të shprehet vetë thelbi i librit.

Konfrontimin në B e H Tanaskovićit e vështron si një paradigmë dhe avangardë, njëkohësisht, përlëshje ndërcivilizuese me përmasa planetare. Ideja themelore e librit të

tij përfshihet në atë se për "përlshje" në B e H fajtor i vetëm është Islami i cili kinse është radikalizuar deri në atë masë sa që u bë e domosdoshme të intervenohet në mënyrë radikale kundër tij, përkatësisht kundër muslimanëve.

Kështu, autori thekson se "tezat" për muslimanët boshnjakë të sekularizuar janë një kurth: ata janë xhihaditë; komponenta islame e luftës është më e rëndësishmja për ta kuptuar drejt situatën në tërësi (krahaso fq. 64). Nga ky pozicion, autori i diskualifikon ashpër të gjithë ata që mendojnë ndryshe. Për shembull, qëndrimet e filozofit francez, Bernard Henri Levy-it i quan "qëndrime perverse të qytetëruara", për arsye se ka rekomanduar që muslimanëve të atëhershëm në B e H t'u jepet e drejta e armatimit për vetëmbrojtje (fq. 103); Vepra e Roy Gutmanit *Dëshmitari i gjenocidit* dhe shpërblimi i Pulitzerit, të cilin e fitoi më (1993) për të është "një nga elementet ekskluzive të mashtrimit të mediumit lidhur me luftën në Bosnjë e Hercegovinë. Fjala është për theksimin e shenjtërisë së gjithmbarshme dhe paqëdashësisë së muslimanëve boshnjako-hercegovinas dhe Sllovenëve, muslimanëve sllovenë" (fq. 87), dhe përfundon se vepra e Gutmanit është "një falsifikat i shëmtuar dhe tepër i dëmshëm" (fq. 87). Angazhimi i Noel Malcolmit është "një koktel i jokompetencës profesionale, paragjykimesh ideologjike dhe arrogancës së paturp" (fq. 89).

Çdo personalitet i shquar në botë, i cili u angazhua haptas kundër agresionit në B e H, në të njëjtën mënyrë u diskualifikua në librin e Tanaskoviçit: ashpër dhe guximshëm, emocionalisht, por pa argumente. Në fakt, porositja e librit të Tanaskoviçit është ta justifikojë "luftën" në B e H, por duke qenë se Perëndimi nuk i ofroi agresionit sërë një përkrahje unanime, autori e ndjen veten "shkencërisht" i obliguar ta kritikojë atë pjesë të botës perëndimore, faktorët politikë (para së gjithash SHBA), të cilët nuk i ofruan përkrahje këtij agresioni dhe t'u a dëftojë rrënjët dhe përmasat e "devijimit" të tyre. Pasi "konstaton" se në B e H "fjala është për përfshirjen e elementit musliman, e bashkë me këtë edhe atë islam në konflikt politik dhe luftarak, gjë që qysh nga fillimi i jepte një dimenzion të veçantë, të thelluar, brenda-

politik, jashtëpolitik si dhe qytetëruës" (fq. 61), Tanaskoviç mbetet gojëhapur se si "rendi i ri botëror" nuk ka mirëkuptim për agresionin në B e H (fq. 103) dhe "se me këmbëngulje mohohet haptas dimenzioni islamist i ndikimit musliman politik dhe i luftës së armatosur - xhihadiste në Bosnjë e Hercegovinë" (fq. 102). Në këtë kontekst ai do të theksojë një "largpamësi" dhe "misionarizëm qytetëruës" të atyre të cilët në B e H, sipas këtij autori, kanë luftuar kundër Islamit dhe në pajtim me qëllimet të cilat i rekomandon Tanaskoviçit:

"Nëse Perëndimi edhe ishte i mashtruar, dhe nuk ia doli ta hetojë kanosjen fundamentaliste në B e H, Sërbët, e sa i përket kësaj edhe Kroatët, nuk u mashtruan dot. Ata ishin plotësisht të vetëdijshëm për aktivitetin radikal islam të përshkruar më sipër, i cili ishte i pranishëm shumë më përpara shturjes së shoqërisë jugosllave" (fq. 89). Duket sheshit se autori konsideron që tërë ajo çka u është bërë muslimanëve në B e H paraqet mbrojtje heroike, strategjike dhe vizionare të vlerave qytetëruese, të cilat i kultivon përmiri i tij "ne"(mi). Në pajtim me këtë, krimet në B e H gradohen në vepra të heroizmit, jo vetëm që nuk guxohet të qortohen, por është e domosdoshme të afirmohen për shkak të hetimit të "rrezikut" "në kohën e duhur" nga muslimanët dhe veprimt e fikas ndaj kësaj: nga kjo rrjedh se ushtarët e Milosheviqit në B e H e "obligojnë" botën pa masë.

Mbi të gjitha, Tanaskoviç në mbledhjen e njohur ku morën pjesë intelektualët sërë, në Holiday Inn-in e Sarajevës, në vigjilje të agresionit ka mbajtur një fjalim të cilin e boton edhe në këtë libër, ku midis tjerash tekstualisht thotë: "*Sërberit... janë dhe doemos duhet të jenë kundër Islamit*" (fq. 57). Punimet dhe stili i islamologut islamofob dhe ambasadorit të Milosheviqit në Republikën e Turqisë (i cili u dëbua nga atje dhe i cili kësulave të kaltra turke në B e H ua dedikoi një artikull të tërë me titull inkativ *Fest i kalter*) janë të njohura mirë. Kjo përmbledhje tekstesh dallohet nga të mëparshmet me pamfletizëm të theksuar, mungesë argumentesh, gjegjësisht me atë, se tekstet janë plot emocione. Kjo edhe është e natyrmë, ngase lindnin në kohën kur "kalorësi"

e autorit i cionet, me mentim ra nevojshtëm "Pasqë", "me kë sërbe për ngjyrë të e prezentohe rekomandu zjarreve të bërtë", pasu në fusha të plotësisht i

EL-DIJA, r... numër specij 32 + 4, D U H

Ky prez... ratet e Bashk... male nuk do... para opinionit... rëpo, pasi që k... dur është një... thotë mendja... tanë. Aq më p... Orientale, e cil... minin e dhe ku... me Ballkanin -... Revista El... drejtorja e vakf... lluar të botohet... revistë tremujor... Në numrin 57... (Rebiu-l-ahir -... numër special i... përjetoi populli s... në periudhën ma... Kryeredakt... Abdull-llah Bin... dhe bashkpuntorë... t'ia kushtojë popu... të revistës duke... shqipe. Besoj se... hotuar edhe në gju

e autorit i kishin të rëndësishme vetëm emocionet, me të cilat tekstet ushqeheshin: argumentim racional nuk kishte, e as që ishte i nevojshëm.

"Pasqyra islame", shkruan Tanasković, "me këmbëngulje e shtrembëron figurën serbe për arsye se është e turbulluar me ngjyrë të gjelbër" (fq.84). Me këtë libër ai prezantohet, vërtet dhe mjerisht, si një ndër rekomanduesit më të ftohtë që me anë të zjarreve të shkatërrohen "sipërfaqet e gjelbërta", pasuria kulturore-civilizuese, e arritur në fusha të ndryshme dhe si një protagonist, plotësisht i humbur i qytetërimit.

Dr. Esad Duraković

Shqipëroi: Jahja Hondoz

EL-DIJA, revistë mujore arabe, nr. 57, numër special (qershor-korrik) 1999, pp. 32 + 4, D U B A J

Ky prezentim i revistës arabe nga Emiratet e Bashkuara Arabe, në rrethana normale nuk do të kishte kuptim të paraqitet para opinionit shqiptarë me kaq vonesë. Mirëpo, pasi që ky numër i revistës së përmendur është një botim i jashtzakonshëm, më thotë mendja se duhet prezentuar lexuesve tanë. Aq më parë në revistën tonë Studime Orientale, e cila në konceptin e vet ka afirmimin e dhe kultivimin e lidhjeve të orientit me Ballkanin – konkretisht me shqiptarët.

Revista El-Dija (Shkëlqimi) që e boton drejtorja e vakfeve Islame në Dubaj, ka filluar të botohet prej vitit 1879, në fillim si revistë tremujore, kurse tani e përmuajshme. Në numrin 57 Qershor – korrik, 1999 (Rebiu-l-ahir – xhumadi-l-ula, 1420) është numër special i cili i kushtohet katrahurës që përjetoi populli shqiptarë i Kosovës, sidomos në periudhën mars-qershor '99.

Kryeredaktori i revistës zotëri Isa Bin Abdull-llah Bin Mani Al-Hamiri, me stafin dhe bashkpuntorët e tij vendosi që këtë herë t'ia kushtojë popullit të Kosovës 32 faqe + 4, të revistës duke bërë një botim në gjuhën shqipe. Besoj se i njëjti material do të jetë botuar edhe në gjuhën arabe.

Edhe sikur të mos kishte të shkruar asnjë fjalë, kjo revistë, vetëm me ilustrimet që ka zgjedhë redaksia, prej faqes së parë e deri te e fundit, i mjafton secilit lexues, i cili ka sadopak ndjenja humane, të kuptojë peripetite e këtij populli.

Në ballinë qëndron Kosova plagë e thellë njerëzore. Këtë plagë më së miri e shpreh syri i mjeshtrit fotografit, i cili me mjeshtrinë e tij – me portretin e një nane shqiptare nga Kosova me me ata dy pika lot ndër faqe e me shikim e saj të tretur kush e di se ku, diku larg, ku do t'i kenë mbetur bijt e saj nën thundrat e policisë barbare apo paramilitarëve serb. Në faqen e brendshme pasojnë dy duar të pafuqishme, të rrudhura nga mosha e shtyrë, drejtuar të Gjithfuqishmit, Zotit Xh.sh. për ndihmë që ta shpëtojë këtë popul nga ajo dhunë e paparë... ndërsa në fund, një i mitur, i cili axherr kryet për një dëre të bërë copë e grimë nga plumbat e armikut sheku-llor, që me një shikim plot shpresë ndjell ardhmërinë, thua se i përgjigjet krimeve bresimin e plotë se "Botën do ta trashëgojnë robërit e mi të mirë..." Anbija.

Tërë atë që e shprehin ilustrimet në foto, portuaj e ka ka përfshi edhe kryeredaktori në fjalën e tij shpresëdhënëse e kuptimplote, i cili për Ditëlindjen e Pejgamberit Muhammed a.s. vazhdon "... u përputh me rastin e çlirimit të Kosovës prej kthetrave serbe, në mënyrë që të bashkohen përkujtimet dhe mjerimet drejt ndërtimit të atdheut të çliruar dhe të deklarojmë para botës se Kosova e ka paguar çmimin e lirisë shumë shtrenjt, duke i vjelur frytet e durimit e të qëndrimit" f.1.

Ai duke uruar heronjt e Kosovës për suksesin në beteja i porositi " Shoqërojeni zhvillimin e vendit duke u kapur fuqishëm për fenë tuaj dhe motivin e lartë të saj" f.1.

Përbrenda katyre faqeve pasojnë informacione të ndryshme të ilustruara: Delegacioni i revistës El-Dija viziton refugjatët në kampin e kuksit, fq.4-8; Intervista me Dr. Rexhep Bojën kryetar i Meshihatit Islam të Kosovës, fq. 9-11. Në vazhdim, për gjendjen e mjerueshme që po përjeton populli i Kosovës, kanë dhënë mendimet e tyre autoritete të larta të botës arabe dhe islame: Isa Bin Abdull-llah Bin Al-Hamiri, Shejh Jasir Halil Kebisi, Dr. Halif Muhammed Siri, Shejh

Kritika dhe recensionet

Abdu Hasan Habib, Shejh Muhammed Ahmed Mahmud Mustafa, Ahmad Al-Assam (f.12 - 17). Të gjithë i dhan përkrahje dhe bënë thirrje opinionit që të gjejnë mënyrën dhe format për ta ndihmuar këtë popull, i cili vë është nënshiruar këtyre vuajtjeve so "... se kërkuan një shtet Islam..." por për shkak se "... ata janë musliman dhe i përkasin fesë islame" thotë dr. Halif Muhammed. (Kështu pat thënë edhe presidenti i SHBA, Bill Klinton...).

Në fq. 18-19, pason informata e ilustruar Refugjatët Kosovar kthehen, me urimin Zoti ju çliroft dhe i mposhtë armiqt tuaj, armiqt e njerëzisë!

Në vazhdim është intervista me dr. Xhevdet Lizën - Universiteti i Prishtinës (20-21), kurse në fq. 22-25, pason Aspekte kulturore e edukative në Krizën e Kosovës - nga dr. Mustaf Rexhepi, i cili i referohet edhe revistës "El-Ma'arife" në të cilën janë dhënë shenime të plota për krizën që përjetoi populli shqiptarë i Kosovës nën thundrën e push-tuesit të beogradit prej vitit 1989 e këndej.

El-DIJA ka zhvilluar një bisodë me daktoreshën Zade Begu (f. 26-27), e cila rri-fen për ndjekjen e tyre nga Kosova për në Shqipëri dhe përshkruan arritjen në Kukës. Ajo ka shprehur respekt e mirënjohje kur thotë "Sigurinë e humbur e gjetëm vetëm në kampet e Emirateve..."

Në përmbyllje të revistës vijoje raportet e gazetarëve që kanë zhvilluar me refugjatë nga Kosova, dhe përfundon me rrëfimin e një nëne, së cilës i lindi vajza Fatimja - kjo trashëgoi emrin e bëmirëses nga Emir-etet e Bashkuara Arabe.

Dr. Feti Mehdiu

Akade
datën 20.0
këtij institu
1919, këtu
i kanë kor
orientale.

Me kë
profesorë të
Anëtar
Prof. d
1974 e deri
parë i Kur'a
i haditheve
orientale.

Prof.dr.
Fakultetin e
"Bejtu-l-hikr
Prof.dr
Filologjisë m
në Fakultetin
i veprës "100

Zy
Sektori i
M.Maklellejn
në Kosovë.

Një ekip
Kombëtare d
kryesuar nga
Kosovës dhe
prej 28 gusht
dhe në Prizren

Gjatë kë
dorëshkrime o
të institucione
nga këto treva
edhe pa u dës
hulumtues kan

Kronikë

Profesorë të Universitetit të Prishtinës anëtarë të Akademisë Arabe të Shkencave

Akademia Arabe e shkencave në Damask, në Kuvendin e vet të mbajtur me datën 20.01. 2002 kishte në rend dite pranimin e anëtarëve të ri. Sipas traditës së këtij institucioni më të lartë dhe më të vjetër shkencorë, është themeluar në vitin 1919, këtu pranohen anëtarë korespondent autoritete shkencore nga tërë bota të cilët i kanë kontribuar dijes – veçanrisht nga fusha e arabistikës dhe e studimeve orientale.

Me këtë rast, në mesin e 36 anëtarëve të ri nga tërë bota, janë pranuar edhe tre profesorë të Universitetit të Prishtinës.

Anëtarët e sapopranuar janë:

Prof. dr. Fetii Mehdiu, prof. i gjuhës arabe në Fakultetin e Filologjisë prej vitit 1974 e deri sot, është autor i dy teksteve për mësimin e gjuhës arabe dhe përkthyes i parë i Kur'anit komplet në gjuhën shqipe, përkthyes i katër vëllimeve nga koleksioni i haditheve Sahuhu-l-Buhari dhe një varg kontributesh tjera nga lëmi i studimeve orientale.

Prof.dr. Muhamed M. Arnauti, ish profesor i gjuhës arabe në praktikë, në Fakultetin e Filologjisë, prej vitit 1975-1986, i cili tani është drejtor i Institutit "Bejtu-l-hikme" pranë Universitetit Alu-l-Bejt në Jordani.

Prof.dr. Esad Duraković, ish profesor i letërsisë arabe në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë prej vitit 1975 – 1988, i cili tani është prof. i letërsisë arabe në Fakultetin Filozofik, në Universitetin e Sarajevës, studjues i njohur dhe përkthyes i veprës "1001 natë", "As-habu-l-mual-lakat" në gjuhën boshnjake, etj.

Zyra Amerikane ndihmon hulumtimet e dorëshkrimeve orientale

Spektori i kulturës pranë Zyrës Amerikane në Prishtinë, të cilin e udhëheq zotëri M.Makllefajn, ka ndihmuar gjatë vitit 2002 hulumtimin e dorëshkrimeve orientale në Kosovë.

Një ekip ekspertësh për studime orientale, në organizim të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës – sektori i dorëshkrimeve orientale, i kryesuar nga zotëri Nehat Krasniqi, në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Degën e Orientalistikës dhe Shoqatën e Orientalistëve të Kosovës, prej 28 gusht deri më 20 shtator 2002 ka kryer hulumtime, pjesërisht, në Gjakovë dhe në Prizren.

Gjatë këtyre hulumtimeve janë vjelë të dhëna për rreth 700(shtatëqind) dorëshkrime orientale (arabe, turke dhe persiane) që janë në pronësi të bibliotekave të institucioneve islame si : teqe dhe xhami, ose janë në familjet e ulemave të shquar nga këto treva. Në mesin e dorëshkrimeve që kanë shpëtuar pa u shkatërruar, por jo edhe pa u dëmtuar, ka të atilla që janë shkruar në shekullin 14. Në këtë ekip hulumtues kanë punuar, përveç Nehat Krasniqit, përgjegjës i sektorit pranë BKU të

Kosovës, edhe Dr Bahtije Gërbeshi, Dr. Feti Mehdiu, Dr. Abdullah Hamiti dhe Mr. Qemajl Morina.

U mbajt Kongresi i Orientalistëve në Aman

Prej 22-24 tetor 2002 në kryeqytetin e Jordanisë, Amman, zhvilloi punimet Kongresi i Orientalistëve në temën Dialogu kulturorë. Me thirrje të nikoqirit – si mysafir në këtë Kongres mori pjesë dr. Abdullah Hamiti, shef i Degës së orientalistikës në Fakultetin e Filologjisë pranë Universitetit të Prishtinës, udhëtimin e të cilit e sponsorizoi Shoqata humanitare palestineze në Prishtinë (HSAC) dhe (IIRO) me simotrat e tyre.

Ky Kongres është organizuar në Jordani me rastin e shpalljes së Ammanit kryeqytet i kulturës arabe për vitin 2002. Me këtë rast doc. Dr. A. Hamiti pati një serë takimesh me studjues dhe studentë të universitetit Alu-l-Bejt, me ç' rast këmbyen informacione me interes për opinionin arab dhe shqiptarë. Të pranishmit shfaqën interesim për të arriturat shkencore nga fusha e studimeve orientale në Kosovë dhe rrethanat e përgjithshme në Kosovën e pasluftës. Dr. A. Hamiti u përgjegi në shumë pyetje të interesuarëve.

Ndërroi jetë prof.dr. Muhammed Hamidullahu

Me 17 dhjetor 2002, në moshën 96 vjeçare, në Florida (SHBA) ndërroi jetë dijetari i njohur islam Muhammed Hamidullah. Hamidullahu u lind në Hajderabad dhe fillimisht studjoi shkencat juridike në Hajderabad, kurse doktoratën e parë e mbrojti në Pariz në temën *Korespondenca luftarake e Pejgamberit të All-llahut*, kurse doktoratën tjetër në temën *E drejta shtetërore të muslimanët* e mbrojti në Bon, në vitin 1935. Ishte njohës i thelluar në çështjet islame dhe studjues i Kur'anit dhe i përkthimeve të Kur'anit në gjuhë të botës. Ka hulumtuar edhe përkthimet e Kur'ani kerimit në gjuhën shqipe.

M.Hamidullahu ka mbajt ligjëratat në një varg Univerzitetesh të botës: Köln, Gotingen, Ankara, Stamboll, Erzurum, Rijad, Sarajevë etj. Lexuesit shqiptarë e njohin përmes veprës Hyrje në Islam, ndërkaq vepra e tij kapitale për jetën e Pejgamberit : *Muhammedi a.s., jeta dhe vepra*, e cila është përkthyer qysh para dhjet vjetësh, në dy vëllime, ende ka mbet në dorëshkrim. Këtë përkthim e ka iniciuar shtëpia botuese "Logos-a" nga Shkupi dhe e ka përkthyer nga origjinali – frengjisht-verzionin e plotësuar nga M. Hamidullahu, prof. dr. Ruzhdi Ushaku, profesor i gjuhës frenge në Universitetin e Prishtinës.

Hamidullahu është autor i përkthimeve të Kur'ani kerimit në tri gjuhë të ndryshme botërore: në gjuhën frenge, gjermane dhe angleze.

unimet
rit - si
gës së
pëtimin
dhe
nmanit
ati një
ç' rast
nshmit
tale në
amiti u

roi jetë
erabad
parë e
llahut,
ë Bon,
it dhe i
Kur'ani

Koin,
parë e
jetën e
ra dhjet
nicipuar
ngjisht-
fesori i

juhë të

Tabela 1
Alfabeti i gjuhës arabe me transkriptim

	1	2	3	4	5
1	ا	ā	a,e	ā,a,i,u	1
2	ب	b	b	b	2
3	ت	t	t	t	400
4	ث	th	th	t	500
5	خ	xh	xh	ğ	3
6	ه	h	h	h	8
7	ح	h	h	h	600
8	د	d	d	d	4
9	ذ	dh	dh	d	700
10	ر	r	r	r	200
11	ز	z	z	z	7
12	س	s	s	s	60
13	ش	sh	sh	š	300
14	ص	s	s	š	90
15	ذ	d	d	d	800
16	ط	t	t	t	9
17	ظ	z	z	z	900
18	ع	a	a	a	70
19	غ	g	g	ğ	1000
20	ف	f	f	f	80
21	ك	k	k	q	100
22	ك	k	k	k	20
23	ل	l	l	l	30
24	م	m	m	m	40
25	ن	n	n	n	50
26	و	v	v	w	6
27	ه	h	h	h	5
28	ي	j	j	y	10

Legjenda për tabelën 1:

1. grafia arabe
2. transkriptimi shkencorë (në gj. Shqipe).
3. transkriptimi praktik.
4. transkriptimi (në gj. Evropiane) sipas ZDMG.
5. vlera numerike e shkronjave arabe.

THIRRJE PËR BASHKPUNIM

Të çmuar dhe të nderuar bashkëpunorë të revistës Studime Orientale!
Vazhdon revista Studime Oriental dhe tani keni në duar numrin 2.. Siç e shihni, këtu botohen punime nga fusha e studimeve orientale-ballkanike me gjatësi rreth një tabak autori.

Punimet janë të mbështetura në burime të dorës parë, të dëshmuara me aparaturën shkencore, me fusnota në fund të faqes, dhe me rezime deri në një faqe. Mundësisht rezimetë i dërgoni në gjuhën angleze, ose vetëm shqip, dhe redaksia do t'i përkthejë në anglisht.

Lusim bashkëpunorët të na dërgojnë adresën e sakt me nr telefoni dhe postë elektronike për konsultime të nevojshme e komunikim ekspeditiv. I njoftojmë bashkëpunorët se revista jonë burimet orientale do të zbatojë transkriptimin e paraqitur në tabelën nr. 1, që po e japim në faqen. i lusim autorët e punimeve që punimet e tyre të na i dërgojnë me postë elektronike, ose në disketë.

Materijalet për numrin vijues i presim deri me 30 gusht 2003

Propozimet e sugjerimet i mirëpresim me kënaqësi.

Ju falënderojmë për bashkpunim.

Angazhimi Juaj – ardhmëri e revistës!

Falënderojmë fondacionin *Kur'ni për ndihmën simbolike për përgatitjen teknike të këtij numri.*

Drejtimi: Dr. Feti Mehdiu (SHORK), F. Filologjisë-Orientalistika,
Prishtinë, Kosova. E-mail: fetimehdiu@hotmail.com. Ose tel: 227-970 dhe Mr. Isa Memishi, 221-971

Përkrahjen financiare për Revistën e pranojmë në conto nr. 10461812 Micro Enterprise Bank – Prishtinë, për revistën *Studime Orientale*.

Shoqata e orientalistëve të Kosovë

Studime orientale

2

Lektor:
Shaha Haliti

Rezimetë në gjuhën angleze i përktheu
Mr. Shefije Hasani

Korrektor:
Autorët e punimeve

Kopertina:
Bashkim Mehani



